



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

**VEÇORI STRUKTUREORE DHE SEMANTIKE TË
LEKSIKUT DHE FRAZELOGJISË NË VEPRËN E
MITRUSH KUTELIT**

Punoi

MA. Liri SEITLLARI

Udhëheqës shkencor

Prof. Dr. Ali JASHARI

TIRANË, 2014



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

DISERTACION

Përgatitur nga: Liri SEITLLARI
Për marrjen e gradës shkencore: “DOKTOR”

Fusha: Filologji bashkëkohore

VEÇORI STRUKTUREORE DHE SEMANTIKE TË
LEKSIKUT DHE FRAZELOGJISË NË VEPRËN E
MITRUSH KUTELIT

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ali JASHARI

Mbrohet në dt. __. __. 2014 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ Kryetar
2. _____ Anëtar
3. _____ Anëtar (oponent)
4. _____ Anëtar (oponent)
5. _____ Anëtar

TIRANË, 2014

Tabela e përmbajtjes

Fjalë mirënjohjeje	5
PËRMBLEDHJE	6
ABSTRACT	7
PARATHËNIE	8
I.HYRJE	10
Metodologjia e studimit	13
Struktura e punimit	14
KREU I	18
MITRUSH KUTELI DHE VENDI I TIJ NË LETËRSINË SHQIPE	18
KREU II	24
LEKSIKU I VEPRËS SË MITRUSH KUTELIT	24
2. 1. Tipat leksiko-gramatikorë	27
2.1.1. Dialektalizmat emërorë	27
2.1.2. Dialektizmat mbiemërorë	40
2.1.3. Dialektalizmat foljorë	45
2.1.4. Dialektalizmat ndajfoljorë	48
2.2. Onomatopetë dhe fjalët onomatopeike	53
2.2.1. Onomatope që imitojnë tinguj, zëra, zhurma të shpendëve e kafshëve	56
2.2.2. Onomatope që shprehin tinguj, zëra, zhurmë, klithma e britma të njerëzve	56
2.2.3. Onomatope që shprehin zhurma të dukurive, sendeve, objekteve	57
2.2.4. Onomatopetë kontekstuale	58
2. 3. Fjalët me burim popullor sipas fushave konceptore	59
2.3.1. Dialektalizma nga fusha e etnografisë	59
2.3.2. Leksema që shënojnë lojëra popullore apo emërtime	67
2.3.3. Togfjalëshat popullorë	69
2.3.4. Urimet dhe mallkimet	71
2.3.5. Leksiku i botës fetare	78
2.3.6. Shtresa e fjalëve nga krijimtaria gojore popullore	81
2.4. Grupet paradigmatiche	88
2.4.1. Sinonimet	88
2.4.2. Antonimet	97

2.5. Dialektalizmat e huazuar	103
2.6. Leksiku i figurshëm dhe mjetet gjuhësore të krijimit të tij.....	107
2.6.1. Metafora	110
2.6.2. Krahasimi.....	114
2.6.3. Epiteti.....	117
2.7. Një përjasje e leksikut të veprës së Mitrush Kutelit me leksikun letrar dhe pasqyrimi i tij ndër fjalorë të shqipes.....	120
KREU III	128
FRAZELOGJIA POPULLORE NË VEPRËN E KUTELIT.....	128
3. 1. Karakteristika të lidhjeve brendësore të njësive frazeologjike....	131
3.1.1. Bjerja e gjymtyrëve të njësive frazeologjike	132
3.1.2. Përsëritja e gjymtyrës së njësisë frazeologjike brenda një konteksti	134
3.1.3. Variantet leksikore sinonimike në frazeologji	135
3.1.4. Rrethi i lidhjeve leksiko-sintaksore të njësive frazeologjike .	138
3.2. Karakteristika të lidhjeve të jashtme të njësive frazeologjike	140
3.2.1. Shkrirja e njësive frazeologjike në sintagma	140
3.2.2. Lidhje të dy njësive frazeologjike brenda një konteksti	142
3.2.3. Lidhjet e njësive frazeologjike me kontekstin.....	149
3.2.4. Tekste të figurshme frazeologjike	152
3. 3. Fjalorthi frazeologjik i veprës i veprës së Mitrush Kutelit	156
IV. PËRFUNDIME	199
PROPOZIME.....	211
V. SHTOJCA.....	212
5.1. Fjalorth toponomastik i veprës së Mitrush Kutelit.....	212
5.2. Fjalorth onomastik i veprës së Mitrush Kutelit	216
Bibliografia e shfrytëzuar.....	222

Fjalë mirënjohjeje

Dua të shpreh mirënjohjen për udhëheqësin tim shkencor prof. dr. Ali Jasharin i cili ndihmoi në mënyrë të pakursyer me profesionalizmin e tij të lartë akademik.

Falënderoj departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Historisë e Filologjisë në Tiranë, për miratimin e kësaj teme doktoare., për ndihmën e pakursyer dhe dashamirësinë ndaj kërkesave tona.

Falënderim dhe mirënjohje e pakufishme dhe për familjen time, e cila më nxiti dhe më inkurajoi vazhdimisht, duke më krijuar gjithë hapësirat e duhura, për t'ja dalë mbanë kësaj detyre të vështirë.

Për të gjithë faleminderit!

PËRMBLEDHJE

Kuteli është dhe do të mbetet mjeshtër i madh i prozës shqiptare, sepse ai, si askush tjetër, mundi ta përdorë cilësisht gjuhën shqipe, gjë që duket në vëmendjen e lartë të tij për përzgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve gjuhësore. Vepra e tij dëshmon shkallën më madhe të ndjeshmërisë së tij prej shkrimtari ndaj gjuhës shqipe në përgjithësi e gjuhës së popullit në veçanti. Ky studim vendos në qendër të hulumtimit dhe analizës leksikun, si treguesin kryesor, që shpërfaq më qartë pasurinë gjuhësore të një vepre, si dhe origjinalitetin e saj. Do të trajtohet leksiku popullor në kuptimin e tij më të gjerë, si dhe funksionet që merr ai në prozën e tij. Autori shfrytëzon deri në fund materialin e begatë gjuhësor, me shtresime krahinore, historike, kulturore të zonës së Pogradecit, të cilin e ka shumë për zemër, por duket se kjo nuk i mjafton, prandaj i kapërcen kufijtë e tij, duke iu drejtuar shqipes në një shtrirje më të gjerë e më të thellë. Kështu, gjuha në prozën e tij, përveçse gjuhë krahinore, është dhe gjuhë kombëtare. Fondi leksikor që përdor Kuteli përbën bazën e gjuhës letrare shqipe, por në mënyrë të spikatur, gjithnjë në përputhje me nevojat artistike të veprës, përdoren edhe dialektalizmat, arkaizmat dhe fjalët e huaja, si: turqizmat, sllavizmat, greqizmat dhe neolatinizmat. Të gjitha përdoren gjithnjë me dorë të kujdesshme e në mënyrë funksionale, ndonëse nuk mungojnë rastet kur ato marrin ngarkesë të theksuar stilistike. Frazeologjizmat gjuhësorë dhe letrarë pasurojnë më tej shprehësinë e teksit kutelian. Autori sjell risi edhe në mënyrën e përdorimit të lidhjeve të brendshme e të jashtme të njësive frazeologjike, duke mbërritur deri te krijimi i njësive të reja. Fjalëkrijimet e tij, të krijuara duke përdorur të gjitha modelet fjalëformuese të shqipes, janë ndër më të bukurat dhe me interes, jo vetëm për gjuhën artistike, por edhe për atë letrare. Shumë prej tyre kanë hyrë tashmë në fjalorët e shqipes e shumë syresh presin të hyjnë. Vepra sjell pasurim të shqipes në të gjitha planet: kuptimor, emocionues, stilistikor dhe fjalëformues. Figurshmëria dhe mjetet të tjera të shprehësisë e afrojnë prozën e Kutelit me poezinë. Për këto e për shumëçka tjetër vepra e tij dëshmon forcën dhe begatinë e gjuhës shqipe, mundësitë që i ofron ajo njerëzve të penës për arritje të larta artistike. Studimi synon të nxjerrë në dritë të diellit pikërisht njohjen e thellë të autorit ndaj gjuhës, origjinalitetin në përdorimin e saj, si dhe marrëdhënien e tij të ndërsjellë me të.

***Fjalët çelës:** leksik popullor, dialektalizëm, krahinorizëm, leksik i figurshëm, fjalë të huazuara, njësi frazeologjike.*

ABSTRACT

Kuteli is and will remain the great master of Albanian prose, because he, like nobody else, could use Albanian language qualitatively, which is evident in his high attention to the selection and use of language. His work shows the greatest degree of sensitivity as a writer of Albanian language towards the general language and towards that of the common people, in particular. This study set in the center of research and analysis the lexicon, as the main indicator, which clearly reveals the linguistic richness of a work, as well as its originality. The popular lexicon will be treated in terms of its widest meaning, and the functions that it takes in his prose. The author uses at the highest degree possible the prosperous linguistic material, with regional, historical and cultural strata of the area of Pogradec, which it seems is not enough, therefore, he transcends his limits, turning to Albanian in a wider and deeper stretch. Thus, language in his prose, except being a regional language, is national language too. The lexical fund employed by Kuteli makes up the kernel of Albanian literary language, but prominently, in accordance with the artistic needs of his work, used regionalism, archaic words and foreign words like: Turkish vocabulary, Slavic, Greek and Neo-Latin words. All used increasingly cautiously, in a functional way, though there are also cases when they get stressed stylistic influences. Linguistic and literary phraseologisms further enrich the expressiveness of Kutelian text. The author brings innovation in the use of internal and external connections of phraseological units, reaching to the creation of new units. His new words created using the Albanian word-formation models are among the most beautiful and interesting, not only for the artistic language, but also for the literary one. Many of them have already entered the Albanian dictionaries and many of them are expected to enter. His work brings the enrichment of the language in all plans: semantic, emotional, stylistic and formative one. The use of plenty of figures of speech and other tools of expressiveness endears Kuteli's prose with poetry. For these and many others, his work shows the power and the prosperity of Albanian language, the opportunities it offers to the writers towards a high artistic achievement. The study aims to bring to light the deep knowledge of the language the author possesses, the originality in its use, and his mutual relationship with it.

Key words: *popular lexicon, regionalism, provinciality, figurative vocabulary, borrowed words, phraseological units.*

PARATHËNIE

Çdo shkrimtar i madh hyn në një marrëdhënie të caktuar me gjuhën e kombit të tij. Kjo marrëdhënie varet nga dy faktorë: së pari, sa dhe deri në ç'nivel e njeh ai gjuhën amtare dhe, së dyti, sa është i aftë ai për t'i përdorur në mënyrë përzgjedhëse dhe krijuese mjetet gjuhësore. Në konceptet e sotme për letërsinë udhëheq mendimi se vërtet kanë rëndësi temat, idetë, këndvështrimet e autorit për jetën, por ajo që i jep vulën origjinale një krijimi është, në fund të fundit, mënyra se si ato realizohen gjuhësisht. Kjo ka qenë shtypa e parë që na çoi te mendimi për të bërë objekt studimi leksikun në prozën e Kutelit. Gjithashtu, për ndërmarrjen e këtij studimi kemi pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ky autor i kushton formës, përpjekjes për të kaluar nga gjuha e përditshmërisë drejt një gjuhe me modalitet të lartë semantik dhe estetik, si dhe vlerësimet e larta të studiuesve të ndryshëm për përdorimin cilësor të gjuhës shqipe nga ana e këtij tij.

Përpara se të mendonim praktikisht për ta shkruar këtë studim, nisëm të grumbullonim materialet e nevojshme, të cilat do të ndihmonin në realizimin cilësor të tij. Kështu, puna filloi me mbledhjen e materialeve studimore të gjuhëtarëve të ndryshëm, të cilat kishin të bënin me studimin e gjuhës të veprave letrare të autorëve të ndryshëm. Mund të përmendim E. Çabejn, A. Dhrimon, E. Hysën për studimin e gjuhës së Buzukut; F. Agalliun për gjuhën e Nolit, Gj. Shkurtajn për gjuhën e Naimit, Kadaresë, Agollit; J. Kastratin për gjuhën e Mjedës, De Radës, Konicës; Sh. Rrokajn për gjuhën e Kadaresë, Sh. Islamajn për gjuhën e Xoxës, A. Haxhin për gjuhën e Fishtës etj. Natyrisht, në qendër të vëmendjes patëm dhe studimet për veprën e Kutelit, duke u fokusuar sidomos në ato që kishin të bënin me gjuhën e këtij shkrimtari. Përmes studimit të këtyre autorëve morëm impulse idesh dhe mendimesh në lidhje me realizimin e punimit tonë.

Por, mbi të gjitha, miniera e arit mbi të cilën e bazuam studimin ka qenë vetë vepra letrare e Kutelit, konkretisht gjithë proza e tij. Në punimin tonë kemi bërë objekt studimi leksikun e kësaj vepre, veçoritë semantike e strukturore të tij, duke u ndalur në klasifikimin e tij sipas tipave leksikogramatikorë, sipas fushave konceptore, sipas ndërtimit të sinonimisë dhe antonimisë, figurshmërisë, gjuhëkrijimit etj. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar begatisë frazeologjike të veprës. Në këtë linjë, punimi ynë ka si qëllim të nxjerrë në dritën e diellit pasurinë leksikore e frazeologjike të veprës së Kutelit, aftësinë e tij për të përzgjedhur mjetet gjuhësore, aftësitë

fjalëkrijuese, të cilat, jo vetëm i japin vulë origjinale krijimtarisë së tij, por e bëjnë autorin një ndër ndihmësit kryesorë në pasurimin e gjuhë letrare shqipe.

Pasi përcaktuam çështjet që do të trajtonim, e filluam punën me rileximin e veprës dhe skedimin e leksikut dialektor, etnonimeve, toponimeve, leksikut të figurshëm dhe të frazeologjizmave. Skedat e shumta (janë me qindra të tilla) i përpunuam duke i ndarë sipas kategorive të studimit. Përveç se e vështirë, kjo punë na dha kënaqësinë e familjarizimit me gjuhën e autorit dhe materialin e domosdoshëm mbi të cilin duhej të hulumtonim dhe të analizonim më tej. Skanimi i leksikut nëpërmjet skedimit ka qenë sipërmarrje e vështirë për vetë gjerësinë e veprës, por, nga ana tjetër, bollshmëria e tyre na ka ndihmuar për analizën, interpretimin dhe vlerësimin e tij në pikëpamje strukturore-semantike dhe estetike. Ai na ndihmoi gjithashtu në hetimin e disa dukurive gjuhësore karakteristike për Kutelin dhe në mbërritjen në disa përfundime të tëndësishme.

Vjelja e veprës na çoi dhe në hartimin e tre fjalorëve të rëndësishëm: fjalorit frazeologjik dhe fjalortheve onomastike dhe toponomastike, të cilat konfigurojnë në mënyrë më të plotë, më të qartë dhe më konkrete pasurinë e leksikut dhe frazeologjisë të veprës së Kutelit, dhe autencitetin e tij gjuhësor.

Studimi ynë është ndër të tjera edhe një homazh për vetë shkrimtarin Mitrush Kuteli dhe veprën e tij të pavdekshme.

I.HYRJE

Veprat letrare të shkrimtarëve cilësorë bëhen domosdoshmërisht objekt studimi nga gjuhëtarët për vetë vlerat që ato sjellin në këtë fushë. Ato dokumentojnë gjuhën e një epoke të caktuar, të një komuniteti gjuhësor të caktuar, prandaj janë të dobishme për të studiuar historinë e gjuhës, veçoritë fonetike, morfologjike, dhe sintaksore në raport me gjuhën letrare apo me atë të kohës kur janë shkruar. Në këtë drejtim janë kryer studime të plota, veçanërisht për shkrimtarët e vjetër të letërsisë shqipe.

Në një vështrim të përgjithshëm, studimet me karakter gjuhësor për veprat e shkrimtarëve shqiptarë janë të begatë, sidomos për autorët e vjetër, si Buzuku, Bogdani etj., si dhe për disa shkrimtarë klasikë, si Jeronim De Rada, Naimi Frashëri, Gjergj Fishta etj. Më rrallë janë bërë objekt studimi veprat letrare të autorëve bashkëkohorë. Gjithashtu, vërehet se në literaturën tonë shkencore gjuhësore janë të pakta monografitë, studimet dhe analizat e plota. Nga ana tjetër, ka mjaft studime të pjesshme, artikuj e kumtesa shkencore që kanë lidhje me anë të veçanta të përdorimit të gjuhës nga njerëzit e penës. Të gjitha këto kanë qenë dhe mbeten një ndihmesë shumë e madhe në lidhje me shtjellimin e problemeve të ndryshme të gjuhës, por edhe një ndihmë e drejtpërdrejtë dhe konkrete për mënyrën se si duhet të lexohen këto vepra, si dhe çfarë vlerash sjellin ato në rrafshin stilistiko-gjuhësor, çfarë ndihme japin ata në hijeshimin dhe pasurimin e gjuhës sonë letrare.

Pikëpamja e sotme mbizotëruese është se arti i të shkruarit, në fund të fundit, nuk është gjë tjetër veçse mënyrë e përdorimit të mjeteve gjuhësore në ligjërimin e shkruar, prandaj me më shumë interes do të ishin studimet gjuhësore në lidhje me përdorimin vetjak të gjuhës, me modelet e të shprehurit nga ana e shkrimtarëve, me stilet dhe prurjet e tyre gjuhësore. Në literaturën tonë shkencore janë më të shumta dhe më të plota studimet e veprave të shkrimtarëve në rrafshin letrar dhe më të pakta ato në rrafshin gjuhësor. Mendojmë se sot kërkimi shkencor gjuhësor duhet të përqëndrohet pikërisht këtu, duke pasur për objekt sidomos shkrimtarët e viteve tridhjetë dhe ata bashkëkohorë.

Me këtë anë, së pari, u përpoqëm të hulumtojmë studimet gjuhësore për autorë të ndryshëm:

Artan Haxhi, *Proza e Fishtës në pamje gjuhësore: sistemi foljor*, Camaj-Pipa, 2002; Aleksandër Xhuvani *Naimi si poet dhe prozator*, në "Literatura jonë", 3/4, 1945; Ali Dhrimo, *Bibliografi, Meshari i Gjon Buzukut*

– përmendorja e parë e plotë e gjuhës shqipe (430 vjet më parë), në gazetën “Bashkimi”, 5 janar 1985; Anton Nikë Berisha, *Mbi disa qenësi të poezisë së Vorea Ujkos*, Katanzaro, 1998; *Qenësia poetike e prozës së Martin Camajt*, Princi, 2010; Behar Gjoka, *gegnishtja – mallkimi dhe lavdia e Camajt*, 2010; Enver Hysa, *Buzuku dhe gjuha e tij*, Akademia e shkencave, Tiranë, 2005; Eqrem Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, Botime kritike, Tiranë, 1962-1968; *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, Prishtinë, Rilindja, 1977; *Vepra e Gjon Buzukut në vështrimin gjuhësor historik*, studime filologjike, Nr,1, 1979; *Epika e Gjergj Fishtës*, 1942; *Fan Noli ynë (botuar me rastin e vdekjes)*, Studime gjuhësore, nr.5, 1965; Emil Lafe, *Lidhëzat te “E mbsuame e Krështerë” e Lekë Matrangës dhe disa tipare të sistemit lidhëzor të shqipes së shek. XVI*, Studime filologjike 44/3, 1990; *Për neologjizmat e Faik Konicës*, Studime filologjike, 49/1-4, 1995 Fatmir Agalliu, *Monografi: Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Tiranë, 1999; Fran Luli, *Fjalor dhe shprehje të “Kanunit të Skanderbegut”*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2005; Gjovalin Shkurtaj, *Studime dhe vlerësime rreth gjuhës së Naim Frashërit; Tri studime për gjuhën e Fishtës: Antroponime dhe leksema të tjera të Malësisë së madhe në veprën e Fishtës “Lahuta e Malsisë”*; *Fryma e Pajtimit dhe mirëkuptimit në poemën “Lahuta e Malsisë”*; *Urtia dhe emrat e Malësisë në “Lahutën” e Fishtës; Disa tipare të ligjërimit poetik të Dritëro Agollit; Jehonë madhështore e gjuhës shqipe dhe e kombit shqiptar (Disa mendime dhe vlerësime rreth gjuhës së veprave të Ismail Kadaresë); Shqyrtime rreth prurjeve leksikore në veprat e Ismail Kadaresë; Njëpër labirintet e stilemave lasgushiane: fjalëformimi si vetjakësi e gjuhës së hijshme; Vështrim rreth ligjërimit poetik të Visar Zhitit; Shënime për gjuhën e romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qoses; Disa vlera gjuhësore të prozës së Bilal Xhaferrit; Vlera dhe prurje gjuhësore në ligjërimitin e Anton Pashkut; Rreth gjuhës dhe ligjërimit artistik të librave të Viron Konës; Fjala e bukur dhe prurjet e freskëta të një poeti (Rreth vëllimit të Sokol Zekës “Poeti e rren emocionin”); Malësia e Madhe dhe pasuria ligjërimore në veprat e Nikolla Spatharit; Vlerësime për prurjet leksikore dhe ligjërimitin e Nokë Sinishtajt; Shënime për ligjërimitin e vjershave të Ndoc Gjetjes; Njëpër labirintet e stilemave lasgushiane: fjalëformimi si vetjakësi e gjuhës së hijshme*, Tiranë, 2009; Gjovalin Shkurtaj, Tefik Çausi, *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tiranë, 2004; Idriz Metani, *Vështrim mbi gjuhën e figurshme të Xhevair Spahiut*, Studime filologjike, 3-4, 2006; *Sintagma metaforike në poezinë e Xhevair Spahiut*, Mehr licht! Nr. 25, 2005; Ina Arapi, *Tipat strukturore të mbiemrave në veprën “Çeta e profetëve” të Pjetër Bogdanit*, Studime filologjike, 44/1, 1990; Ibrahim Rrugova, *Figuracioni. Gjuha poetike e Bogdanit 1675-1875*, Rilindja, Prishtinë, 1982; Jup Kastrati, *Faik Konica, (jeta dhe veprat)*, Nju jork, 1995; *Kontribute për studimin e Ndre Mjedës*, Shkodër, 1958; *Ndre Mjeda, çështje gjuhësore*, Tiranë, 1967; *Ndre Mjeda, Vepra II*, Prishtinë, 1982; *Studime për De Radën*, Monografi, Prishtinë 2003; Haki Hysenaj, *Ernest Koliqi, në rrafshin gjuhësor*, Revista shkencore

“Filologji”, Nr.19, 2013; Kol Ashta, *Neologjizmat në shkrimet e Kostandin Kristoforidhit*, dorëshkrim në arkivin e Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë; Laura Smaçi, *Modele ndërtimore në prozën e shkurtër të Ernest Koliqit*, Tiranë, 2009; Mentor Qurku, *Studime për Mjedën 1866-1888*, Tiranë, 2005; Martin Camaj, *Shëndrimi e përpunimi i thanieve popullore në Lahutën e Malcis*, në: Shejzat, Romë, 1961; Miaser Dibra, *Përkime të këngëve popullore epike dhe Lahutës të Malcisë së Gjergj Fishtës*, Tiranë, 2007; Nonda Bulka, *Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit “Histori e Skënderbeut”*, BUSHT, seria SShSh, 1, 1957; Nobert Jokl, *Naim Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe*, në botimin përkujtimor “Naim Frashërit”: Vjershëtorit dhe edukatorit kombëtar, Graz, (Austria), 1925; Nysret Krasniqi, *Rrëfimi dhe shkrimi: Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës*, AIKD, 2003; Orjeta Baja, *Gjuha dhe stili në epikën e Fishtës*, Tiranë, 2009; *Elementet fonetike – burim shprehësie në kryeveprën e Fishtës*, Revista shkencore “Filologji”, Nr.19, 2013; Ruzhdi Ushaku, *Mbi motivet onomastike në poemthin “Scodra” të Ndre Mjedës*, Prishtinë, 2006; Shaban Demiraj, *Gjuha e Sami Frashërit*, BUSHT, SShSh, 3, 1957; Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, 2011; Shefkije Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000, *Gjergj Fishta – gjuha dhe stili*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012; Shpëtim Elezi, *Mjetet e formimit të shumësit të emrave në Çetën e Bogdanit*, Revista shkencore “Filologji”, nr. 19, Prishtinë, 2013; Shezai Rrokaj, *Gjurmime në veprën “Shkaba” të Ismail Kadaresë; Fjalësi me –shëm në veprën e Kadresë*, Albatros, 2007; Simon Pepa, *Veçori gjuhësore në veprën poetike të At Gjergj Fishtës*, Rilindja demokratike, Nr.926, 8 prill, 1995; Tefë M. Topalli, *Rreth veçorive të alfabetit të Pjetër Bogdanit*, Studime filologjike 44/1, 1990; Tomorr Osmani, Tefë M. Topalli, *Fjalë e shprehje me interes leksikor nga epika e Fishtës*, Buletin Shkencor: seria e skenave shoqërore, Nr.56, 2006; Tonin Çobani, *Fishtologji*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2006; Tonin Daija, *Fjala, tingulli, metrika në Lahutën e Malcis*, Botime Françeskane, Shkodër, 2004; Zenun Gjocaj, *Gjuha e Luigj Gurakuqit dhe konceptet e tij gjuhësore e stilistike*, Prishtinë, 2001; *Pikëpamje leksiko-frazeostilistike të poemave jasonetike të Mjedës*, Prishtinë, 2008 etj.

Përfundimi që mund të nxjerrim është se janë më të shumta studimet e pjesshme se sa studimet e plota, siç janë monografitë dhe gjithashtu, janë më të shumta studimet që kanë për objekt gjuhën dhe më të pakta studimet që kanë për objekt stilin e shkrimtarëve, veçoritë vetjake të përdorimit të gjuhës nga ana e tyre.

Të inkurajuar nga studimet e plota apo dytësore e të pjesshme të deritanishme të veprave letrare në aspektin gjuhësor, menduam të japim ndihmesën tonë me një studim të kësaj natyre për veprën letrare të Mitrush Kutelit. Tema e zgjedhur, e cila ka lidhje me veçoritë strukturore dhe semantike të leksikut dhe frazeologjisë në prozën e këtij autori, mendojmë se

ka interes për gjuhësinë dhe letërsinë shqipe dhe mund të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme.

Studimi ynë ka përfshirë serinë e plotë të veprës letrare të Mitrush Kutelit, botuar nga shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1990, në të cilën përfshihet krijimtaria e tij letrare që nga vitet tridhjetë e deri në fund të jetës së shkrimtarit.

Një nga parimet kryesore krijuese të Kutelit është kujdesi për formën, prandaj, natyrshëm, ai shfaq një kujdes të veçantë në përdorimin dhe përzgjedhjen e mjeteve gjuhësore. Leksiku, mrekullisht i pasur, është treguesi që shpërfaq në mënyrën më të qartë pasurinë gjuhësore të veprës së tij dhe që tregon se sa mirë ai e njeh gjuhën shqipe dhe potencialet e saj, gjë që i krijon dhe mundësinë për të krijuar pamjen e një shkrimtari tejet origjinal. Pikërisht, pasuria dhe larmia e shtresave leksikore, delikatesa në përzgjedhjen e fjalëve, begatia e fjalëkrijimeve dhe e mjeteve shprehëse stilistikore, e ka bërë të vështirë studimin e gjuhës së veprës së plotë të Kutelit, si një nga shkrimtarët më përfaqësues të toskërishtes letrare. Studimi i saj është një ndërmarrje e vështirë, por gjithsesi i domosdoshëm për t’u kryer.

Metodologjia e studimit

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur disa metoda. Së pari, ka qenë e domosdoshme të përdoret metoda e hulumtimit dhe e skedimit të leksikut popullor, në kuptimin më të gjerë të këtij termi. Me anë të saj kemi siguruar material të bollshëm, i cili ka shërbyer si bazë e sigurtë për ecuri të mëtejshme në trajtimin e çështjeve të ndryshme, si dhe në ndërtimin e fjalorit frazeologjik, e fjalorit toponomastik dhe atij onomastik. Por kjo nuk ka mjaftuar. Për studimin plotë të veprës së Kutelit na është dashur të kombinojmë metodën e hulumtimit me atë të analizës, të përshkrimit dhe të vlerësimit. Në ndonjë rast janë përdorur edhe të dhëna statistikore, kur ka qenë fjala për shkallëzimin e numrit të dialektalizmave emërorë, foljorë, mbiemërorë, ndajfoljorë, të numrit të frazeologjizmave të pranishëm në vepër, si dhe në lidhje me raportin e pasqyrimin të dialektalizmave dhe fjalëformimeve të Kutelit në fjalorët e gjuhës shqipe.

Megjithatë, metoda kryesore që përshkon punimin tonë është metoda analitike, e cila na ka ndihmuar që të paraqesim hap pas hapi tiparet e dialektalizmave, tiparet e tipave të tyre leksiko-gramatikore, veçoritë strukturore-semantike të paradigmës sinonimike dhe antonimike, të leksikut të figurshëm, të fjalëkrijimeve, të frazeologjisë etj. Kjo metodë na ka lejuar të vemë në dukje dukuritë më karakteristike gjuhësore, në lidhje me përdorimin e leksikut nga ana e Kutelit, aftësitë e tij të veçanta e stilformuese në përzgjedhjen e mjeteve gjuhësore, si edhe aftësitë e tij në krijimin e mjeteve të reja, gjë që pasuron ndjeshëm gjuhën shqipe.

Struktura e punimit

Studimi ynë është i ndarë në tre krerë: 1) Mitrush Kuteli dhe vendi i tij në letërsinë shqipe. 2) Leksiku popullor dhe përdorimi i tij; leksiku i figurshëm dhe mjetet gjuhësore për krijimin e tij si edhe një përjasje e leksikut të veprës së tij me leksikun letrar dhe pasqyrimin e tij në fjalorë të shqipes. 3) Veçoritë e lidhjeve të brendshme dhe të jashtme të frazeologjisë shqipe.

Në **kreun e parë** jepen momentet kryesore të jetës dhe veprës së Kutelit, vendi që zë ai në letërsinë shqipe, si dhe receptimi i veprës së tij nga studiues të ndryshëm. Në të është përshkruar rruga e formimit të tij të njëkohshëm si ekonomist dhe si shkrimtar, peripecitë e rrezikshme të jetës, pastërtia shpirtërore, atdhedashuria e lartë, përkushtimi vetmohues ndaj artit, përthimit, dhe ndaj të gjitha detyrave në përgjithësi.

Kreu vazhdon me receptimin e veprës së Kutelit, nga studiues të ndryshëm, si: N. Jorgaçi, A. Plasari, K. Trebeshina, K. M. Shala, S. Bashota etj., ku janë përzgjedhur vlerësime të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mjeshtërinë e lartë artistike e gjuhësore të autorit, me ndihmën e tij në krijimin e prozës moderne shqiptare, si dhe me ndihmën e tij në lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe.

Një vend të rëndësishëm këtu i kemi kushtuar edhe ndihmës së çmuar të gjuhëtarëve në studimin e gjuhës së veprave të shkrimtarëve në përgjithësi. Në shenjë mirënjohjeje për punën e tyre (e cila na ka shërbyer jo pak edhe në kryerjen e këtij studimi) kemi ndërtuar një bibliografi për të cilën nuk mund të pretendojmë të ketë natyrë shteruese.

Kreu i dytë është më i gjeri dhe më i ploti. Në të Kuteli është parë si magjistari i fjalës shqipe, si njohës i shkëlqyer jo vetëm i gjuhës së vendlindjes së tij, i gjuhës së trevës juglindore, por si njohës shumë i mirë i gjuhës shqipe në përgjithësi. Vepra e Kutelit është analizuar gjerësisht në aspektin leksikor nga ka dalë si tipar kryesor begatia leksikore, për të cilën studjuesit kanë shprehur prej kohësh admirimin e tyre; si dhe shtrirja e gjerë e tij, moskufizimi kohor e gjeografik. Në këtë kapitull është trajtuar fillimisht termi “leksik popullor”, i cili është në vetvete shumë më i gjerë, ku së pari na vijnë ndërmend dialektalizmat. Kuteli i jep një shtrirje të gjerë shtresës së fjalëve dialektore, duke hyrë kështu në shkrimtarët, që në mënyrë të ndërgjegjshme i drejtohen këtij leksiku, për shkak të natyrës së tij origjinale dhe mundësisë së tij për të shërbyer si burim real për pasurimin e gjuhës letrare.

Çdo shkrimtar, si në shumë mjete e mënyra të tjera, “*veç së përgjithshmes, ka diçka të vetën edhe në përdorimin e dialektalizmave, kjo shfaqet përmes sasisë së dialektalizmave që përdor, tipave gjuhësorë, llojit të ligjërit ku përdoren dhe gërshetimit të tyre, vlerave të reja që fitojnë në*

rrethanat e ndryshme ligjërimore, shpërndarjes në kontekste të ndryshme etj"¹. Në këtë këndvështrim është analizuar leksiku popullor i veprës së Kutelit, dhe është vënë re se në të janë të pranishëm të gjithë tipat leksikogramatikorë të dialektalizmave: emërorë, mbiemërorë, ndajfoljorë etj. Nga studimi tërësor i veprës së tij del se dialektalizmat emërorë përbëjnë grupin më të madh (rreth 600). Gjithashtu, kemi analizuar dhe përshkruar përmes shembujsh të larmishëm vlerën më së shumti shenjuese të dialektalizmave të tij, por pa harruar edhe përdorimin e tyre stilistik në përshkrimin e mjedisëve shoqërore lokale, në tipizimin apo individualizimin e personazheve sipas përkatësisë kulturore, arsimore, psikologjike, si dhe në ngjyrosjet gjuhësore historike.

Në analizën e lëndës gjuhësore kemi pasur si qëllim të zbulojmë veçoritë semantike e strukturore të leksikut popullor, për të cilën na kanë ndihmuar dhe studimet e bëra në literaturën shkencore gjuhësore për leksikun, dialektet, gjuhën letrare, ligjërimet, stilet funksionale etj. Gjithashtu, jemi përpjekur të shqyrtojmë arsyet artistike të shkrimtarit në përzgjedhjen dhe përdorimin e kësaj apo asaj fjale, apo të strukturimit të tyre të brendshëm në tekst. Siç thotë Jani Thomai "*Çdo tekst mund të shndërrohet në rrafshin e shprehjes gjuhësore pa prekur në thelb rrafshin e përmajtjes*"² dhe ky shndërrim në veprën e Kutelit realizohet më së shumti me anë të sinonimisë së pasur gjuhësore në të gjitha rrafshet: fjalët sinonimike, ndërtimet sinonimike, sinonimia frazeologjike etj. Në këtë pikë, karakteristikë lehtësisht e dallueshme në prozën e tij mbetet përdorimi dyshe i fjalëve. Sidoqoftë, disa herë shndërrimi i tekstit në veprën e Kutelit nuk mund të ketë interpretime semantike, sepse ai ka vlerë vetëm në rrafshin fonologjik, pra në krijimin e rrjedhave dhe lojërave tingullore. Në këto të fundit luajnë një rol të rëndësishëm edhe onomatopetë dhe fjalët e shumta onomatopeike të cilat gjallërojnë tekstin kutelian, duke bërë që gjithçka që shkruhet t'i përcillet lexuesit së pari, përmes shqisës së dëgjimit. Në vepër tingëllojnë tepër interesante një numër fjalëkrijimesh onomatopeike të autorit, të cilat flasin qartë për aktivitetin e tij krijues gjuhësor.

Në këtë studim, e kemi parë Kutelin si një ndër shkrimtarët kryesorë ndihmës në krijimin e gjuhës letrare shqipe. Përveç vlerës së shenjimit të fytyrës gjuhësore shqiptare të një epoke të caktuar, merita e tij qëndron së pari, në faktin se ai riqarkulloi dhe rijetësoi një numër të madh fjalësh të vjetra, të cilat për arsye të zhvillimeve të reja shoqërore-ekonomike rrezikonin harrimin dhe zhdukjen dhe së dyti, në fjalëkrijimet e shumta që sjell. Me këtë rast kemi analizuar dhe vlerësuar fjalët edhe në aspektin e fjalëformimit dhe kemi vënë re se aty nuk mungojnë përveç gjedheve të njohura të shqipes, edhe modelet vetjake të tij. Kuteli nuk sillet vetëm si shkrimtar, por edhe si gjuhëtar. Ai ndihmon ndjeshëm në pasurimin e shqipes letrare me fjalë të

1. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 135.

2. Jani Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 9.

krijuara më së shumti me anë të prejardhjes, kompozimit, por nuk mungojnë dhe fjalët e krijuara me anë të përngjitjes, paranyjzimit etj., disa prej të cilave na duken me vlerë më të veçantë, sidomos ato me karakter poetik, siç është rasti i disa mbiemrave. Kemi vënë re se shumica e fjalëkrijimeve kuteliane janë pasqyruar nëpër fjalorët tanë të shqipes dhe pjesa tjetër qëndron e gatshme për t'u futur në to, gjë që flet për marrëdhënien e ndërsjellë dhe bujare të tijën me gjuhën amtare.

Prozën e Kutelit e kemi trajtuar edhe në aspektin stilistik, pra jemi përpjekur të zbulojmë veçori të ndryshme të shprehësisë gjuhësore, si: përzgjedhjen e leksikut, ngjyrimin dhe ngarkesat stilistike, kundërvëniet stilistike në rrafshet të ndryshme etj. Në çdo rast jemi përpjekur të shqyrtojmë leksikun e figurshëm të veprës, të zbulojmë mjetet e veçanta gjuhësore, përftesat stilistike, figurat gjuhësore e letrare, ndërthurjen e tyre, të cilat formësojnë individualitetin e tij krijues; kemi analizuar veçoritë strukturore e semantike të sintagmave metaforike, llojet më tipike të krahasimeve dhe epiteteve, sepse i kemi vlerësuar si figurat më të shpeshta dhe që i japin tone poetike origjinale prozës së tij.

Në **kreun e tretë** kemi hulumtuar në lidhje me praninë dhe rolin e frazeologjisë në veprën e Kutelit. Duket qartë se autori i sheh njësitë frazeologjike si një mundësi të shkëlqyer për ta pasuruar dhe hijeshuar gjuhën e veprës së tij, për faktin se “*ato i përkasin gjuhës së gjallë dhe kanë më shumë ngarkesë e figurshmëri.*”³ Nga analiza jonë del se vepra e Kutelit përbën një sofër të begatë në këtë drejtim dhe se peshën më të madhe të frazeologjizimeve e zenë ato me karakter popullor. Një tipar i rëndësishëm i veprës është përdorimi jo vetëm i frazeologjisë krahinore, por edhe i atyre me karakter të gjerë kombëtar, e cila lidhet me prirjen e autorit drejt gjuhës kombëtare.

Në studimin tonë kemi synuar të zbulojmë veçoritë e lidhjeve të brendshme dhe të jashtme të frazeologjisë së përdorur në vepër. Përsa i përket lidhjeve të brendshme, në ligjërimin artistik të Kutelit është vënë re dukuria e bjerjes së strukturës së njësisë frazeologjike, e cila i shërben atij “*për të rritur ritmin e ligjërimin*”⁴; dukuria e përsëritjes së njëres gjymtyrë të njësisë frazeologjike në të njëjtën fjali apo në të njëjtin kontekst në funksion të synimit të autorit për ta transmetuar qartë dhe me forcë kumtin, si dhe për të rritur shprehësinë e tekstit etj.; ndryshueshmëria leksikore në njësitë frazeologjike, e cila shfaqet e shumëllojshme dhe që i jep mundësinë autorit të shumojë variantet e njësisë frazeologjike, të ngrejë ndërtime të reja letrare me shprehësi më të lartë mbi ato të mirënjohurat etj.

Frazeologjia kuteliane shfaq veçoritë e veta edhe në lidhjet e saj të jashtme. Kështu, kemi analizuar dukurinë e shkrirjes, e cila takohet shpesh te Kuteli, tipet e ndryshme të saj, ku struktura e re e lindur ka sjellë rritje të

3. Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë 2005, f. 129.

4. Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 11.

peshës kuptimore dhe emocionale në krahasim me rastet, kur ato janë përdorur veç e veç; kemi analizuar përdorimin e frazeologjizmave në lidhje dyshe, çiftet frazeologjike sinonimike dhe antonimike, vargjet frazeologjike me anë të të cilave autori energjizon dhe fuqizon vlerat kuptimore dhe stilistike të ligjërimit. Një tjetër dukuri e lidhjeve të jashtme frazeologjike, e pranishme në ligjërimitin kutelian, është edhe ajo e aktualizimit të njësive frazeologjike, e cila siç e përkufizon Ali Jashari është “*pranëvënia e fjalëve të tjera përpara, në mes ose pas gjymtyrëve të togfjalëshit frazeologjik, për t’u lidhur më ngushtë me situatën konkrete të ligjërimit, me idetë dhe ngjarjet, me personat e çështjen për të cilën shkruhet, me kohën a vendin për çka bëhet fjalë në kontekstin e dhënë*”⁵. Aktualizimi në veprën e Kutelit shfaqet në tërë larminë e vet, por ajo që është më e rëndësishme është se me anë të tij ai arrin të krijojë njësi frazeologjike cilësisht të reja edhe kuptimisht.

Kemi vërejtur se origjinaliteti i Kutelit nuk mungon edhe në krijimin modeleve të teksteve të figurshme, duke pasur në qendër njësitë frazeologjike dhe duke i plotësuar ato me mjete të tjera, siç janë aktualizuesit, identifikatorët semantikë, perifrimitet, përsëritjes së gjymtyrës vatër të njësive frazeologjike, me anë të lidhjeve të reja leksikore të vatrës semantike etj.

Gjatë shqyrtimit të veçorive të përdorimit të frazeologjisë në veprën e Kutelit jemi përpjekur të theksojmë ndihmesën e tij në pasurimin e saj me anë të krijimit të njësive të reja.

Te **përfundimet** kemi përmbledhur të dhëna në lidhje me veçoritë e leksikut të Mitrush Kutelit, në lidhje me shumëllojshmërinë e leksikut popullor, në lidhje me pasurinë dhe begatinë e leksikut të figurshëm, si dhe në lidhje me ndihmën e tij të çmuar në rigjallërimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe. Gjithashtu, janë dhënë disa nga karakteristikat më kryesore të cilat shfaqen në përdorimin e frazeologjisë popullore në veprën e këtij autori.

Më pas, si pjesë e rëndësishme e studimit mbi leksikun dhe frazeologjinë popullore jepen tre fjalorë: fjalorhi frazeologjik i veprës së Kutelit, fjalorhi onomastik dhe fjalorhi toponomastik. Në fund jepet bibliografia e shfrytëzuar dhe literature e vjelë për këtë studim.

5. Po aty, f. 117.

KREU I

MITRUSH KUTELI DHE VENDI I TIJ NË LETËRSINË SHQIPE

Mitrush Kuteli (pseudonimi i Dhimitër Paskos) është një nga penat më të fuqishme në letërsinë e viteve 30, i cili bashkë me krijues të tillë, si Gjergj Fishta, Lasgush Poradeci, Fan Noli, Ernest Koliqi, Faik Konica, Migjeni etj., krijuan letërsinë më cilësore dhe më të larmishme brenda krejt kësaj periudhe kohore. Me Kutelin ndodh si me gjithë shkrimtarët e tjerë të mëdhenj: është e vështirë, thuajse e pamundur, ta futësh në kuadratin e një drejtimi apo epoke të caktuar letrare. Metaforikisht, Martin Camaj do ta karakterizonte si një “*mik triditësh*”⁶ të tyre. Ai është unik, i papërsëritshëm në llojin e vet, tradicional dhe modern njëkohësisht. Origjinaliteti i tij qëndron në faktin se për të modernizuar prozën, ai nuk iu drejtua modeleve të prozës së huaj, por modeleve të rrëfimit popullor shqiptar. Vërtet thuhet se ai është shkrimtari i parë që shënon fillesën e prozës moderne, por të mos harrojmë, që ai shënon njëkohësisht edhe kulmin e saj, sepse nuk njohim autor tjetër deri më sot që t’i ketë kapërcyer standartet e tij letrare. Studiuesit me të drejtë e përqasin atë me shkrimtarë të tillë, si Borhes apo Markez, por nënvizojmë se Kuteli ka shenja të veçanta edhe përkundrejt tyre. Ai është unik në gjithçka: në përmbajtje, në stil, në gjuhë. Lexuesi duhet të jetë i pajisur me një shqisë të veçantë për leximin e veprës së tij, me një pikëvështrim të ndryshëm nga ajo që i është dashur për gjithë pjesën tjetër të prozës shqiptare, por, gjithsesi, përkundër kësaj, ai është një shkrimtar i dashur dhe i perceptueshëm për të gjithë, si për shqiptarin e toskërisë dhe për shqiptarin e gegërisë, si për shqiptarin e Shqipërisë dhe për shqiptarin e Kosovës apo atë të diasporës dhe e gjitha kjo së pari, për vetë mënyrën se si ngjizet gjuha, se si shkrihet përvoja vetjake e autorit me përvojën e të tjerëve, se si shkrihet e kaluara me të tashmen, se si këto të dyja prekin të ardhmen, se si një përjetim i caktuar, një përjetim konkret vishet me misterin e së përgjithshmes, universales, se si gjithçka që emërtohet traditë shndërrohet në modernitet.

Udhët që lidhin tokën me qiellin, Këtë botë me Atë botë, shfaqen të tilla në veprën e Kutelit, sa të duken gjëja më normale: lë lëkurën (trupin) dhe mund të shkosh si vizitor “atje ku maji s’ka të sosur”; kthehesh, vesh lëkurën, por rrezikon të mos kesh asnjë lidhje me realitetin, sepse në Këtejbotë koha rrjedh më shpejt se andej, për shkak të mjerimeve e tallazeve të cilat e

6. M. Camaj, *Kuteli ende i pazbuluem*, në “Hylli i Dritës”, 3-4, 1994, f. 82-83.

karakterizojnë atë. Ura e vetme që propozon Kuteli për t'i dhënë kuptim qenies dhe për të mbërritur paqen e jetës së përjetshme është t'u bësh mirë të gjallëve se, ndryshe, je një i pasur "i varfër fort". Të mos kesh mundësi të vdesësh shihet si fatkeqësi, ndërsa varri si pragu për të kaluar përjetësi. Mesazhet e forta, mesazhet universale mund t'i marrësh vetëm pjesërisht në leximin e parë; vepra të fton që ta rilexosh disa herë dhe të befasohesh gjithaq.

Dihet se thelbi i artit të Kutelit është tregimi, më saktë një lloj i veçantë i tij: rrëfenja, gjë që përbën një lloj të ri letrar, një risi. Për sa i përket receptimit të veprës së tij nga studiues të ndryshëm, ai vjen me vlerësime nga më të lartat duke e konsideruar një nga autorët më të rëndësishëm të letërsisë e të kulturës shqipe. Në këtë kontekst duhet të përmendim Petraq Kolevicën, Agim Vincën, Sabri Hamitin, Kujtim M. Shalën etj. Nasho Jorgaqi e vlerëson Kutelin për shumëçka, por veçanërisht për gjuhën, duke u shprehur se: "Rrëfimet më të mira të Kutelit u takojnë atyre krijimeve të shquara të letërsisë sonë, që lexuesi mund t'u kthehet e rikthehet me dëshirë e dobi. Kjo vjen ngaqë nëpër to rrjedhin burime të jetës së gjallë të popullit, ndihen zërat dhe flakërojnë ngjyrat e saj. Kuteli, duke krijuar një tip të ri tregimi në prozën tonë, dëshmoi e provoi dhe një herë forcën dhe bukurinë e fjalës shqipe, mundësitë e saj të mëdha shprehëse, aftësitë ndërtuese e krijuese. Gjuha shqipe në pendën e Kutelit ka arritur një nga bukuritë e saj më të rralla. Të gjitha këto e bëjnë Kutelin një nga mjeshtrit e tregimit shqiptar"⁷. Aurel Plasari duke përcaktuar krijimtarinë gojore të popullit dhe tekstet religjioze të shqipes kishtarë, si dy mësues të tij të mëdhenj në fushë të gjuhës, vlerëson përpjekjet e tij për t'u zhvendosur nga shija e rëndomtë e gjuhës së përditshme, drejt një gjuhe me modalitet më të lartë semantik, shprehet se Kuteli i kushtohet "me përsipirtshmëri aktit gati-religjioz të të vendosurit një mbi një të tullave në ngrëhinën e prozës së vet, duke i shpirtëzuar njëërën pas tjetrës fjalët e gjuhës amtare."⁸ Kasëm Trebeshina, duke shkruar për vendin e prozës së Kutelit në letërsinë shqipe, për karakteristikat e modelit të tij tregimtar, për procedimet e reja tregimtare, për mjetet e reja retorike, vëren se "Për herë të parë te ne fillon të marrë rëndësi të veçantë jo ajo që thuhet, por forma me të cilën thuhet, gjë që më vonë do të çojë në kalimin e "formës" në "përmbajtje" dhe në pandashmërinë e tyre."⁹ Në këtë kontekst, Kasëm Trebeshina pohon se "dy autorët e parë që hapën rrugën për modernitetin e letërsisë shqipe janë Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli."¹⁰ Sali Bashota vlerëson se poezia merr frymë në prozat e Kutelit dhe shprehet se ai "është një ndër stilistët më të shquar të prozës shqipe, i cili shprehjes letrare dhe mendimeve të tij u jep fuqi krijuese duke i përsosur dhe sublimuar

7. Nasho Jorgaqi: *Rrëfimet e Mitrush Kutelit*. Tregime të zgjedhura, Tiranë 1972, f. 32.

8. Aurel Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Tiranë 1995, f. 100.

9. Kasëm Trebeshina, *Një skicë për historinë e letërsisë shqipe* (mendime të censuruara), 1993, f. 15.

10. Po aty.

*poetikisht.*¹¹ Kujtim M. Shala, duke analizuar modelin oral të rrëfimit në tekstin autorial, nënvizon origjinalitetin e kodit narrativ (të cilin e sheh si shenjë të modernitetit) të Kutelit dhe shprehet se proza e tij “*si rrëfimet gojore, e teston lexuesin kohë pas kohe. Ajo e sheh Lexuesin përbrenda vetes, për ta konceptuar si Dëgjues. Proza e tillë në planin e rrëfimit, është e shtruar, e qetë, suksesive në relacion me fabulën, më mirë – me nivelet e saj, por jo me kohën. Shenjat autoriale dalin së pari e më fuqishëm në planin sintagmatik të tekstit dhe në modelimin e personazhit. Proza e Kutelit njih rrëfimin oral me status reference (narracionin) e personazhin-autorial. Një thyerje kjo specifike. Personazhi e lidh këtë prozë edhe një fish me autorin e saj, derisa s’arrin ta lidhë me kohën e tij.*”¹² Po kështu, ky autor, duke e parë prozën e Kutelit si një variacion të prozës moderne, thekson edhe origjinalitetin e tij përsa i përket kodeve tematike dhe shprehet se “*temat e rrëfenjave të Kutelit janë kryekëput të kundërtat e kodeve tematike tipike për realizmin.*” Sabri Hamiti, duke nënvizuar praninë e poezisë në prozën e Kutelit, shprehet se karakteristikë e rrëfimit të Kutelit “*është gjuha e bukur poetike, si kur përshkruan pamjet e jashtme, ashtu dhe kur shpreh gjendjet e brendshme.*”¹³ Spiro Gjoni, duke shkruar për “jashtëkohësinë” e Kutelit në optikën e dy regjimeve, shprehet se ai me artin e tij mjeshëtor “*madhështoi edhe më gjuhën amtare e na la pas trashëgim perla të krijimtarisë letrare, ku spikasin tablotë e papërsëritshme të natyrës dhe ndërthuren në përjetësinë e tyre skena sat ë veçanta aq dhe të përgjithshme të botës dhe jetës shqiptare.*”¹⁴ Shkrimtari Ismail Kadare duke vlerësuar prozën e Kutelit e quan atë “*një vepër e shkruar bukur.*”¹⁵ Martin Camaj, duke shkruar për vendin që zë Kuteli në letrat shqipe, shkruan se “*Mitrush Kuteli ka vendin e vet në historinë e letërsisë shqiptare, sigurisht jo atë vend që ia caktuan historiografët në vëllimet e kritikës e të periodizimit të letërsisë sonë. Diçka e tillë arsyetohet me faktin sepse Kuteli na paraqitet si letrar e si njeri kulture, si vetje fort komplekse.*”¹⁶

Dhimitër Paskoja lindi më 13 shtator 1907 në qytetin e Pogradecit në një familje me tradita atdhetare dhe arsimdashëse, çka do të lërë gjurmë në formimin e tij të përgjithshëm si dhe në rrugëtimin e tij jetësor dhe krijues. Familja e tij ishte me origjinë nga qyteti i Artës, (konturet e të cilit i gjejmë te proza e mrekullueshme “E madhe gjëma e mëkatit” apo dhe “Në një cep të Ilirisë së Poshtme”), por u vendos në Mokër e më pas në Pogradec. I ati Pandi, u burgos disa herë, sepse ishte ndërlidhës për të sjellë librat shqip, të botuara në kolonitë e mërgimtarëve. Në formimin e tij kanë ndikuar edhe lidhjet e familjes së tij me luftëtarët patriotë, si Themistokli Gërmenji, Menduh

11. Sali Bashota, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Prishtinë 2007, f.221.

12. Kujtim M. Shala, *Kujtesa e tekstit* (Mitrush Kuteli), Prishtinë 2003, f. 178-179.

13. Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare* (gjysma e parë e shek. XX), Albas, 2000, f. 288.

14. Spiro Gjoni, *Letërsia si e tillë*, Tiranë 1996, f. 333.

15. Ismail Kadare, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, Tiranë 1991, f. 38.

16. Martin Camaj, *Kuteli ende i pazbuluem*, në “Hylli i Dritës”, 3-4, 1994, f.81.

Zavalani, Dervish Hima etj., të cilët do të kthehen në personazhe mbresëlënës të veprës së tij; libraria e vogël e babait, si dhe përrallat e rrëfimet e gjyshes, nënës etj.

Mitrush Kuteli studimet e tij të para i kryen në shkollën fillore të qytetit të vendlindjes, të cilat i përfundon në vitin 1920 dhe më pas, në vitin 1921, fillon studimet në shkollën e mesme tregtare në Selanik, të cilat i përfundon në vitin 1928. Studimet e larta i vijoi në Bukuresht në degën ekonomike, të cilat i përfundoi në vitin 1931, dhe po aty, në vitin 1934, mbrojti doktoraturën në të njëjtën fushë, me tezën “Tre probleme të Bankës”, ku mori vlerësimin më të lartë “*Diplomum Magnam cum Laude*” për nivelin e lartë shkencor të studimit doktorat. Mitrush Kutelit do t’i mjaftonte edhe vetëm kontributi bankar, studimet me vlerë në këtë fushë, për të hyrë në historinë e Shqipërisë, në personalitetet e shquara të saj. Disa prej librave të botuar në këtë fushë janë: “Banka Kombëtare e Shqipërisë” (1936), “Kapitalet e huaja në bankat e mëdha të Bullgarisë” (1936), “Krediti bujqësor në Rumani” (1937) etj.

Përsa i përket aktivitetit profesional bankar, ai e filloi atë në Rumani si funksionar i lartë në Bankën Kombëtare Rumune. Pasi kthehet në atdhe më 1942, Dh. Pasko punoi si konsulent për çështjet monetare në Bankën Kombëtare Shqiptare. Ai vazhdoi të punojë në poste të larta të kësaj banke deri në vitin 1946, kur dha dorëheqjen.

Siç dihet, në vitet e para pas Çlirimit, regjimi i kohës filloi një fushatë spastrimi ndaj gjithë atyre, emri dhe fjala e të cilëve kishte peshë dhe autoritet të padiskutueshëm kudo në trojet shqiptare. Në këtë valë përfshijnë edhe Mitrush Kutelin, i cili nuk ishte dakord për njëjtësimin e lekut shqiptar me dinarin jugosllav, sepse kjo do të sillte zhvlerësimin e të parit, duke e akuzuar se gjoja e bënte këtë për të prishur marrëdhëniet me Jugosllavinë komuniste. I etiketuar si shkrimtar borgjez, ai do të futej dy vjet në burg, kohë gjatë së cilës do të kryente punë të rënda, siç ishte ajo për tharjen e Kënetës së Maliqit, ku e varrosën për së gjalli dhe e shpëtimit nga vdekja për një fije. Si rezultat i një amnistie, nga pesë vitet burg bën vetëm dy. Kuteli nuk foli kurrë dhe me askënd për burgun dhe për torturat, madje as me gruan e vet, për të mos i përfshirë ata në dhembjen e tij, por edhe për t’i mbrojtur. Kutelit punoi si përkthyes në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, ku i duhej të përkthente një numër të konsiderueshëm faqesh për të realizuar normën e për të marrë rrogën me të cilën të mbante frymën familja e tij. Por, për fatin tonë, Kuteli i madh, i madh do të shfaqej edhe në këtë fushë, sepse nuk mund të ishte ndryshe; në mendjen e tij asgjë s’mund të ndodhte, sa për të kaluar radhën. Në përkthimet e tij gjuha shqipe flet me hirin e një gjuhe të madhe në vepra të tilla, si “Kujtimet e një gjahtari” të Turgenjev, “Shpirtra të vdekur” të Gogolit, “Zotërinj Gollovlinovë” të Shçedrinit dhe autorë të tjerë, si Mihai Eminesku, Gorki etj.

Jetën e tij si krijues, Kuteli e fillon që në vitin 1928, kur nisi të botojë duke përdorur disa pseudonime letrare, si: Izedin Jashar Kutrulia, Dr. Pas, Lugati etj., por pseudonimi më i famshëm me të cilin është identifikuar plotësisht mbetet Mitrush Kuteli.

Mitrush Kuteli është shembulli i intelektualit shumëdimensional dhe, më kryesorja, i intelektualit që shfaqet i madh në çdo fushë, si kritik letrar me veprën “Shënime letrare”, (1944); si studiues i folklorit me “Këngë e britma nga qyteti i djegur” dhe botimin në rumanisht “Proverba shqiptare”; si publicist me pamletet “Havadan më havadan” (1944); si poet me librin “Sulm e lotë”, në të cilin përmblihet edhe “Poemi kosovar”, (1943); si përkthyes me përkthimet e shumë veprave të shquara botërore, të cilat i përmendëm më lart, por, mbi të gjitha, spikat profili i tij prej prozatori. Të parat proza, që ai botoi në organin “Shqipëria e re” janë tregimet “Më kot” dhe “Natë kollozheku”, më pas vepra “që i dha famën e një prozatori me një nivel jot ë zakontë, ishte “Netë shqiptare – Rrëfime e kujtime”, botuar në Konstancë më 1938. Ajo përmbante gjithsej tetë rrëfime të shkruara të shkruara prej Kutelit. Pas kthimit në atdhe, në vitet 40, Kuteli vazhdon edhe më intensivisht veprimtarinë e tij letrare. Kështu boton në vitin 1943 librin “Ago Jakupi – Rrëfime dhe kujtime”, më 1944 librin “Kapllan Aga i Shaban Shpatës – Rrëfime.”¹⁷

Pas vitit 1944, ai u muar me përkthime letrare dhe nisi një projekt letrar për krijimin e romanit ilirik; duke përshtatur në prozë ciklin e legendave shqiptare nën titullin “Tregime të moçme shqiptare”. Vepra të tjera të autorit janë “Dashuria e barbarit Artan për të bukurën Galatea” (1946); “Pylli i gështenjave” (1958), “Xinxifillua”, “E madhe gjëma e mëkatit”, “Në një cep të Ilirisë së Poshtme”. Nëse do ta ndajmë rrugën krijuese të autorit në dy periudha: para dhe pas Çlirimit, do të vërejmë se intensiteti krijues i tij është më i lartë në periudhën e parë, sepse në të dytën do të merret më shumë me përkthimin dhe, fatkeqësisht, projektet e tij letrare mbetën të papërfunduara ngaqë u nda para kohe nga jeta.

Kuteli, një shpirt i pastër kristian, një “sui generis” nuk ka asgjë të përbashkët me zilitë e zakonshme të shkrimtarëve për njëri-tjetrin, të cilat ai njeh mjaft mirë, kur thotë: “*Profesionalizmi në letërsi në vendin tonë është hë për hë një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur... Terreni i letërsisë është tokë ku gëlojnë gjerprinjtë. Të vrasin shokët se u bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi*”¹⁸. Për moralin e tij, çuditërisht aq të pastër, mjafton të kujtojmë ndihmën për botimin e veprës së Lasgush Poradecit, bashkëvendasit të tij si dhe botimin për herë të parë të poezive të Fan Nolit me titullin “Mall e brengë”, duke e befasur dhe prekur shumë këtë të dytin. Këtë frymë prej të krishterit të mirë ai e shtrin në çdo veprimtari të tij

17. *Letërsia shqiptare* 3, Tiranë, 2002, f.157.

18. Mitrush Kuteli: *Testament* në “Hylli i Dritës”, 3/4, 1994, f. 75.

dhe e shpreh në thënien e pakrahasueshme atdhetare që u fali fëmijëve të vet dhe njëkohësisht të gjithëve ne: “*Atdheu është atdhe, bile edhe kur të vret*”¹⁹.

Sa ishte gjallë, Kutelit nuk iu kthye ajo dashuri që ai dhuroi për vendin e tij. Vetë ai pas shumë kohësh dhe me shumë mundime, arriti të bëjë një shtëpizë të vogël; i sëmurë vazhdoi të realizonte normën e punës etj., e, megjithatë, asgjë nuk e shkuli dot atë nga lartësitë morale, intelektuale e atdhetare. Ai shkoi i pastër në përtejbotë njëlloj si personazhi i tij Ago Jakupi. Pastërtia morale e shpirtërore e Kutelit shfaq madhështinë e vet edhe përmes një fraze të thjeshtë, përmbledhëse të rrugëtimit të tij njerëzor: “*Kam punuar shumë, kam dashur shumë, kam gabuar shumë*”²⁰. Ky ishte Kuteli përballë të tjerëve, por a ishin të tillë të tjerët përballë tij? Pyetja merr një përgjigje të dhimbshme, fatkeqësisht negative: jo, sepse ai pati fatin e shkrimtarit, të cilin për arsye të kulturës së tij të madhe dhe të fjalës së tij të lirë, nuk e duroi dot as Monarkia e viteve 30-të, as diktatura komuniste e pas çlirimit dhe vepra e tij e ndaluar apo gjysëm e ndaluar u botua e plotë vetëm pas viteve 90-të, dhe vonë, shumë vonë, në 27 shtator të vitit 2002 Presidenca e Shqipërisë i akordon titullin “Mjeshtër i Madh i Punës”. Për periudha të tëra kohore ai u mbulua me heshtje dhe vetë vdekja e tij u përcuall vetëm me dy rreshta në gazetën “Zëri i Popullit”.

Pyetjes së vetë autorit: “*Do të më njohë dhe do të më kuptojë dikush, të paktën pas vdekjes?*”²¹ do t’i përgjigjemi po, sepse ai i ngjan malit, të cilit sa më shumë i largohesh, aq më i madh duket. Siç u tha dhe më lart, jo pak studjues e kanë thënë fjalën e tyre për veprën e Kutelit, duke e vendosur atë në rolin e patriarkut të prozës moderne shqipe, por ende mbeten shumë të pathëna, sepse proza e tij i ngjan burimit, ku uji është përherë i ri; rruga për ta lexuar dhe analizuar atë siç duhet është ende e gjatë, veçanërisht në drejtim të gjuhës, e cila mbetet vazhdimisht një minierë ari si për shkrimtarët dhe për gjuhëtarët. Këtë mund ta argumentojmë në disa anë:

Së pari, ai sjell një pasuri të paçmueshme lënde leksikore e gramatikore prej të folmes së një treve që pak ose aspak ishte selitur më parë në letërsinë artistike, duke nxjerrë prej harrimit fjalë të gurrës popullore.

Së dyti, kjo lëndë gjuhësore me karakter ngushtësisht krahinor, e ndërlihur natyrshëm me indin e përgjithshëm të veprës, i ka kaluar në masën më të madhe dhe mund t’i kalojë edhe më tej caqet e përdorimit të saj, jo vetëm në veprat letrare të autorëve të tjerë, por edhe në gjuhën letrare kombëtare, duke i plotësuar mungesat e saj ose duke e pasuruar më tej atë.

Së treti, Kuteli me veprimtarinë e tij gjuhëkrijuese, mund të shërbejë si një shkollë e vërtetë në fushën e fjalëkrijimit, të modelimeve të reja sintaksore dhe rritjes së shprehësisë e figurshmërisë së ligjërit etj.

19. Po aty, f. 74.

20. Po aty, f. 72-73.

21. Po aty, fq. 74

KREU II

LEKSIKU I VEPRËS SË MITRUSH KUTELIT

Leksiku është treguesi që shpërfaq më qartë pasurinë gjuhësore të veprës së një shkrimtari, ai është treguesi kryesor se sa ai njeh gjuhën dhe potencialet e saj dhe, nëse kjo është në nivel shumë të mirë, i krijon atij mundësinë për të qenë i ndryshëm, përballë kolegësh të tjerë të letrave. Leksiku i veprës së Kutelit ka si tipar kryesor shtrirjen e gjerë në kohë dhe si i tillë është i pasur e i shumëllojshëm: leksik i përdorimit të përgjithshëm, leksik krahinor, leksik që ka dalë nga përdorimi apo përdoret rrallë, leksik fjalësh të huaja, leksik terminologjik, leksik i krijuar prej atij vetë, frazeologjizma gjuhësore, frazeologjizma letrarë etj. Në vijim do të përqipemi të analizojmë leksikun popullor, i cili merr një peshë të veçantë në veprën e tij.

Kuteli është dhe do të mbetet mjeshtër i madh i prozës shqiptare, sepse askush tjetër si ai nuk mundi ta përdorë aq cilësisht gjuhën shqipe. *“Adhures dhe ndjekës besnik i gjuhës së rilindësve të mëdhenj, i yshqyer në gurrën e pasur të të folurit të vendlindjes, Kuteli do të formohet si shkrimtar, sa në shkollën e gjuhës shqipe, aq edhe në atë të jetës shqiptare. Konceptet e tij për gjuhën amtare janë jo vetëm ato të një atdhetari të flaktë, që e sheh atë si një nga tiparet kryesore të kombit dhe pasuri të madhe shpirtërore të popullit, po edhe të një artisti të shquar, që i përkushtohet asaj shpirtërisht, intelektualisht e fizikisht.”*²² Duke qenë se një nga parimet kryesore krijuese të tij është kujdesi i posaçëm për formën, vjen natyrshëm dhe vëmendja e lartë në përzgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve gjuhësore. Te ai vëmë re shkrimtarin që zotëron më së miri gjuhën amtare e veçanërisht të folmen juglindore të saj, gjë që i lejon atij të shfrytëzojë mjeshtërisht mundësitë e saj shprehëse dhe t’i japë prozës së vet një vulë tejet origjinale; mbi gjithçka vepra e tij dallohet për një leksik mrekullisht të pasur. Ai shfrytëzoi, jo vetëm fjalët e përbashkëta të shqipes, por edhe shumë fjalë të tjera krahinore. Me plot gojën mund të themi se ai është kokë e këmbë i dashuruar, apo ta themi më mirë i magjepsur pas ligjërimit popullor, ndaj dhe di ta vjelë dhe ta përdorë atë me bukuri të pashoqe. Gjuha e Kutelit shquhet jo vetëm nga *“leksiku i pasur dhe i pastë, por edhe nga fryma ngjizëse, nga aftësitë analitike e sintetike, nga vetitë ndërtuese të një sintaksi thjesht shqip”*²³. Si poet i shpirtit të kombit shqiptar dhe i natyrës shqiptare ai dëshmoi me veprën e vet forcën dhe magjinë e fjalës shqipe. Vetë tematika, subjektet e marra nga jeta e fshatit, vetë thelbi i

22. Nasho Jorgaqi, *Parathënia për veprën S.T.Z. të M. Kutelit*, 1989, f. 57.

23. Po aty, f. 54.

personazheve, fshatarë të pasur apo të varfër, formimi i tyre kulturor, psikologjia dhe mendësia e tyre e jetës e bëjnë autorin të jetë plotësisht i përqendruar te gjuha e popullit dhe në mbushjen e leksikut me fjalë e shprehje popullore, si dhe në ndërtime sintaksore tipike për të folmen popullore. Kuteli është rasti i shkrimtarit të përgjegjshëm, që punon e punon pa u lodhur me gjuhën, i shkrimtarit të pakënaqur nga vetja e vazhdimisht kërkues, që vërtet e shfrytëzon të folmen e krahinës së vet, por duke e riorganizuar atë artistikisht “për të mos rënë në ngjyresa krahinore ose në një ligjërim të rëndomtë.”²⁴

Kuteli shfrytëzon deri në fund materialin e begatë gjuhësor, me shtresime krahinore, historike, kulturore të zonës së Pogradecit, të cilin e ka shumë për zemër, por duket se kjo nuk i mjafton, prandaj i kapërcen kufijtë e tij, duke iu drejtuar shqipes në një shtrirje më të gjerë e më të thellë, dhe themi se gjuha në prozën e Kutelit, përveçse gjuhë krahinore, është dhe gjuhë kombëtare.

Vepra e tij dëshmon më së miri njohjen e thellë dhe shkallën e lartë të ndjeshmërisë së tij prej shkrimtari ndaj gjuhës shqipe në përgjithësi e gjuhës së popullit në veçanti, prandaj në veprën e tij dalin si në dritën e diellit vlerat e kahmotshme të gjuhës, të pasuruara më tej si në planin kuptimor, emocionues, shprehës dhe në atë fjalëkrijues.

Fondi leksikor që përdor Kuteli përbën bazën e gjuhës letrare shqipe, por në mënyrë të spikatur, gjithnjë në përputhje me nevojat artistike të veprës, përdoren edhe dialektalizmat, arkaizmat dhe fjalët e huaja, si: turqizmat, sllavizmat, greqizmat dhe neolatinizmat, gjithnjë me dorë të kujdesshme e në mënyrë funksionale, ndonëse nuk mungojnë rastet kur ato marrin ngarkesë të theksuar stilistike, si për shembull fjalët me prapashtesa turke *-llëk, -xhi* etj., të cilat përgjithësisht kanë ngarkesa ironizuese apo sharëse. Gjithsesi, ky numër nuk është i madh, por është lehtësisht i dallueshëm.

Kuteli ka krijuar me korrektesë gjuhësore fjalë apo kuptime të reja fjalësh të cilat pasurojnë ligjërimin e tij artistik dhe lënë te lexuesi i vëmendshëm një shije të paharrueshme dhe në fund të fundit, i ndikojnë dhe atij për një të ligjërim sa më cilësor dhe interesant, sepse vepra në vetvete ka vlerën e një shkolle të vërtetë gjuhësore. Ai të mëson ta duash gjuhën shqipe, të bind natyrshëm që të kesh vlerësimet më të larta për të dhe, mbi të gjitha, të ndihmon me zellin e një mësuesi pasionant. Të lexosh veprën e Kutelit, do të thotë të ndjekësh një kurs të shkëlqyer në fushën e gjuhës shqipe por dhe më tej, sepse proza e tij dallohet në gjithçka: në pasurinë e leksikut, në qartësinë dhe shprehësinë e admirueshme, në begatinë e paradigmave, në lidhjet e veçanta fjalësore, në strukturimin e togfjalëshave, fjalive dhe frazave. Fjalëkrijimet e tij janë ndër më të bukurat dhe me interes, jo vetëm për gjuhën artistike, por edhe për atë letrare dhe mund të themi se ai i përdor me sukses të gjitha modelet fjalëformuese të shqipes, ndonëse mbizotëruese janë fjalët e krijuara me anë të prejardhjes dhe kompozimit.

24 . .Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, f. 140.

Duke e parë në tërësi leksikun e veprës së Kutelit del se grupin më të madh e përbën leksiku asnjans, me funksione të pastra shënuese, i përbashkët për variantet ligjërimore dhe për stilet funksionale të shqipes letrare, por duhet thënë se shpesh edhe ky leksik merr karakteristika të ngjyrimin stilistik dhe emocionues e vlerësues. Vendin e dytë e zë leksiku i cilësuar stilistikisht për shkak të polisemantizmit dhe figurshmërisë, që arrijnë nivele më të larta, veçanërisht te shtresa e fjalëve me kuptime të prejardhura.

Termi “leksik popullor” është në vetvete një term shumë më i gjerë, por së pari na vijnë ndërmend dialektalizmat. Dihet se dialektalizëm quhet “çdo fjalë a kuptim i një fjale, shprehje, variant fonetik a trajtë gramatikore, që është veçori dalluese për një dialekt dhe që nuk përputhet me normën e gjuhës letrare kombëtare”²⁵. Kuteli i jep një shtrirje të gjerë shtresës së fjalëve dialektore duke hyrë kështu në shkrimtarët që në mënyrë të ndërgjegjshme i drejtohen këtij leksiku për shkak të natyrës së tij origjinale dhe mundësisë së tij për të shërbyer si burim real për pasurimin e gjuhës letrare. I magjepsur pas artit të fjalës, ai hyn në grupin e atyre krijuesve të cilët këmbëngulin me një forcë gjithnjë e më të madhe në thellësitë e tij për të zbuluar vlera të reja, ai ndalet te fjala, te shprehjet, i peshon ato me peshoren e farmacistit duke lakmuar përsosmërinë.

Leksiku popullor në veprën e Kutelit paraqitet shumë i pasur si në sasi, ashtu edhe në shumëllojshmëri dhe si i tillë paraqet vështirësi për t’u klasifikuar dhe për t’u interpretuar. Shtresa e fjalëve të leksikut popullor të përdorura prej tij vijnë, siç thamë më lart, edhe nga gjuha shqipe edhe të huazuara nga gjuhët e tjera. Duket se ai njeh shumë mirë dhe ndjehet si në shtëpinë e vet jo vetëm brenda kufijve të gjuhës së vendlindjes, por edhe të shqipes në tërësi; ai zotëron potencialin gjuhësor të dialekteve të tjera, të dialektit verior, të variantit arbëresh etj. dhe nuk ngurron t’i përdorë ato në ligjërimin e vet gjithmonë në varësi me temën, subjektin, kulturën, profesionin, prejardhjen e personazhit etj. Gjithsesi, këtë fakt do ta trajtojmë më pas si një çështje më vete. Ajo që duhet thënë që në fillim është se vërehet qartë se te Kuteli dialektalizmat që kanë për burim gjuhën shqipe janë më të shumta në numër, se ato të huazuara.

Jani Thomai shprehet se “çdo shkrimtar, si në shumë mjete e mënyra të tjera, veç së përgjithshmes, ka diçka të vetën edhe në përdorimin e dialektalizmave, kjo shfaqet përmes sasisë së dialektalizmave që përdor, tipave gjuhësorë, llojit të ligjërimin ku përdoren dhe gërshetimit të tyre, vlerave të reja që fitojnë në rrethanat e ndryshme ligjërimore, shpërndarjes në kontekste të ndryshme etj.”²⁶ Në këtë këndvështrim do ta analizojmë leksikun popullor të veprës së Kutelit i cili shfaq shumëllojshmëri tipesh:

25. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, f.330.

26 . Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 35.

2. 1. Tipat leksiko-gramatikorë

Në veprën e Kutelit janë të pranishëm të gjithë tipat leksiko-gramatikore të dialektalizmave: emërorë, mbiemërorë, ndajfoljorë etj. Më poshtë do të ndalemi t'i shqyrtojmë me radhë:

2.1.1. Dialektalizmat emërorë

Nga studimi tërësor i veprës së Kutelit rezulton se dialektizmat emërorë përbëjnë grupin më të madh (rreth 600). Të tillë janë, si: *abrazh* “njeri me flokë e vetulla të bardha, njeri i prapë”, *agshol* “piku i mëngjesit”, *ajazmë* “vend me burime e lëndina”, *alivani* “të fikët”, *alësvivë* “finjë”, *allonar* “korrik”, *avaz* “veprim i përsëritur shumë herë”, *babale* “emër me të cilin i drejtohen babait ose gjyshit me përkëdheli e dashuri në familje”, *baltovinë* “vend me baltë”, *bandill* “djalë i ri që do një vajzë”, *bandër* “rrjetë merimange”, *batrac* “duhan vjeshtak”, *be* “betim”, *belcë* “një lloj shtroje e krijuar në vegël prej druri, ku bëhen edhe qilimat, por kjo ka si karakteristikë thekët e nxjerrë jashtë”, *befa* “peng”, *bereqet* “drithë”, *bigël* “degë që mbaron në majë me dy degëzime”, *breshtë* “pyll me bredha”, *bubuzhel* “brumbull”, *buenë* “lumë drite, lumë njerëzish”, *bullçi* “nofull”, *bumbeskë* “gonxhe”, *buqe* “gojë (përdoret me nuancë negative)”, *burbujë* “zhurmë e madhe, gurgule”, *buvojë* “burim”, *but* “voze”, *bështinë* “kope dhësh a dhish pa bari”, *bun* “kasolle e vogël e mbuluar me degë e gjethe që ngrenë barinjte atje ku bjeshkojnë”, *bulogë* “thuhet për ujkun kur maskohet të mos duket duke u mbuluar me këmbët e para e duke qëndruar pa lëvizur”, *bumurimë* “bubullimë”, *bokxhana* “mallkim i madh i shpirtit”, *çallëm* “rreptësi”, *çallaber* “njeri mendjelehtë”, *cabje* “shpat”, *cikmë* “mot me acar”, *cifun* “vrime e ngushtë e koritës së mullirit” *cërmë* “mpirja e këmbës apo gishtit”, *cubar* “ai që bredh pas grave”, *çallë* “kokërr e papjekur e pemës”, *çap* “hap”, *çardhak* “një pjesë e rrethuar me parmakë, që, zakonisht, gjendet në katin e dytë të shtëpisë dhe përdoret për të pritur miq”, *çare* “zgjdhje, rrugëzgjdhje”, *çatall* “dhëmbë ose diçka tjetër që bigëzohet më dysh, dhëmb i shtrembër”, *çehre* “pamja ose shprehja e fytyrës”, *çengel* “grip i trashë hekuri me majë të kthyer, që përdoret për të varur diçka në të”, *çetele* “shkop druri i lëmuar që shërbente për të mbajtur llogarinë midis blerësit dhe shitësit, duke gdhendur dhëmbëza si shenja për numërim”, *çun*, *çupë*, *dajandë* “durim; trung ose hu që vihet për të mbajtur një mur apo diçka tjetër”, *damaz* “kafshë mashkull i zgjedhur për ndërzim”, *damf* “kundërmim”, *darovë* “dhuratë”, *dashatar* “njeriu i dashuruar”, *defter* “fletore shënimesh”, *derrpë* “pyll shumë i dendur; vend me driza të shpeshta”, *dhele* “përkëdhelje”, *dhiar* “çobani i dhive”, *dhiare* “çobane e dhive”, *dhokan* “çark për të kapur minj”, *djellishtë* “copë vend që e zë shumë dielli”, *delmator* “bari dhensh”, *dobec* “një lloj shkop me majë që përdoret për t'i shpuar kafshët me qëllim që të ecin më shpejt”, *donoma* “festë

zyrtare me dëfrime në kohën e Turqisë”, *drangë* “peshk i ujërave të ëmbla, me trup të gjatë e me hala, që peshon deri në gjysmë kilogrami”, *dredhkë* “erë e fortë me të rrotulluar, që sjell rrotull dëborën”, *dredhak* “njeri dredharak”, *divit* “takëm shkrimi, që zakonisht mbahet në brez”, *dritëzore* “një dritare e vogël, një hapësirë e vogël që lejon hyrjen e dritës”, *drobolitë* “të përbrendshmet, rropullitë”, *duak* “veli që përdorej për të mbuluar fytyrën e nuses ditën e dasmës”, *dushnik* “pyll a koriye me dushqe”, *duva* “lutje”, *dymen* “timon”, *duvaxhi* “njeri që lutet për të realizuar diçka”, *dëngla* “fjalë të mëdha, të bukura, por pa vlerë; gjepura”, *dërstilë* “vegël prej druri, e cila shërben për të shkelur shajak apo velenxha prej leshi”, *ergastol* “burg nëntokësor”, *farkë* “punishte e vogël për farkëtimin e metaleve”, *fragji* “i ftohtë i madh, i thatë, me ngricë, acar”, *fetaq* “pjesa e poshtme që vë në lëvizje gurin e mullirit, bosht, pendë”, *fellëtirë* “gropë e thellë e mbushur me ujë, hapësirë ujore që ka shumë thellësi”, *feçor* “një lloj guri lumi i murmë”, *fîromë* “frymë”, *flamë* “sëmundje e rëndë, murtajë”, *frenjë* “kërcelli i veshulit të rrushit”, *fri* “tundës i qumështit”, *fëllëzë* “thëllëzë”, *fëndyell* “vegël e këpuçarëve me majë hekuri ngulur në bisht druri për të hapur vrima në shollë”, *fërtymë* “furtunë”, *fushqi* “pleh dhish”, *fushëtirë* “fushë e vogël nëpër kodra ose male”, *gagaç* “njeri që i mbahet goja”, *garramet* “problem për të zgjidhur, punë për të kryer, bela”, *garan* “secili nga dy gurët e vatrës, vendi, qoshja pranë vatrës”, *gavyell* “rrethi i drunjtë i rrotës së qerres”, *gazhdare* “ndërtim i veçantë, i bërë me dërrasa a i thurur me thupra dhe i mbuluar, ku mbahen kallinjte e misrit ose misërishtet”, *gaztar* “njeriu që merr pjesë në një gëzim”, *gjindje* “grup njerëzish”, *gjingjër* “zhivë”, *gjol* “liqen”, *gjyllyrti* “rrëmuje”, *gjzylykë* “syze”, *galiç* “punëtor që mban llaç”, *gllavinë* “kokë e madhe (me tallje)”, *grendë* “gur i madh”, *gëmbër* “shkëmb i madh, rrasë”, *gobillë* “njeri me trup të madh e të çrregullt”, *gollup* “përbindësh, njeri i egër me një sy në ballë”, *gogol* “figurë e përrave dhe e besimeve të kota, që përfytyrohet si një qenie e tmerrshme me të cilën trembin fëmijët që të mos qajnë e të rrinë urtë”, *gostiar* “njeriu që merr pjesë në një gosti”, *gramë* “kundërmim jo i mirë; shkrim e këndim, shkollë”, *grosh* “pare, lek”, *grunar* “hambar ku ruhet gruri”, *guguçe* “kumri”, *gurgule* “rrëmuje, sherr”, *gushell* “njeri me gushë të madhe”, *gëzhita* “mbeturina që dalin gjatë pastrimit të drithërave”, *gjongli* “vullnetar”, *gjevrek* “kulaç”, *haje* “ushqime”, *hallexhi*, *hambarxhi*, *haps* “burg; çelës”, *harbi* “shufër e hekurt për të mbushur pushkën ose për të pastruar grykën e saj”, *hatri*, *haznë* “thesar”, *havale* “bezdi, hall”, *hejbe* “dy torba të mëdha prej leshi a prej liri, të endure a të qepura së bashku, që shërbejnë për të mbajtur sende të ndryshme”, *hergjele* “tufa e kafshëve të ngarkesës të cilat janë lënë të lira të kullotin në natyrë, kalë i pamësuar dhe që rri në tufë”, *hordop* “gropë e madhe që mbushet me dëborë”, *humbë* “njëfarë deltine e lyrshme që lëshon shkumë dhe përdoret për të larë kokën”, *hutë* “lloj pushke e vjetër, me katër viaska dhe me një fishek, që mbushej nga prapa”, *idare* “sigurimi minimal i një ushqimi”, *imdat* “ndihmë”, *imshtë* “pyll ose koriye me lisa të rinj”, *jaz* “vijë a hendek i vogël,

që shpie ujin në mulli, në arë”, *kajmak* “ajkë”, *kalakul* “njeri pa dinjitet që i lëpohet tjetrit”, *kalama* “djalë ose vajzë e vogël deri tetë ose nëntë vjeç”, *kalor* “kalorës”, *kallamishtë*, *kallamishtër* “kërçelli pa gjethe i kallamit, misrit, grurit etj. që mbetet në arë pas korrjes”, *kalldrëmxi*, *kamai* “mjegull e hollë që ngec midis degëve të drurëve halorë, sidomos atyre të bredhave”, *kamish* “çibuk i gjatë”, *kamare* “vend i hapur në murin e një shtëpie, zakonisht në të dyja anët e oxhakut, ku bahen enë e sende të vogla që përdoren përditë (xhezve, filxhanë etj.)”, *kamje* “pasuri”, *kanare* “kërde e madhe, kasaphanë”, *kaplloqe* “mendje, kokë”, *kaptell* “pjesa e përparme e djepit, që ka një dërrasë të ngritur, koka e djepit; pjesa e përparme samarit, ku mblidhen litarët”, *kaptinë* “kokë”, *kapan* “peshore me pjatë që mbahet në dorë”, *kapua* “këndes, gjel”, *karpë* “shkrep”, *karabaçkë* “vizatim i vogël i rrëmujshtëm, i pakuptueshëm; shkrim i keq, me shtrembërime të cilat e bëjnë të pakuptueshëm”, *kartë*, *katarr* “mundim, vuajtje”, *katragjysh*, *katua* “ahur në katin përdhes të një shtëpie, ku mbahen kafshët shtëpiake, ose bodrum, qilar”, *katandi* “pasuri”, *kazami* “kalendar i festive fetare”, *kalivar* “varg me kallëpe misri ose me duhan që varet”, *klisyrë* “grykë mali”, *kllanik* “gryka e vatrës së zjarrit”, *kllongjir* “spica akulli”, *kobë* “vjedhje brenda në shtëpi, vjedhje e fshehtë që është bërë nga një pjesëtar i familjes; vjedhje gjërash të vogla nga dikush që e ka si ves të vjedhë”, *kobëtar* “njeri që sjell fatkeqësi; spiun”, *kokonë* “thuhet për një vajzë të bukur, kukull”, *kolibe* “kasolle e vogël sa për të futur kokën”, *kollan* “rrip”, *komçë* “pjesa mashkull e kopsave prej teli femër-mashkull, për të mbërthyer tirqit, xhamadanët, fustanët etj.”, *kopaçe* “copë druri, zakonisht e gjatë sa krahu e jo shumë e trashë, që përdoret për të bërë zjarr në vatër”, *kopile* “shërbyes për punë të rënda të shtëpisë në familjet e të pasurve, shërbëtor; i lidur jashtë martese”, *koromane* “copë buke”, *krahosh* “trastë me rrip të gjatë, që mbahet varur në sup”, *keqan* “njeri i keq”, *kreshk* “luspë peshku”, *kreishtë* “majë mali”, *krips* “kuti e vogël ku mbahet kripa”, *krodhe* “copë buke e thatë, kothere”, *krongjill* “spica akulli”, *kronikas* “kronikan”, *kudër* “bushtër”, *kukurë* “këllëfi i shigjetave”, *kujë*, *kule* “grumbull i madh, i dendur ferrash”, *kume* “kumbare (trajtë e shkurtuar)”, *kuturi* “hamendje”, *kukunj* “puçrra të dendura, të kuqërreme, të forta si çibanë”, *kulluzmë* “një vend me kulpra e ferra”, *kumerë* “lemeri”, *kupë* “gotë”, *kutë* “këlysh qeni”, *kuvendar* “ai që merr pjesë në një kuvend, anëtar i kuvendit të burrave”, *këmbalec* “kanxhë”, *kërbishte* “pjesë e poshtme e shtyllës kurrizore”, *kërde* “shkatërrim a dëm i madh; fatkeqësi e madhe; shfarosje”, *kërriç* “i vogli i gomaricës, pulisht”, *këltyrë* “kapak”, *këlpishtë* “bajame e egër”, *këlkëzë* “bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të gjera e me zhardhokë, që përdoren si ushqim për derrat”, *krezhë* “thuhet për një femër që i mban flokët e pakrehura”, *lale* “ushqim i ëmbël që përgatitet duke pasur për bazë gjalpin, sheqerin, miellin”, *lapra* “copë e vogël e shqitur nga lëkura e diçkaje”, *lavrë* “prroskë, rrëke mali”, *lavomë* “plagë”, *leshra* “flokë”, *levenxë* “shtroje leshi e punuar me krahë në avlëmend”, *libë* “palare, pjatë”, *lirishtë*

“livadh i vogël në mes të pyllit”, *lirësi* “kur mallrat, sendet, prodhimet e ndryshme shiten me çmim të ulët”, *listopadh* “nëntor”, *lingëri* “luftim i vogël midis dy fuqive kundërshtarë”, *llambadhë* “qiri i trashë që e ndezin zakonisht në kishë”, *llaznicë* “hardhi, pjergull”, *llokandë* “lokal publik, ku hahet e pihet”, *llokmë* “thelë”, *log* “lëndinë, shesh vendi ku rrinë zanat në rapsoditë e kreshnikëve”, *lopçar* “njeriu që kujdeset për lopët”, *lugajë* “luginë e gjerë dhe e thellë”, *luzmë* “shumicë njerëzish, turmë”, *lyfyt* “pjesë druri e thelluar që vihet te burimi për të pirë ujë”, *lyrek* “fëmijë i vogël i mbështjellë me pelena leshi”, *lyshtër* “turmë e madhe, mizëri”, *lëkuraxhi* “njeri që merret me përpunimin e lëkurave”, *lëkurçe* “veshje e sipërme, e bërë me lëkurë deleje të paqethur”, *lëmashk* “shtresë e hollë që zë diçka nga sëmundja, kur prishet”, *lëngjyer* “sëmundje nga ato që vazhdojnë gjatë”, *mangër* “bakër”, *magje* “enë e drunjtë si govatë, ku ngjishet e punohet brumi për të bërë bukë; sasia e brumit sa nxë kjo enë; bukët që dalin nga ky brumë”, *magjyp* “egjiptian”, *mandër* “kope bagëtish; vathë bagëtish; stan bagëtish”, *mathimë* “mësimi që bëhej në shkollat greke”, *mbudhë* “në udhë”, *murtar* “njeri i vrenjtur”, *mungët* “memeç”, *meqezme* “lule, zbukurim vertikal që bëhet në çorape në zonën e Mokrës”, *mezchnik* “gur ose ledh që përdoret si kufi ndarës”, *mide* “dëshirë për të ngrënë”, *mollaqe* “tulet e të ndenjurrave, vithet”, *morracak* “njeri që ka zënë morra; njeri i fëlliqur, i keq”, *mullë* “bark”, *murgë* “vajzë a grua që ka mbetur e shkretë, e vetme, pa njeri; vajzë a grua e mjerë që bën një jetë të rëndë, të vështirë”, *mushtulluk* “ai që sjell lajme të mira”, *mëshere* “top djathi”, *mëregë* “trirë prej dërrasash”, *nalle* “lloj heqlash prej një cope druri të latuar sa shputa e këmbës dhe me rrip përsipër, që mbahen nëpër shtëpi e nëpër oborr”, *naplungë* “trastë prej leshi e endur rrallë, ku hidhet djathi ose gjiza për t’i kulluar hirra”, *noteshë* “grua e zgjuar”, *notishtë* “vend me lagështirë”, *nozull* “ushqime që ruhen për dimër, ushqime që merren për rrugë të gjatë”, *ndrikull* “e shoqja e kumbarës, nunë; grua që kujdeset për nusen ditën e dasmës; grua llafazane”, *nun* “ai që mban foshnjën gjatë pagëzimit”, *nëmë* “mallkim”, *nënurdhës* “njeri që është në varësi ose nën urdhërat e dikujt”, *ograje* “livadh pranë pyllit a në mes të koriëve ku kullot baëtia”, *oftikë* “sëmundje e tuberkulozit”, *opllaf* “yshtje”, *orent* “orientim”, *ortatë* “ortakëritë”, *padinë* “shpat i kodrës”, *pagëtyrë* “pagë”, *palavi* “papastërti, morra, pleshta”, *palmetë* “ndarje e vogël në anije, kabinë”, *pallajsë* “pallat, shtëpi e madhe”, *pallavër* “fjalë të kota, të gënjeshtër”, *palldëme* “rrip i gjerë prej lëkure a prej leshi, që i kalon kafshës nën bark për të mbajtur samarin të shtrënguar pas trupit”, *pampor* “anije”, *panxhë* “pjesa e poshtme e gjymtyrëve të përparme të disa kafshëve katërkëmbëshe me kthetra”, *papare* “përshesh me bukë të grunjtë e me erëza, që përvëlohet me ujë të nxehtë e me gjalpë dhe hahet zakonisht në mëngjes”, *papistan* “njeriu që nuk shkon në kishë”, *paraqender* “mospërfillje; moskokëçarje”, *pash* “largësia ndërmjet dy dyarve me krahë të shtrirë anash plotësisht; masë largësie e matur në këtë mënyrë”, *pashmangë* “këpucë pa thembra; këpucë të vjetra që përdoren si pantofla”,

paragon “trari kryesor i çatisë”, *pasunar* “pasanik”, *pendur* “roje të kralit (në rapsoditë e kreshnikëve)”, *peristil* “pjesë oborri e rrethuar me kolona”, *petlikë* “pesë gishttrinj njëri mbi tjetrin”, *plane* “hije, vegim”, *pehlivan* “njeri i shkathët”, *pikëllesë* “pikëllim”, *pipingo* “spitullaq”, *plaçka* “rroba”, *plaçkaxhi* “njeri që merret me shitje rrobash”, *pestil* “lëng a qull kumbullash të ziera, që hapet në tepsi, thahet në diell dhe përdoret për t’i dhënë gjellës një shije të veçantë pak si të athët”, *plevit* “sëmundja e rëndë e mushkërive”, *plithar* “qerpiç”, *plëng* “pasuri, mall”, *pojak* “roje”, *pojakllëk* “rojtari”, *pojatë* “kasolle bagëtie e mbuluar me dushk”, *poçar* “njeri që bën poçe”, *poçe* “enë prej balte”, *protomars* “fillim marsi”, *pirinxh* “bronx, tunxh”, *prytan* “kryegjyqtar”, *përdhes* “cermë”, *përgjëratë* “përgjërim”, *qelbak* “gjitari i egër sa një shqarth, me hundë të ngritur, me lëkurë në ngjyrë të çelur në pjesën e sipërme dhe të errët poshtë, që ha minj, pula etj. dhe që lëshon një erë të keqe për t,u mbrojtur nga egërsirat e tjera”, *qetë* “shkëmb i madh shumë i thepisur” *qereç* “llaç me gëlqere, që bëhet shumë i fortë”, *qiqërimë* “mjegull e lehtë”, *qikalore* “majë, thumb”, *qivur* “arkivol” *qojle* “rob, skllav; shërbëtor”, *quar* “katua”, *qymez* “vendi ku mbahen pulat”, *rajallëk* “fshatarësi e varfër”, *ramë* “bakër”, *refene* “llogari”, *regëtimë* “rrahje e zemrës me të dridhura, grahmat para vdekjes, dridhje e lehtë e një drite të dobët”, *resë* “smirë”, *rëbozh* “rrobull”, *rizë* “peshqir”, *rosan* “suva e fortë për të mbrojtur muret nga lagështia”, *rob* “njeri”, *robinjë*, *rondokop* “njeri që ecën në mënyrë të çrregullt”, *rusp* “monedhë e vogël floriri”, *rregallë* “vend i pjerrët i mbushur me gurë”, *rrëmet* “diçka me shumicë”, *rrësk* “mall, gjë, plaçka”, *rrëzall* “rrënja me gjithë fijet apo degët”, *rrezhdë* “copë e grisur fasha-fasha”, *rrofatë* “copë e madhë, gur i madh”, *rrotullë* “rreth i vogël, i plotë, i trashë, me një vrimë në mes, që vihet në bishtin e një vegle ose përdorëseje”, *rrozgë* “lëmishte, kërcu me cokla që sjell lumi”, *sahishtë* “vend me hije”, *salavate* “nderime të mëdha”, *sallkën* “akacie”, *sarikë* “shtizë e gjatë që përdorej në ushtrinë maqedonase”, *sem* “kufi”, *silah* “brez i lëkurtë, shpesh i zbukuruar me qëndisje të arta”, *sinjak* “brymë e hollë që mbulon drurët në dimër”, *sixhim* “spango, fije”, *syngjitat* “luftë me thikë ose me bajonetë”, *skorovod* “lugat”, *somune* “bukë gruri në formë të rumbullakët”, *shakullimë* “erë e fortë që sillet rrotull e ngre pluhur përpjetë”, *shamshallo* “njeri i çrregullt në të folur, në të veshur, në të ecur”, *sharan* “kafshë (kalë, dash, dele) me turi të bardhë, përzier me të murrme”, *shavarinë* “vend ku rritet shavari”, *shekle* “enë e drunjtë që bëhet nga dërrasa të shtënguara me rrahtë për të mbajtur bulmet”, *shembëtirë* “vend i rrëzuar, gropë”, *sheputkë* “zhgualli që mbështjell frutin e gështenjës”, *shkrepje* “krunde që kanë dhe miell”, *shinik* “enë druri e rumbullakët, që shërben si masë drithi dhe që ka madhësi të ndryshme sipas krahinave (nxë nga 25 deri në 110 okë); sasia e drithit që nxë një enë e tillë”, *shkorretë* “shkurre”, *shkurtë* “petk i sipërm prej shajaku ose prej pëlhure, i hapur përpara e me mëngë, që arrin deri në gju ose deri në mes; xhaketë e shkurtër grash, zakonisht e mbushur me pambuk dhe e rrahur me tegel”, *shqytëtar* “njeri që

lufton me shqytë”, *shtringël* “objekt i vogël, zakonisht zbukurimi (vath, unazë etj.)” *shtrofkë* “strofkë”, *shtrojcë* “lëkurë deleje a dhie, e tharë, postiqe”, *shtërpinj* “hardhucat”, *shukretë* “shpullë e fortë”, *shullër* “vend që e zë mirë dielli dhe nuk e rreh era”, *shultër* “tatëpjetë”, *shurishtë* “sipërfaqe toke me rërë e zhavor”, *shërëmëtimë* “psherëtimë”, *sillë* “afsh”, *sinora* “kufi”, *skile* “dhëlpër”, *skopak* “kafshë mashkull i tredhur”, *skotë* “racë”, *skripeckë* “rotkat e veglës ku varet spangoja e lidhur me lisat”, *skurë* “mysliman”, *sojtar* “njeri prej soji”, *sorollop* “farefis i largët”, *sosja* “vdekja”, *stap* “shkop”, *stavë* “grumbull drush ose gjërash të tjera të vëna me radhë njëra mbi tjetrën, stivë”, *stereni* “një nga drurët e anijes për të nderë pëlhurat”, *stomnë* “enë prej balte që shërben për të mbajtur ujë”, *stringël* “sende stolie si: vëthë, unaza, byzylykë etj.”, *stërnishte* “arë e korrur që lihet që lihet për një kohë si kullotë ose mbillet përsëri me një bimë tjetër”, *sundonjës*, *suvalë* “valë e furishme”, *sërë* “radhë”, *stërvinë* “kërmë”, *tabut* “arkivol”, *tagar* “një lloj site prej lëkure”, *tarak* “dem”, *takije*, *taler* “tinar për të shtypur rrush”, *trapezitë* “njerëzit e bankave”, *tallamaz* “daulle e vogël”, *tatë* “baba”, *tatrivan* “mjet transporti i mbyllur, që mbahej nga dy njerëz”, *taminë* “tringëllimë”, *tebabi* “shtresa më e ulët e njerëzve që jetojnë nën mbrojtjen e bejlerëve”, *tejqyrë* “dylbi”, *teneqçkë* “fletë e vogël e hollë hekuri e veshur me një shtresë shumë të hollë kallaji e cila mund të punohet lehtë dhe përdoret për të bërë enë të ndryshme”, *teferiç* “shëtitje për tu prehur, për t’u zbavitur”, *tevatyrë* “fjalë të shumta që thuhën poshtë e lart ose zhurmë që bëhet për një njeri a për një çështje”, *toptanxhi* “ai që i shet mallrat toptan, pra pa i ndarë në pjesë”, *tragë* “gjurmë; vija që le rrota e qerres në tokë”, *trambë* “shkëmbim”, *tredhak* “kafshë mashkull i tredhur”, *tëmbli*, *tërsëllëmë* “inat, egërsi”, *tërkuzë*, *trisai* “bllok i vogël ku shënoheshin emrat e të vdekurve”, *tullaxhi* “njeri që merret me përgatitjen e tullave”, *turi* “fytyrë”, *tyrymbetë* “bori”, *thellëtirë* “vend i thellë” *thembër* “femër”, *thirrmë* “thirrje”, *thjeshtër* “djali që gjen gruaja e dytë e një burri nga gruaja e parë e tij ose djali që i shpie gruaja burrit nga martesja e saj e parë”, *ushë* “kasolle e vogël e ndërtuar me degë e fletë”, *vojtinë* “vend me kodra njëra pas tjetrës”, *urdhëratë*, *valishtë* “ortek”, *valth* “luginë e vogël”, *vashë*, *vastangar* “një shkop i trashë i kthyer në majë zakonisht përdoret për të mbajtur barazpeshën gjatë shkarkimit të barrës së një kafshe”, *vezullimë* “përndritje”, *vigmë* “thirrmë”, *vilar* “rrip i gjatë e i ngushtë i diçkaje”, *viran* “njeri i shkretë, i braktisur”, *vilustë* “copë e lëmuar me shkëlqim dhe me push”, *votrome* “dëborë e hedhur e hedhur me erë”, *vraç* “kalë i zi”, *vrundull* “vrull”, *vullajë* “gëmushë”, *vëllamëri* “vëllezërit jo prej një gjaku, por që lidhen me besë si të tillë”, *vëllazëri* “njerëzit e afërt me lidhje gjaku” *visako* “vit i brishtë”, *xhidavi* “plagë që i del kafshës nga samari në pjesën e ngritur në fund të zverkut tek bagëtitë”, *xhëghonë* “bujë e madhe”, *zabullimë* “zagushi”, *zahire* “ushqimet e dimrit”, *zali* “të fikët”, *zamzane* “enë për të mbajtur rakinë”, *zbardhëllimë* “agu i ditës”, *zemberek* “çelësi me të cilin kurdiset ora”, *zgrip* “buza e një gremine, e një shkëmbi të thepisur”, *zgurdh*

“fundi i zorrës së trashë”, *zgërbonjë* “dru i tharë, i ngrënë nga krimbat”, *zullum* “teprim i një veprimi duke përdorur forcën”, *zhabllimë* “zhurma që bëjmë kur ecim mbi gjethe të thata”, *zhallogë* “copë prej lëkure ose prej leshi që vihet në tavanin e opingës, zakonisht nga brenda për të mbrojtur putrën e këmbës; copë e vogël lëkure që përdoret për të arnuar këpucët”, *zhargë* “këpucë të vjetra të grisura” *zhgan* “tufë, lukuni”, *zhingë* “bubuzhel”, *zhvalinë* “ortek bore, vend me gurë”, *zhizhë* “gjinkallë” etj.

Duke analizuar dialektalizmat e Kutelit sipas tipave leksiko-fjalëformues vihet re se brenda grupit të dialektalizmave emërorë mbizotërojnë fjalët e thjeshta, e pastaj vijnë me radhë fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra. Si fjalë të thjeshta përmëdim: *aht* “psherëtimë, rënkim”, *bluzhdë* “lakër, barishte e grirë dhe zierë, që përdoret për ushqim”, *brrac* “vjedhës xhepush”, *buki* “broke drunjtë për të mbushur ujë”, *bullë* “grua që zbukuronte e stoliste nusen e re kur martohej dhe përcillte atë deri në derë të burrit”, *bic* “derrkuc”, *cen* “ves”, *dackë* “shpullë”, *dhogë* “dërrasë”, *dordolec* “figurë e ngjashme me njeriun, që bëhet me shkopinj, me rroba të vjetra etj., që vihet në kopshte e ara për të trembur shpendët dëmtues”, *drakmë* “dhrami”, *gdhe* “një shumë e fortë në dru a dërrasë”, *glyrë* “vegël muzikore e bërë prej lëkure druri, sidomos prej gështenje, e nxjerrë rathë-rrathë”, *guak* “lloj pëllumbi i egër shtegtar, me trup të mbuluar me pendë ngjyrë hiri në të kaltër dhe me pendë të larmë”, *gufu* “shpellë”, *gërnjë* “grindje”, *cingël* “shkop i shkurtër, i prerë pjerrtas në të dy anët, me të ilin luajnë fëmijët duke e goditurme një shkop më të gjatë”, *gjes* “nxitje”, *gjep* “kallam i hollë për të mbështjellë fije”, *japi* “trupit, gjatësia e tij”, *krazë* “lak prej fijesh bishti kali për të zënë zogj” *këllk* “secila nga dy pjesët anësore të trupit; aftësi”, *kith* “mjegull e hollë, që vesh majat e maleve, ose bie në vende të ulëta kur ndërton moti”, *plane* “hije, vegim”, *pupë* “valë”, *legëtyrë* “ushqim i lëngshëm me ujë e krunde për bagëtitë”, *lingë* “zile e vogël që u varet kafshëve”, *llabanë* “kapuç i madh që përdoret nga barinjtë për t’u mbrojtur nga shiu e nga dëbora”, *llapë* “gjuhë”, *llërë* “parakrahu”, *napë* “trastë prej leshi e endur rrallë, ku hidhet djathi ose gjiza që t’i kullojë hirra”, *nofkë* “emër i dytë që i vihet dikujt për tallje, për shaka a përkëdhelje, duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar tjetër dallues i tij”, *nëmë* “mallkim”, *niqa* “kontrata e martesës, sipas së cilës gruaja është e detyruar t’i paguajë gruas së tij në rast divorci”, *oputë* “gjalmë, rripi i opingave”, *trëmbë* “vilar, top pëlhure i bërë në shtëpi”, *trirë* “rrjetë e thurur me degë për të tharë fruta, për të mbyllur vathën, tezgë”, *ojnë* “llastim, përkëdhelje”, *okë* “njësi e vjetër peshe rreth një kilogram e një çerek”, *opllaf* “një lloj të yshturi, magji”, *otra* “spango e trashë dhe e fortë zakonisht e bardhë ose e verdhë”, *plloskë*, “enë druri e rrumbullakët për të mbajtur ujë, verë etj.”, *qokë* “rast i jetës së njeriut, si lindje, fejesë, martesë etj., në të cilin duhet shkuar për të bërë zakonin”, *reng* “dredhi”, *retër* “robo e grisur”, *rrozgë* “shkorret, vend me ferra”, *sem* “kufi”, *setrë* “xhaketë”, *shur* “rërë”, *shushë* “xhade”, *skistër* “vegël prej metali që përdoret për të pastruar

dysshemetë nga mbeturinat e ngurta”, *stivë* “grumbull gjërash të vëna në radhë njëra mbi tjetrën”, *sumbull* “kopsë”, *tagji* “lloje të ndryshme drithërash, zakonisht kokrra të cilat u jepen si ushqim kafshëve të punës ose bagëtime të trasha”, *tengëll* “xhingël zbukuruese prej metali të hollë”, *troskë* “bimë që mbin vetë dhe shumohet shumë duke penguar kështu mirërritjen e grurit, elbit etj.” *trumbë* “tufë, grumbull”, *vraç* “kalë i zi”, *valomë* “valë shumë e madhe, trazirë”, *vërë* “vrime”, *zefk* “dëshirë”, *zët* “inat”, *zybë* “njeri i pazoti, i trashë nga mendja” etj.

Kuteli ka përdorur në veprën e tij edhe shumë emra të prejardhur, të cilët janë pak ose aspak të njohur dhe, me anë të rigjallërimit apo rifreskimit të tyre, ai ndihmon për pasurimin e gjuhës letrare duke zgjeruar vargjet fjalëformuese, prejardhjen fjalëformuese dhe semantikën e saj. Disa nga mjetet fjalëformuese të përdorura prej tij janë prapashtesa të tilla, si: *-ak, -ale, -ar, -im, -ishtë, -li, -nik, -një, -ore, -ri, -tar, -uc, -ule, -ës* etj., si: *agullimë, babale, besëtar, bredhishtë, buçimë, buljareshë, bërtimë, cingunëri, çupëri, djallush, djeguri, djemuri, drejtar, drekëtar, dreqush, drizonë, dusherjë, fqinjëri, fshatarak, fushëtirë, gjahtoreshë, gostiar, grunare, guriçkë, gurneckatar, gushell, iriqeshë, jakuce, kalori, kapadaillëk, kapule, karvanar, kedhëzë, dhëlpërushë, kobëtar, koshadhe, krapishtë, kreacor, krushqar, krushqëri, kshetëzë, kumerë, kunatëzë, kurbetliu, këllëk, lexonjë, linjëzë, lotore, lugajë, lëçitës, lëmizhdë, magjëtore, mituri, mjegullishtë, motërzë, muziktar, ngordhalaq, nipëri, njerëzi, noteshë, notishtë, palavoz, pasunar, pazarak, pianik, pipëtimë, plevicore, pushtanik, qarrishtë, qepaxhi, qiçërimë, qullnik, regëtimë, robeshë, robëreshë, rrogoztar, rropulli, rrugajë “copa gurësh e shkëmbinj”, shakatar, shatëzë, shkallëzimë, shoqezë, shpifararak, shtangësi, shtrigore, shërimtar, stanar, strunjak, stërmik, tapanxhë, tatëlosh, terrëti, thekëz, thellëtirë, thieshë “femra e dërrit”, urdhëratë, verdhaniku, vogëli, zabullimë, zezonë etj. Disa prej këtyre fjalëve, si: *agullimë, babale, besëtar, buljareshë, gjykatore* etj. mendojmë se janë formime të autorit.*

Në grupin e dialektalizmave emërorë të prejardhur krijojnë një grup të veçantë formimet me prapashtesën *-kë*, si: *cërkë, defterkë, dhëmkë, dockë, dredhkë, dremkë, flamurkë, gllënkë, gurneckë, kadishkë, kleçkë, kockë, këndeskë, këpuckë, kërpudhkë, kërrkë* “kërric i vogël në ngjyrë të përhimë”, *ledhkë, llupashkë, lopkë* “diçka në sasi të vogël”, *majuckë, ngjelkë, odiçkë, pepellashkë, peshkulkë* “peshk i vogël”, *plëncë* “plënc i vogël”, *pyetkë, përdhëskë, skërpinjë* “një lloj këpuce me majë dhe takë të hollë”, *skërkë* “copë e vogël toke e djerrë”, *syçkë, tërtëllashkë* “vajzë a grua që flet shumë”, *veshkë, virankë* “femër e shkretuar, e braktisur”, *yllkë, zoçkë* etj. Fjalët në këtë rast përveç kuptimit bazë marrin edhe nuancat e përkëdhelisë apo të ironisë së lehtë, sipas rastit. Shprehësia rritet sidomos, kur ato jepen të grumbulluara në tekst. Për shembull: ...na kishin një çupë të vetme, një **zonjëzë miuçkë kocomiuçkë** me **turiçkë** e **turuçkë**... me këto **syçka** vëngëroshka, njërin te mana tjetrin te thana; me këto **veshka** llapushka, sit ë atij mikut që kemi

poshtë në katua; me këto **cullufka** si xhufka kulmaku; me këto **këmka** kleçka e stërkleçka, si e Bukura e Dheut. (Vepra 3, f. 440); Kish një **përdheshkë** sa një qymez pulash, me strehë të varur. (Vepra 1, f. 280); ...i bie Tili Samarxhiut t'i shkulë ca **lopka**, se futi dy gomerë me thekërishte nëpër Pazar, shkeli udhën, shkeli të drejtën e bazhdarit. (Vepra 1, f. 273); ...na erdhë me kopsa e **flamurka**, me gazeta e **kalendarka** ... Tashi i sheh udhës me **gomarka** e me rroba të grisura. (Vepra 3, f. 305) etj.

Prejardhja, më konkretisht prapashtesimi, është një dukuri e rëndomtë te Kuteli dhe duket se prapashtesat përdoren për të sjellë dallime kuptimore, funksionale dhe stilistike; një grup formimesh të tilla të ngarkuara me ngjyresa stilistike, janë emrat e formuar me disa prapashtesa me burim vendas dhe me burim të huaj, si: *-injë, -çi, -eshë, -llëk, -xhi*: *baballëk* “mirësi”, *batakçi, bejllëk, bollëk, çifçeshë, çiflikllëk, dasmoreshë, duvaxhi, fiknaxhi* “njeri që fut spica për të armiqësuar të tjerët”, *gjahtoreshë, hallexhi, haremllek, iriqeshë, kalldrëmxhi, kapadaillëk, këllëk, plaçkaxhi, pojakllëk, rajallëk, sajaxhi* “ai që nget sajën”, *sehirxhi, skllavinjë, sojtareshë, thieshë, tullaxhi, zorraxhi* etj. Për shembull: ... kur çatis dita, mblidhen **dasmoreshat**, i venë çupës këna e mazi, të bardhë e të kuq, bëjnë dasmë, i këndojnë nuses bukurinë. (Vepra 1, f. 244); Mirë, nënoke, që tashi e tutje nuk do t'i zë në gojë as dhjetarët, as **fajdexhinjtë**, as **plaçkaxhinjtë**. (Vepra 3, f. 449); Lëkurën e kish të hollë si cipën e qepës, se nuk e nxirrin kurrë në shi e në diell. S'bënte si ne, **qepaxhinjtë**, që rrimë tërë ditën me shatë në dorë, natën thurim qepë, në mëngjes dalim e lajmë në lumë, me kopan, pastaj shkojmë prashitim e shkulim qepë, thurim. (Vepra 3, f. 442); Mbreti është mbret, s'është **qepaxhi**. (Vepra 3, f. 424); Edhe ti do ta kesh punën mirë se do të bëhesh nënë **kraleshe**... Atyre u qesh buza të bëhen **kralesha** e të mos shkojnë për shkarpa. (Vepra 4, f. 280); ... fjala i vajti në vesh së shoqes, **pashalleshës**. (Vepra 1, f. 82); **Zorraxhi** ka qënë, **zorraxhi** ka mbetur. (Vepra 1, f. 323); Puna e **bejllëkut** e **çifçillëkut** do marifet. (Vepra 1, f. 65); Njëri është **lëkuraxhi**, tjetri **hambarxhi**, i treti **manifaturaxhi, toptanxhi** me magazëra të mëdha. (Vepra 1, f. 321) etj.

Në veprën e Kutelit janë karakteristikë vetjake përdorimet dyshe: emra të gjinisë mashkullore, të cilat shërbejnë si tema fjalëformuese plus emra të gjinisë femërore të krijuara me anë të prapashtesave *-eshë* dhe *-injë*. Çifte të tilla sjellin vlera të veçanta në rrafshin stilistikor, si për shembull: ... reshpërojnë **xhindet** e **xhindseshat**, sapo falet dielli prapa maleve. (Vepra 4, f. 373); Pastaj dolën **sojtarët** e **sojtareshat** të lyera me blozë e me humbë të kuqe, si rrogeçë e luajtën në litar që të mahnitet i madh e i vogël. (Vepra 4, f. 382); A mos do të vriste ajo mendjen për punë? Punët i bënin **sklleverit** e **skllavinjat**. (Vepra 4, f. 383); **Thiu** e **thiesha** shkonin e vinin herë andej, herë këtej dhe **fshinin** me bar turinjte e përlyer me thiu gjak. (Vepra 4, f. 318) etj.

Një kategori më vete te Kuteli përbëjnë emrat e krijuar me anë të parashtesës *-nën*, për shembull:

Po ashtu, sipas shijes vetjake kishin kallkanosur edhe mollëzat e **nënmollëzat**. (Vepra 1, f. 317); Enkeleu vinte kaluar mbi një kalë të thjermë ndenjtur në një lëkurë ariu të palosur më dysh dhe të mbërthyer mirë me rripin e kraharorit, me **nënbishten e nënbarkëzën**. (Vepra 3, f. 17) etj.

Te Kuteli ndodh jo rrallë, që e njëjta fjalë të marrë nuanca të holla kuptimore, përveç vlerës së shtuar stilistike, përmes ndajshitesimit: *Ne s'jemi nga ata që u falen shtrigave e shtrigoreve*. (Vepra 4, f. 470), fjala *shtrigore* e formuar me prejardhje, me prapashtesën *-ore*, nënkupton një shtrigë të re në zanatin e vet. Po kështu, në shembullin: *Angullijnë qentë, alurijnë ujqit e çakajtë, kuisin djajtë e djallushët nëpër shkëmbinj*. (Vepra 4, f. 460). Këtu, këtë lloj dallimi e bën prapashtesa *-ush*. *Djallush* nënkupton të vegjlit e djallit, shpjegim ky që jepet edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980.

Kuteli e përdor prapashtesën *-ore* edhe për të krijuar njësi leksikore të cilat shërbejnë për të emërtuar bashkëshorten e një personi, ose për të përcaktuar kombësinë e personave të gjinisë femërore, por ajo që është më e rëndësishme është se përdorimi i tyre rrit shprehësinë e tekstit, sidomos në përdorimet dyshe. Për shembull: *Dil moj Sinanore, se ka ardhur ai xhaxhua me poçe e misurë*. (Vepra 1, f. 331); *Pastaj Shabanorja i jepte lajmin Halitores, Halitorja Xhemalores e kështu me radhë, gjersa e merrte vesh tërë fshati*. (Vepra 1, f. 332); *Allah-bir janë frëngë e frëngore*. (Vepra 1, f. 317); *Ç'është e drejta, atyre s'u bëhej vonë për Frëngun e Frëngoren e tij, për Nemcin e Nemcoren e tij, për djallin e djalloren që, thoshin, le t'i nxirrnin sytë njëri-tjetrit*. (Vepra 1, f. 194) etj.

Shembujt e mëposhtëm tregojnë se janë pasuruar semantikisht edhe emrat e formuar me anë të parashtesës *-stër*, të cilët emërtojnë dukuri, cilësi etj., që kanë brenda tyre teprimin, zmadhimin ose emërtojnë farefis shumë të largët, si: *allallajkë-stërallajkë, borxh-stërborxh, kuçedër-stërkuçedër, kuçkë-stërkuçkë, lëng-sterlëng, makutëri-stërmakutëri, mbesë-stërmbesë, nip-stërnip, nipëri-stërnipëri, plak-stërplak, punë-stërpunë, vëllazëri-stërvëllazëri* etj. Siç dihet, parashtesa *-stër* “është nga të paktat parashtesa të mirëfillta në fushën e emrave dhe që nga pikëpamja e origjinës lidhet me latinishten extra”²⁷. Te emrat kjo parashtesë bashkohet me:

- a) tema fjalëformuese emërore, të cilat zakonisht janë tema të parme, si:
borxh,

dhëmb, fajde, njeri, plak, punë, kleçkë, mik etj. Për shembull: *Dy vjet e ca mezi lamë paratë e udhës, me fajde e stërfajde*. (Vepra 3, f. 421); ... *agallarët e bejlerët janë turrur si Ingjilizi nëpër dete për të zaptuar me borxhe e stërborxhe arat e botë*. (Vepra 1, f. 325); *E sollën murtajën... me ca dhëmbë e stërdhëmbë si dikelë për të prashitur vreshtin*. (Vepra 4, f. 392); *Bujti atë natë në fshat, në shtëpinë e një plaku stërplaku me mjekër të bardhë gjer në brez e me vetullat strehë*. (Vepra 4, f. 341) etj.

27. A. Xhuvani – E. Çabej. art. cit. f. 44.

b) me emra që shënojnë lidhje familjare me largësi brezash, si: *mbesë, nip, kushëri, baxhanak* etj. ... *ndjeva se më ngritën lar duart e përgjëruara të nënës e më shpunë në odën e zjarrit ku flinin fëmijët e tjerë – kushërinjtë e stërkushërinjtë.* (Vepra 2, f. 157); *Më tej për të forcuar oxhakun u martua me një bijë pashai, mbesë veziri, baxhanakë e stërbaxhanakë* sulltani. (Vepra 1, f. 83) etj.

c) me emra përmbledhës, si: *vëllazëri, nipëri, krushqëri* etj. Për shembull: *Siç do ti që t'i kesh të tre djemtë të shtuar me nipëri e stërnipëri, ashtu dua edhe unë.* (Vepra 1, f. 309); ...*për të vozitur tetë a nëntë shtëpi të vëllazërisë e stërvëllazërisë.* (Vepra 1, f.264) etj.

ç) me emra abstraktë, si: *makutëri, djallëzi, lirësi* etj. Për shembull: *Agò Zylali e kish në dorë t'i bënte ndonjë të mirë edhe miqësisë e stërmiqësisë.* (Vepra 1, f. 233) etj.

Në një qasje krahasuese të grupit të fjalëve të krijuara me parashtesën –*stër* të veprës së Kutelit me fjalët e këtij lloji të pasqyruara në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, kemi vërejtur ndihmën e autorit në fushën e fjalëkrijimit. Kështu, në këtë fjalor gjenden vetëm disa emra foljorë, si: *stërlodhje, stërmadhim* etj., si dhe disa prej fjalëve që kanë si temë fjalëformuese emra të përgjithshëm. Mungojnë në tërësi emrat e prejardhur me parashtesën –*stër* të cilët kanë si temë fjalëformuese emra përmbledhës dhe emra abstraktë, si: *vëllazëri, stërnipëri, makutëri* etj. Pra, ajo që duhet të theksojmë me forcë është aftësia e autorit për të kaluar nga formimet e zakonshme *stërnip, stërgjysh, makut*, në grupe të tjera leksikore.

Në veprën e Kutelit përbën një dukuri karakteristike përdorimi dyshe i fjalëve me parashtesën –*stër*, gjë që rrit ndjeshëm vlerat emocionore, shprehëse dhe kuptimore të tekstit dhe vë më në spikamë origjinalitetin e tij në përdorimin e gjuhës. Kjo duket në të gjithë shembujt e mësipërm, ku dyshja krijohet duke pranëvënë temën fjalëformuese dhe emrin e krijuar prej saj me anë të parashtesimit. Shprehësia e tekstit fuqizohet akoma më shumë dhe kur çifti përbëhet prej dy emrash të krijuar me parashtesën –*stër*, si për shembull: *Unë të mos e dua stërbirin e stërmikut.* (Vepra 4, f. 477) etj.

Brenda kësaj hullie, do të veçojmë një përftesë të krijuar nga autori duke përdorur si formante fjalëformuese dy parashtesa njëherësh, parashtesën –*tej* dhe –*stër*, gjë që flet përsëri për aftësinë e tij për të krijuar fjalë me nuancime të veçanta semantikore dhe për të ndihmuar në sistemin fjalëformues të shqipes. E tillë është leksema *tejestërgjysh*, e cila mungon në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980. Në këtë fjalor, formanti fjalëformues –*tej* përdoret në emrat foljorë, si *tejnngopje, tejjpekje, tejnxehe* ose në foljet *tejshpoj, tejshtrij* etj. Në të gjitha rastet ky formant atje është i barazvlershëm me ndajfoljen *shumë*, ndërsa te Kuteli ai barazohet më shumë me ndajfoljen *larg apo shumë larg: Unë të kam mik nga gjyshi, stërgjyshi, tejestërgjyshi e*

tutje më tutje... im **tejtërgjyshi** me **tejtërgjyshin** tënd kanë qenë burra me *mustaqe*. (Vepra 4, f. 476). Të dy formantet së bashku janë në funksion të krijimit të një largësie të madhe brezash. Mendojmë se ky fjalëkrijim i bukur i Kutelit vlen të përfshihet në fjalorët e shqipes.

Në prozën e Kutelit janë me interes edhe emrat onomatopeikë të krijuar me anë të prapashtesës *-im*: *angullimë, buçimë, bumurimë, bërtimë, fërmëllimë, hamullimë, krokëllimë, pipëtimë, shërëmëtimë, trokëllimë, ungërimë, çuçurimë* etj.

Kuteli provon t'i përdorë të gjitha mjetet fjalëformuese, dhe kështu nuk mungojnë në veprën e tij edhe emrat e krijuar me anë të parashtesës *-pa*, emra me vlerë kryesisht në rrafshin stilistikor; kjo ndoshta, sepse ai përdor si tema fjalëformuese emra të parmë, ndërkohë që karakteristike për fjalëkrijimet me të janë kryesisht emrat e prejardhur. Për shembull: *U lëkunda sa u lëkunda midis gjumit e pagjunit*. (Vepra 2, f. 131) etj.

Në veprën e Kutelit, përveç vlerave shënuese, marrin vlera të veçanta në rrafshin stilistikor sidomos emrat abstraktë dhe përmbledhës, të formuar me prapashtesat *-esë, -si, -ri* etj. Për shembull:

-emra abstraktë: *Filloi djeguria*. *Këlkishën hovshëm gjinkallat*. (Vepra 3, f. 118); *Dhe zemrat gufonin në mes të djegurisë që dukej kaq e ëmbël*. (Vepra 3, f. 119); *Tërë ashtën e bjeshkëve e ka mbuluar terri i natës. Heshtje, shtangësi, gjumë*. (Vepra 4, f. 74); *...s'ditka kurrë se ç'qenka dhembja e pikëllesa*. (Vepra 1, f. 6); *Ama, që thua ti, lirësi të madhe na ka sjellë mbretëria!* (Vepra 3, f. 478) etj.

-emra përmbledhës: *Që atë ditë Muji nis e punon për vete...Tmerrohet ujqëria kur i ndjen hapin*. (Vepra 4, f. 59); *Shpesëria* *tulitet nëpër degë, tulitet në gjumë*. (Vepra 4, f. 66); *... beu zgjeronte çifligjet lart e poshtë, në skërrkat e bujqërisë*. (Vepra 1, f. 65); *Shpesëria ... cicërinte e ngazëllohej*. (Vepra 1, f. 6); *Ndërkaq Cecua humbi midis grarisë në një fron të vogël me tri këmbë, duke derdhur frullat e fustanit gjer poshtë në thembrat*. (Vepra 3, f. 474); *...filloi të rrojë mirë ai vetë edhe gjithë fqinjëria – sepse shatapani kish hequr dorë nga malli i tij*. (Vepra 2, f. 225); *...të gëzohej dhe ai, se mban dhëndëri e nusëri përsipër*. (Vepra 2, f. 207); *Luftonin asohere njerëzia me dyfeqe të gjatë sa për të fjetur dyzet pula*. (Vepra 2, f. 51); *...bejlerët dhe agallarët ta shtrojnë vetë harbutërinë*. (Vepra 3, f. 350) etj.

Si fjalë dialektore ose me ngjyrimë dialektore dalin edhe disa emra prejmbiemërorë, prejndajfoljorë, prejpreëmërorë etj., si: *të atyshmit, hiçërit, i këtushmi, i lartmi, ndajnatat, e pastajmja, e rrema, i sotmi* etj. Për shembull: *Shqipëria nuk mund të bëheshe për laskandurët, për ata që s'kanë veçse rripkën e kleçkën*. (Vepra 3, f. 479); *Errësira më e mirë se sa drita? E rrema më e mirë se sa e vërteta!* (Vepra 4, f. 41); *... të djegtë enjti yt me shigjetë zjarri po s'ia more një kënge albane! - thirri korrobeshi* (Vepra 3 f. 258); *Edhe të këtushmëve ua kanë frikën*. (Vepra 3, f. 250); *... Etleva kish nisur në Laveshtë një djalë të vogël, Batushin e Ballakrionit, për të lajmëruar të*

atjeshmit se ç'kish ndodhur në Drimonë. (Vepra 3, f. 181); *Tërë të lodhurit e asj dite të gjatë vere ia kish hequr ujët e liqerit, ku ish zhytur kur po kthehej nga puna.* (Vepra 3, f. 126); *Si mbaruan të përshëndoshurat Anyla u ul në një trung të luguar.* (Vepra 3, f. 94); *Është ajo egërtira, ime motër, kedhja.* (Vepra 3, f. 62); *Në ndajnatat e qeta të pranverës na tregonte ndonjë rrëfim të lashtë me hazna të fshehura nëpër shpella pa fund, ku nuk shkel dot këmba e njeriut.* (Vepra 1, f. 155); *Dashkan të marrin qeverinë në dorë, tua ndajnë tokën hiçërve.* (Vepra 3, f. 505); *Nëpër lugjet e gropat dergjet ende të zymtët e natës.* (Vepra 4, f. 131); *Po në çastet e ndërdysheve, kur shpirti i tij luhatej midis të kundërtave, i kujtohej Batuni i Drimonës.* (Vepra 3, f. 216); ... *i ke thënë të gjitha mynxyrat e asaj kohe dhe të pastajmes.* (Vepra 4, f. 196); *Nisen të dyzetët me motrën dhe vëllanë.* (Vepra 4, f. 472); *Si mbaroi të folët ky bujari Marko Arbënashi, ndenji dhe pakëz e pastaj u ngrit më këmbë.* (Vepra 2, f. 48) etj.

Mjaft emra krijohen me anë të prapashtesave zvogëluese *-osh, -oshe, -th, -thi, -zë, -z* etj. Këto fjalë, përveç vlerës shënuese, në disa raste, tregojnë edhe qëndrimin e personazhit apo të autorit ndaj diçkaje, përmes nuancave pozitive, si përkëdhelia, dashamirësia, apo nuancave negative, si tallja, ironia etj. Si të tilla kemi: *babale, birth, çunth, degëz, dheuth, ditëz, djalth, dyzë, flokëz, kripth, lajthizë, lugth, mëmëz, pulpëz, pëllumbth, qokth, vogëloshe, vëllath, zokth, zëth* etj.

Dialektizmat emërorë të përbërë janë jo vetëm më të paktë në numër, por, gjithashtu, “*ndryshe nga dy klasat e mësipërme, ata kanë më shumë karakter të përgjithshëm sesa karakter të ngushtë popullor*”²⁸. Të tilla janë: *babagjysh, babambret, çerekdhjetar, gjysmëdhjetar, gojëmbylluri, kartëcigare, kobëziu, kryedasmor, kryefaltar, nipstërnip, nusetrimja, paloburrë, paravithe, parëverë, prapapashi, përç-kapedani, rrethkomandant, shoqezeza, tetemadhe, xhingamingua, zemërqeni* etj.

Ata që kanë një vlerë të veçantë në rrafshin stilistik janë emrat e përbërë të krijuar prej emëzimit të mbiemrave të përbërë, të cilët marrin nuancime kuptimore dhe vlera të caktuara shprehëse, sepse brenda kontekstit ligjërimor ata shërbejnë për të dhënë qëndrimin e folësit, ndonjë tipar të personazhit etj., dhe jo në pak raste shënojnë vetë emrin e personazhit, pra një emër-nofkë, si: *ditëzeza, dorëthati, gjëmëmadhi, gojëlidhuri, gojëmbërthyeri, hundëleshja, këmbëkuqi, shoqezeza* etj. Për shembull: *Mos u nxito, gjakun do të ta marrin tim vëllezër. A mos kemi frikë se je kumandar i atyre kokëlakrave.* (Vepra 1, f. 198); *Ç'kish ndodhur? Veshllapushi i giorë kish ndërruar jetë nga frika dhe kish ngrirë në vend.* (Vepra 4, f. 322); *Ty do të të bëjmë, fli me thikë, në gërmadhat e shtëpisë së Batunit... Këmbështrembri u zbeh, po nuk u dha.* (Vepra 3, f. 177); *Në krye të tre muajve krisi dasmë e madhe, se martohet gjëmëmadhi me gjëmëmadhen.* (Vepra 4, f. 382); *Ky është mulliri i Hundëleshës, që bluan gëlqere të pashuar.* (Vepra 4, f. 449); *Aty u del*

28. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f.141.

përpara **Këmbëleshja** me një rën buzë në qiell me tjetrën përdhe, me hundën sa një spuell, me synë sa një qepë (se vetëm një sy ka **Këmbëleshja**). (Vepra 4, f. 451); *Shkop kish ky **Shkurto-dhaskali**, po këngë jo... Edhe Shkurtua kish një shkop sa veten, gjithë prej thane si të Qoses.* (Vepra 2, f. 106) etj.

Në veprën e Kutelit tingëllojnë si vetjake e tipike disa kompozita popullore me vizë lidhëse në mes, përdorimi i disa prej të cilave rrit valencën kuptimore, si: *gjumë-harresë, kalë-at, kurbeti-selameti, njerka-piperkë, plaka-guxhumakë, shoqeza-motërza, turku-ujku* etj.; ndërsa në disa raste të tjera ato dalin si lojë fjalësh dhe si të tilla e gjallërojnë ligjërimin, për shembull: *cinxulli-minxulli, hardhucka-gërdhucka, hoçët-doçët, onxhot-bonxhot, lalë-lule, mingot-pipingot, miu-kocomiu, nemo-nemuçkë, xhingra-mingra* etj. Për shembull: *Pa më t'iu mblodhë pastaj rreth e rrotull njato **zonjusha-zoga**, njato **zonja-pula** me **zotërinj- kaposhë** në krye edhe një tabor rosa e rosakë, të gjithë të pirë si në dasmë të Rogos beut.* (Vepra 2, f. 278); *Një nga këto fjalëzat thotë: "**Turku-ujku**". Dhe kur thua "ujk" i ke thënë të gjitha mynxyrat e asaj kohe dhe të pastajmes për qindra vjet me radhë.* (Vepra 4, f. 196); *Një ditë na vjen ngëc-ngëc, me stap në dorë, ajo shtriga e zezë, **plakë-guxhumagë, gufellë e çalë, si gjithë shtrigat e botës.*** (Vepra 4, f. 442); *Do ta pyesim edhe njëherë diellin, se sot s'qenka në vete. **Hardhucka-gërdhucka** i ka bërë magji.* (Vepra 4, f. 440); *Ne do t'u bëjmë varrin gjithë **hoçëve-doçëve** të botës, ne jemi fuqi e madhe, ne jemi më të shumtit.* (Vepra 3, f. 377); *Lënë gratë e fëmijët në shtëpi e shkojnë shtrojnë aheng në **Stamboll-hotel**.* (Vepra 1, f. 285); *Mirëpo dimri me dredhka kish prerë udhën e gjolit, sa nuk e çante as gjemia e Kaçamakut, as gjemia e Dios dhe sa vetë **zgalem-trimoshi**.* (Vepra 4, f. 372) etj.

2.1.2. Dialektizmat mbiemërorë

Dialektalizmat mbiemërorë (rreth 400) zënë vendin e dytë në veprën e Kutelit për nga denduria e përdorimit. Grupin më të vogël të tyre e përbëjnë mbiemrat e parmë, si për shembull: *brus* "që e ka zemrën të mbushur plot", *bullë* "që është e shëndoshë", *cingun* "dorështrënguar", *cuckë* "thuhet për frutin që është bërë shumë, që është i butë", *çyryk* "i prishur, i shkatërruar", *ficë* "e zbutur", *gdhë* "kokëfortë", *hurup* "që s'ka shtëpi të vetën", *kërr* "i zhveshur nga drurët e bimët", *makut* "i pangopur", *matuf* "që është jo në rregull mendërisht", *mingo* "që është i dobët", *qibar* "sqimatar", *shqeto* "i papërzierë, i pastër", *titis* "që nuk i jep dora", *ulok* "që nuk lëviz dot, i paralizuar", *xurxull* "i dehur", *i xhymertë* "dorëdhënë", *zgjyrë* "i palarë" etj., ndërsa më të shumtë janë mbiemrat e prejardhur dhe ata që janë formuar me anë të paranyjëzimit të pjesores.

Mbiemrat e prejardhur krijohen kryesisht me anë të prapashtesave *-ar, -ak, -all, -të, -ës, -man, -njës, -osh, -or, -ul, -ëz* etj., si: *balosh* "që i ka qimet e fytyrës krejt të bardha", *barbaç* "që ka të bëjë me arbëreshët e greqisë",

bardhosh “që e ka lëkurën të bardhë”, *e bardhëzë* “që e ka lëkurën të bardhë”, *barkor* “që ndodhet në pjesën e barkut”, *barkul* “që e ka të nxjerrë pjesën e barkut përpara”, *begator* “që jep prodhime të bollshme”, *biskonjë* “i hollë, i gjatë”, *bojalli* “shtatlartë”, *bubulak* “që digjet me flakë të madhe”, *bullafiq* “që i ka faqet e fryra”, *i bytyntë* “i ngathët mendërisht”, *çalkë* “që çalon”, *çalok* “që çalon”, *çapraz* “i praptë”, *dërrmajë* “i bërë copa-copa”, *fiknatar* “që fut spica, që fut sherr”, *freskoshe* “e freskët”, *fujake* “që është e njomë”, *fertile* “që nuk lind dot”, *finosh* “delikat”, *gagaritës* “zhurmues”, *i gjorë* “i mjerë”, *gojtare* “që flet bukur”, *gorarçe* “që vepron si gorarët”, *i grynjët* “që është prej gruri”, *gufallë* “i dobët kockë e lëkurë”, *guxhamagë* “që është si dosë”, *gërdhuckë* “e imët, trupvogël”, *gërmuqe* “kurrizdalë”, *gërnjëtar* “sherrxhi”, *harrage* “e shastisur”, *i hazërtë* “i bërë gati”, *hidhatake* “e hidhur”, *hidhërake* “e hidhur”, *i hollëz* “i hollë”, *katandisëz* “i mjerë, i rënë poshtë”, *kobash* “që merr diçka vjedhurazi”, *kobëtar* “që bën keq”, *korrobesh* “zeshkan”, *krekonjë* “që mbahet më të madh”, *kekosh* “që mbahet duke nxjerrë gjoksin para e kokën lart”, *i krirtë* “me shkëlqim prej sedefi”, *kullmë* “që ka ngjyrën të mjaltit”, *kuqalosh* “që është në ngjyrë të kuqe”, *i kuqëreshmë* “që vjen si i kuq”, *kënute* “i përhimë”, *kërcure* “që ka mbetur vetëm, pa njeri”, *lapërdhar* “gojëpistë”, *levorash* “shumë i lëvizshëm”, *lezetar* “i hijshëm”, *majoshe* “e athët”, *i mangët* “që s’është në rregull nga mendja”, *marrok* “i çmendur”, *i marrtë* “i zbehtë, i paqartë”, *matuf* “trutharë”, *mbrëmësor* “i errët”, *i mekur* “i shtangur”, *miturak* “i mitur”, *i moçëm* “i kaluar në moshë”, *mokrarçe* “që vishet si nga Mokra”, *morracak* “i qelbur”, *i motuar* “i bërë një vjeç”, *i mungët* “memec, i pagojë”, *murrak* “i murrëm”, *mëshirëtare* “që ka mëshirë”, *i ndjerë* “i dëgjuar”, *i ndërdushëm* “që nuk vendos dot”, *ngrodhaq* “i pafuqishëm”, *njomzak* “i njomë”, *i padjalë* “që nuk ka djalë”, *i panusëruar* “që nuk ka nuse”, *i papërkëmbur* “i pazhvilluar”, *i pasosur* “i pafund”, *palavos* “i pisët”, *pjellëtore* “pjellore”, *i prapë* “i keq”, *prekaman* “që ka preka në fytyrë”, *pupulak* “topolak”, *pusht* “që shkon pas femrave”, *i pëgërë* “i pisët”, *i përvojtur* “i vuajtur”, *i qielltë* “që ka ngjyrën e qiellit”, *i qëmoçëm* “i vjetër”, *i remët* “i bakërt”, *rondokop* “që ka fizik të çrregullt”, *shakatar* “që bën shaka”, *shishko* “i ndërkryer”, *shkurtabiq* “i shkurtër”, *i shkëmbtë* “shkëmbor”, *shtatanik* “i lindur para kohe, shtatëmuajsh”, *i shtërmadh* “që është shumë i madh”, *shurak* “që është prej shuri”, *i shushatur* “i hutuar”, *smirak* “që ka cmirë”, *spastronjës* “që spastron”, *stumbulaq* “njeri me gushë të madhe”, *i stërmadh* “që është shumë i madh”, *i stërtrashë* “që është shumë i trashë”, *tahmaqar* “që është i pangopur”, *tezgane* “e dobët”, *i thjermë* “që ka vetinë të përthyejë në mënyrë të rregullt rrezet e dritës”, *thumbace* “që bën shaka ose ngacmon me thumba”, *thuthuqe* “që nuk mund të shqiptojë mirë tingujt fishkëllyes (s, z, sh, zh) dhe në vend të tyre shqipton tinguj ndërthëmborë (th, dh); *i thëthirë* “i thithur”, *topolak* “buçko”, *trashaluk* “që e trupin të trashë, të ngjallur”, *trimosh* “trim”, *tringëllonjës* “që është kumbues”, *tullupane* “që e ka kokën pa flokë”, *ullastre* “në ngjyrën e ullirit të egër”,

vajtore “që vajton të vdekurit”, verdhanik “i verdhë”, i vogëlith “i vogël”, i zalisur “që i ka rënë të fikët”, zanatore “që është me përvojë të madhe në një punë”, zderre “llafazane”, zerzevul “i lëvizur, që nuk ze vend”, zezoshe “që është në ngjyrë të zezë”, i zëmbaktë “që është i bukur si zëmbak” etj.

Përsa u përket mbiemrave të krijuar me anë të paranyjëzimit më të përmendurit janë: *i akrosur* “i inatosur”, *i andrallosur* “i kapur nga problemet, nga vështirësitë”, *i babëzitur* “i pangopur”, *i bumbyer* “i enjtur, i fryrë”, *i bumbyer* “i enjtur, i fryrë”, *i dagëndisur* “që është në gjendje jo të mirë fizike apo shpirtërore”, *i dimëruar*, *i etosur* “i etur”, *i fimgjëllosur* “i mërzhitur”, *i fragjepsur* “i tharë nga era, nga dielli”, *i fraquar* “i tharë nga dielli, nga era”, *i harbuar* “i bredhur, i shëtitur”, “i jeremitur” “i përgjumur”, *i kallkanosur* “i ngrirë”, *i kapitur* “i lodhur”, *i krekosur* “që mbahet më të lartë”, *i kullundrisur* “i rregulluar, i veshur mirë”, *i kuturitur* “që ka një guxim të tepruar”, *i kënduar* “i lexuar”, *i marmarosur* “i bërë si dhi shterpë”, *i ngrysur* “i mërzhitur”, *i nisur* “i zbukuruar”, *i nemosur* “i mykur”, *i nginjur* “i ngopur”, *i nëmosur* “i mallkuar”, *i pendosur* “që është i mbushur me pendë”, *i qanitur* “që është bërë shumë mirë, i goditur”, *i qurrosur* “i trembur”, *i sëndisur* “i mërzhitur”, *i tapinosur* “i urtë, i bindur”, *i tarkalisur* “që i merren mendtë, i hutuar”, *i teptitur* “që ka dalë jashtë rrugës së drejtë”, *i tromaksur* “i trembur”, *i tulitur* “i strukur”, *i tulitur* “i strukur”, *i verbosur* “i verbuar”, *i zalisur* “që i ka rënë të fikët”, *i zgjebur* “i fëlliqur, i ndyrë”, *i zgurdulluar* “që i ka sytë e të shqyera”, *i zhelosur* “i rreckosur”, *i ziosur* “i pangopur”, *i zografisur* “i pikturuar” etj.

Kuteli është i kujdesshëm edhe në përdorimin e mbiemrave të përbërë. Këta lloj mbiemrash, siç ka vënë në dukje Jani Thomai, “*kanë më shumë karakter të përgjithshëm se sa karakter të ngushtë popullor dhe se ky tipar i tyre shfaqet si i tillë edhe në veprat e shkrimtarëve të tjerë*”²⁹. Kuteli di të shfrytëzojë shumë mirë gjedhet fjalëformuese popullore duke rritur e zgjeruar vargjet fjalëformuese të tipit: *barkbosh* “që e ka barkun bosh”, *barkmadh* “që e ka barkun të madh”, *barkthatë* “që nuk e ka ngopur barkun me bukë”, *belhollë* “që e ka belin e hollë”, *brifortë* “që i ka brirët e fortë”, *brirëdredhur* “që i ka brirët të dredhur”, *buzëbardhë* “që i ka buzët e bardha”, *buzëçarë* “që e ka buzën të çarë”, *buzëvarur* “i mërzhitur”, *cullufeverdhë* “që e ka cullufet e verdha”, *dhëmbëzi* “që i ka dhëmbët të zinj”, *ditëgjatë* “që ka jetë të gjatë”, *ditëzezë* “e mjerë”, *dorëdjathtë* “që përdor mirë dorën e djathtë”, *dorëdhënë* “bujar”, *dorëgjerë* “bujar”, *dorëhollë* “i varfër”, *dorëplot* “i pasur”, *dorëshkathët* “që punon shpejt e mirë”, *dorëshpuar* “që prish shumë”, *dorëthatë* “që nuk i jepet për të punuar”, *duarzbrazët* “që nuk sjell asgjë”, *dyzetkutësh* “që është i gjatë dyzet kut, tre metra e njëzet centimetra”, *emërmadh* “që është bërë shumë i njohur”, *faqebardhë* “i nderuar”, *faqekuq* “që i ka faqet e kuqe”, *festekuq* “që e ka festen të kuqe”, *fjalëmadh* “që flet me fjalë të mëdha”, *flakëmadh* “që bën flakë të mëdha”, *fletartë* “që i ka fletët

29. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 141.

e arta”, *fletëpruar* “që i ka fletët e pruarara, të arta”, *gazprurës* “që sjell gas”, *gjuhëhollë* “që është i shkathët në të folur”, *gjuhëprerë* “që nuk flet fare”, *gjuhëtrashë* “që nuk di të flaes mirë”, *gjysmëgollomesh* “gjysmëzhveshur”, *gjëmëmadh* “që bën shumë zhurmë e bujë”, *gojëhapur* “i mahnitur”, *gojëlidhur* “që nuk flet dot”, *gojëmyllur* “fjalëpak”, *gojëmjaltë* “që flet fjalë të mira”, *grykëhollë* “që e ka grykën të hollë”, *grykëthatë* “që nuk ka ngrënë gjë prej kohësh”, *gurxhezë* “e keqe, që kërkon t’u bëjë keq të tjerëve”, *hijerëndë* “që ka pamje të rëndë, të zymtë”, *hundëlesh* “i trashë, që mund t’ja hedhësh kollaj”, *hundësamar* “që e ka hundën në formën e samarit”, *hundëvarur* “i mërziur, qejfmbetur”, *jetëgjatë* “që e ka jetën të gjatë”, *kokëbosh* “që nuk ka mend”, *kokëlakër* “që i ka flokët e thinjur”, *kokëlidhur* “që e ka kokën të lidhur”, *kokëmadh* “që e ka kokën të madhe”, *kokëndezur* “i inatosur”, *kokëshkretë* “i pabindur”, *kokëtrashë* “që është i trashë nga mendja”, *kokëvarur* “i mërziur”, *kreshtështizë* “që e ka kreshtën në formën e shtizës”, *kryeprerë* “që e ka kokën të prerë”, *kuqzikuq* “që është në ngjyrë të kuqe dhe të zezë”, *kurrizdalë* “që e ka kurrizin të dalë”, *këmbëkuq* “që i ka këmbët në ngjyrë të kuqe”, *këmbëlehtë* “që ecën shpejt dhe pa pa u ndier”, *këmbëlepur* “që ecën shpejt”, *këmbëleshe* “që i ka këmbët me lesh”, *këmbëpulë* “që i ka këmbët të shkurtra dhe ecën si pulë”, *këmbështrembër* “që i ka këmbët e shtrembra”, *këmbëtaskë* “që i ka këmbët me shputë të gjerë”, *lavdëdashës* “që pëlqen ta lavdërojë”, *lemerimadh* “që është shumë i tmerruar”, *leshgjatë* “që i ka flokët e gjatë”, *leshgështenjë* “që i ka flokët në ngjyrën e gështenjës”, *leshkuq* “që i ka flokët në ngjyrë të kuqe”, *leshzezë* “që i ka flokët në ngjyrë të zezë”, *llërëbardhë* “që i ka llërët të bardha”, *llërëplotë* “që i ka llërët të shëndosha”, *lugëthatë* “që është i varfër”, *mendjefyell* “mendjelehtë”, *mendjehollë* “i zgjuar”, *mjekërbardhë* “që e ka mjekrën në ngjyrë të bardhë”, *mjekërfshesë* “që e ka mjekrën në formën e fshesës”, *mjekërverdhe* “që e ka mjekrën në ngjyrë të verdhë”, *mustaqepresh* “që i ka mustaqet të drejta si presh”, *mustaqeqërruar* “që i ka rruar mustaqet”, *mustaqeverdhë* “që i ka mustaqet në ngjyrë të verdhë”, *nazemadh* “që bën shumë naze”, *nofullmadh* “që i ka nofullat e mëdha”, *pendëlarushe* “që i ka pendët larushe”, *perëndilutës* “që i lutet perëndisë”, *qesethatë* “që nuk ka parë”, *sarikagjatë* “që ka veshur sarikë të gjatë”, *shkumbëbardhë* “që ka shkumbë të bardhë”, *shpatëzhveshur* “që e ka shpatën të zhveshur”, *shpirtkazmë* “zemërgur”, *shpirtzi* “që do t’i bëjë keq tjetrit”, *shqytarëndë* “që e ka shqytën të rëndë”, *sisëplotë* “që i ka sisët plot me qumësht”, *sqepgjilpërë* “që e ka sqepin si gjilpërë”, *syçoçkë* “që i ka sytë të kërcyer dhe të rrumbull”, *syplasur* “që nuk shikon mirë nga sytë, që gënjehet lehtë”, *sypëgërë* “që e ka syrin të keq e të merr më sysh”, *syzezë* “që i ka sytë e zinj”, *turispicë* “që e ka turinë të hollë si spicë”, *veshgjatë* “që i ka veshët e gjatë”, *vetullzezë* “që i ka vetullat e zeza”, *vithemadhe* “që i ka vithet e mëdha”, *vlukmadh* “që le vlagë të madhe”, *xhybemadh* “që ka xhybe të madhe”, *zemërbardhë* “bujar”, *zemërdredhur* “i frikësuar”, *zemërgur* “i pamëshirshëm”, *zemërquen* “që nuk ka

mëshirë”, *zemërthyer* “që nuk i është plotësuar dëshira”, *zorrëthatë* “që nuk ka ngrënë asgjë”, *zulmëmadh* “që është shumë i lavdishëm”, *zëmadh* “që është shumë i njohur” etj.

Shembujt e mësipërm janë mbiemra të përbërë ekzocentrikë, të cilët, në thelb, janë mbiemra cilësorë, por ndryshe nga mbiemrat e thjeshtë cilësorë të cilët tiparin e një sendi e shënojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, “*mbiemrat ekzocentrikë tiparin cilësor e shënojnë në mënyrë të ndërmjetuar*”³⁰. Pra, mund të thuhet, se këta janë cilësorë të zgjeruar të shprehur me një fjalë të vetme dhe se “*cilësimi i emrit, të cilit mbiemrat ekzocentrikë i vishen si atribut, bëhet duke u cilësuar një pjesë që zotëron qenia, sendi që shënohet nga emri përkatëtes*”³¹. Për shembull: *kaptinëzi* (që e ka kaptinën të zezë), *leshgështenjë* (që i ka leshrat në ngrën e gështenjës), *këmbëpulë* (që i ka këmbët si të pulës); *mjekërfshe* (që e ka mjekrën të gjatë e të dendur si fshesë) etj.

Dihet se mbiemrat e përbërë ekzocentrikë përdoren shpesh në krijimtarinë gojore dhe në gjuhën e folur dhe M. Kuteli, duke qenë se është një shkrimtar që në bazë të krijimtarisë së tij ka pikërisht këtë, i përdor dendur ata për të treguar cilësi fizike, shpirtërore e mendore të personazheve; ndërkohë që përdorimi i tyre sjell jo vetëm shprehësi stilistikore, por edhe ekonomizim të gjuhës.

Duke u mbështetur te struktura e kompozitave mbiemërore duket se në numër më të madh janë ato *emër+mbiemër*, si: *cullufeverdhë, gjuhëtrashë, jetëgjatë, leshverdhë, mjekërthinjur, zulmëmadh* etj., më pas vijnë ato të tipit *emër+emër*, si: *hundëlesh, leshgështenjë, mustaqepresh, zemërgur* etj.

Po t’i shohësh në tërësi fjalët e përbëra, qoftë emrat, qoftë mbiemrat, bie në sy mbizotërimi i temës emërore, ku paraprijnë kompozitat te të cilat njëra gjymtyrë përcakton tjetrën dhe jo kompozitat këpujore që përbëhen prej gjymtyrësh të barazvlershme.

Te fjalët e përbëra të mirëfillta të Kutelit vihet re se ato kanë një strukturë më të gjerë kuptimore, ndërsa po t’i shikonim të bashkuara, kuptimi i tyre do të dendësohej dhe mëvetësohej, dhe si i tillë do të bëhej edhe më shumë shprehës, për shembull: *arbërmohonjës, atdhemohonjës, ballëmadh, flakëmadh, gjuhëtrashë, gushëpëllumb lavdidashës, paloburrë* “burrë i keq, i pavlerë”, *perëndilutës, shigjetargjendi, therorsjellës* etj. Ndalemi konkretisht te mbiemri ekzocentrik *arbërmohonjës*, i cili shënon tipar përmes cilësimit të një pjese që zotëron vetë sendi që cilësohet nga mbiemri; nga ana tjetër është e rëndësishme të thuhet, se ai nuk zërthehet në togun “*arbër mohonjës*”, por zërthehet nëpërmjet marrëdhëniesh pronësore me emrin që cilëson, pra zërthehet në togun “*që është mohues i arbit*”. Brenda kësaj forme analitike, dy njësitë *mohues* dhe *arbër*, të marra secila më vete, kanë strukturë më të

30. Androkli Kostallari, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 97.

31. Po aty

gjerë kuptimore, se tërë kompozita *arbërmohonjës*, sepse veç e veç ato shenjojnë dy gjëra të ndryshme, ndërsa të ngjizura në një fjalë të vetme, ato kondensohen semantikisht, sepse të dyja së bashku kanë vlerën e një shenjuesi të vetëm. Gjithashtu, mbiemri ekzocentrik në fjalë fiton një përmbajtje të re cilësore “*e cila i vishet e gjitha si atribut drejtpërsëdrejti një nocioni substantivor të jashtëm për ta cilësuar*”³². Këtë përmbajtje të re cilësore, ky mbiemër e fiton, sepse përdoret në mënyrë të figurshme, të metaforizuar, gjë që rrit forcën e parafytyrimit për fenomenin e caktuar dhe bëhet më mbresëlënëse. Kështu mund të thuhet edhe për kompozitat e tjera të këtij lloji të cilat më së shumti janë fjalëformime të vetë autorit në funksion të rritjes së shprehësisë.

Në veprën e Kutelit sjell vlera të rrafshit stilistikor sidomos përdorimi i kompozitave me temë të njëjtë, si: *hundëgërvishtur; hundëlesh, hundësamar, hundëvarur, këmbëlehtë, këmbëlepur, këmbëpulë, këmbëshajkë; këmbështrembër, këmbëtaskë, mustaqedirsur, mustaqepresh, mustaqeqërruar, mustaqespice; mustaqeverdhë, syçoçkë, sykaltër, sylarushe, symadhe, syplasje, sypëgërë, syzi* e të tjera si këto. Por, jo rrallë përdoren edhe raste kompozitash të cilat kanë të përbashkët pjesën e dytë përcaktuese, për shembull:

As kësaj s'i dukej bukuria e shëmtia... fustanmadhe, nazemadhe xhybemadhe. (Vepra 4, f. 384); *...çatis laraska këmbëtaska, stolisur me një gjerdhan me guaska, si zonjë e rëndë: fustanmadhe, fjalëmadhe, zëmadhe.* (Vepra 4, f. 272); *Kapedani është mjekërzi, vetullzi, fustanezi.* (Vepra 2, f. 122) etj.

2.1.3. Dialektalizmat foljorë

Në ligjërimin e Kutelit kanë një përdorim të mjaft të gjerë edhe dialektalizmat foljorë. Me një llogaritje të përafërt shënohen rreth 250 të tillë, si: *adunarem* “mbledh veten”, *akrosem* “kërcënoj”, *begenis* “përfill, respektoj”, *begëndis* “respektoj”, *brazdoj*, *bret* “bërtet”, *brof* “çohet menjëherë”, *bubutin* “thërret fort, me zë të lartë”, *bubëtij*, *buj* “shkoj si mysafir”, *buçkaritem* “fryhem, ngrëfosem”, *cicërin cimbis* “pickoj”, *cingëlloj* “nxjerr një zë të hollë, tringëllon”, *çakërroj* “hap sytë shumë sa më shtrembërohen”, *çatis* “mbërrij”, *çetoj* “dal me një çetë për t’u ndeshur me dikë”, *çafkëlloj* “ngre mendjen”, *çaprashit* “ngatërroj”, *çatis* “vij menjëherë”, *çepkat* “shkriptom me duar, shprish”, *çulit* “hap dhe mbyll sytë rresht”, *darovit* “bëj dhurata”, *dasmoj*, *dermishem* “gjakosem, plagosem rëndë”, *dhëndëroj*, *drithmëron*, *dushkohem*, *dëndem* “ha shumë, ngopem”, *faroj* “shfaros”, *fingjillosem* “dëshpërohem”, *firos* “rralloj, e çoj diçka drejt fundit”, *fragjeps* “bën acar”, *fugon* “vrapon”, *fërmon* “fryn”, *gajasem* “mekem nga të qeshurit

32. Androkli Kostallari, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 98.

ose të qarët”, *gjegjem* “dëgjothem”, *gjeçë* “gjeta”, *gojos* “përflas”, *grazhdoj* “i shtie ushqim kafshëve në grazhd”, *gurosem* “ngurosem”, *harboj* “vrapiroj”, *has* “takoj”, *hiros* “mëshiroj, i fal mëkatet dikujt”, *iskros* “imtësoj”, *jaratis* “rregulloj”, *javit* “përkëmb”, *kalpëtoj* “zë të çarat e një fuçie, të një bucele etj. me shtupë liri, me lecka a me diçka tjetër që të mos rrjedhë”, *kandis* “bind”, *kapitem* “lodhem shumë sa mezi qëndroj në këmbë”, *kapsit* “pastroj grurin, misrin etj. nga kashta ose byky, duke e hedhur me lopatë në ajër, ose duke e hedhur në tepsi, hedh në erë”, *kaptoj* “kapërcej”, *karkanjosem* “bërtas”, *kashais* “kreh, pastroj e kruaj me kashai qimet e kalit, lopës etj.”, *kollofit* “përlaj”, *kollovitem* “tundem”, *kopanis* “rrah, shtroj në dru”, *kosarit*, *kotheris* “ndaj bukën në copa, në kothere”, *krekothem*, *kreshpëroj* “i bëj qimet a flokët të ngrihen përpjetë”, *kukat* “vë kujën”, *kuqëroj*, *këlkish* “këndon gjinkalla”, *lajthit*, *lamandryqem* “bëhem pis”, *lartoj*, *kukëzohet* “ngrihet kukumale”, *laturis* “fëlliq”, *lbardh* “zbardh”, *lebetitem* “tmerrohem”, *lkuq* “skuq”, *llafosem*, *llaftaroj* “tmerroj”, *llamps* “ndrit”, *llapashit* “përplas këmbët kur eci në ujë”, *llup* “përlaj”, *logorit* “qaj me të madhe”, *lolis* “e turpëroj, ia nxjerr bojën”, *lëçit* “lexoj”, *maqerisem* “therem, zihem me fjalë”, *mbllaçit*, *mbloj* “mblesëroj”, *mbretësoj*, *mbrëçel* “mbyll gojën”, *mburon* “buron”, *mejtohem* “mendohem”, *mekem* “mbetem pa frymë”, *mrizonte*, *mëngo* “ngrihem pa zbardhur mirë drita”, *mëno* “vonohem”, *nagas* “nxit”, *nakatos* “përziej”, *ndyj*, *ngjëroj* “provoj një gjellë për kripë e për shije”, *ngrafis* “nguros”, *ngrefosem* “krekothem”, *nguros*, *nomatis* “i bëj shenja dikujt me sy, me dorë apo kokë për t’i dhënë të kuptojë diçka”, *nçoj* “rrit”, *nëm*, *nëmos* “mallkoj”, *nunosem* “rrefehem (sipas kërkesave të fesë së krishterë)”, *ograis* “bie më sysh”, *pandeh* “kam përshtypjen”, *pickat* “pickoj”, *pikas* “zbuloj”, *pleqëroj*, *pllavit* “godas”, *prozhmoj* “flas keq për të tjerët mbas shpine”, *pshoj* “psherëtim”, *përkëmb* “gjallëroj”, *përlaj*, *përndahem* “shpërndahem”, *përrallos*, *përshëndosh*, *qahem* “ankohem”, *qasem* “afrohem”, *qetohem* “qetësohem”, *qëmëton* “bie shi ose borë e imët”, *regëtim* “rreh e dridhet (zemra)”, *reshpëroj* “bëj tregti të gjerë”, *resit* “fshij diçka të shkruar”, *rois* “shkalloj”, *roi* “iku shpejt, u zhduk”, *shembëllej*, *shkalloj* “çmendem”, *shkërfas* “rrjep lëkurën”, *shushuret*, *shushëllit*, *shërëmetij* “psherëtim”, *sokëllij*, *sosem* “mbërrij diku”, *stërfryj*, *stërlyhem*, *sëlloj* “godas”, *sërendit* “i vendos gjërat palë-palë, radhë-radhë”, *s’përpëronte* “s’nxirrte zë”, *taraksi* “u qetësua, pushoi”, *tekem* “më shkrepet për diçka”, *teptis* “vërshon, shpërthen”, *tintëllij* “vringëlloj, tringëlloj”, *tipos* “ngulit diçka në kokë, në mendje, në zemër, në kujtesë”, *truhem* “i lutem shumë, i përgjërohem dikujt”, *tutem* “frikësohem”, *tëholloj* “hap petë”, *tërhos* “përlan pjesën më të madhe të tufës”, *tëroll* “hap petë të holla me petës për byrek apo baklava”, *tok* “i shtëngojmë duart njëri-tjetrit”, *uhit* “fryj me frymën e gojës”, *unjem* “ulem, zbutem”, *urtohem* “më hahet ushqim”, *valloj* “los valle”, *vardisem* “i ngjitem”, *vegëloj* “punoj në vegël”, *velem* “stërngopem me diçka”, *verdhem*, *vlohem* “fejohem”, *volit* “më vjen për mbarë”, *vuvos* “ia mbyll gojën dhe veshët dikujt”, *vështjell* “mbështjell”,

xhaftoj “përpiqem shumë”, *xhindosem* “inatosem shumë”, *xhingëroj* “bëj zhurmë me sende të vogla prej metali që përdoren si stoli”, *ysht* “nxit”, *zalisem* “më bie të fikët, këputem”, *zbardhëlloj*, *zburruj* “i heq burrërinë”, *zgrap* “marr diçka pa të drejtë”, *zugrafis* “pikturoj”, *zgëllij* “zgurdulloj”, *zhabarit* “tund fort ujin a një lëng tjetër në një enë”, *zhdëpem* “ngjishem me të ngrënë”, *zhgalit* “rrëzoj” *zhuf* “rrah dikë”, *zhuzhërij* etj.

Ligjërimin e Kutelit e ngjyrosin kuptimisht e stilistikisht në veçanti foljet e prejardhura të formuara me anë të parashtesës –*stër*, të cilat japin një veprim të zmadhuar, si: *blojtur* - *stërblojtur*, *fishkur* - *stërfishkur*, *lagur* - *stërlagur*, *mëkëmbur* - *stërmëkëmbur*, *ngjeshur* - *stërngjeshur*, *nisur* - *stërnisur*, *puthur* - *stërputhur*, *kullandisur* - *stërkullandisur* etj. Për shembull:

Do të të degdis gjer në vend, në shpellë. Atje bëj ç’të duash me arinë: mundu e stërmundu, puthu e stërputhu. (Vepra 1, f. 257) etj. Dukuri gjuhësore tipike për Kutelin mbetet përdorimi dyshe i foljeve të krijuara me parashtesën –*stër*, gjë që përforcon stilistikisht ligjërimin e tij, njëlloj siç ndodh me emrat dhe mbiemrat.

Kuteli, si gjithë shkrimtarët e mëdhenj ndihmon me të gjitha mënyrat në pasurimin e gjuhës dhe kjo duket në mjaft fjalë të krijuara prej tij, sidomos në disa folje të krijuara me anë emrash, duke i shtuar prapashtesën fjalëformuese –*o*, si: *bandill* - *bandilloj*, *brazdë* - *brazdoj*, *burrë* - *burrnoj*, *dasmë* - *dasmoj*, *dhjetë* - *dhjetoj*, *dhëndër* - *dhëndëroj*, *dushk* - *dushkoj*, *farkë* - *farkoj*, *farë* - *faroj*, *gojë* - *gojoj*, *grazhd* - *grazhdoj*, *iskër* - *iskroj*, *kosë* - *kosarit*, *kukëz* - *kukëzohet*, *mriz* - *mrizoj*, *valle* - *valloj*, *vegël* - *vegëloj*, *velë* - *velëzoj*, *çetë* - *çetoj* etj. Për shembull:

Kur nisi të dushkohet mali, qyqja qëndroi mbi muranën e varrit të ri. (Vepra 4, f. 41); *Moj nënë, Muji ka dalë të çetojë me të tridhjetë zotërit e Jutbinës.* (Vepra 4, f. 30); *Dy nisin vallen e vallojnë, njëra rri i kundron e pikëlluar.* (Vepra 4, f. 78); *Pëlhura që kish vegëluar e ëma e Genthit për veshje të gëzuar dhëndërie ish bërë savan harrimi.* (Vepra 3, f. 181); ... *po të donte mund të farkonte një udhë të tërë me florin.* (Vepra 4, f. 379); *Dhelpërushët u binin veglave, ajo kasneconte siç kish dëgjuar tregtarët.* (Vepra 4, f. 304); *Gjer të palcohet pakëz me darova e me kokë të unjur përdhe, si bënte gjithë robi, Kuzi i Nestorit mori Vllahinë.* (Vepra 1, f. 113); *U hirosën brigjet, nisën të ndihen kronjtë.* (Vepra 2, f. 56); *U guros agai nga dhimbja.* (Vepra 2, f. 52); *Edhe ky brumbulli i Lenës gjithë brumbullonte, kur më pranë e kur më larg.* (Vepra 2, f. 79) etj.

Në prozën e Kutelit ndeshet dendur dhe përdorimi i foljes në kohën e tashme të mënyrës habitore, përmes së cilës “shprehet modaliteti i vërtetësisë, i shoqëruar edhe me ndjenjën e habisë së folësit për një veprim të papritur, që është kryer në të shkuarën ose që kryhet në çastin e ligjërimin.”³³ Me anë të tyre Kuteli realizon, pikërisht qëndrimin afektiv, por ndërkohë, bën dhe

33. Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 1995, f. 291-292.

aktualizimin e ngjarjes, pra bën që veprimi të kryhet përpara syve të lexuesit, gjë që sjell një ndikim më të madh te ai; pra, ndodh ajo që thotë Shezai Rrokaj se “aktualizimi rrit edhe më shumë kërshërinë, e cila në përrallë është domethënia e vetë së pamundurës që mund të bëhet e mundur falë habitores, si mënyrë dhe të tashmes së saj si kohë e ngjarjes (synimi informativ, pra përralla si e tillë) si dhe përkimit të saj me të tashmen e aktit kumtues (synimi komunikues, pra çfarë synohet nëpërmjet asaj që thuhet) që lidhet me çastin e ligjërimin.”³⁴ Për shembull:

Aty, ne Kroi i Shkëmbit, ardhkan e pikan ujë kuajt e të birt' të mbret. Mirëpo tani sapo u afruakan, u trembkan, hingëllikan, u ngritkan kas, kafshuakan frerët, ua dhënkkan këmbëve, shkelkan njerëzit... Sot, nesër mbetkan kuajt pa ujë. Atëhere vajtkan njerëzit e i thënkkan të zot: o i biri i mbret', pisk e kemi punën, se kuajt po na i djeg elbi e tërshëra. (Vepra 4, f. 462); Kjo e thëna i paske ardhur nga sevdaja. (Vepra 2, f. 46); Mirë bëke, i thashë, edhe mora targaçet të dal. (Vepra 2, f. 29); Eh, ne të mjerët, o Bushi, që s' ditekmi gjë. (Vepra 2, f. 31); ... i i i mor im zot si ardhkam unë në mes të burrave. (Vepra 2, f. 20); ... këta lalët e karvanit kripën e paskan bërë mexhite, mexhitet raki edhe ia paskan shtruar, në rogos, ne Han' i Petres. (Vepra 2, f. 285-286); ... në ato fushat e gjelbra rrjedhke një ujë që s' është ujë. (Vepra 2, f. 283) etj.

Te Kuteli haset shpesh edhe habitorja e modelit *qenkej mos na qenkej*, në të cilën është e pranishme dhanorja etike, një karakteristikë kjo tipike e ligjërimin popullor, më konkretisht e përrallës, për shembull:

Qenkej, mos na qenkej... Qenkej, moj, mos na qenkej. Na qenkej një mbret e na kishtre djem. (Vepra 4, f. 378); Qenke mos na qenke. Na qenke njëherë, në mal, një dhelprë dinake – si të gjitha dhelprat; na qenka dhe një ari sylesh si të gjithë arinjte. (Vepra 4, f. 510); E kur i paska rënë kjo gjë mbretit në vesh, na qenke hidhëruar fort e i paska dhënë urdhër të kurdiset një ferman i madh, sa një rrogos Svirinë edhe e paska vulosur me vulën e Dovletit e na i paska vënë vetë gishtin e tij... e kur e mbaruake së kënduari, të gjitha mjekrat që ishin aty na dridheshin sikur frynte er' e drethkës. (Vepra 2, f. 45-46) Se në luftë e sipër na paske pëlqyer një shkirë të bukur nga fshatrat e Ohrisë. (Vepra 2, f. 46) etj.

2.1.4. Dialektalizmat ndajfoljorë

Një grup të rëndësishëm në leksikon popullor të Kutelit e përbëjnë dialektalizmat ndajfoljorë, të cilët janë të shumtë në numër (rreth 350, pra në vendin e tretë, pas emrave e mbiemrave) dhe gjithashtu janë të shumëllojshëm për nga fjalëformimi: të parmë, të prejardhur, me parashtesim, prapashtesim, me përbërje apo me përngjitje, si: *allabraca* “sipas modës së Evropës perëndimore”, *arithi* “që qëndron mbi dy këmbët e parme”, *asfare* “aspak”,

34. Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2007, f. 45.

asohere “atëherë”, *atythi* “aty”, *atëkohë* “atëherë”, *bajat* “pa shije”, *bërlok* “copë-copë”, *capthi* “që qëndron mbi dy këmbët e parme”, *damkuku* “kuturu”, *derrçe* “me këmbëngulje”, *dinga* “plot e përplot”, *çmos* “gjithëçka”, *dyzash* “më dysh”, *dëng* “plot e përplot, sa s’nxë më”, *dërdëng* “përplot”, *esëll* “pa vënë gjë në gojë”, *farësisht* “gjer në farë”, *ferk* “kur dallohesh në një punë, kur bën emër”, *fil* “shëndoshë e mirë”, *fillall* “menjëherë”, *fillthi* “vetëm”, *fshaçe* “ashtu si sillen e veprojnë fshatarët”, *gafil* “në befasi”, *gjene* “përsëri”, *gjëkund* “në ndonjë vend, diku”, *grarishte* “ashtu si sillen gratë”, *hajdutçe* “fshehurazi”, *harram* “e shkuar kot”, *hëpërhë* “tani për tani”, *kikithi* “kur ecën në majë të gishtave të këmbës”, *kotmësikoti* “kot, pa nxjerrë gjë në krye”, *kotnasikot* “pa ndonjë qëllim”, *kullutumba* “të ecësh duke u rrokullisur”, *kështuzë* “në këtë mënyrë”, *këskëvrëk* “lidhur këmbë e duar”, *këtunë* “këtu”, *lehtazi* “lehtësisht”, *linkthi* “me vrap, me të shpejtë”, *maçokçe* “ashtu si veprojnë maçokët”, *mbrëmanet* “në mbrëmje”, *menatë* “herët në mëngjes”, *mezi* “me zor, me vështirësi”, *marrtas* “jo qartë”, *menatë* “herët në mëngjes”, *mezi* “me zor”, *mësysh* “e dëmton dikë duke e parë me sy të keq”, *namëta* “menjëherë”, *ngahera* “gjithmonë”, *njatythi* “aty”, *njëdizaj* “disa ditë më parë”, *njëmend* “tani, këtë çast”, *njëmenti* “me siguri të plotë, sakaq, patjetër”, *papandyer* “papratur”, *paq* “pastër; ja bëri mire; ashtu si duhet”, *pasandaj* “më pas”, *peshin* “menjëherë”, *pisk* “e ka keq punën, është në rrezik”, *pizgë* “plot”, *prapë* “përsëri” *prerë* “shkurt”, *purë* “i djegur me gjithsejt”, *pëllor* “pjellor”, *përngaherë* “përgjithmonë”, *përnjimend* “me të vërtetë”, *qibarçe* “në mënyrë sqimatare”, *qyq* “vetëm”, *qëkur* “para shumë kohësh”, *qëmenatë* “herët në mëngjes”, *qëmoti* “shumë kohë më parë”, *qirithi* “ngritur mbi dy këmbët e prapme”, *razi* “gati”, *rishtaz* “përsëri”, *rrokas* “për mesi”, *rëngë* “plot aq shumë sa nuk nxe më”, *rrëc* “plot sa nuk nxe më”, *rrëke* “me shumicë, me vrull, si përrua”, *sakaq* “menjëherë, në atë çast”, *sallmë* “me të drejtën për të bredhur i lirë”, *shuk* “si lëmsh, kruspull”, *sidokudo* “sa për të shkuar radhën”, *stërplot* “shumë plot”, *sus* “pa zë”, *symbyllkë* “luajnë symbyllkë, luaj kukafshehtas”, *syngjytak* “luftë me thikë, me bajonetë”, *tanithi* “tani”, *tarafënda* “t’i zgjidhësh punët në bazë të tarafeve, miqësive”, *taraphanë* “nuk la gjë pa marrë ose pa shkatërruar”, *tejetutje* “në të gjithë vendin, kudo”, *tejmatanë* “tejendanë, nga njëra anë në tjetrën”, *teptil* “krejt ndryshe në veshje, në fytyrë, në pamje për të mos u njohur”, *trashë* “në mënyrë më të gjerë se zakonisht, që i kapërcen përmasat e zakonshme; në mënyrë të pakuptueshme”, *turbullturbulluar* “në mënyrë të paqartë”, *turravrap* “me shpejtësi, me të katra”, *turçe* “ashtu si turqit”, *tutjetëhu* “kudo, gjithandej”, *tërposhtë* “poshtë”, *ujem* “rrëmujsëm”, *varangjel* “sa andej-këtej”, *vendçe* “sipas mënyrës a zakonit të vendit, fort”, *veresie* “pa para në dorë, shumë lirë”, *vetëtimthi* “menjëherë, shpejt”, *vrik* “shumë shpejt”, *vrulltaz* “me vrull”, *vëngër* “shtrembër”, *vërdallë* “rrotull”, *vërdovarçe* “sipas mënyrës a zakonit të fshatit Vërdovë, me sherr” *xhaba* “shumë lirë”, *zinxhirli* “në

mënyrë zinxhir”, *zotërisht* “në mënyrë të fisme”, *zuzarçe* “në mënyrë të turpshme” etj.

Bien në sy ndajfoljet e krijuara me anë të prapashtesave: *-as, -çe, -az, -thi* etj. dhe fakti se autori herë qëndron te mënyrat e njohura popullore e dialektore të fjalëformimit dhe herë në gjedhe të reja. Të tilla janë përftesat - variante stilistikore, si: *arithi, capthi, farësisht, fillthi, fluturimthi, linkthi, njatythi, njëmenthi, tanithi, ëmbëlthi* etj. të cilat krijojnë një atmosferë të lartë shprehësie, si për shembull:

Na e gjen leshverdhën fillthi tek po ujit lulet. (Vepra 4, f. 460); *Papritur pasaniku ngrihet arithi, zgjat krahët, zgurdullon sytë e bulërin me të madhe.* (Vepra 4, f. 422); *Shtangu një çast ... dhe pastaj ia këputi zuzarthi: - hej ti, buf!* (Vepra 3, f. 246); *Miellushell Hocu rrinte kredhur në kolltuk dhe përdridhte maçoqçe mustaqet.* (Vepra 3, f. 405) etj.

Një grup tjetër i madh përbëhet nga lokucionet ndajfoljore, si: *afri-bufri, anës e anës, aty-aty, bahu-brihu, bri më bri, buzë më buzë, bylyk-bylyk* “njëra pas tjetrës”, *copë e çikë, den-baba-den* “në kohëra shumë të largëta”, *dhëmb për dhëmb, ditë më drekë, fill e për pe, flet-e-qesh, fund e krye, fyt për fyt, fët e fët* “shpejt e shpejt”, *gllap-gllup, gojë-gojë, grykë-grykë, gur-gur, here-herë, hidhe-prite, aty për aty, kohë pas kohe, kokë më kokë, kollaj-kollaj* “lehtë-lehtë”, *kot më kot, krah për krah, krep më krep, kryq e tërthor, kur e kur, kurrën e kurrës, këmba-këmbës, larg e larg, lart e poshtë, shesh e lëndinë, majë më majë, mire e mirë, mot për moti, më të mëngjër* “më të majtë”, *ndajnatë për ndajnatë, më të ngrysur, ngut e ngut, njeri më njeri, një më një, njëherë e një kohë, me pahir* “me forcë”, *pike për pikë, pllaze-pllaze, poshtë e lart, puk e puk* “të vendosura ngushtë, afër njëra tjetrës”, *për qark, qark e qark, tej qindit* “më shumë se njëqind vjet”, *me radhë, rishtaz-rishtaz, rrallë e tek, rrëmbe-këmbe* “shpejt e shpejt dhe pa kujdes”, *shatra-patra* “gjysmagjysma; duke hequr këmbët zvarrë”, *shesh më shesh, shoq me shoq, shuk e puk* “kruspull”, *shumë-shumëmijë, shëndoshë e mirë, stërc e stërc* “një nga një”, *syri-syri* “radhë-radhë”, *tashi-tashi, tej e tek, toje-toje* “togje-togje”, *tej e tutje, tym për tym, udhë e pa udhë, valle-valle, vend më vend, vet i vet, vetëm për vetëm, vjete-vjete, këmba këmbës* etj.

Në veprën e Kutelit shohim shpesh ndërtime të tilla, si: *gur i rëndë, i ftohtë akull, brisk i ftohtë, mjaltë i ëmbël, flakë i kuq* etj. Për shembull: *Ju ikët e më latë fill të vetëm, me gjithë shkarpa.* (Vepra 4, f. 291); *...i kulluar jar e i lehtë sa ta pije me grushte e të mos ndieje kurrë të ngopur.* (Vepra 1, f. 348); *Ky dyfek s'ishte as karajfile, as manxura, as martinë e as dogra, po manxer tringo i ri.* (Vepra 1, f. 186); etj. Siç dhe duket, këto ndërtime janë të qëndrueshme, pra kanë kryesisht një rend të përcaktuar të gjymtyrëve, ku gjymtyra emërore qëndron e para, kurse mbiemri vjen i dyti, por mund edhe t'i këmbëjnë vendet, siç ndodh në shembullin e dytë.

Këto ndërtime janë rrjedhojë e një krahasimi të pashprehur dhe e leksikalizimit të plotë të figurave gjuhësore, pra për të mbërritur te ato, “*është*

zhvilluar një proces i gjatë kuptimor, nga figura letrare (zakonisht metaforë) në një kuptim të figurshëm dhe pastaj në kuptim të ri leksikor. Këtë mund ta vërejmë sidomos për ato fjalë, ku ky kuptim nuk ndjehet më si i figurshëm: akull i ftohtë, mjaltë i ëmbël.”³⁵

Sipas teksteve të morfologjisë së gjuhës shqipe këto ndërtime përdoren për të shprehur një shkallë shumë të lartë të cilësisë, pra shërbejnë për të ndërtuar shkallën sipërore të mbiemrave, krahas ndajfoljeve të tilla *fort, fare* etj.

Emrat *akull, brisk, derr* etj. në këto ndërtime “kanë kuptim të prejardhur, sepse nuk shërbejnë për të shënuar realien, por një nga tiparet më të rëndësishme të këtyre realieve, të cilën e kanë në një shkallë shumë të lartë.”³⁶

Në Fjalorin e gjuhës shqipe (1980) kuptime të tilla veçohen dhe jepen si përdorime ndajfoljore, pra trajtohen si ndajfolje për të dhënë shkallën më të lartë të tiparit cilësor (të shprehur me emër) ose të veprimit (të shprehur me folje).

d) Te Kuteli bie në sy edhe mënyra se si i përdor përemrat: ai zgjedh trajta krahinore përemrash, madje dhe forma që i përkasin shqipes së hershme dhe i vendos në lidhje të veçanta, të cilat i japin ligjërimin të tij vlera artistike. Për shembull:

Kur ja, më shkrep gjësend në mendje. (Vepra 2, f. 164); ...u ngrit ajo *Krezha e Njerkës me njato* leshra vërdallë, sa mund të bënte fole miu, e i la të gjitha në baltë me një këngë si nga Mokra, me të hedhur këmbën. (Vepra 2, f. 170); *Bubullon më keq se Shkumbiu në njato* shkallë. *I kuja je ti?* (Vepra 2, f. 60); *Me to* ha bukë e mish, *me to* pi verë, *me to* do të ndërtoj një shtëpi për pleqëri. (Vepra 3, f. 174); *Po kjo qengje e njomë e kuja* është? (Vepra 3, f.90) ... zbresim ne *njajo* grope. (Vepra 2, f. 24); ...as ia thoni *yve* pleqtë? (Vepra 2, f. 11); ...e ç'nuk na kish ky në këtë botë. (Vepra 2, f. 216); ...s'ishin parë *kësi* lugetërish. (Vepra 2, f. 307); *Po ç'është ky shkrep murrak, që po rrokulliset kullutumba njasaj* gurishte? (Vepra 4, f. 275); *Ne s'kemi parë kurrë kësi* njeriu kaq harbut. (Vepra 4, f. 77); *Ti shko atje, qëndro në majë të majës*, kuket dy a tri herë dhe ndofta do të të dëgjojë *ndokush*. (Vepra 4, f. 183); *Se dhe vjet, këso* kohe na ke kukatur majë manit. (Vepra 4, f. 183); *Duhet t'jap gjësend* që t'ia mbyll gojën e të na falë këtë çupë. (Vepra 4, f. 289); *Ja thotë ky emrin; akcili* i biri i *akcilit* nga *akcili* fshat. (Vepra 4, f. 340); - *Dale* – i thotë plaku – *gjeç* do të të jap. (Vepra 4, f. 340); *E shoh se ti do të thuash gjëkafshë*, po nuk e marr vesh mirë se ç'do të thuash. (Vepra 2, f. 140); *Qilim, shpjermë në aksh* vend. (Vepra 4, f. 484); ...bënë nga *një palë* fëmijë, rruan e trashëguan gjer arrinë pleq mjekërbardhë. (Vepra, 4, f. 501); *Në asish* punë ne s'hyjmë. (Vepra 3, f. 361) *Ne s'marrim vesh asish* gjërash. (Vepra 3, f. 401) *Po ce* ia shpie bufit macen? (Vepra 2, f. 79); *U mendova:*

35. Ali Jashari, *Përsiatje për gjuhën shqipe*, Korçë 2003, f. 24.

36. Po aty, f. 25.

dua **filan** çupë. (Vepra 4, f. 507); **Ca** morën malet, **ca** ndenjën në shtëpi. (Vepra 2, f. 129) etj.

Në disa raste, në veprën e Kutelit, përdoret emri “kusur” në vend të përemrit të pacaktuar “ca”: *Jemi njëzet e kusur dyfeqe të gjatë aty lart.* (Vepra 2, f. 28) etj.

Në vend të togfjalëshit “zotit tënd”, Kuteli përdor trajtën e përngjitur “tynzoti”, ndoshta, kjo është dhe në vazhden e ekonomizimit të gjuhës: *Ka ardhur e trokëllin ne porta një grua që e ka zënë të lindurit edhe kërkon t’ia hapim për mall të tynzoti.* (Vepra 2, f. 211) etj. Në këtë rast do të ishte më mirë që autori të kishte përdorur togfjalëshin *tët zoti*, sepse fjala *tynzoti* nuk e shpreh qartë vlerën e saj shënuese.

Në ligjërimin e Kutelit tingëllon e veçantë, sidomos, paraprirja e emrave me përemra dëftorë, gjë që shton notat kuptimore theksuese - veçuese: *Ish kaq i tretur ky Kapllan Aga.* (Vepra 2, f. 9); *Ky Matua vdiq me lot në sy e me zemër të zhuritur.* (Vepra 2, f. 42); *Ky Bendua me shokë na bëri batërdinë.* (Vepra 2, f. 46); ... *qëndro aty se kam një fjalë goje me këtë mikun.* (Vepra 2, f. 200); *Ziente kjo këngë e kjo valle, majë më majë.* (Vepra 2, f. 227) etj.

Një tjetër dukuri gjuhësore te Kuteli është parandejtimi i përemrave pronorë (karakteristikë kjo e ligjërimin bisedor dhe e letërsisë gojore), për shembull:

Shëndoshë ju, o tim kunetër. (Vepra 4, f. 14); *Një ditë dëgjova se i qenke venë së mbesës... sime reje, asaj të Taqos.* (Vepra 3, f. 426); ... *shko ne jot ëmë, me gjithë fëmijë.* (Vepra 2, f. 21); *Mos u nxito gjakun do të ta marrin tim vëllezër.* (Vepra 1, f. 198); *Pyete tim vëlla, Genthin.* (Vepra 3, f. 62); *Druhesh nga im vëlla, Genti? Po unë pse druhem nga yt vëlla, Enkeleu? Nuk jemi të dyja të fejuara unë me tët vëlla, ti me tim vëlla?... Është ajo ime motër, egërsira, kedhja.* (Vepra 3, f. 61- 62); *Ne, një copë bukë që do të na japë zoti, do ta hamë bashkë, zëre sikur m’u ngjall ime gjyshe.* (Vepra 1, f. 222); *Unë, moj, kam qenë mike e motër me ndie-zot tët gjyshe.* (Vepra 1, f. 221); *o im shoq, mua më digjet zemra zjarr për djalin.* (Vepra 4, f. 472); *Ku po na shpie, o yn zot.* (Vepra 4, f. 505); *Të ardhte yt zot shëndoshë.* (Vepra 2, f. 24) etj.

Përsa i përket përemrave hasen dhe forma të shqipes së hershme, me fonetikë të vjetër, me grupin *-tn* të asimiluar në *-n*: *Të zonë (të zotin) e arrës, Muken, e mbaj mend.* (Vepra 1, f. 270); *Pse s’del vetë i zoti ta kërkojë? Të zonë e vrau.* (Vepra 3, f. 338); *Edhe të zon’ e dasmës e paçim sa malet!* (Vepra 2, f. 226); *Grendelli kish lajmëruar të zonë e pazarit.* (Vepra 1, f. 28) etj.

e) Kuteli përdor forma dialektore edhe për sa i përket lidhëzave, si: *daha* “akoma”, *sindozot* “sikurse, sikundër”, *anagjore* “po ashtu” etj. Për shembull: *“Të kesh njëqind qese aspra është mirë, - thosh, - po dyqind më mirë se një qind edhe treqind daha më mirë”.* (Vepra 2, f. 218)

Disa fjalë dialektore përdoren edhe nëpër ndërtimet frazeologjike, për shembull:

Në je mbretëri, bëja çaren vetes. (Vepra 1, f. 333); *Edhe bjeri t'i bjemë bot e qyt.* (Vepra 2, f. 194); *Na digjte miza në shapkë.* (Vepra 2, f. 187); *Ngriti sytë lart në trarët e bëri sikur vrau fiqirë.* (Vepra 3, f. 438);...*e kish halë në sy.* (Vepra 2, f. 140); *E bëri hasha e hasha më thertë.* (Vepra 2, f. 141); *tërë ato shtëpi të mëdha e të vogla ishin bërë hi e shpuzë.* (Vepra 2, f. 135); ...*dilte tagar e shoshë.* (Vepra 2, f. 108); *Qosja lahej pisk e lakuriq brenda në gjol.* (Vepra 2, f. 108); ... *ky Ago Dajlani ç'na u bë firar.* (Vepra 2, f. 36); *Gur zënç, dyvjaçkë t'u bëftë!* (Vepra 4, f. 277); ... *po ç'e do këtë zanat, kur të bie bretku e s'e mbush dot barkun me bukë.* (Vepra 4, f.404); ... *të ze tartakuti kur mi shikon.* (Vepra 4, f. 406); *I vete goja rodhan.* (Vepra 4, f.411); *Që atë ditë i madhi iu qep si rodhe e më s'i ndahej.* (Vepra 4, f. 411); *I vogli e gjeti belanë.* (Vepra 4, f. 412); *Kapedani bëhet shafran.* (Vepra 4, f. 423); ... *ik or djall në punën tënde, mos më bëj të ndyj dorën.* (Vepra 3, f.402); ...*na e la plëng në dorë këtë rrësk të keq.* (Vepra 3, f. 415); ...*bëhet hi e fani.* (Vepra 3, f.458); *Nejse, ne e bëmë toka.* (Vepra 3, f. 500); *Dushk për gogëlla, qir Kiço.* (Vepra 3, f. 504); *Ky... e humbi toruan.* (Vepra 1, f. 184); *Nusja e Gaqos prap i varit turinjtë.* (Vepra 3, f. 461); ... *kështu që këtë radhë sharra kish zënë shajkën.* (Vepra 1, f. 313); *I therën kokallat.* (Vepra 3, f.313) etj.

2.2. Onomatopetë dhe fjalët onomatopeike

Siç ka vënë në dukje Jani Thomai, “një fushë të lirë për krijimin e fjalëve dialektore a krahinore përbëjnë fjalët onomatopeike të cilat janë format e perceptimit vetjak të zhurmave e të tingujve, janë mënyra origjinale e riprodhimit të nyjetuar, prandaj ndërtimi i veçantë i fjalëve që krijohen sipas temave onomatopeike dhe ndajshesave të zgjedhura japin një varg njësisish leksikore me shtrirje territoriale të kufizuar.”³⁷ Duket qartë që Kuteli di t'i shfrytëzojë shumë mirë format onomatopeike dhe t'i verë ato në funksion të harmonizimit gjuhësor e të krijimit të rrjedhave fonologjike, të krijimit të pamjeve të gjalla të natyrës, si përplasja e valëve, rrjedhja e lumenjve, burimeve, frymëmarrja e pyjeve, bimëve, zhurma e gjetheve, kënga e zogjve, gjuha e kafshëve, zhurma apo tingujt që lëshohen gjatë një procesi pune e kështu me radhë. Onomatopetë i shërbejnë shkrimtarit për të krijuar një botë, ashtu siç e percepton ai, pra, një botë që jeton edhe përmes shenjave të veçanta gjuhësore “që nuk kanë fare kuptim të mirëfilltë leksikor, ndonëse janë shenja të motivuara dhe kanë diçka arbitrare.”³⁸ Siç dihet riprodhimi i tingujve, zërave, zhurmave, britmave etj., që kanë të bëjnë me sende a dukuri të ndryshme të natyrës është i përafërt dhe asnjëherë i plotë e i përpiktë, sepse

37. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 59.

38. Jani Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 86.

zëri, klithma, britma, zhurma e një sendi të dhënë perceptohet dhe riprodhohet në mënyra të ndryshme nga njerëz të ndryshëm. Kuteli shfaqet jo vetëm si njohës shumë i mirë i njësive onomatopeike, por edhe si krijues i tyre dhe kjo duket edhe në përdorimin e onomatopeve me karakter sinonimik. Kështu për të qeshurën e njeriut ai përdor disa trajta onomatopeike: *ga-ga-ga*, *hi-hi-hi*, *ho-ho-ho*, *ku-ku-ku*, ose për këngën e këndesit përdor sipas rrethanave trajtat: *ki-ki-ki*, *kikiriku*, *kukuriku*, *kukurigu* etj. Përdorimi i dendur i onomatopeve, pra i njësive tingullore, ndihmon në estetizimin e mëtejshëm të prozës së tij, duke ndikuar që gjithçka që paraqitet në vepër t'i shkojë lexuesit më me gjallëri e me një forcë të madhe mbresëlënëse dëgjimore. Kështu, gjithçka që përshkruhet mund të përjetohet maksimalisht në mënyrë shqisore. Për shembull:

Trëndelinos i ze veshi një zhuzhërimë, sikur të ardhkej vërdallë ndonjë memece gjuhëprerë e buzëçarë: zh-zh- zh...zh-zh-zh... Ngre kokën dhe pyet: Ç'je ti që zhuzhërin kështu? – Zh-zh-zh... vëëzhzh..., vëëzhzh... Lum kush ik, mjerë kush rri! Vjen i madhi bën kërdi! ... Zh-zh-zh... Gjarpri futet tre pashë nën dhe, petriri merr qiejt përperjetë, iriqi kreshpëron gjembat e vet e tulitet në gjembat e ferrës. Treqind grosh vrim' e miut! Fol të foltë sorra mbi krye! Kush je ti? Zh-zh-zh... jam... jam më i urti dhe më plaku... Namëta plas një buçimë gjëmëmadhe që drithmëron bunacën: aaau-baaau! Aaau-gaaau! Sikur ka plasur ndonjë shkulum nga ata që vijnë vetëm një herë në jetë. Buçima rritet e pushton malin. (Vepra 4, f. 274); Papritur plas një uturimë e shtërmadhe që të kall tmerrin: krisin majat, fishkëllon era nëpër ahe, bubullojnë e vrungullojnë bjeshkët. Pastaj, në mes të krismave e të fishkëllimave, dalin fluturimthi mbi majat ato tri zanat hidhërake, shkërfasin dhëmbët, nxjerrin tym e zjarr nga goja, turren drejt mrizeve tek janë ndaluar dasmorët... Aty ku një çast më parë gjëmonte kënga e vallja, s'ndihet më zë njeriu e hingëllimë kali. Bunacë e madhe, vdekje... Majat nuk kërcasin, era nuk fishkëllon. (Vepra 4, f. 62); Atë çast kish plasur burbujë e madhe nëpër bungishte dhe pas pak kish dalë që andej një derr i egër sa një dem, me kreshtën si drizë, me një dhëmb sa një bri, me sytë e ndezur. Demi vinte si ortek mali, sepse e ndiqnin nga prapa xhingërima armësh me gjëmë gjahtare: krisma, thirrma, fishkëllima. (Vepra 4, f. 24); Kur e solla ish si ish, tani sa vjen e tretet, si ai dylli i bletës pranë zjarrit. Derdh lotë sa për shtatë kronj. Blegërin si qengji pa nënë. Si t'ia bëj hallit? A të vete t'i sjell një falltare që ta këndojë? Dhelpira tundi fap-fap bishtin e kolmë rrëzë dëllinjës; sytë ndezen flakë. - Gau- giu! Gau-giu! Jo, zoti mbret mos na sill falltarë në pyll. (Vepra 4, f. 314); Aaau-gaaau! Vrungullon tërë lugaja më shumë se sa gjithë livaret bashkë. Vjen ariu si shapatani me gurgule të madhe. Krisin trungjet e shtegut, bubullojnë shkallët, thua se do shembet tërë kjo botë shkrepash. Brumbum! Bubullon dera e madhe. Ariu është ngritur arithi në të dy këmbët e para e flet me grahmë. (Vepra 4, f. 350-351); U zgjua kur dielli ish ngritur nja dy hostenë mbi mallet, vuri bërtimën, po prapë i ra zalia. Aty nga dreka nis e

fërmon tërë pylli i largët. *Fërmon* sa *fërmon*, pastaj zë e *buçet*. (Vepra 4, f. 356); *Fiu-fiu, cirifiu! Fiu-fiu!* Uf, moj dhuvalë qyqale, mend në kokë s'paske fale! Të plasën sytë e s'më sheh si jam lalë e ndëluar pël dasmë? ... Thotë kështu rabecka e *fëëër!* Futet në një kulë drizërie... Trëndelinua *shërëmëtin* zemërthyer e nëmos: Uf, e theve qafën moj llupashkë *tërtëllashkë* që nuk le dy gurë bashkë. (Vepra 4, f. 271); *Glu-glu-glu* ziente xhezyja e kafes, *bëz-bëz* një mizë në xham edhe Milka; *mër-mër-mër* me tri fije fshesë në dorë. (Vepra 2, f. 84) etj.

Në veprën e Kutelit, krahas onomatopeve, shfaqen dendur edhe fjalët onomatopeike të cilat vijnë në forma të ndryshme:

- Onomatope emërore përbëjnë grupin më të madh dhe që shënojnë vegla,

sende e dukuri të tjera, të cilat kanë lidhje me lloje të ndryshme zhurmash, si: *duduk*, *gllënjë*, *glyrë*, *grahmë*, *lingë*, *trokashkë*, *xhingë*, *zhingë*, *zhizhë* e ndonjë tjetër. Për shembull:

Si lëshoi lëng gështenja, nisi të dëgjohet, mëngjes e ndajnatë, duduku e glyra në Gorricë. E kaq bukur këndonin ata të Gorricës, sa unë rrija i tulatur ne oxhaku të dëgjoj atë du-du-du e atë gly-gly-gly, që i sillte oxhaku pranë e që ma turbullonin krejt mendjen time. (Vepra 2, f. 93); *Uf, e theve qafën, moj llupashkë tërtëllashkë.* (Vepra 4, f. 271); ... *Pahu i miellit ishte kaq i ëmbël dhe kënga e parreshtur e trokashkës na bënte të lumtur.* (Vepra 1, f. 157); ... *Thithte... sikur të thithte palcën e ndonjë kocke, gllënqet e para të "kahves" së valë...* (Vepra 1, f. 85); *Krik-krik! bënë shkripekat.* (Vepra 1, f. 222); *Një thuthuq i hollë, i gjatë, rrëfente se s'di në cilin katund një ka i mbrehur i kish folur të zot.* (Vepra 1, f. 226); *Sonte qenka bërë kanare e madhe në skotën e ujqve.* (Vepra 4, f. 339) etj.

Në veprën e Kutelit nuk mungojnë fjalëkrijimet me karakter onomatopeik, në krijimin e të cilave duken si modelet fjalëformuese të shqipes, ashtu edhe prirja fjalëformuese vetjake e autorit. Si të tilla krijohen:

-folje: *brumbullon*, *buburon*, *bubutin*, *bumurin*, *hamullin*, *këlkish*, *shkërfas*, *shushuret shërëmëtin*, *tintëllin*, *xhingëron*, *zhuzhërin* etj, si për shembull:

... *Dëgjon gjinkallat që këlkishin* sa zien tërë dushniku, dhe, hop, e zë gjumi. (Vepra 4, f. 269); *Kamësi xhindoset: leh si qen, alurin si çakall...* *Kusarët qeshin sa bubullon tërë shpella.* (Vepra 4, f. 421); *Bëhet si hije e i shushuret në vesh Bardhos.* (Vepra 4, f. 495); *Bli e shit, ua hodhi të gjithëve... s'përpëronte njeri.* (Vepra 4, f. 428); *Harruan të dyja të ngacmuarit, u përqaftuan, u puthën e zunë të xhuxhurasin.* (Vepra 3, f. 60) etj.

-emra: *trokëllimë*, *bumurimë*, *zhuzhërimë*, *cingërimë*, *bërtimë*, *tingëllimë*, *kërkëllimë*, *bucimë*, *uturimë*, *zhaurimë*, *fërmim*, *fishkëllimë*, *brambullimë*, *bulërimë*, *krokëllimë*, *fërmëllimë*, *angullimë*, *pipëtimë*, *çuçurimë*, *shërëmëtimë*, *shushuritje*, *logoritje*, *llokoçitje*, *kukurisje*, *fërfëllizë*, *burbujë*, *xhingërimë*, *llapashitje* etj. Në këto fjalëformime ndajshitesa fjalëformuese më

prodhimtare është prapashtesa fjalëformuese – *im* dhe më pak prapashtesat – *izë* dhe – *je*. Disa prej këtyre formimeve janë me interes në ligjërimin artistik për vlerat e tyre shprehëse dhe njëkohësisht edhe për sistemin fjalëformues të shqipes, si për shembull:

... *fle sa fle, papritur dëgjon një burbujë të madhe që vjen nga larg.* (Vepra 4, f. 408); *Trëndelinos i zuri veshi një zhuzhërimë.* (Vepra 4, f. 274); *Mbreti bën be e thotë: jo s'janë bumurima qielli.* (Vepra 4, f. 179); *U zgjua... vuri bërtimën, po prapë i ra zalia.* (Vepra 4, f. 356) etj.

Lirshmëria e Kutelit në krijimin e fjalëve onomatopeike duket edhe në krijimin e kompozitave të tilla, si: *bubuzhingë, trakatruke, zhingë-bubuzhingë, xhingamingë, drangadrungë* etj., kështu që mund të thuhet se ai ndihmon ndjeshëm në pasurimin e onomatopeistikës shqiptare.

Onomatopetë në veprën e Kutelit janë më të shumta se sa fjalët onomatopeike. Ato shërbejnë për të imituar akoma më drejtpërdrejt tinguj, zëra, zhurma etj., të cilat e gjallërojnë ligjërimin dhe e sjellin përshkrimin apo ngjarjen shumë më afër lexuesit. Nëse do të përpiqeshim për një klasifikim të tyre do të kishim:

2.2.1. Onomatope që imitojnë tinguj, zëra, zhurma të shpendëve e kafshëve

Rosat zunë dhe ato këngën: vak-vak-vak. (Vepra 2, f. 287); *Ciu-ciu-ciu* (si bëjnë zogat) për shumë mot gëzuar. (Vepra 2, f. 86); *Fërr-fërr-fërr*, - *krahët e shpeshërisë.* (Vepra 1, f. 122); *Kështu rrinte derri majë kotecit, si në tatrivan, mbi lumë, edhe gau-giu tërë ditën.* (Vepra 1, f. 350); *Hau-hau!* zuri të çirret një grifshë. (Vepra 4, f. 273); *Kikiki, kikiki,* ngreu ari se u gdhi (Vepra 4, f. 355); *Beee... beee* blegëriu një gjë e gjallë aty në ferrat. (Vepra 2, f. 304); *Qentë e Sulit ia ndjenë erën dhe zunë të lehin. – Gam-gam-gam! Gam-gam-gam.* (Vepra 2, f. 303); *Atë çast u dëgjua këndesi i parë... kukurigu, kukurigu.* (Vepra 2, f. 129); *Vetëm qyaja e kuqe kukat në një rrem të thatë: Kuku, kuku.* (Vepra 4, f. 181); *Natën buuu! Çatisin ujtit me sy të ndezur flakë.* (Vepra 4, f. 339) etj.

2.2.2. Onomatope që shprehin tinguj, zëra, zhurmë, klithma e britma të njerëzve

Gjyshja qeshi ga-ga-ga dhe sytë i shkrepën të njohur. (Vepra 2, f. 129); *Atëhere ia krisi të qeshurit: Ha-ha-ha! Ha-ha-ha.* (Vepra 4, f. 423); *I dëgjonte beu e s'thosh dot një fjalë, të paktën "efnëm" ose hëm-hëm, siç e kish zakon.* (Vepra 1, f. 98); *U bëre si ato zdërret plaka: zdërr-zdërr tërë këtë bijë ditë.* (Vepra 1, f. 268); *Dhe shu- shu-shu diç i thoshte në vesh.* (Vepra 4, f. 193); *Ssst... pusho se na dëgjon Kuma Marua, zot i malit.* (Vepra 4, f. 288); ... *Zuri e po fërshëllen natën se puna i kish vajtur mirë me poçet. Fi-fi-fiu e*

fi-fi-fiu kapërceu luadhe e ju afrua Shkallës së parë. (Vepra 2 f. 304); *Dhe kur fliste kështu, mër-mër-mër e bër-bër-bër, erdhi dhe e zuri gjumi.* (Vepra 2, f. 219); **Hu-hu** bën ai si ujk i tërbuar. (Vepra 4, f. 419); *Dhe u ul e piu gllëng e gllëng, u rëndua, sa u mek.* (Vepra 4, f. 405); *Herë pas here bënte me kokë lart e poshtë, duke nxjerrë ca tinguj të thatë: “ncuk”, “ncuq”, “ntxk”, “ntck” e kështu më tej.* (Vepra 1, f. 86); *Kështu vërvërvër, e shastis fare të gjorin.* (Vepra 3, f. 452); *Dalipi ... mendjen e ka top. Vetëm se flet me “thëthëthë” për shkak të dhëmbëve.* (Vepra 1, f. 272) etj.

Në këtë grup dallohen veçanërisht disa onomatope me vlera të veçanta shprehëse, të cilat shprehin ndjenja njerëzore të ndryshme, si: gëzim, zemërim, ironi, përbuzje etj. Për shembull:

Sapo lëshuan bukë e gjellë në sofër, urr! Një zhgan me minj. (Vepra 2, f. 98); *Ta dish se unë do të ta shtyp kokën si të gjarprit, po bëre atë që bëre me mua! Y-y-y, murtajë.* (Vepra 1, f. 96); *Lehtësoi mamuzet, hoqi frenë, bëri “trrrp” dhe pela zbuti vrapin.* (Vepra 1, f. 98); *Tyt, bre! Ky ish isnaf njeri.* (Vepra 3, f. 490); - *Mizhë, mizhë, - e talli një, aty nër driza. – Ptui! - më të djathtë, ptui! – më të mëngjër... Ptui! Lugat i mallkuar, të plastë zoti.* (Vepra 2, f. 306-307) etj.

2.2.3. Onomatope që shprehin zhurma të dukurive, sendeve, objekteve.

U ndez pastaj puna anembanë si lufta e Grekut me Turkun: Dangërdungër, bambër-bumbër, cingër-mingër... (Vepra 2, f. 104); Bam-bam! - çiftja e Argjirit. Bam! - çiftja ime. (Vepra 1, f. 110); *Lluk-lluk i bënte barku.* (Vepra 1, f. 98); ... *dëgjonte dajre e dauille bashkë: xhing-xhing, dum-dum.* (Vepra 1, f. 97); *Kur e shtrëngoja në krahë, trupi i bënte këërc, këërc.* (Vepra 1, f. 147); *Qeveria të do paret çink-çink në dorë. Çink- çink ia japim dhe ne në dorë.* (Vepra 1, f. 304); *Ja, pas tre vjet pam-pum i tha ta kam falur...* (Vepra I, f. 293); *Misrat?... Të na bëhen të mëdhenj që t'i këpusim zhgrup-zhgrup, t' i pjekim e t' i hamë krap-krup.* (Vepra 1, f. 289); *U vete ariu në der' e shtëpisë, u troket taktak, mirë se ju gjeta.* (Vepra 1, f. 260); *Bien brirët tatata-tatata, pa pushuar.* (Vepra 4, f. 70); ... *lotët i rridhnin çikër-çikër faqeve të vyshkura...* (Vepra 4, f. 137); ... *dëgjon, vret mendjen pastaj përpyek llap-llap të dy duart.* (Vepra 4, f. 176); *Po kjo fësht ikën e fshihet.* (Vepra 4, f. 306); *Hop, zemra nis t' i rrahë dung-dung.* (Vepra 4, f. 295); *Rëk-rëk bëjnë arrat në hambar... Vjen dhe mjalti. Gllap-gllup!- me të dy duart... i zbraz shpejt libat me togje pitesh të verdha.* (Vepra 4, f. 353); ... *i bënë dëng-dëng tërë rropullitë.* (Vepra 4, f. 288); *Ariu i ka dhëmbët e fortë si kiza. Nis e hap udhë nëpër drizëri, i pret kësht e kësht ferrat* (Vepra 4, f. 365); *S'di se si i rrëshqiti këmba e gëlldump brënda në det.* (Vepra 4, f. 393); *Uji mburonte glu-glu-glu.* (Vepra 2, f. 73); ... *një burrë po mundohet të shkrepë me masat.*

Shkrap-shkrup shkëndija plot e zjarr jo. (Vepra 2, f. 301); **Trak-trak** bënë skripeckat, **vizhgëlliu** shigjeta (Vepra 2, f. 159); **Tank e tunk** bëmë një shaqiluar me ca drurë. (Vepra 2, f. 25); Edhe jazi ish gjithë aty me atë zhurmë **glu-glu-glu**, ku uji godet gurin e madh. (Vepra 2, f. 162); **Vring!** Kërcen tutje një dorë; **vring!** Kërcen tërë krahu; **vring!** Koka që rrokulliset si kungull e ndalet. (Vepra 4, f. 423); ... tete Ngjelua qeshi me zë të të mbytyr, si trirë e prishur kur rrëkëllehet **drangadrunga**, nëpër kalldrëm. (Vepra 3, f. 428) etj. Siç shihet edhe nga shembujt e dhënë, onomatopetë në veprën e Kutelit më së shumti paraqiten të veçuara.

2.2.4. Onomatopetë kontekstuale

Në veprën e Kutelit nuk mungojnë dhe onomatopetë kontekstuale, pra fjalët që nuk janë onomatope të mirëfillta, por të përdorura brenda kontekstesh të caktuara, tingëllojnë si të tilla, si për shembull:

... i bie derës me kokë sa i **shkrepin** sytë **shkëndija** larushe dhe lëshon **bërtimë** (Vepra 4, f. 357); Aluriu si bushtër, **shkrepi** si **shkrepletimë** edhe plasi në vend (Vepra 2, f. 307); Çiftet e teket **krisën** bambum, nëpër koriye (Vepra 1, f. 93); **buçima** poshtë rritet e rritet, sa **gjëmon** tërë klisyra tutje (Vepra 4, f. 406) etj.

Gjithashtu bien në sy edhe rastet e emëzimit të disa onomatopeve, si për shembull:

Rifillonte që në krye... me **dang-dangun** e krehrët. (Vepra 2, f. 76); Kusarin e kusarëve e kanë zënë **dëdëckat**: dridhet. Ku të futet! (Vepra 4, f. 417); ... Ç'bëri dhelpra me mollokof të gjatë, me dhelprushët që u binin **xhingamingave**. (Vepra 4, f. 335); Aty, në mes të mjegullishtes së tymit të duhanit, të **trakatrukeve** të tavllave ... zuri një tryezë të lirë në qoshe. (Vepra 3, f. 345); ... shikonte herë unazat e dhëndrit, gojën e dhëndrit, **xhingër mingrat** e dhëndrit. (Vepra 3, f. 476) etj.

Onomatopetë në veprën e Kutelit fitojnë jo rrallë ngarkesa me vlera të veçanta stilistikore në ndërtimet me paralelizma, në rastet, kur krijojnë lidhje të figurshme me fjalët e tjera dhe ca më fort, kur krijojnë lidhje me njëra tjetrën, si për shembull: ... **duduku rënkoi** thellë e më thellë, **xhingat xhingëruan**. (Vepra 4, f. 305); Çunat e mbretit habiten e thonë: ç'janë këto **bumurima** që **bumurojnë**. (Vepra 4, f. 179); ... Ranë brirët këtej, **bubulluan** daullet andej. Kushtrim. Filloi lufta. **Rropama** mbushi dhenë. U ngritën mijëra heshta majëndritura, **vringëlluan** mijëra shpata të mprehta, **vërshëlljen** mijëra shigjeta. Dhe anembanë viktima, **uturima**, **thirrma**, urrejteje e nxitjeje...Mirëpo në mes, në ballë, **bubulluan** më fort daullet, **fishkëlluan** zurnatë e turqërisë. (Vepra 4, f. 239); ... Njëri **gërhët**, tjetri **vërret**. (Vepra 4, f. 360) etj.

Në fund, themi se në veprën e Kutelit vërehen dy lloje onomatopesh: onomatope të cilat janë thjesht imituese të zhurmës së dukurive, pra që mbeten

te vlera e tyre shënuese dhe onomatope me kuptim të figurshëm, që sjellin pasurim të shprehësisë leksikore. Nëse do t'i llogarisnim se cilat zënë vendin më të madh, do të thoshim me plot gojën se peshorja anon në të dytat, sepse duket përkujdesja e autorit për t'i përdorur ato në një mënyrë sa më interesante.

Gjithashtu, mund të themi se materiali onomatopeik te Kuteli është shumë i pasur, ndaj vlen për një studim të mëtejshëm më vete dhe më të hollësishëm.

2. 3. Fjalët me burim popullor sipas fushave konceptore

Fjalët dialektore në prozën e Kutelit shfaqin pasuri dhe larmi edhe po t'i hetojmë sipas fushave konceptore, gjë që tregon se ai është jo vetëm njohës i shkëlqyer i gjuhës së trevës së tij, por po aq edhe njohës i jetës së banorëve të saj, i strukturave të tyre sociale, i marrëdhënieve të tyre ndërnjerëzore, i pasurisë e veçanësisë së riteve e zakoneve të tyre, i punëve dhe mjeteve me anë të të cilave ata sigurojnë jetesën. Kuteli është njohës deri në detajet më të imta i të gjitha orendive artizanale, i veglave bujqësore, i armëve, i mjeteve të gjahut dhe i pjesëve të tyre përbërëse. Ai është gjithashtu njohës po aq hollë i mjedisit të larmishëm gjeografik që ofron krahina: kodrinor, malor, fushor, i pasurisë së tyre të jashtëzakonshme, si në florë dhe në faunë. Duket se Kuteli njih fare mirë vendlindjen e tij që shquhet, veçanërisht, për begatitë e saj natyrore: njih mirë çdo gur, çdo pemë, çdo bimë, çdo lule, çdo gjemb, çdo kafshë, çdo egërsirë, çdo zog, çdo zvarranik, çdo larvë e gjithçka tjetër, por sigurisht, ai është një njohës dhe një dashurues i flaktë i mjedisit liqenor, i bimëve e gjithfarë gjallesave të tij, i llojeve të ndryshme të peshqve e gurneckave etj. Të bësh një udhëtim gjuhësor në veprën e Kutelit do të thotë të udhëtosh nëpër vendlindjen e tij dhe të dalësh i mrekulluar me begatitë e saj të gjithanshme.

2.3.1. Dialektalizma nga fusha e etnografisë

Shtresa e dialektalizmave nga fusha e etnografisë, për nga sasia e përdorimit të tyre qëndron në vend të parë. Këta dialektalizma emërtojnë nocione nga kultura shpirtërore e materiale e vendlindjes, si: tradita, rite, zakone, marrëdhënie farefisnore apo sociale, veshje, ushqime, orendi shtëpiake, mjete pune të sferës blegtorale, bujqësore etj. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre në veprën letrare është me rëndësi të veçantë në planin gjuhësor, sepse sjell rigjallërim dhe rijetësim të tyre. Nga ana tjetër vërehet se Kuteli ka sjellë një thesar fjalësh, ekzistenca e të cilit rrezikohej në një masë të konsiderueshme përballë rrjedhave të kohës, përballë zhvillimeve të reja, prandaj ai është nga radha e shkrimtarëve të mëdhenj, të cilët janë të aftë që të ndihmojnë për të ruajtur nga shuarja fytyrën gjuhësore të të gjithë brezave

njerëzorë të kombit të tyre. Kritika ka thënë se në planin përmbajtësor vepra e Kutelit formëson pamjen e asaj që quhet “Shqipëri e përjetshme”³⁹, por kjo ka vlerë edhe për vlerësimin e gjuhës së përdorur në të. Vepra e tij, edhe në pikëpamje gjuhësore, është një pikë takimi gjyshërisht e stërgjyshërisht, nipërisht, stërnipërisht e nipstërnipërisht, siç do të shprehej Kuteli. Ajo është një mekanizëm jetësues që e bën shqipen të duket ashtu siç është, një nga gjuhët më të vjetra, por edhe më të pasura të botës. Për meritë të padiskutueshme të gjuhës, lexon veprën e tij dhe të duket sikur zhytësh në një surrealist, por në të vërtetë je duke prekur rrënjët e tua, identitetin tënd. Aty koha është tre dimensionale: e shkuar, e tashme, e ardhme. Duket si absurd, por modernia nuk bën dot pa tradicionalen në cilëndo pikëpamje qoftë, pra edhe në atë gjuhësore. Nuk është e sigurtë nëse Kuteli do të ishte po aq modern sa është, nëse nuk do të punonte me mjeshtëri e dashuri mbi brumin e gjuhës së popullit, sepse dhe balta është e vjetër, po poçari i vërtetë bën mrekullira me të; ca më tepër me baltën shqiptare, me “*baltën magjistare*”⁴⁰, me të cilën “poçari”⁴¹ Kutel është i dashuruar “*egërsisht*”⁴² e “*dëshpërimisht*.”⁴³ Midis Kutelit dhe gjuhës shqipe ka një marrëdhënie bujarie të ndërsjellë: gjuha shqipe i ofrohet autorit me gjithë pasurinë e madhështinë e saj, por edhe autori bën riqarkullimin e rijetësimin e saj. Të ndarë sipas fushës konceptore, dialektalizmat vijjnë të rijetësuar në veprën e tij, sipas kësaj radhe:

- Në vendin e parë dialektalizmat nga fusha etnografisë:

a. Fjalë që emërtojnë dukuri, vegla e mjete të ndryshme, profesione njerëzish etj., si: *alësivë* “finjë”, *bare* “një vegël e rëndë prej hekuri që shërben për të thërrmuar gurë”, *bashtë* “barçë”, *belcë* “velenxë me lesh dhe pa thekë”, *belçyk* “rreth hekuri që i vihet kafshës për mesin ose në hundë për ta mbajtur me zinxhir”, *blatë* “një pjesë toke që mban shumë ujë”, *briri* “vegël e bërë nga briri i një kafshe për të dhënë sinjale me zë”, *buki* “brokë e drunjte për të mbushur ujë”, *bulirë* “bucelë”, *bulitë* “bucelë”, *cergë* “qilim ose mbulesë e ashpër që është punuar zakonisht me lesh dhie”, *çepurkë* “enë e drunjte e luguar me dorezë. Përdoret në mulli për të hedhur në thes miellin e bluar”, *cifun* “vrime e ngushtë e koritës së mullirit, që ku del me fuqi uji që godet dhe vërtit pendën”, *cigarishte* “pipë, në të cilën futet bishti i cigares për të thithur tymin”, *cingël* “shkop i shkurtër, i prerë pjerrtas në të dy anët, me të cilin luajnë fëmijët duke e goditur me një shkop të gjatë; loja që luhet me këtë shkop”, *çotillë* “dorë e dybekut”, *dallëndyshkë* “kryqi që lidh sipër pendën e mullirit”, *damaluk* “lloj parmende prej hekuri”, *çatmë* “mur i hollë ndarës, zakonisht prej dërrasash ose thuprash të lyera me baltë a me suva”, *çerep* “enë balte si tepsi e thellë në të cilën pjekim bukën”, *çupallkë* “kungull uji”, *delmator* “bari dhensh”, *dorak* “parmendë”, *dordolec* “figurë e ngjashme me

39. I. Kadare, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, Tiranë 1991, f. 38.

40. M. Kuteli, *Vepra 5*, Tiranë 1990, f. 64.

41. Po aty.

42. Po aty.

43. Po aty.

njeriun që bëhet me shkopinj e rroba të vjetra dhe vendoset në mes të arës me drithë për të trembur zogjtë”, *dykel* “vegël bujqësore me dy dhëmbë, për të prashitur në tokat me shumë gurë”, *dhjar* “bariu i dhive”, *dhogë* “dërrasë”, *falera* “pllakë prej bronxi ose argjendi që u vendosej kuajve në gjoks e në kokë si shenjë e rangut ushtarak të të zotit”, *felaqi* “pjesa e poshtme që vë në lëvizje gurin e mullirit: bosht, pendë”, *feste* “kësulë”, *fushqi* “pleh dhish”, *fëndyell* “vegël e këpucarëve me majë hekuri ngulur në bisht druri për të hapur vrima në shollë”, *gavyell* “rrethi i drunjtë i rrotës së qerres, mbi të cilën mbërthehet rrethi prej hekuri”, *gjemi* “varkë”, *gjep* “kallam i hollë dhe i shkurtër për të mbështjellë fije me të, masur”, *gjym* “enë bakri a llamarine, me fund të gjerë e me grykë të ngushtë dhe me një vjegë, që përdoret zakonisht për të mbajtur ose valuar ujin”, *gojtare* “që di të flaës shumë mirë”, *grunar* “hambar ku ruhet gruri ose drithëra të tjera”, *gurneckëtar* “peshkatar gurneckash”, *haps* “çelës”, *harbi* “shufër e hekurt për të mbushur pushkën e për të pastruar grykën e saj”, *jamake* “një lloj ene më e madhe se gota dhe me bisht që shërben për të mbajtur ujë apo lëngje të tjera”, *kaci* “lopatë e vogël prej metali, me bisht të gjatë, që përdoret për të marrë prush ose për të hequr hirat e vatrës”, *kadishkë* “kade e vogël me djathë”, *kapan* “kandar”, *kapë* “kësulë”, *karthje* “degë të holla drurësh, zakonisht të thata që përdoren për të ndezur zjarrin”, *karvanar* “ai që i prin karvanit”, *kashtore* “kasolle kashtë”, *kalenicë* “enë, zakonisht prej balte, përdoret për të mbajtur verë”, *killë* “masë drithi e barabartë me dy shinikë (me 50-60 kilogramë)”, *kizë* “thikë e madhe me majë të kthyer si drapri dhe me bisht prej druri, që përdoret për të krasitur pemët”, *kllanik* “vatra e oxhakut”, *kobellë* “lloj ene prej lëkure, si kacek, ku mbahej vaji e bulmeti”, *kukurë* “këllëfi i shigjetave”, *kocak* “gërshetë”, *koritë* “govatë”, *koshare* “koçek misri në trajtën e një koshi të madh, të përmbysur”, *kotrulli* “kova dhe litari me të cilin mbushet ujë në pus”, *krazë* “leqe për të kapur zogj”, *krips* “ena ku mbahet kripa” *kupë* “gotë”, *këllbra* “enë e drunjtë e ngushtë poshtë dhe e gjerë lart, me rrahë hekuri, pak si plloçake. Përdoret për të mbajtur rrushin nga vreshti në vend të koshave”, *këltyrë* “kapak”, *libë* “palare, pjatë”, *lingë* “zile e vogël bagëtish”, *lyrek* “fëmijë i vogël i mbështjellë me pelena leshi”, *lëmë* “vend i sheshtë e i gjerë, ku grumbullohen drithërat”, *magje* “enë e drunjtë si govatë, ku ngjishet e punohet brumi për të bërë bukë”, *majuckë* “pjesa më e hollë e më e mprehtë e majës së diçkaje”, *mangër* “monedhë bakri e madhe, me vlerë shumë të vogël”, *masat* “uror”, *mastrapan* “enë e vogël me bisht që shërben për të mbajtur ujë”, *matare* “pagur”, *mazgallë* “vrimë ose e çarë në mur, në dërrasat e derës a të tavanit; vrimë a plasë e një ene, vendi i shpuar i një ene”, *mballomë* “arnë”, *minder* “ndenjëse e bërë prej dërrasash. Mbi to shtrohet një si tip dysheku i mbushur me kashtë të tharë gruri”, *mëregë* “një farë trire prej cope dërrasash ose hunjsh të vegjël, që vendosen në krye të koritës së mullirit për të mbajtur sendet që mund të pengojnë punën e rregullt të pendës”, *mërezhdë* “një lloj rrjete për të kapur peshq”, *mërezhë* (njëlloj si mërezhdë), *naplungë* “trastë prej leshi e

endur rrallë ku hidhet gjiza ose djathi për të kulluar hirra”, *naxhake* “sëpatë e vogël, latore”, *ndënëkresë* “jastëk”, *neçë* “përparëse leshi”, *odiçkë* “dhomë e vogël”, *odë* “dhomë që shërben për të pritur miqtë”, *oshmak* “pjesa e oxhakut që del sipër vatrës dhe shërben për të vënë sende të ndryshme”, *otra* “hu i gjatë, i fortë që futet nga lart në dhëmbët e pendës së millirit që të ndalet”, *palare* “dërrasë e gjerë e rrumbullakët dhe e lëmuar, mbi të cilën tëhollin petët e lakrorit, të byrekut etj.”, *pendë* “digë”, *pengore* “litar me të cilin i lidhim dy këmbët e para kafshës që të mos largohet nga vendi ku kullot”, *pepellashkë* “copë leckë e lidhur në një dru të gjatë që përdorej për të fshirë furrën e bukës”, perusti “përdorëse prej hekuri, në trjtë drejtkëndëshi ose e rrumbullakët, me tri këmbëza, mbi të cilën vihen enët në zjarr”, *plevicë* “kasolle për të mbajtur kashtrat”, *pllashtë* “dërrasa me vlerë të vogël të cilat përdoren për çati ose për të rrethuar kopshtet si gardh”, *plloçë* “rrasë, pllakë”, *pod* “arkë ose e ndarë drejtkëndëshe, ku bie mielli i bluar”, *poshtage* “shkop i gjatë, i trashë që shërben zakonisht për të shkundur arrat”, *poçe* “enë prej balte që përdoret për të zier fasulet”, *prokavë* “lloj velenxe e trashë që bëhet me lesh dhie”, *qakapikë* “reska që ka dera kur mbyllet në bërryl”, *qenar* “rripi në anë të një sendi ose të një vendi; buzë”, *qeprë* “secili nga trarët e hollë e të gjatë që mbërthehen mbi gërshtëzat nga të dy anët e kulmarit të çatisë”, *qymez* “kotec”, *qypore* “qyp i vogël në trajtë të vorbës, me një vegjë, që përdoret zakonisht për të zënë kos”, *ramë* “bakër”, *rizë* “peshqir”, *rraqe* “rrangulla, vjetërsira”, *rrogozta* “njeriu që bën rrogoza”, *saç* “fletë hekuri e rrumbullakët, e ngritur si gungë dhe me dorezë sipër, që pasi nxehet mirë mbi zjarr, mbulohet me shpuzë e me prush dhe i vihet përsipër lakrorit, bukës etj. për t’u pjekur”, *sepet* “sënduk”, *skripeckë* “rrotkat e veglës ku varet spangoja e lidhur me lisat”, *skistër* “lopatë e vogël me të cilën kruajmë brumin që ngjitet në magje”, *sixhim* “spango”, *shajkë* “gozhdë”, *shals* “lloj mëngre që shërben për të rrahur lirin”, *shaneshin* “një tip minderi i ngushtë”, *shatë* “vegël metali me dru bishti që shërben për të prashitur”, *shaqiluar* “shilarth”, *shilurth* “shilarth i vogël”, *shitkë* “shpullë”, *shkrepje* “krunde bashkë me miellin”, *shkurtë* “zog shtegtar që i ngjan thëllëzës”, *shoshë* “një lloj site prej metali me vrima”, *shpargë* “rrobë e vogël prej leshi që përdoret për të mbështjellë ose mbuluar fëmijën”, *shtrojcë* “postiqe”, *shkluhë* “dyfek”, *tagar* “lëkurë kafshe e regjur”, *takije* “lloj kësule me majë të ngushtë, prej pëlhure të bardhë dyfishe, të rrahur me tegel të cilët e mbajnë fshatarët e myzeqesë”, *tallamaz* “daulle e vogël”, *tambura* “vegël muzikore me tre tela me kasë të vogël dhe me bisht të gjatë”, *targaç* “një lloj traste prej lëkure”, *telik* “rri mbërthyer mbi tra në tavan dhe përmes tij kalojnë penjët e pëlhurës”, *teneqeçkë* “copë e vogël teneqeje”, *thelmë* “copa të vogla që mbeten pasi priten një palë rroba për t’u qepur”, *thembër* “femër”, *trirë* “tezgë”, *tyrymbetë* “një lloj pizge e bërë prej lëkure shelgu, por më e gjatë dhe me dy-tre vrima sipër”, *vërshë* “kosh për të kapur peshk i bërë prej thuprash shelgu të cilat vendosen në një mënyrë të tillë që peshqit të hynë dhe të pengohen në të”, *vërzomë* “rrjetë e madhe prej litari

që e qepin anash si thes dhe e përdorin për të mbartur bar, kashtë etj. me kafshë”, *zamzane* “enë e madhe prej qelqi, me bark të gjerë e me grykë të ngushtë, që vishet nga jashtë me një thurimë kashte ose xunkthi për të mos u thyer dhe që përdoret zakonisht për të mbajtur raki” etj.

b. Fjalë që emërtojnë veshmbathje karakteristike për banorët e zonës, p.sh: *bufanto* “pjesë të fryra në veshjen e grave, p.sh. nën bel, në mëngë”, *dizgë* “shirip a rrip i ngushtë, zakonisht prej leshi, që shërben për të lidhur foshnjën në djep”, *çepkene* “veshje e moçme për meshkujt, që bëhej prej cohe, qëndisej me otra, vinte gjer mbi bel; mëngët ishin të hapura dhe të zëna me një sumbull ose me otra afër byzylykut të dorës, që të dukej mëngorja e bardhë. Rëndom këto mëngë mbaheshin varur prapa, d.m.th. nuk visheshin”, *dumane* “një tip pantallonash të gjera”, *dylben* “pëlhurë e hollë dhe e endur rrallë”, *guneshkë* “veshje e sipërme kombëtare për burra e për gra, e punuar prej leshi ose prej liri si një fustan i hapur në gjoks, me fundin e trupin të qepur njësh dhe kaluarthi”, *kofshore* “veshja e poshtme e burrave në formë pantallonash të ngushta”, *kollan* “rrip”, *komçë* “kopsë”, *kësulë*, *kiton* “petk që vishnin në mish burrat në Greqinë e Vjetër dhe që i përngjante tunikës romake”, *mëngore* “xhamadan prej shajaku, prej cohe etj., i stolitur me gajtanë e me fije arid he me mëngë të gjata që nuk vishen, po varen prapa krahëve për zbukurim”, *mollokof* “veshje e qëmoçme grarie, që mbetej përsipër e arrinte gjer në noçkat e këmbëve”, *neçë* “përparëse leshi”, *opingë*, *oputë* “gjalmë, rripa të opingave”, *papuçe*, *pashmanga* “këpucë grash që vishen si pantofla në shtëpi e si këpucë për jashtë”, *peshtamall* “rizë e madhe që të vë beriberi kur të qeth”, *qosele* “opinga me rripa”, *silah* “brez i lëkurtë, që shërben për të mbajtur armët e brezit”, *stringël* “send stolie si vëthë, unaza, byzylykë etj.”, *shkurtelkë* “veshje e sipërme grash në formë sakoje me jakë të madhe”, *thurak* “këmishë e gjatë, e thurur si rrjetë me rripa e me fije të trasha prej metali, që e vishnin luftëtarët në kohë të vjetra për t’u mbrojtur nga armët e ftohta”, *vilustë* “copë e lëmuar me shkëlqim”, *zhapërdhina* “heqla” etj.

c. Fjalë që emërtojnë gatesa ushqimore *bukëvale* “bukë e thërmuar e përvëluar me ujë të valë, me vaj ose me gjalpë dhe e përzier zakonisht me djathë”, *gajgana* “vezë të fërguara së bashku me specia, me domate, me erëza”, *haje* “ushqime”, *hoshaf* “fruta të ziera me sheqer”, *hoshmare* “ushqim i përgatitur me miell misri, gjalpë, djathë të cilat përzjehen me ujë të nxehtë dhe trazohen me shpejtësi derisa të shkëputet nga anët e enës dhe të dalë nga yndyra”, *kolloface* “zorrë e mbushur me mish koke, me presh dhe erëza”, *kominë* “bërsi”, *lakruar* “lakror”, *lale* “revani”, manure “djathë me qumësht delesh, i ngjizur në trajtë rrotulle, që është zakonisht i kripur; një rrotull e tillë djathi”, *maznik* “një lloj buke prej misri, vezësh dhe djathë”, *narden* “brumi që mbetet nga zierja e kumbullave të tharta”, *papare* “ushqim i përgatitur me bukë të thërmuar në ujë të valuar, i përzjerë me gjalpë e djathë”, *pastërma* “mish bagëtie i regjur me kripë dhe më pas i tharë”, *pekmes* “lëng i ëmbël pemësh, që trashet duke e zier në zjarr, qëpërdoret si ushqim e që mund të

ruhet për një kohë të gjatë”, *petanik* “një lloj byreku me petë të pjekura”, *prepir* “raki e holluar që mbetet në fund të kazanit dhe që rizjehet për t’u bërë raki”, *qullnik* “bukë e hollë që bëhet me miell misri të përvëlur me ujë të nxehtë, ose të trazuar me ujë të ftohtë”, *qumështuar* “ëmbëlsirë që përgatitet kryesisht me qumësht e vezë dhe me pak miell”, *tagji* “tërshërë, elb, misër etj., zakonisht kokrra, që u jepet si ushqim kafshëve të punës ose bagëtive të trasha”, *trahana* “brumë thartë me miell gruri që zihet me kos a me qumështë e pastaj thahet në diell e thërrmohet”, *zaire* “ushqime, kryesisht ato dimërore” etj.

ç. Fjalë që emërtojnë marrëdhënie farefisnore e ndërnjerëzore: *atë*, *atëlosh*, *babale*, *babëlosh*, *bandill*, *baxhanak*, *bej* (fjalë që nuk përdoret për të shprehur rang shoqëror, por për të shprehur respekt, p.sh. *Halit beu*), *dajo*, *halitore* “nuse e Halitit”, *Istrefi i Bellkamenit* (Një karakteristikë për trevën juglindore bashkëshoqërimi i emrit të një personi dhe me emrin e babait të vet) *krushqëri*, *lalush*, *lartmadhëri*, *mble* “lajmës, shkues”, *nusja e Naqos*, *ndrikull* “e shoqja e kumbarës, nunë”; *ngjelkë* “grua llafazane”, *nipoll*, *njerkë*, *nun* “kumbarë”, *nënokë*, *Olimbaqkë*, *nusja e Ristos*, *ristovicë* “nuse e Ristos”, *Ristua i Ristos*, *stërmbesë*, *stërnipëri*, *tatë* “baba”, *tatëlosh* “baba, thuhet me përkëdheli”, *tete* “teze; përdoret nga fëmijët, zakonisht para një emri të përveçëm, për të thirrur me nderim një grua”, *tetemadhe* “tezja e madhe”, *tekë* “teze, përdoret me përkëdheli”, *thjeshtë* “djali që gjen gruaja e dytë e një burri nga gruaja e parë e tij ose vajza që i shpie gruaja burrit nga martesja e saj e parë”, *vëlasho* “vëlla”, *vëllauth* “vëlla”, *xha* “përdoret para emrit të përveçëm të një burri të moshuar, kur thirret me nderim nga një më i ri”, *xhaxho* “vëllai i babait kundrejt nipit a mbesës; përdoret nga fëmijët kur i drejtohen me nderim e me dashuri një më të madhi”, *xhaxhovicë* “nuse e xhaxhait”, *zonjë*, *zoti*, *çupë*, *çupërlinë*, *çun*, *nipstërnip*, *zotrote*, *emtë* “hallë, teze” etj.

d. Të përhapura janë dhe emrat e kafshëve, si: *balicë*, *baliskë*, *balo*, *buzo*, *gjesë*, *kaso* etj.

-Në vendin e dytë vijnë fjalët nga bota e kafshëve, si: *atkinë* “pelë shale”, *arrakë* “desh ose cjep të fortë, të patredhur”, *belbicë* “belushkë”, *brevë* “gjarpër i zi, një a dy pash i gjatë; bollë”, *bilbilgjyzar* “figurë e përrallave popullore; bilbil me zë shumë të bukur”, *buall* “kafshë shtëpiake ripërtypëse e dythundrake, me trup të madh e të mbushur me qime të zeza, me qafë të shkurtër dhe me brirë të kthyer mbrapa, që mbahet për punë bujqësore”, *bubuzhel* “brumbull”, *buf*, *bulkëz* “*bulkth*”, *kaproll*, *bulogë* “thuhet për ujkun kur maskohet të mos duket duke mbuluar me dhe këmbët e para e duke qëndruar palëvizur”, *buçe* “bushtër”, *cinxull* “zokth me pupla të verdha e të gjelbra, që u afrohet në dimër vendeve të banuara”, *cëri* “rabeckë”, *çallmaxhuk* “një lloj zog me çallmë”, *çoçërr* “cinxami”, *dockë* “dosëz, insekt që rri në tokë e dëmton rrënjët e bimëve”, *ferrak* “cinxami”, *ftujak* “kec mashkull nga një vit deri në dy vjeç”, *ftujë* “kec femër nga një vit deri në dy

vjeç”, *gallof* “korbi i bardhë”, *galë* “stërçokë”, *gargull* “bregcë; shturë”, *gatakë* “çafkë e vogël”, *gatë* “çafkë”, *grerak*, *grifshë* “zog i larmë nga trupi dhe me një xhufkë në kokë”, *guguçe* “kumri”, *gurneckë*, *gushkuq*, *guzë* “lloj rose e egër me ngjyrë të zezë, me sqep të bardhë që ushqehet me peshk e dimëron në liqen”, *iriqeshë* “femra e iriqit”, *kaposh* “këndes, gjel”, *kaprua* “kaproll”, *kapua* “gjel”, *karabatak* “një nga zogjtë e liqenit të Pogradecit që vjen në vjeshtë e ushqehet me peshq”, *kedhe* “kec”, *klen* “një lloj peshku i egër me shumë hala që rritet në Liqenin e Pogradecit”, *kreshk* “luspë peshku”, *kokosh* “gjel”, *krapishtë* “krap i vogël”, *kunadhe* “shqarth”, *kutë* “këlysh qeni”, *kuçkë* “bushtër”, *kudër* “bushtër”, *këlysh* “i vogli i një kafshe”, *kërriç* “i vogli i gomarit”, *lakuriqkë* “gjitar i vogël sa një zog, i zi, me krahë të gjerë e të mbuluar me lëkurë të hollë, që i ngjan miut, fluturon natën dhe ushqehet me kandrra dhe me pemë të ndryshme”, *larash* “thuhet për kafshët që janë lara-lara”, *laraskë* “shpend i ngjashëm me sorrën”, *leknë* “peshk me pikëza të kaltra, të kuqe, të gjelbra në lëkurën e bardhë si argjend”, *marauzhgë* “milingonë”, *milor* “qengj mashkull një deri në dy vjeç”, *misërok* “gjel deti”, *mëllenjë* “zog i vogël shtegtar nga rendi i harabelave, me pupla të zeza të ndritshme, me sqep të verdhë si në ngjyrë portokalli e me këmbë të murrme, që rri zakonisht nëpër ferra e nëpër shkurre”, *mërenë* “një lloj peshku i egër i Liqenit të Pogradecit, karakteristikë është koka e tij si prej gjarpri”, *nosit* “pelikan”, *muselalë* “kafshë gjitare mishngrënëse sa një mace, me trup të shkathët, me gëzof të murrme a të kuqërremtë sipër e të bardhë në bark”, *oç* “pjella e buallicës”, *pëllëje* “dele ose dhi që ka pjellë dhe jep qumësht”, *përç* “cjav i patredhur”, *piku* “qukapik”, *pisërëngë* “nuse e lalës”, *pllashicë* “peshk pak më i madh se gurneckat”, *pulestrat* “zog pule i rritur”, *pulisht* “kërriç”, *pupë* “larva e disa kandrrave, e mbështjellë me një fshikëz të mbyllur”, *qelbak* “qelbës”, *qimegjallë* “qime e gjallë”, *qokth* “shpend grabitqar me pendë të murrme, pak më e vogël se kukuvajka, që këndon natën në verë”, *qyqe* “zog shtegtar i pyjeve, me pendë ngjyrë hiri në të zezë, që këndon me një zë të përvajshëm dhe që nuk bën fole, por i lëshon vezët në foletë e zogjve të tjerë”, *rabeckë* “harabel”, *rrëqebull* “kafshë e egër mishngrënëse e ngjashme me macen”, *sharan* “kafshë si kalë, dele, dash që kanë turi të bardhë përzier me të murrme”, *sheleg* “qengj që ka mbushur vitin”, *shkurtë* “zog shtegtar që i ngjan thëllëzës, me pendë të murme e lara-lara, me këmbë të shkurtra dhe me mish shumë të shijshëm”, *shushunjë* “krimb parazitar me trup unazor, që ushqehet me gjakun e kafshëve të ndryshme duke u ngjitur në trupin e tyre”, *skile* “dhelper”, *sutë* “drenushë”, *thieshë* “femra e derrit”, *torozhan* “zog me madhësinë mëllenjës, ngjyrë afërsisht kafe që del dimrit”, *turtulleshë*, *ulkonjë*, *vraç* “kalë i zi”, *zegër* “zekth”, *zhingë* “gjinkallë” etj.

-Në vendin e tretë vijnë fjalët nga bota bimore, si: *anason* “bimë nga familja e umbrelloreve, me lule të bardha e me fruta, me aromë të fortë”, *belicë* “qershë e kuqërreme, kokërrmadhe”, *bërsi* “mbeturinat e farave të disa bimëve ose të frutave të disa pemëve, pasi këto shtypen e shtrudhen për të

nxjerrë prej tyre vajin, lëngun etj.”, *binek* “bimë barishtore parazitare, me kërcell të shkurtër e të hollë, që bën kokrra të vogla si të fshesës dhe që del në arat e mbjella me oriz”, *boçkë* “fryti i disa pemëve, që ka trajtën e një kokrrë të rumbullakët e të fryrë”, *brozdongane* “një lloj dardhe e madhe dhe me shumë lëng të ëmbël”, *bumbeskë* “syth i fryrë bime që sapo çel”, *bung* “lloj dushku tridhjetë-dyzet metra i lartë, me trung të trashë, me kurorë të gjerë e të çrregullt, me lëkurë të murrme e gjethe vezake, që nxjerr tri deri shtatë lende së bashku në një bisht”, *bungishtë* “pyll me bungje”, *bush* “shkurre me shumë degë, që e ka lëndën të verdhë, të fortë e me palcë”, *dashtër* “bimë barishtore e egër, me kërcell të drejtë e të lartë, me gjethe të gjera, të çara e të kthyera lart, me gjemba të fortë, që çel në verë lule të bardha”, *dyyvjaçkë* “një farë molle e egër, e athët që zbryllet buzë dimri”, *dëllinjë* “dru a shkurre me gjethe halore gjithnjë të blerta, që bën kokrra të rumbullakëta në ngjyrë të zezë, të kuqërremë ose blu të errët dhe me erë të mirë”, *egjër* “bar i keq që rritet zakonisht në arat e mbjella me grurë dhe që bën kokrra të vogla me ngjyrë të zezë të cilat pot ë përzjehen bashkë me grurin, e prishin cilësinë e bukës dhe e bëjnë këtë të dëmshme për njeriun”, *gjemb gomari* “gjembaç”, *gorricë* “dardhë e egër”, *grashinë* “bimë barishtore zvarritëse e kacavarëse me kërcell të degëzuar me gjethe çift e e lule ngjyrëmanushaqe ose të verdha, që lidh bishtaja me fara të zeza dhe që dëmton drithrat e sidomos grurin, por është ushqy i mirë për bagëtinë”, *gëmushë* “shkurre me degë të dendura që dalin drejtpërdrejt nga rrënja, kaçubë”, *gështenjë*, *gëzhutë* “lëvozhga që mbështjell kokrrën e grurit, thekrës etj”, *jeshillëk* “pjesë toke e mbjellë me bimë të gjelbra”, *kajkushkë* “lloj dardhe që bën kokrra të verdha e të rumbullakëta, të cilat piqen në vjeshtë dhe ëmbëlsohen e zbuten duke ndenjtur”, *kallmishtë* “vend me kallama”, *kallmër* “bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të gjatë, të hollë e të fortë, që rritet nëpër moçale”, *kokarkë* “qepujkë”, *koqiskë* “thuhet për kokrrën e misrit, grurit etj.”, *koçan* “kalli misri i shkoqur nga kokrrat”, *koçkorr* “gjemb i trashë”, *kulpër* “shkurre kacavarëse që rritet deri në gjastë metra dhe bën lule të bardha me erë të mirë”, *këlkëzë* “bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të gjera e me zhardhokë”, *larushk* (një lloj rrush i egër), *llapushkë* “lëvorja e kallirit të misrit”, *llaznicë* “pjergull”, *man* “pemë që lidh kokrra të përbëra prej kokrrizash të lëngshme e të ëmbla, në ngjyrë të bardhë, të kuqe a të zezë”, *poleskë* “aguliçe”, *qarr* “lloj dushku”, *rasat* “vezë peshku që hidhen për t’u shumëzuar në një liqen a pellg”, *resnjë* “bimë barishtore e kënetave dhe e liqeneve, që bën fije të gjata”, *rrapishte* “pyll me rrape”, *shavar* “bimë shumëvjeçare deri tre metra e lartë, me kërcell të drejtë pa nyja, me gjethe të gjata e të ngushta dhe me lule të mbledhura si kalli, që rritet në kënetat e buzë ujërash etj.”, *sheputkë*, *shpendër* “bimë barishtore shumëvjeçare e ngjashme me shtogun që rritet në djerrina dhe që bën disa kokrriza të zeza” *shibojë* “shebojë”, *troskë* “gram, bar i keq”, *thanishtë* “vend me thana”, *thanë* “bimë që rritet e lartë e si shkurre, me dru të fortë, me gjethe të vogla vezake e të ashpra, që lulëzon herët në pranverë dhe bën kokrra të

kuqe, gjatoshe si ulli dhe me shije të athët”, *thekër*, *unap* “një lloj druri që çel lule me aromë shumë të këndshme”, *urof* “bimë barishtore njëvjeçare e ngjashme me grashinën, me kërcell të shkurtër, që bën bishtaja me fara të rrumbullakëta dhe përdoret si ushqim për kafshët”, *xhenxhefil* “bimë barishtore shumëvjeçare e vendeve të nxehta, me gjethe si heshta e me lule të verdha, rizomat e së cilës kanë njëlloj vaji dhe përdoren të thara për t’u dhënë erë të mirë , pijeve, gatesave”, *xhumble* “bimë të ngjeshura me njëra-tjetrën”, *zhavar* “bimë që rritet në anë të kënetës e liqenit, me kërcell të hollë, shavar” etj.

2.3.2. Leksema që shënojnë lojëra popullore apo emërtime

Leksikun popullor e pasurojnë edhe leksemat që shënojnë lojëra popullore, si: *symbyllkë*; *laga-thata*; *e pashë*, *s’e pashë* etj. Për shembull:

-*Lozim*, *ç’lozim*?

-*Symbyllkë!* - njëri.

-*Këmbëçalkë!* - tjetri.

-*Me dasmë!* - një i treti.

Do të kish qënë mirë symbyllkë, se do kishim gjetur kësaj radhe një furrik më të vogël se ai i djeshmi andej nga mulliri ku nuk do na pikaste asnjëri, po puna mbeti për dasmë. E kur gjithë fshati kërkon dasmë , s’ke qysh i thua ndryshe!

-*Me dasmë*, po kush martohet?

-*Zhapiku me Magalinën!*

-Kokorozi me kunadhen. (Vepra 2, f. 167) etj.

Disa njësi leksikore që kanë interes të veçantë për gjuhën letrare, janë ato që emërtojnë vende apo tokë të mbjellë me bimën, me drurin ose pemën e shënuar nga tema fjalëformuese, si edhe njësi leksikore që emërtojnë vende, të cilat kanë nga një karakteristikë, që shënohet nga tema fjalëformuese, si: *ahishtë* “vend me ahe”, *bredhishtë* “pyll me bredha”, *breshhtë* “bredhishtë”, *derrpë* “pyll shumë i dendur”, *djellishtë* “copë vend që e zë shumë dielli”, *dushkajë* “vend me dushqe”, *dushnik* “pyll me dushqe”, *fierishtë* “vend ku ka shumë fier”, *fletishtë* “vend i mbushur me fletë, me gjethe”, *kule* “grumbull i madh ferrash”, *lirishtë* “livadh i vogël në mes të pyllit”, *plepishhtë* “vend me plepa”, *pyllishtë* “vend i mbjellë me drurë të rinj”, *qarrishtë* “vend me qarre”, *stërnishtë* “ arë e korrur që mbillet përsëri me një bimë tjetër”, *thekërishtë* “vend i mbjellë me thekër”, *vullajë* “vend me gëmusha” etj.

Me dorën e një mjeshtri dhe njëkohësisht të një “dashatari” të madh, (po të përdornim një nga fjalëkrijimet e tij më të bukura), Kuteli arrin të shpërfaqë para lexuesit, me shumë magji, tërë atë pasuri e shumëllojshmëri bimësh, lulësh, zogjsh dhe kafshësh, që zotëron vendlindja e tij, përmes përshkrimeve të hollësishme, si:

Drapri sapo kish rënë në **grynjat**, po **bari** kish ditë që ish prerë. Nga **luadhet** e kositura vinte një erë dehëse; **trëndeline** e **makthi**, **mender** e **tërfili**, **pparune** e **kokoçeli**, **modhëze** e shumë të tjerash. Kjo erë përzihej me atë të **luleve** e të **barishtave** të **grynjave** dhe të bëntë që të të vinte mendja qerthull. Nga toka e zjarrtë, tërë plasurina, buronte një afsh i valë, i përndritur, luhatej si një mori sumbullash sedeft dhe ngrihej lart. Liqeri kish shtangur në diellin e mesditës dhe llambarinte me luspa të shumta argjendi. Rreth e qark vagëllonin mallet e veshura me afsh drite, duke u pasqyruar përmbys në ujë.

Ziente **gjinkalla**.

Përtej vigut të Drimit të Vogël, në atë shtegun që përshkonte kulluzmën e **rrapishtes** dhe shpinte tutje në arat, u duk një zbardhëllimë: një vajzë e veshur me linjës të shkurtër, me kinda e qëndima përfundi, që i valaviteshin mbi gjunjë. Vajza u largua me hap të shpejtë. Të ecurit e kish të këndshëm si këngë **ferraku**. (Vepra 3, f. 55).

Bagëtia e leshtë kish kohë që kish pjellë. Tani **qengjat** ishin përkëmbur e këputur nga **mandra** e **pëllejave** dhe kullosnin veçan, vinin **mish** e **dhjamë**, ndërsa nënat e tyre sillnin në **vathë**, më drekë e më darkë, lumenj të tërë **qumështi** shkumbëbardhë. Nëpër shkrepat e **qetat** e varura mbi gremina kërcenin **dhi** të egra briforta; nëpër **lirishtet** e epërme, të qarkuara me **pyje** të dendura, ku **bari** i ri kish një ngjyrë të gjelbër, të ndezur, kullosnin **suta** këmbëshpejta, që zbrisnin e pinin ujë nëpër kronjtë e ftohtë dhe i druheshin edhe **fëshfërimës** së **gjethit** kur frynte puhia, dasmonin **kaponjtë** e egër dhe **pulat** pikalore. Andej-këndevoj zozitnin **dhelpra**, **kunadhe**, **lepuj**, **ketra**. Domosdo nuk mungonte as **ujku** ladut, as **ariu** shputërendë, as **maçoku** i egër dhe as **bisha** të tjera mishngrënëse, të heshtura apo të zhurmshme. (Vepra 3, f. 8)

...Ndërkaq, sipër kreshtave e pllajave, mbi honet e mbuluara me avull të zbardhlyt plevasnin **shqiponja**, **gjeraqina**, **larashë** dhe grabitës të tjera të veshur me **pupla**, vëzhgonin e pastaj këputeshin e binin poshtë sikur t'i paskej tërhequr të rëndët e dheut. Pas një çasti brofnim së andejmi me ndonjë **kapua**, **thëllëzë**, **pëllumb** a **shtërpi** ose me ndonjë **gjë** tjetër të **gjallë**, mjaft të rëndë, që e mbanin në **sqep** e **kthetra** dhe shpinin atje ku dinin vetë, për të gostitur **zogjtë** dhe veten. Poshtë fare, në fusha e kënetat, në liqeret zbardhnin herëherë krahë **shtërgu**, **krille** e **nositi**, apo nxinte ndonjë zhgarravinë reje udhëtare. (Vepra 3, f. 9)

...Dhe kështu **gomari** hyri në një shteg që cante një qarrishte. Vendevende, atje ku **gjethet** ishin më të rralla, depërtonin rrezet e diellit, ia ndriçonin fytyrë e zbehtë dhe ia përlotnin sytë. Atëhere, ndjeu se i gërvinin zorrët nga uria. Nxori një krodhe bukë tërë **hala** dhe nja dy **ullinj** të fishkur dhe zuri të hajë, dukë shtyrë kafshatet me **rrush** e **fiq**. (Vepra 3, f. 264).

...Si mbaron këtë punë brënda në fshat, Kuma Marua kthehet në mallet dhe u kall tmerrin gjithë atyre që ka nën urdhër: **drerëve** e **drenushëve**, **kunëzës** e **ketrit**, **rrëqebullit** dhe **baldosës**. **Skilja** tinëzare tulitet në strofull me

gjithë veshë e me gjithë bisht. As **ujku** që është **ujk** e **thiu** që është s'guxojnë t'i dalin përpara...**breshka** mbyllet brënda në zhguall e mbetet pa zë. (Vepra 4, f. 297). Gjahu i egër nuk është si gjahu i **shkurtave** nëpër **grykat** e Drimonës. Dhe ish zhdukur **pyllit**, duke lënë prapa një **erë** turbullonjëse: **qumështi** e **mjalti**, **molle** e **ftoi**. (Vepra 3, f. 25) etj.

2.3.3. Togfjalëshat popullore

Përbërës të rëndësishëm të shtresës dialektore në prozën e Kuteli janë edhe togfjalëshat popullore apo lidhjet fjalësore sipas modeleve të gjuhës së përditshme të popullit dhe krijimtarisë së tij gojore, të cilat më shpesh i gjejmë në krijimet që mbështeten në rrëfimet popullore, përrallat apo mitet dhe kjo është e natyrshme. Në përgjithësi, ai i merr ato si formula të gatshme, por nuk mungojnë rastet, kur ai vetë ndërton sipas gjedhes së tyre: *Eja ditë – shko ditë, eja muaj – shko muaj, eja mot – shko mot*, fundja, i erdhi koha të martohej si gjithë bota. (Vepra 4, f. 60); Ky Beluli na kish një zonjë të bukur *rënë-qielli*. (Vepra 2, f. 307); ... më ka çuar fjalë ajo *copë grua*. (Vepra 2, f. 24); *Po hap gojën e kërko, moj Xëme*. (Vepra 2, f. 308); Vajti atje ku ishin mbledhur *të parët e fshatit*. (Vepra 2, f. 99); *E rruan e u trashëguan*. (Vepra 2, f. 100); ... që kur është *bota botë* plakati i përcjellin pleqtë në varr. (Vepra 3, f. 457); Le që zotrote s'je as një po *hiç bir hiçi*. (Vepra 3, f. 509); Ti moj kutrumajë paske qënë *lëngjyer e shkuar lëngjyeri*. (Vepra 3, f. 450); *Ama çudi*: të gjithë këta burra – nënprefekti, togeri, ushtarët e ata të tjerë – flisnin shqip si unë. (Vepra 1, f. 162); *Ka qënë si ka qënë* unë s'dua t'ja di. (Vepra 1, f. 198); Për punën e një çupe, *një Xhoxhi-Xhoxhi*, nga ata të motovilës, i ra me dyfek beut. (Vepra 1, f. 213); *Ishe si ishe, ishte si ishte*, ai të prët andej. (Vepra 1, f. 198); Këtë punë e merrte vesh *mirë e bukur* Sefedini Sefedini. (Vepra 1 f. 194); ... e u binin faqeve kur *të kuqtë e fruthit* e kur *të verdhët e verdhicës*. (Vepra 1, f. 212); *E shëmbëlleja e s'e shëmbëlleja* dot Selvinë e vogël. (Vepra 1, f. 114); *Do të të bëj zonjë mbi zonja*. (Vepra 1, f.95); *Gjak sot gjak nesër, varr sot varr nesër*, ja, së fundi, erdhi çasti i lig... (Vepra 1, f. 183); *Burrë burrë* po dhe *plagët plagë*... dhembin të shkretat, rrjedhin gjak. (Vepra 1, f.185); Gjaku u ndez *s'di se si* e *s'di se ku* për një çupë dhe pastaj *bjeri t'i biem, vritini të vritemi*. (Vepra 1, f. 179); *Merr të marrim, rrëmbe të rrëmbejmë*. (Vepra 1, f.335); ... po Lumi ynë i madh *lumë ishte, lumë është*. (Vepra 1, f. 348); *Fry mos fryfsh* moj erë e shkretë. (Vepra 1, f. 338); ... *merr të marrim, rrëmbe të rrëmbejmë!* ... *Hanë e s'ngopen* sikur t'u ketë hyrë qoftëlargu brënda në bark. (Vepra 1, f.335); Ky *besoi e s'besoi* dhe, *me të besuar e pa të besuar*, e humbi toruan. (Vepra 1, f. 184); *Punoi e punoi* ky dyfeku i Sefedinit, gjersa tre Gjatollinj mbetën shtrirë në rrah, *sa të gjatë të gjerë*. (Vepra 1, f. 185); ... *tundu e shkundu*, me armët e Sefedinit në brez. (Vepra 1, f. 186); Po qeni është i mençur si njeri; *i mirë me të mirin, i lig me të ligun*. (Vepra 3, f. 304); ... i

vetëtin goja: *flori i gjallë*. (Vepra 3, f. 465); E pashë sot majë çatisë. Murator, i *bir i botës*. (Vepra 3, f. 481); *Si i thonë një fjale*: udhëtari do të piqet ngaherë me hanxhinë. (Vepra 3, f.500); *Çuditëshin e s'çuditëshin dot*, jo vetëm bujeri që na kish marrë në punë, po edhe gjithë njerëzia e vendit. (Vepra 2, f. 33); *Kam parë e s'kam parë vite të begatshme*, po mot si atë kur *lashë të shtatat e mora të tetat, s'kam parë e skam dëgjuar*. Edhe *pleqtë që janë pleq* ua dinë radhën punëve të mome, rrëfejnë se s'mbajnë mend të ketë ngjarë ndonjëherë qëmoti një cudi e këtillë... Dhe lëshuan drithë, jo dëngla: *kalli e killë, kalli e killë*. (Vepra 2, f. 115); Më tha t'ia rrëfej pak se do më nxjerrë një pizgë të madhe, një bilbil pa gdhë, e çmos e çnuk, po unë *jo e jo*. (Vepra 2, f. 95); Pa ia ka thirrur ky Xoxi këngës, *bukuri e madhe*. (Vepra 2, f. 23); *Edhe çudi*: mëngjesi s'ishte i keq. (Vepra 1, f. 63); - Ti je, ti je, Tërfile... Ai më tha për herë të parë *Tërfil e tërfil më mbeti*. (Vepra 2, f. 182); ... *ku maji s'ka të sosur e lulja s'ka të shkundur, në jetën e jetës, në jetën e jetës, në jetën e jetëve*. (Vepra 2, f. 214); Po të na thosh *gjysmë fjale*. (Vepra 2, f.255); ... lipset të rrijë i mjeri, *gjithë me kupë në dorë!* (Vepra 2, f.273); *Folëm sa folëm* për drurët dhe gurët. (Vepra 3, f. 229); Siç duket të kanë dhënë *tru laraske*. (Vepra 3, f.332), Ç'njeri është ky? ...*shpirt njeriu*. (Vepra 3, f. 357); Kësaj që bëre ti xhaxho, *i thonë grevë*. (Vepra 3, f. 406); *Vashë mbi vashëzat* e dheut... E kam *shoqin e jetëve*. (Vepra 4, f. 18); *Fjalë pas fjale* ja se ç'i thanë burrat Gjeto Basho Mujit. (Vepra 4, f. 87); Aty gjen Janukën e Bardhë, *të bukurën mbi të bukurat*. (Vepra 4, f. 83); *Shko-shko* shohin një ujë të mirë, të ftohtë e të kulluar. (Vepra 4, f. 127); ... lotët i rrjedhin *çikër-çikër* faqeve të vyshkura. (Vepra 4, f. 137); Dhe më *e keqja e të këqijave*: plakut s'i kish mbetur mashkull në derë. (Vepra 4, f. 137); *Hysua vdes e s'vdes dot*. (Vepra 4, f. 152); Ata të dy luftojnë *egër e më egër*. (Vepra 4, f. 169); *Trima për kokën e trimave* ishin Muji dhe Halili. (Vepra 4, f. 175); *Breshka ik, Gjoni ndiq*. (Vepra 4, f. 203); *e para nga të parat*, mos na thuaj më vëllezër. (Vepra 4, f. 206); *O mbret i mbretërve*, që sundon në të gjithë dherat e detet. (Vepra 4, f. 231); *shoqe, moj shoqe! Motra, moj motra*. (Vepra 4, f. 270); ... i thotë në vesh *kështu e kështu*. (Vepra 4, f. 306); Po çudia e çudive ishte shpella brenda. (Vepra 4, f. 309); ... ky ua tha *galave e galicave*. (Vepra 4, f. 316); Do të të sjell një bandill për kokën e bandillit. (Vepra 4, f. 355); ... ia gjenim radhën *mik pas miku*. (Vepra 4, f. 372); Atëhere *krisi ç'krisi*. (Vepra 4, f. 395); Të mbulojë *balta baltën*, se na bëre për faqe të zezë. (Vepra 4, f. 402); *burrë po burrë* ka qënë. (Vepra 4, f. 429); Vëllezër sot, vëllezër mot – na u dirs të treve mustaqja. (Vepra 4, f. 476); *Na ish, nuk na ish*. (Vepra 4, f. 502); Unë të mos e dua *stërbirin e stërmikut*. (Vepra 4, f. 477); Toka lëkundej *kur e kur*, shtëpitë anoheshin kur këtej e kur andej, bota përpiqte duart, fëmija qanin, e unë, *gjysmëzgjuar, gjysmëfjetur* vështroja i çuditur e nuk kuptoja dot këtë zhurmë. (Vepra 2, f. 71); Ç'i ke tërë këto kosha, *mik i zemrës?* ... Ca dhurata të vogla *vëlla i zemrës*. (Vepra 4, f. 430); *Mer e ler* tashi Xoxi, *zgjidh e mblidh*, se je në mes të lëmit. (Vepra 2, f. 28) etj.

Siç shkruan Gjovalin Shkurtaç, shkrimtari ka nevojë për dy elemente të rëndësishme, që i takojnë sa atij, aq edhe lexuesit, së pari, të tërheqë vëmendjen e këtij të fundit dhe “*kjo duket qartë te fjalët ndjellëse që spikatin në gjuhën e folur të tipit: dëgjo, shiko, ki mendjen etj.*”⁴⁴ dhe, së dyti, të kuptohet prej tyre, gjë që “*duket qartë edhe edhe në fjalët pyetëse që spikasin në gjuhën e folur si funksion fatik i gjuhës: A kupton? A more vesh? etj.*”⁴⁵ Ndërtime të tilla sintaksore, si gjurmë të ligjëritit popullor gjenden edhe te Kuteli, te fjalitë apo frazat me të cilat autori ndërpret për një çast ligjërimin, për t’iu drejtuar lexuesit në një mënyrë të tillë, sikur ai të ishte i pranishëm në momentin e rrëfimit. Kjo e shkund lexuesin nga ndonjë dremetje apo humbje vëmendjeje dhe i mban të gjallë kureshtjen për çka po lexon:

Atje nga goja e pleqve, s’i kisha më parë nga goja e gjyshit, dëgjova këngën e trimërisë e Bendo Shapërdanit që kur shtinte me dajlan, s’i shpëtonte as zogu.

Mbani vesh tani e më dëgjoni:

Ka qënë, o miq një kohë kur kjo Peshkëpia na ish një fshat i madh e i pasur, sindozot se ka qënë edhe Alarupi. (Vepra 2, f. 43); ***E kështu, o të mirë që rrini e këndonit këtë kartë, më falni se e preva fjalën, për nam e për trimëri ndër të huajt, u shkallmua e u blua ajo derë e Gjonomadhëve të Shëmërtisë së Sipërme.*** (Vepra 1, f. 179); ***A doni t’ju them tani o këndonjës, se ç’ndodhi më tej? Dëgjoni.*** (Vepra 1, f. 200); ***Në s’ju vjen të besoni e druhi të ma thoni, urdhëroni e dëgjoni nja dy fjalë.*** (Vepra 1, f. 176); ***A doni tju them si u takua Ndoni me Zallorët? ... Atëhere bëni durim t’marrim të gjitha me radhë.*** (Vepra 1, f. 326) etj.

2.3.4. Urimet dhe mallkimet

Kuteli prozator ndjek rrugën që mbështetet në të dhënë se “*për të provokuar lexuesin në pikëpamje përmbajtësore e stilistike, për të tërhequr vëmendjen e tij, duhet të përfshijë shumëçka në rrafshin gjuhësor, madje edhe krijime të ndryshme popullore siç janë urimet dhe mallkimet*”⁴⁶, të cilat janë një dukuri interesante e leksikut popullor. Si gjithçka tjetër, edhe përdorimi i urimeve dhe mallkimeve është në përputhje me konceptimin tërësor letrar e gjuhësor të veprës së tij. Duke qënë se janë pjesë e jetës së njeriut, mungesa e tyre do t’i krijonte zbehtësi prozës së Kutelit, i cili duket se e njeh dhe e përdor shumë mirë këtë pasuri të shqipes. Urimet dhe mallkimet janë tipike për ligjërimin gojor, por përdorimi i tyre sjell vlera të veçanta edhe në ligjërimin artistik. Dihet se, të ruajtura e të përcjella brez mbas brezi, ato kanë fituar një nivel ngurtësimi e vijne në trajtë formulash të njëjta, por Kuteli përveçse i përcjell si të tilla, krijojnë vetë variante të ndryshme përmbajtësore e

44. Gj. Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë 2008, f. 77.

45. Po aty, f. 78

46. Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë 2000, f.364.

stilitike, ndaj në strukturën e urimeve dhe mallkimeve mund të gjenden fjalë ose trajta dialektore, të cilat përforcojnë frymën autentike etnografike të krahinës së autorit. Kjo shihet veçanërisht në urimet dhe mallkimet, të cilat kanë në përbërjen e tyre emra vendesh, zogjsh, kafshësh apo elemente të besimit popullor të zonës, si emra perëndish, shenjtësh, djajsh etj. Për shembull:

Shëndaum i 'rgjëndë të pastë kujdes; Prema dorëplotë ta dëgjoftë; paç ndihmës Zot Medaurin shpatërëndin; paç Akamosin prijës dhe Zalmoksin mburojë; gur zënç, dyvjaçkë t'u bëftë; u shtofshin si zogjt e bletës; të çaftë ariu i Kakaçit; ja hëngshin turinjtë grerakët e egër të dushkut etj.

Urimet dhe mallkimet në veprën kuteliane, ashtu si gjuha në përgjithësi, nuk qëndrojnë brenda kufirit të toskërishtes juglindore, përkundrazi, ato përfshijnë edhe njësi të tilla të dialektit verior apo edhe njësi me karakter të përgjithshëm kombëtar, në varësi të subjektit, vendit të ngjarjes, prejardhjes së personazheve etj. Në vijim urimet dhe mallkimet do të trajtohen më gjerë të ndara nga njëra tjetra.

- Urimet

Urimet sjellin në veprën e Kutelit pasuri përmbajtësore, gjuhësore e stilitike. Nëpërmjet tyre shprehet mendësia lokale, por edhe më tej, mendësia kombëtare në lidhje me ekzistencën, me trashëgiminë njerëzore, me trashëgiminë shpirtërore e materiale, veçanërisht mendësia në lidhje me rëndësinë e vlerave të tilla morale, si: nderi, bujaria, altruizmi, miqësia, dëlirësia, trimëria etj. Kështu, personazhi i Kutelit i drejtohet mikut me urimin shumë domethënës: *të paça!* Ndërsa të miturin mashkull e uron: *trim u bëfsh! U bëfsh burrë!* etj. Këto urime tregojnë se jeta e shqiptarit ka dy institucione kryesore: mikun dhe trimërinë.

Personazhet e veprës së Kutelit, në përgjithësi, shquhen për ndjeshmëri sociale, gati-gati farefisnore dhe kështu, për shembull, gëzimi i një familjeje për një martesë, përjetohet si gëzim i të gjithëve. Urimet kanë në përmbajtjen e tyre dëshirën që gëzimi të përfshijë të gjitha familjet e fshatit apo zonës ku zhvillohen ngjarjet, duke mbitheksuar kështu vlerat e humanizmit, që nuk i mungojnë në asnjë rast veprës. Në këtë këndvështrim, veçohet si një nga më interesantët e më domethënësit urimi popullor *gaz për derë*, i cili bie në sy jo vetëm për mesazhin që përcjell, por edhe për strukturën e veçantë të ndërtimit, për sintetizmin gjuhësor që rrit më tej vlerën artistike të tij. Kjo vlerë e shtuar do të binte, nëse kjo njësi urimi do të ndërtohej në mënyrë më të zgjeruar gjuhësisht, pra bashkë me përemrin e pacaktuar “*çdo*”, në formën “*gaz për çdo derë*”. Përmendim për një mënyrë intensive të të shprehurit, sidomos ndërtimet dyshe, si: *të shkuara të harruara, rrofsh e qofsh, tul e dhjamë* etj. Pra, edhe urimet duke mos bërë përjashtim, ashtu si shumëçka në veprën e Kutelit, shpërfaqin pasuri sinonimike, shkallë të lartë intensiteti, figurshmëri të krijuar nga metaforat, krahasimet, hiperbolat, epitetet etj. Të gjitha këto elemente përbërëse vërehen në shembujt: *Shërmëria të sjelltë shëndoshë; të lumtë njajo*

dorë; u shtofsh e u bëfsh me njëqind oxhakë; qofsh e gëzuar sot e mot; puna mbarë; udhë e mbarë; u pjekshim shëndoshë; e hëngsh gëzuar bukën; mirëmbetsh, udhembarë; rrofsh e qofsh; hallall e paç; ku rënça mos u vrafsha; më rrofsh; dhëntë zoti; ku hëngrëm hëngshim, ku pimë pifshim; të lumshin krahët; perëndia e shtoftë drithin; misardhe; mirë e më mire; të gjetë shëndoshë; qofsh shëndoshë; u kthefshi shëndoshë; të paça sa malet; rrofsh sa malet; u bëfsh i pari i fisit tënd; marrç shtatë gra të bukura që të të pjellin shtatëdhjetë e shtatë djem të shëndoshë, të gjithë luftëtarë të dëgjuar e me pagëtyrë të madhe; ju gjeça shëndoshë; rri me shëndet e qofsh me jetë; dalç faqebardhë; zana jeni e zana qofshi; ju qoftë udha e mbarë; ju shtoftë zoti vallen; të pastë lokja; u kthefsh shëndoshë e me nder; e bardhë qoftë; ju faltë zoti që ju ka falur; mirë mbeçi; u shtofshi e mbushçi dhenë; t'u shtofshin vjetët; mirë se të solli zoti; gur zënç, dyvjaçkë t'u bëftë; t'u zgjattë jeta; tumirë mbeç; u mplaksh e u trashëgofsh; njëherë e me jetë; bëfsh njëzet çuna, njëzet çupa; zoti e ndjeftë; të qofsha falur; burrë u bëfsh, trim u bëfsh; U shtofshin si zogjt e bletës; paçim derën të hapur; i sotmi na ndiftë: të rinjve dasmën, të martuarit i gëzoftë me djema; për të mirë qoftë; e mira mos t'u ndaftë nga dera; u mbushçin hambaret, u martofshin cucat, u rritshin djemtë; në dorë tënde qofshim; falë të qoftë; vafsh shëndoshë; mbeç shëndoshë; rrofshi dhe ju që dëgjuat; rrini me shëndet e kuvend të mbarë zotërinj; gazi t'u shtoftë etj.

Urimet në veprën e Kutelit dalin dy llojesh: të thjeshta dhe të zgjeruara. Të zgjeruara janë sidomos ato që kanë në strukturën e tyre sinonimi, krahasime ose shpjegime në lidhje me motivet e tyre, si për shembull:

Hej! Na u trashëgofshin e na u mplakshin e na u shtofshin si zgjoi i bletës! (Vepra2, f. 226); *Rrofsh, si shiniku në lëmë!* (Vepra 2, f. 200); *Zoti na dhëntë që t'i japim ... Zoti na faltë durimin për hatrin e foshnjave ... M'i ndriçin eshtrat e shpirtit në këtë e në atë jetë Malush agait, se ai i doli zot nderit të vendit edhe e mbrojti si burrë!* (Vepra 1, f. 213- 214) *U mplaktë e u tashëgoftë! Ku kalli këmbët i rënçin dhëmbët.* (Vepra 1, f 244); *Më rruash, o birthi im, që më dhe këtë lajm të gëzuar, se Konstandini im po vjen njëmend.* (Vepra 4, f. 44); *Të ardhhtë yt zot shëndoshë e me qemerin plot, i kuq si mollë Ohrie! ... Të lumtë goja, t'u bëftë e argjendtë. Nga goja jote në vesh të zotit! Gaz paç!* (Vepra 2, f. 240) etj.

Hasen edhe formulat dyshe të urimit në rastet, kur ato shkëmbehen midis dy personazheve:

Dhënësi: Rrini me shëndet, o pemëtarë! Tani e shoh se qenki njerëz të drejtë. Më falni.

Marrësi: I falur qofsh, o mbret, ne ngaherë kemi qënë të drejtë. (Vepra 4, f. 472);

Dhënësi: E gëzofsh!

Marrësi: Edhe ti e gëzofsh! (Vepra 4, f. 139)

Dhënësi: Mirëse ju gjej, o orët e malit! Ju shtoftë zoti vallen!

Marrësi: Mirë se vjen, o Gjeto Basho Muji! (Vepra 4, f.78)

Në përgjithësi, urimet e Kutelit, ashtu si në ligjërimin gojor, ngrihen mbi bazën e një pohimi, por ka raste, kur urimi bëhet përmes një mohimi, si për shembull: *Mos dhëntë i Sipërmi që të na shuhet kandili, që mezi na u ndez.* (Vepra 1, f. 189); *Mos rënç më sy!* (Vepra 3, f. 456); *Mos të lëntë zoti kurrë pa vëlla!* (Vepra 4, f. 85); *Mos e dhëntë zoti të hysh brënda, se në atë odë rri Januka e Bardhë.* (Vepra 4, f. 83) etj.

-Mallkimet

Disa nga tregimet e Kutelit e në përgjithësi gjithë proza e tij nuk do të kishin atë tharm që kanë, nëse do të mungonin mallkimet. Qenies njerëzore i ndodhin në jetë jo vetëm ngjarje pozitive, por edhe ngjarje negative, të cilat prishin ekuilibrat jetësorë dhe sjellin tek ai tronditje të mëdha shpirtërore e psikologjike që do të bëheshin vërtet të papërballueshme, nëse nuk do t'i vinin në ndihmë së pari, mallkimet. Ato janë në rolin e një ilaçi qetësues për fatalitetet e jetës, për zhgënjimet, tradhtitë, urrejtjet, dëshpërimet, fatkeqësitë, pre e të cilave bie njeriu; janë ilaçi qetësues për situatat e këqija, ku mungojnë zgjidhjet, ku mungojnë shpresat, ku në fund të tunelit nuk ndodhet asnjë dritë. Nuk mund të thuhet se do të ishte aq e mirëportretizuar Marua e Kovit të “Vjeshta e xheladin beut”, pa ato shpërthime mallkimesh kundër beut, përdhunuesit të saj të dikurshëm, që përgatitet të bëjë të njëjtin veprim me të bijën e saj, që është njëkohësisht e bija e tij dhe, për më tepër, nuk do të ishte aq mbresëlënëse dhe aq i paharrueshëm plagimi i saj. Ajo ka përjetuar dhe ndodhet përsëri në prag të ripërjetimit të anës më të shëmtuar të jetës, të tronditjes më të skajshme prindërore, prandaj është krejt i natyrshëm, krejt njerëzor e i logjikshëm reagimi i saj i lartë emocional. Bashkë me të mallkon edhe lexuesi, edhe gjithkushi:

S'më njeh ti mua? S'e njeh ti Maron e Kovit, që e ç'nderove në të ri, se kishe kamxhik në dorë, se ishe i fortë? Ja, ajo që është pranë është jot bijë! Ta dish se unë do të ta shtyp kokën si gjarprit, po të bësh me çupën, ç'bëre me mua! Y-y-y murtajë! Pusht Stambolli! Matuf!

E shtynte, e hiqte, e shtynte prapë, si leckë, dhe ai, Xheladin beu, zot kasabajë e zot çifligjesh, zgurdullonte sytë si të bufit e s'bëhej dot burrë t'i shkëputej nga dora, s'ishte i zoti t'i binte me çifte a të nxirrte koburen nga brezi.

Më ke marrë nderin, të marrtë zoti mendtë! Më ke lënë në turp të zi më të lëntë perëndia pa sy, të heqshin për peri! Më ke ngrënë jetën, të ngrëntë mortja!

E tundi sa e tundi, pastaj i dha një të shtyrë, sa beu i madh ment u shemb përdhe. Gruaja shkoi e mblodhi copat e stomnës së thyer e ia hodhi përpara ku mundi: këmbëve, gjunjëve, duarve, duke mallkuar pa pushim:

Ja theve, thefsh arrëzën e qafës! U kalbsh së gjalli, përmbys, siç u kalb yt atë, që e hëngër krimbat! Ngorç në ndonjë përrua si ndonjë qen i zgjebosur! Na shojte, t'u shojtë emri, të këndoftë kukuvajka në shtëpi! Ku

është parë e dëgjuar të çnderojë i jati të bijën? Të çaftë ulku zorrët! Të pjekshin në hell, të gjallë! Humbsh e mos u duksh, mos u dëgjofsh!

Të gjitha i dëgjonte beu e s'thosh dot një fjalë, të paktën "efnm" ose "hëm-hëm", siç e kish zakon. Sikur i qe kyçyr goja.

-Na plase, më të plastë dhjamët e syrit! Na kalle frikën, më të kallçin të gjallë në varr! Na dogje, të djegshin lugat! (Vepra 1, f. 96-97). Mallkimet në këtë fragment vijnë në një përshkallëzim ngjitës që kulmon me "të djegshin lugat" dhe, ajo që të çudit më tepër, është forca gati e jashtëzakonshme e mallkimit të nënës që ravijëzohet te ngrirja, te mumosja e beut. Marua është në pikën më të skajshme të dhembjes, prandaj mallkimet e saj shoqërohen edhe me sharje të ndryshme (kjo përbën një karakteristikë edhe për personazhe të tjerë të veprës së Kutelit). Në rastin konkret të tilla janë: *pushtanik, pusht Stambolli, murtajë, matuf.*

Vetë përmbajtja e fragmentit të shpie në përfundimin se shkaku kryesor i përdorimit të mallkimeve është ndërlikimi e keqësimi i raporteve individ – individ, individ - shoqëri (këto të dyja i gjejmë në rastin Maro – Xheladin bej) dhe individ – fuqi e mbinatyrshme, të cilën e gjejmë në raste të tjera në veprën autorit: *t'i qitshin sytë galat; të hëngshim hallvën; thefsh arrëzën e qafës; të marrtë zoti mendtë; të lëntë perëndia pa sy; të heqshin për peri; të hëngërt mortja; u kalbsh së gjalli; ngorç si qen i zgjebosur; t'u shojtë emri; të këndoftë kukuvajka në shtëpi; të çaftë ulku e të nxjerrtë zorrët; të pjekshin në hell të gjallë; humbsh e mos u duksh; mos u dëgjofsh; të plastë dhjamët e syrit; të kallshin të gjallë në varr; të djegshin lugat; të ikshin mendtë e kokës; mos arrifsh i gjallë në shtëpi; i mallkuar i qoftë emri; ta bëj harram bukën; ngordhç; të hëngërt ulku pa dhëmbë; turpi mos iu ndaftë nga pragu i derës; iu lidhtë goja e dora të ligut; plaçin ata që s'na duan; ua nxjerrtë korbi sytë; zoti të vraftë; qofsh e zezë; i pafsha tërë mbretërit ja në litar, ja në hell, ja brenda në varr; të daltë përpara ndonjë lukuni ujkonjash të tërbuara e ta bëfshin barkun koritë; të shkaftë këmba në greminë e të hëngshin sytë gallofët; rënç në grackën e gjahtarëve; të rrjepçin lëkurën; të mbiftë përsipër myshk e lëndinë; të rruat; ia lidhça buzët me pe të kuq; ja hëngshin turinjte grerakët e egër të dushkut; i rëntë pika në gjumë; fjetsh të madhin; na marrtë pleshtat e beharit; iu lidhtë goja të ligut; plaçin ata që s'na duan; turpi mos iu ndaftë nga pragu i derës; të marrtë zoti mendtë; të heqshin për peri; të hëngërt mortja; të lëntë perëndia pa sy; thefsh arrëzën e qafës; u kalbsh së gjalli përmbys, siç u kalb yt atë, që e hëngër krimbat; ngorç në ndonjë përrua si qen i zgjebosur; t'u shojtë emri; të çaftë ulku e të nxjerrtë zorrët; të pjekshin në hell të gjallë; humbsh e mos u duksh; mos u dëgjofsh; të plastë dhjamët e syrit; të foltë sorra mbi krye; ju mbylltë dera me tre kyçe e tre katarinë; ua marrtë zhaba qumështin e dhive mbeçi pa dhallë; jua bëj harram bukën; zjarr paçin në shpyrt dit' e natë; t'u thafshin krahët; më qafë më paçi etj.*

Ndodh, që në disa raste, mallkimet nuk kanë motivet e sipërpërmendura dhe as peshën dhe mllëfin e tyre karakteristik, sepse jo rrallë njeriu grindet me veten për ndonjë gabim a faj të bërë nga ai vetë dhe mallkon po veten, si për të bërë një lloj autokritike: *Uu, më verboftë i sotmi! Harruash kalën ne porta! O burra o çuna ta shkarkojmë!* (Vepra 1, f. 222) etj. Kështu ndodh edhe kur dikush “pseudomallkon” një njeri shumë të afërt. Për shembull:

Hajt, moj grua marroke, zoti të vraftë! Me kë do ta kesh ti djalin më mirë se me mua, nën krahun tim. (Vepra 4, f. 124); *Kralesha... ngrihet e tronditur e i vete kralit:*

- *Ngreu, bre kral, të vraftë zoti! ... se unë kam parë një ëndërr të keqe.*

- *Për të mirë qoftë! – i bret krali.* (Vepra 2, f. 115); etj. Fakti që krali i përgjigjet mallkimit me urim, sqaron kontekstin e veçantë në të cilin bëhet “mallkimi”. Në këtë grup mund të futen edhe mallkimet e tipit: *atje i qoftë, pastë hijen e tija* etj.

Te Kuteli gjejmë edhe struktura të tilla që nisin si urim dhe përfundojnë në mallkim. Ato bëhen më domethënëse dhe më shprehëse, kur janë të zgjeruara, kur kanë një variacion mallkimesh dhe figurash letrare të përdorura brenda tyre, si për shembull: *Dhëntë zoti, në ka një zot, as plumbi, as zjarri, as turpi mos iu ndaftë nga pragu i derës! E djegshin dhe shkretofshin si na dogji e na shkretoi. Dhe foshnjat e tij u ndafshin nëpër botë, të shkretë nëpër shkretëtirë, si u ndanë e si u lebetitën foshnjat. E gur mbi gur mos mbettë në shtëpitë e në kasollet e tij. Dhe jo vetëm në të tijat po edhe të atyre nga tanët që u lidhë me Latinin për të djegur Shqipërinë.* (Vepra 2, f. 114) etj.

Urimet dhe mallkimet që artikuloohen në momente të tensionimit të madh psikologjik, në momente përplasjesh të forta të personazheve, janë me interes për t’u shqyrtuar veçanërisht në drejtim të leksikut, i cili është pasqyrë e tyre. Në këto raste, vërehet se leksiku është më pranë të folurit të thjeshtë bisedor dhe është i mbushur me fjalë të burimit krahinor. Për shembull:

Na, lule, na! Na këtu të çaftë ariu i Kakaçit! ...Hej, ngordhç edhe të hëngërt ulku pa dhëmbë. Lanet! Ngordhçin gjithë qentë e botës! ... Lanet! Lanet! (Vepra 1, f. 291) *Edhe rajaja gjithë, me një zë: Zoti shtoftë zullumin!* (Vepra 1, f. 214); *Uf, unë e mjera! Gjallë qenka gojëlidhuri? Mos iu ndjeftë kurrë emri! I tretsha dhjamin në tigan, i hëngërsha mëlçinë e zezë me kripë!* (Vepra 4, f. 287) etj.

Prania e sinonimeve, antonimeve dhe e figurave letrare, si: metaforave, hiperbolave, krahasimeve, eufemizmave në strukturën e urimeve e mallkimeve etj., sjell vlera të spikatura në rrafshin stilistik. Për shembull:

O bjeshkë të larta, bjeshkë juve mos u thënçin! Dushk e bar ndër ju mos daltë kurrë! As ujë ndër ju mos u piftë kurrë! Po ju thënçin bjeshkë të thata! (Vepra 4, f. 129); *Gjiri im u nguroftë, kështjella qëndroftë, djali im trimëroftë, u bëftë mbret e mbretëroftë!* (Vepra 4, f. 14); *Uf, të qeshi buza, më të qeshtë në prush!* (Vepra 4, f. 282) etj.

-Përbetimet

Leksiku popullor në veprën e Kutelit pasurohet edhe me përbetimet, me anë të të cilave folësi kërkon të tregojë seriozitetin e asaj që thotë, duke u betuar për të para dëgjuesit, duke i shprehur atij vlerësim, dhembshuri, sinqeritet dhe besnikëri të shkallës më të lartë. Për këtë arsye, nga ana leksikore, përbetimet kanë në përbërje të tyre leksema me peshë të madhe kuptimore, të tilla që shënojnë elemente të qenësishme të jetës dhe ekzistencës së saj materiale dhe shpirtërore, leksema që shprehin lidhje gjaku, apo emra figurash e vendesh të shenjta, si: *për këtë bukë, për këtë kripë, për këtë dhe, për këtë gur, të jap besën, për kokën tënde, pasha të madhin që rri mbi hënë, pasha bukën që po hani, për at' qime* etj. Për shembull:

E të shikoje atëhere më dyzet ditë, më gjashtë muaj, motë-mot e më tej si zbrisnin nga gradishta, burra e gra bashkë, me uratën në krye, të gjithë si det me valë, për shpirt të dajo Palit (Vepra 2, f. 282); Në doni betim betim u bëj, se për njetë kazan me ulluke, për njetë shlivën e Shëndaumit, e për njato dyzet voze plot, si dyzet shenjtorë, e drejta është e jona e s'ka fshat në botë që e pi rakinë si e pimë ne! (Vepra 2, f. 281); Po të mos dojë të vijë, bëj be për atë dhe, për atë gur e për atë bukë se ndonjë ditë do të më mbushet mendja, do të marr dyfekun e do të zhavuloj në vllahi a vullakë ku të jetë, do ta ze për veshi e do ta sjell në mulli. (Vepra 1, f. 164): Nusja bën be të madhe e thotë: Në daç vramë, në daç premë, o im shoq, po unë do të të them të vërtetën! (Vepra 4, f. 148); Po unë të jap besën se sot një javë do të më kesh këtu dasmor të parë. (Vepra 4, f. 147); E jo më kot! Se, ja! Për atë vakëf! Sapo zunë vend myhyret në pëllhurë, pushoi edhe era, sikur iu paskej bërë magji, jo tjetër gjë. (Vepra 2, f. 25); Ju betohem me be të madhe se unë nuk do t'i bija prapa, po të mos më vinte keq t'ja nxija faqen Jutbinës e Krahinës. (Vepra 4, f. 99) etj Po të mos dua, mos më dashtë i sotmi... (Vepra 3, f. 429); Prandaj po ju betoj me be të madhe, moj zana mali: pasha bukën që hani, pasha majat ku veproni e mrizet ku mrizoni, pasha gurrat ku flladiti e dritën e hënës ku valloni! Pse s'më thoni dhe mua ku e keni fuqinë? Se tani ju më keni motër. Unë do të rri këtu përgjithmonë (Vepra 4, f. 67) etj.

Në disa raste, përbetimet shprehin edhe hierarki shoqërore e pushtetare dhe, kur përbetimi i adresohet një personi që mban pozicionin më të lartë, mund të marrë edhe nota servilizmi e nënështrimi, por edhe nota ironie, si për shembull: *Veç kësaj, burri kish një zë të butë, si të lyer me vaj e mjaltë e betohej orë e çast: "Për kokën e mbretit", "Për kokën e lartmadhërisë"*.

Përbetimet që krijohen duke përdorur foljen në vetën e parë (më rrallë në vetën e dytë) të mënyrës dëshirore, janë edhe më interesantët. Në këtë rast, ata kanë tipologjinë sintaksore të mallkimit, si më poshtë:

Hyfsha gjallë në dhe në më shkon mendja të martohem! (Vepra 4, f. 37); Një e dy dhe betohej: Sa një shtëpi, ore, ja për këtë bukë e më thertë! (Vepra 2, f. 195); Halili qesh e bën be të madhe: Mos qofsha kurrë për shesh luftë! Që sot do t' lë dhitë bështinë. (Vepra 4, f. 84); ... vdeksha para n'u

martofsha! (Vepra 4, f. 88); *Ja hape derën, ja ta mora dritën e syve.* (Vepra 4, f. 83) etj.

-Tipike popullore krahinore, si nga ana leksikore dhe strukturore, paraqiten edhe **lutjet e të falurat**, te të cilat bie në sy sidomos prania e shprehjeve frazeologjike. Për shembull:

Ju falem, o burra të mirë, që rrini e këndonit këtë kartë. Ju falem e ju marr dorën t'ju pyes një fjalë e dua të më ktheni një përgjigje. (Vepra 1, f. 175); *Mos më lër, Argjir, vetë! Kam frikë, Argjir, kam frikë!* (Vepra 1, f. 119); *Pash një zot Muj, që të ka falur! Vërtet s'i njeh, apo s'do që t'i njohësh?* (Vepra 4, f. 123); *Mos më merrni më qafë tani, kur më afrohet dita e lirit...* (Vepra 3, f. 246).

-Aman e më qafsh! – më thesh mua, aman e më qafsh –Selimit, aman e më qafsh! Të gjithëve (Vepra 2, f. 24); *Të puth këmbë e dorë, bej. Ver dorë në zemër, bej. Mos më vraj: Kam fëmijë* (Vepra 1, f. 303); *Në shpëtofsa kësaj here do të bëj kurban një dem të majmë, do të ndez dyzet kandilë, dy kacekë vaj, tre, katër... vetëm të shpëtoj.* (Vepra 4, f. 418-419) etj.

Një tip më vete lutjesh janë ato që në themel të tyre kanë një urim. Për shembull:

Nëm tapinë e shtëpisë, bej, të rrofshin djemtë. (Vepra 1, f. 303); *- Bëj ç'të duash, Halil, - i luten zotërit e Jutbinës, - po shkarkona këta gurë se s'po i mbajmë dot. Në dorë tënde qofshim!* (Vepra 4, f. 84-85) etj.

2.3.5. Leksiku i botës fetare

Përbërës i leksikut etnografik është edhe **leksiku i botës fetare**: emrat e festave zyrtare fetare, emrat e shenjtorëve, emrat që shprehin hierarki fetare, si dhe emrat e vendeve të shenjta. Kjo shtresë fjalësh është mjaft e pranishme te Kuteli, sepse së pari, vetë autori është besimtar i thellë, një i krishterë i devotshëm dhe njëkohësisht njohës dhe respektues i besimeve apo sekteve të tjera fetare që praktikohen në krahinën e tij dhe më gjerë dhe së dyti, sepse fetë dhe filozofitë e tyre përkatëse zenë një vend të rëndësishëm në jetën e çdo komuniteti njerëzor, prandaj, për rrjedhojë, leksiku që ka lidhje me to nuk mund të mungojë në një vepër letrare që synon të pasqyrojë me shumanshmëri jetën e tij. Leksiku i kësaj fushe është pasqyrë e një tipari karakteristik të shqiptarëve, i ekzistencës së disa feve dhe i bashkëjetesës së tyre paqësore në një mjedis të përbashkët. Të tilla janë: *pashkë, kërshëndella, ristozi, shëngjergj, shëndaum, pandelimon, shën Llazri, llazore, ëngjëll, xhind, parajsë, xhenet, xhehne, ferr, të lusuara, tropare, tellua, metani, Avesallomi* (i biri i Davidit, mbretit të Izraelit të vjetër), *papu Tira, shënepremte, përshpirtje, të ndara, selamllëk, Krisht, Muhamet, shën Koll, shën Spiridhon, shëndëlli, këmbanë, shën Prokop, Mulla Kamberi, mulla Açe, nomatis, katallan, prift, hoxhë, qoftëlarg, lugat, dervish, papa Kostandin, perëndi, dhespot, zonja Shërmëri,*

zot, gjynah, mëkat, shëndiel, shën Konstandin, Dekunë, përdëllesë, vakëf, Gropë e qoftëlargut etj. Meqenëse vepra e Kutelit ka shtrirje të gjerë kohore, në të nuk mungojnë as emra perëndish pagane të tilla, si: *Prema, Enjti, Medauri, Thana, Zeusi, Dodona, zoti Bubullimës, Perëndi e Dushkut* etj. Për shembull:

Ata të tjerët kaluan me hap të shpejtë hapësirën midis portës dhe shtatores shumë të mbushur të perëndeshës Premë, begatores. (Vepra 3, f.159); **Kryefaltari** hungërroi si derrkuc kur i ve thikën në fyt. (Vepra 3, f. 159); *Atje, sipas zakonit të vjetër, gratë e fshatit i vajtuan e i shpëlanë me verë Ohrie e pastaj i varrosën në kishën e zonjës Shërmëri.* (Vepra 2, f. 43); *Mitushi gjithë raki do ziej. E jo raki për ty e për mua, se ne s'na peshon njeri, po raki për Shenjtorë. Raki rrushi për Shënkollë, raki mani për Shën Spiridhonë, shlivë për Shëndaumë. ...Shliva vec, uji veç,- ti zgjidh ç'të duash. Nuk përzihet njëra me tjetrën, si nuk përzihet xheneti me xhehnemin, as dita me natën, as dita me natën e as dita me natën e as tregtari me njerinë.* (Vepra 2, f. 270); *Po fjala është se nuk mbetej njeri për turp, pa shkrehur, përpara Shëngjergjit dhe përpara njerëzisë.* (Vepra 2, f. 88); *Si zien e zien afër kërrshëndellave u hodhën në anën time e të Selvisë.* (Vepra 1, f. 118); *Gështenjat ishin ngarkuar me lule si kisha me llambadhet e pashkës. ... Selvia e vogël mblidhte lule për llazore.* (Vepra 1, f. 114-115); *... Lisi i madh i Gurit të Bufit nis e tundet... hija i zbret gur më gur, gjer poshtë, në Pandelimon.* (Vepra 3, f. 45); *Shumë nga ata që rrinin në qarrin e perëndisë së Dushkut bënë buzën në gaz.* (Vepra 3, f. 339); *... kështu më ka porositur nëna plakë, që zoti e ndjeftë.* (Vepra 4, f. 301); *Aso kohe, ndiezot babai ishte gjallë* (Vepra 2, f. 144); *... shkon të falë xhumanë.* (Vepra 1, f. 131); *Vetë e lava, vetë e qava e të shtatëzën ia ndava.* (Vepra 4, f.51); *S'di besa se qysh m'u pat zgjidhur asohere nga zoti të them bismilahinë.* (Vepra 2, f. 303) etj.

Në veprën e Kutelit përbën një dukuri interesante përdorimi në nivel fetar i disa emrave njerëzish apo ditësh, të cilët nuk përfshihen në fjalorët fetarë. Titulli “shën”, për shembull, përdoret lirisht edhe për njerëz të zakonshëm, të cilët nuk janë shenjtorë, por kanë cilësitë e tyre, ose dhe në përdorime të tjera të ngjyrosura me nuanca ironizuese, për shembull:

Kështu e kemi ne andej; ditën e shën Hamitit nuk punojmë ...Policia uroi: “Për shumë vjet ditën e shën Hamitit”, ktheu kupën, fshiu mustaqet dhe e zgjati t'ja mbushnin së dyti. (Vepra 3, f. 389-390); *Edhe në sytë e tyre kjo Plaka e Bubullimës dukej si Shën e Diela e përrallave që vjen e ndihmon të urtit e të vojturit.* (Vepra1, f. 226) etj.

Duke analizuar leksikun dialektor në prozën e M. Kutelit, mund të thuhet se ai e përdor lirisht atë, “jo vetëm me funksione stilistike, por edhe (madje më shumë) me funksione të pastra shënuese, pra si leksik asnjans”⁴⁷. Të tilla janë të gjitha fjalët që emërtojnë elemente të florës, faunës, apo orendi të ndryshme, të cilat nuk kanë gjegjëset e tyre në gjuhën letrare, por sidoqoftë,

47. J. Thomai, *Leksiku krahinor e dialektor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 141.

edhe ato mbeten asnjëherë vetëm nëpër mikrokontekste, ndërsa nëpër makrokontekste përfitojnë përveç vlerave shënuese edhe vlera stilistike, “*pasi duke shënuar realie krahinore ose relie më të përgjithshme me emërtime krahinore, shërbejnë për të bërë edhe lokalizimin vendor të ngjarjeve*”.⁴⁸

Përpyekja e Kutelit për të përthithur leksikun dialektor nuk bëhet në mënyrë sipërfaqësore, përkundrazi, siç dhe u shprehëm më lart, ajo është një përpjekje e vetëdijshme dhe e qëllimshme, gjithmonë në përputhje me synimet e tij të larta ideoestetike. Mënyra se si ai përzgjedh, mënyra se si ai i bën vend leksikut popullor në prozën e tij, vulosin në fund të fundit stilin e tij krejtësisht të dallueshëm nga autorët e tjerë madhorë shqiptarë. Pikërisht, kjo është arsyeja, se përse ai nuk bie në nivelin e një shkrimtari thjesht dialektor. Gjithashtu puna në poçarinë e fjalës artistike, lëmimi me mjështëri veçanërisht i leksikut popullor, e veçon atë si një nga shkrimtarët kryesorë ndihmues në krijimin e gjuhës letrare. Leksiku i shqipes të Kuteli paraqet anën e tij më të mirë, prandaj pohimi se “*gjuha e veprës letrare përbën stilin a variantin më të gjerë e më të larmishëm të shqipes së sotme letrare*”⁴⁹ i shkon më së miri për shtati veprës së tij.

Kuteli vërteton atë që thuhet se teksti është gjithmonë prodhim, por një tekst nuk mund të shihet si prodhim i një individi të vetëm, ai është më tepër shprehje e një realiteti kulturor që shkon përtej autorit të veçantë që e ka realizuar atë materialisht. Në çfarëdo teksti, qoftë dhe më i thjeshti, “*bashkohen si idetë, konceptet dhe mënyrat e të ndjerit të individëve të veçantë, ashtu edhe treguesit pak a shumë të dukshëm të një mjedisi shoqëror dhe kulturor përkatës*”.⁵⁰ Pas ligjërimit kutelian është prirja komunikuese e një komuniteti të tërë, vetëm se ai e sjell atë duke e kaluar nëpër filtrat e vetëdijes së tij gjuhësore prej shkrimtari. Nëse në një numër të konsiderueshëm të disa prej realieve të emëtuara prej tij me leksik dialektor, i gjejmë në përdorim edhe sot në trevën juglindore, ndihmon në argumentimin e asaj çka u tha më lart, se këto njësi dialektore kanë lidhje direkte me jetën kulturore, shpirtërore e materiale të krahinës, ku janë vendosur ngjarjet e tregimeve dhe novelave të tij. Disa prej tyre janë: *pepellashkë* (copë leckë për të fshirë furrën e bukës), *lyrek* (fëmijë i vogël i mbështjellë me pelena), *mëregë* (Trirë që mbledh sendet që mund të pengojnë punën e mullirit), *symbyllkë*, *këmbëçalkë*, *lagathata* (lojëra), *prokavë* (një lloj velenxhe leshi), *skistër* (vegël), *vërshë* (kosh për të kapur peshk), *shekle* (një lloj ene e drunjtë e drunjtë), *taler* (tas), *dizgë* (një lloj rripi prej leshi që shërben për të lidhur fëmijën në djep), *grendë* (copë shkëmbi e madhe), *pizgë* (një lloj vegle muzikore e krijuar me lëkurë shelgu), *koçkorr* (gjemp madh) *notishtë* (vend që mban lagështirë), *zollnicë* (hardhi), *nardën*, *fti,ri* (mjet i drunjtë, ku tundet qumështi), *haznë* (thesar), *krazë* (një

48. Po aty.

49. A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë*, në rev. Gjuha jonë, nr.1, 1985, f. 43.

50. Gj. Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë 2008, f. 82.

lak për të zënë zogj), *ullastre* (ngyrë ulliri), *lolo*, *mangjoskë* (femër që bën magji), *mazgallë* (vrinë ose e çarë në mur, në dërrasat e derës a të tavanit) etj.

2.3.6. Shtresa e fjalëve nga krijimtaria gojore popullore

-Në veprën e Kutelit, si pjesë e pandashme e leksikut popullor, është dhe **shtresa e fjalëve nga krijimtaria gojore popullore**, jo vetëm e zonës ku vendosen ngjarjet, por edhe shtresa e fjalëve e të ashtuquajturit folklor shtegtar, i cili zhvillohet për shkak të afrisë dhe kontakteve territoriale. Këto shtresa janë të shpërndara në të gjithë veprën e tij, por natyrshëm e shpeshojnë praninë e tyre të “Tregime të moçme shqiptare”, të cilat ai arrin ta kthejë përrallën popullore në përrallë letrare. Përralla në penën e tij fitoi cilësi të reja ideoartistike. Ai e konceptoi atë “si një lloj të veçantë të prozës, prandaj lëndën e kaloi nëpër filtrin e shkrimtarit, duke mbryjtur brumin e përrallës popullore, i mbështetur në motivet dhe subjektet, në personazhet dhe situatat tipike, në mjetet dhe poetikën e rrëfimit oral, ai mundi të rijapë përrallën si përrallë letrare.”⁵¹ Një ndihmesë në këtë arritje jep edhe rigjallërimi e përdorimi i emrave që kanë lidhje me mitologjinë e besimin popullor, emra të qenieve të mbinatyrshme, si: *bajloz*, *e bukura detit*, *e bukura e dheut*, *div*, *kanxhallos*, *kshetëz*, *kuçedër*, *kukuth*, *largneshi*, *largqofti*, *lugat*, *orë*, *qeros*, *shkirë*, *shtajzovalle*, *shtrigë*, *skorovod*, *sprijë*, *xhind*, *xhixhimësa*, *zanë* etj.; emra personazhezh të njohur të legjendave e përrallave, si: *Januka e Bardhë*, *Hysen Kraposhniku*, *Kuma Maro*, *Mbreti i Bardhë*, *Paji Harambash*, *Hysen Radoica*, *Omeri i Ri*, *Sokol Halili*, *Trëndelino*, *Mbreti i Verdhë Xinxifillo*, *Xëme e Alarupit*, *E Bukura e Dheut* etj. Për shembull:

Shok-o, nuk di në fshatrat e tjera, po fshati ynë është rëngë me lugetër. (Vepra 2, f. 295); *Tërë graria, bashkë me tri “sprijat” fshinë sytë me pëllëmbë.* (Vepra 3, f. 463); ... na paske pëlqyer një **shkirë** të bukur... është rëngë me **lugetër**. (Vepra 2, f. 295); ... i njuh pas shenjës **kreshnikët** e tij. (Vepra 4, f. 63) etj.

Pena e shkrimtarit krijon imazhe të pasura e të detajuara duke futur në ligjërim, krahas fjalëve që shënojnë elemente të besimit popullor e mitologjik, edhe një varg të gjatë emrash të mjediseve, të bimëve, të zogjve, të kafshëve që gjenden në arealin gjeografik, ku ndodhin ngjarjet. Për shembull:

Lisi është varur në një rrokullimë të keqe, ku mezi hiqet zvarrë gjarpri. Njeriu nuk ngjitet dot aty, po frika e bën të ngjitet... Pra, burri i qepet me këmbë e duar **gurishtës**, arrin me shpirt në dhëmbë gjer rrëzë **lisit**... Ku të fshihem? Të futem në **zgërbonjë** nuk shoh gjë, s’kam si ta përdor sëpatën: çatis **ujku** më çan, vjen i ligu më vret... Më mirë do të ngjitem lart e do të tulitem nëpër **degë e fletë**. Të thënë, të bërë: i qepet **lisit** lart e më lart, **degë** më **degë**, gjersa gjen një **thellëtirë** të mirë plot **bigla** të shëndosha. Aty mund të rrijë

51. Nasho Jorgaqi, *Seria e tregimeve të zgjedhura*, Vepra 1, Tiranë 1989, f. 37.

shesh, si në rrogoz; natën lidhet me brez e bën gjumë. **Fletët** janë të kuqe flakë, se **dielli** i bie drejt në sy. **Buçima** poshtë rritet e rritet, sa gjëmon tërë **klisyra** tutje. (Vepra 4, f. 406); **Hop! Kërcen nga gremina hëna e ngrënë, e çarfalitur nëpër driza. Po dhe ashtu siç është, ajo ndrin mjaft sa për të rrëfyer shtegun. Kaq priste ajo: dritëzën e hënës, ia merr. Një kaproll i prin përpara, një kaprolle i vjen prapa. Hëna i qesh lart në qiell, i jep zemër vragës.** (Vepra 4, f. 453); **Ikin ujqit me bishtin ndër shalë, harbojnë dhelprat, fugojnë shqarthët, thinjtë, rrëqebujt, kunëzat, kunadhet...** ikin të gjithë si mundin e ku mundin, që të tuliten nëpër **strofuj e shpella**, thellë e më thellë. **Po ç'është ky shkrep murrak që po rrokulliset kullutrumba njasaj gurishte? Qenka i veshur i tëri me myshk dhe po u vë fshesën grendave, i rrokullis tatëpjetë, me gjëmë. Jo, s'është shkrep, po, ariu vetë! Ja, tek brof më këmbë, pushton një lis plak, e shkul nga rrënja dhe e shtyn në greminë. Ja edhe një, edhe një. Buçima zien grykë më grykë.... Trëndelinua trembet... Ti qenke, Kuma Maro? Sa u tremba... Pandeha se mos kushedi se kush ishte: Ndonjë kanxhallos i dalë nga varri, ndonjë xhind i dalë nga shpella apo vetë qoftëlargu.** (Vepra 4, f. 275) etj.

-Dihet se **eufemizmat** janë përgjithësisht krijime popullore, me burim krahinor dhe konsiderohen si pjesë e etnografisë së të folurit. Sipas besimit popullor, të keqes nuk duhet t'ia zesh emrin në gojë, sepse kjo sjell fatkeqësi, prandaj leksema që shënon diçka të keqe zëvendësohet me një fjalë a një shprehje tjetër më të zbutur, që e shënon indirekt atë, dhe që quhet eufemike. Kuteli përdor në vepër eufemizma që janë karakteristike për të folurin popullor të trevës juglindore, si: *gojëlidhuri, xhuxhullima* etj. Për shembull:

- *Nëno, ç'i ke thënë Kuma Maros?*

-*Uf, unë e mjera! Gjallë qenka gojëlidhuri? Mos iu ndjeftë kurrë emri!* (Vepra 4, f. 287); *Ua preu udhën dyfeku i Themistokliut me shokë: dora e zezë.* (Vepra 1, f. 128); *Merri, krushkë, po hap sytë se, në s'ma solle çupën, do të të hajë xhixhima.* (Vepra 4, f. 301); *Ti, moj murgë, do të kishe fjetur të madhin, po erdhën këta trima e të zgjuan.* (Vepra 4, f. 494); *Namëta, si rrufeja që shkrep në të kthjellët, nis vrungullon tërë lugaja: aaau! Gaaau! - sikur të ardhkej sosja e madhe.* (Vepra 4, f. 285); *Kë të gjej e ha e zeza!* (Vepra 2, f. 246); *Rroi ca vjet pa sy... pastaj shkoj me të shumtët.* (Vepra 2, f. 182); *Hap sytë e mos ma gërryey kopshtin, se të ha xhuxhullima.* (Vepra 1, f. 350); *Motn' e parë, kur e ndjeu zoti, u fanitej të gjithëve në ëndërr.* (Vepra 2, f.281); *... ndërroi jetë kur ishte nja njëqind e tetë vjeç.* (Vepra 2, f. 128); *... zanat flenë gjumin e dheut.* (Vepra 4, f. 68); *... kavajasi u gjet duke rënkuar e duke gulçuar, sikur ta kish zënë ajo punë.* (Vepra 2, f. 296); *Ti je "ashtu"?* (shtatzënë) – *e pyeti Xheladin beu sa për të thënë një fjalë.* (Vepra 1, f. 72); *Mua të ma falni o djem, se unë kaq e pata. Helbete, kam punuar edhe mirë edhe keq. Ma bëni hallall, se m'u mbarua vaji i kandiles.* (Vepra 2, f. 66); *... ua preu udhën dyfeku i Themistokliut me shokë: Dora e zezë!* (Vepra 1, f.

128); ...e pleqëruan dhe e nderuan gjer në **çastin e heqësit**. (Vepra 4, f. 501) etj.

- Në ndonjë tregim të Kutelit, si te “Si u takua Ndoni me zallorët”, te “Natë marsi” e në të tjerë, ndeshim më shumë se një të folme. Kjo, së pari, e bën më interesant relievin gjuhësor, së dyti, flet për njohjen që ka autori edhe për të folmet e tjera dhe, së treti, për aftësinë që ka ai për ta bërë gjuhën e personazheve të vet sa më të gjallë, sa më të larmishme e sa më të individualizuar prej njëri-tjetrit, sipas përkatësisë gjeografike. Për shembull:

Kto qi folët deri tash gjyqi ja u njeft si fillim provet, - flet ai gega i gjatë. (Vepra 2, f. 280); - *Ho, mre, ho! – bëri Selimi si ata të Vërçës.* (Vepra 2, f. 29); *Pa dëgjo, more kral kapedani! Njeriu s’është kurrë ngushtë gjer çastin kur i del ahti.* (Vepra 4, f. 100); *Na furoi sokol Halili!* (Vepra 4, f. 99); ... *Halili... s’është cub fëlliqësisish ... në dashtë na koritë fisin, më mirë i rëntë që tani rrufeja kresë... kam ndenjtur kuk si natën e varrit.* (Vepra 4, f.88-89) etj. Ndërsa, e folura e Plakës së Bubullimës te proza “Natë marsi”, dallon qartë nga e folura e liqerasve, te të cilët ajo ka bujtur për arsyet e veta. Në këtë tregim bashkëjetojnë gjuha e autorit (rrëfimtari) që mbështetet te gjuha popullore, gjuha e vendasve (Zona e Pogradecit, fshati Peshkëpi) dhe gjuha e të ardhurës (Zona e Rrajcës, Librazhdit):

Autori: *Një natë ranë ca miq në shtëpi të Kote Komit edhe fjalë pas fjale folën kush për thuthuqin e kush për kuqalë.*

Një burrë vendas: *Mbaroi bota. Erdhi koha të themi: hapi varre, ngrihi të vdekur të hymë të gjallët!*

E ardhura, Plaka e Bubullimës: *Ho, mre turk! Dua tri ditë ta rraf mendjen si e qysh... Hap, mre, rrugë se përndryshe – për atë qime!- të boj shesh e londinë.* (Vepra 1, f. 227) etj.

Në veprën e Kutelit është interesant fakti që personazhet përdorin me natyrshmëri njësi leksikore të dialektit tjetër. Kjo ndodh në tregime të cilat vendosen në kohë shumë të largëta, (gjë që flet për tezën e pranuar tashmë nga gjuhëtarët shqiptarë, se dikur dialektet kanë pasur më shumë afri me njëri-tjetrin), ose ku ka popullsi të përzierë, si për shembull te “Natë prilli”:

-*As, ngreu, mori grua, të lozim valle, se dasmë pa valle s’ka si bëhet! - Jo, mori burrë, tha ajo, me zë si të maces, jam le-ho-në, e s’mund të bëhet.* (Vepra 2, f. 21); *Pastaj Dani hodhi në rromuz: ... Radhën e ujit kërkon ta ndajë sipas numrit të dynymëve: asnjë dakikë më shumë, asnjë më pak.* (Vepra 1, f. 254); *Amua qeshi: ...Mos u tremb, bacë Dardo.* (Vepra 3, f. 296) etj. Po kështu te tregimi “Nga Dyrakiona në Bardhonë” kemi: *Është i hidhur, po mos u tut.* (Vepra 3, f. 301) etj

Ndodh, që te i njëjti tregim kombinohen natyrshëm forma të ndryshme dialektore e krahinore dhe madje bashkë me to edhe variante letrare, sepse siç kemi thënë në mënyrë metaforike, Kutelit do t’i rrinte ngushtë kostumi prej shkrimtari lokal, gjë që shënon një vlerë më tepër në fizionominë e tij prej shkrimtari gjithëkombëtar e gjithëshqiptar. Për shembull, te “Xinxifillua” ai

përdor aty për aty një herë variantin dialektor jugor “çupë”, një herë variantin dialektor verior (ndoshta me një ndërthurje të të folmes të labërishtes) “vasho” dhe një herë tjetër variantin letrar “vajzë”, për shembull: *hajde, vjen koha dhe Trëndelinua na lind një vajzë të bukur: yll me dritë! “Të rruat! - i thonë. Trëndelinua lindi një vasho yll me dritë... po ajo bëhet helm e vrer. “E mjera unë! Do të ma marrë çupën ai gojëmbylluri që më dha dorën të ngrihem. (Vepra 4, f.283); te “Vjeshta e Xheladin beut”: Çupa nuk lotoi, veçse kur u ngrit që poshtë me linjën të çjerrë, me vajzërinë të humbur. (Vepra 1, f. 99); Po kështu, aty për aty, përdor ndajfoljet “hëpërhë” dhe “tani për tani”: **Hëpërhë** s’dua gjë o zoti mbret ... **Tani për tani** dua ndonjë shekle mjaltë. (Vepra 4, f. 300) etj. Pra, te Kuteli merr vlerë ajo që shkruan Gjovalin Shkurtaç, se gjithçka që ka krijuar populli ynë, qysh në kohët më të lashta të historisë së tij, është bërë pasuri e përbashkët e shkrimtarëve shqiptarë “*duke shembur çdo dasi hapësinore e kohore, si dhe duke kapërcyer plotësisht ndonjë paragjykim krahinorist.*”⁵²*

Prania e dialekteve të tjera në veprën e Kutelit ndodh për disa arsye: të afërsisë e fqinjësisë krahinore, të lëvizjeve, si të shkuarit komit, të shkuarit ushtar në treva të tjera etj. Një nga arsyet pse në ligjërimin e personazheve ndeshim krahinorizma e dialektalizma të një treve tjetër është dhe emigrimi i brendshëm, gjë që e pohon vetë autori për njërin prej tyre, për Asllanin e tregimit “Natë marsi”: *Asllani s’qeshi nga pikëllimi për miellin që i kishte mbajtur Ilua.... Ai, kish kohë që ishte i ngrysur si Guri i Kamjes kur e rrethojnë retë. Kështu rrinte pothuaj gjithnjë nga dita kur ish kthyer nga kryeqyteti, ku kish nisur të përziante toskërishten me gegërishten, siç bëjnë ca kohë ata që shkojnë andej ushtarë. (Vepra 1, f. 295)*

Dialektalizma të të folmeve të tjera gjenden jo vetëm në gojën e personazheve, por edhe në gojën e autorit, gjithmonë për t’u harmonizuar gjuhësisht me ta. Për shembull:

*Hej, sa të pabëme u bënë që nga moti i zi kur Turku u derdh me shpatë e zjarr mbi vendin e lulëzuar të arbërit. (Vepra 4, f. 196); Një çun ishte në shtëpi, një çun i vogël e dy **cuca**. (Vepra 4, f. 222); Atëhere sokol Halili **bret fort**: ki mendjen, Muj... **Plaku i motuar** e di shqipen, siç e dinë dhe shumë pleq të tjerë. (Vepra 4, f. 102); ...krali qesh me të **ngjokur**. (Vepra 4, f. 100); Tërë **ashtën** e bjeshkëve e ka mbuluar terri i natës. (Vepra 4, f. 74); **Vasha** hedh bulirën krahut, i thotë **tu mirë mbeç** Mujit, hyn thellë në ahishtë. (Vepra 4, f. 66) etj.*

Gjuha e veprës së Kutelit është është në favor të prirjes drejt standartizimit gjuhësor, mëqenëse gjuha letrare shqipe ka për bazë dialektin e vendlindjes së tij, pra dialektin tosk. Gjuha e tij si autor dhe gjuha e personazheve të veprës së tij është e pajisur natyrshëm me leksik dialektor, por ajo që është më e rëndësishme është se autori asnjëherë nuk abuzon me të, e përdor me masë dhe me vend. Përpjekjet e tij për t’i afruar të folmet me

52. Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2009, f. 4.

gjuhën standarte të kohës, ndërhyrjet në origjinal nuk arrijnë të bien në sy për shkak të dorës së tij mjeshtërore. Gjithshka në prozën e tij, që nga leksiku, gramatika, sintaksa etj., përdoret në një mënyrë të lirshme, elegante, duke shënuar sjellje vetjake ndaj gjuhës. Ai qëndron si dirigjues midis gjuhës dialektore e gjuhës standarte, duke i vënë ato në ndërveprim e harmoni të paparë. Prirja drejt standartizimit duket, jo vetëm në fjalët e autorit, por edhe në fjalët e personazheve. Mund të thuhet me zë të plotë se orkestrimi i elementeve gjuhësore në veprën e Kutelit është i përsosur.

Siç u shprehëm më lart, dallimi ndërmjet gjuhës së autorit dhe gjuhës së personazheve është i tillë që nuk tërheq vëmendjen, për shkak se një pjesë e mirë e leksikut dialektor hyn në ligjërim me funksione shënuese e jo stilistike. Pra, përdorimi i elementeve leksikorë krahinorë në gjuhën e autorit, nuk bëhet aq me vetëdijen e afrimit të gjuhës së tij “*me atë të personazheve, si te vepra e Jakov Xoxes, po më shumë vjen vetvetiu nga tipat e krahinorizmave të përdorur. Kjo sepse tipari kryesor i krahinorizmave leksikorë te vepra e Kutelit është më shumë përdorimi tyre për lokalizimin vendor e kohor se sa për karakterizimin e gjuhës së personazheve.*”⁵³ Qartësisht vihet re përdorimi i të njëjtave fjalë me burim krahinor, si në ligjërimin e autorit, ashtu edhe në ligjërimin e personazheve. Për shembull:

Tete Ngjelua e mori vesh se këtë ojnë ia kish kurdisur Fija ... Po ç'panë kur sosën aty? (Vepra 4, f. 432- 433); Namëta tete Ngjelua e harroi nusen e madhe e nisi të sërënditte disa nga andrallat e shumta që kish hequr... se si qe ngarkuar me sheputka e misërishte për lopë, se si e kish marrë lyrekun e qe kthyer në shtëpi. (Vepra 4, f. 418); Ndërkohë Bardhona kish kohë që zbardhonte në qenarin e mureve dhe të pirqjeve të lartë. (Vepra 4, f. 319); Ngriti çeturin me qumësht që gumëzhinte. (Vepra 4, f. 311); Askush nuk zgjati dorën të ngjëronte. (Vepra 4, f. 295); Skllavi u ngrit, iu afrua gomarit, zgjidhitrastën e nxori pesë zile tringo të reja. (Vepra 4, f. 287); Ndërkaq Agroni nxori nga quari demin balisk, që do t'ja flijonte Genthit. (Vepra 4, f. 182); ... u dëgjuan ca çape të rënda në rrasat e oborrit. (Vepra 4, f. 93); ... dhëmbët kataroshë... iu zverdhën e shtrembëruan... Vajzat panë një zhelan kokëmadh, gushell, me një çomage në dorë, veshur me rrecka të kërpta, sin ë të verdhë e të përhimë, me një palë zhapërdhina, që s'ishin as opinga, as sandale... leshrat i kish bubuzhele. (Vepra 4, f. 83); ... Vëzhgonte nga limeri i saj, mbi një rrokullimë (Vepra 4, f. 81); Nganjëherë vinte në xhep të fermelesë ndonjë varg rruazash. (Vepra 1, f. 332); ... tani dukeshin pllackat si ca brinjë gomari... Ngrihet Ilua, mbush çepurkat, i hedh në hambar. (Vepra 1, f. 293); ... I kujtonte zhurin e nënës e të babes. (Vepra 1, f. 224); ... i ziente zemërimi në zemër, sindozot zien jashtë fërtyma e kolozhekut. (Vepra 1, f. 215); Edhe zullumi shtohet e shumohet dita ditës. (Vepra 1, f. 214); Ja, këto gjëra i vinin vërdallë në kokë të bijës së Nures, atje në mezhdën që ndante arat e Gjatollinjve nga arat e Gjonomadhëve. (Vepra 1, f. 196); Nga dera e mullirit

53. J. Thomai, Leksiku krahinor e dialektor në shqipen e sotme, Tiranë 2001, f. 142-143.

teptisi gjyryk një lumë më vete. (Vepra 1, f. 173); ... *u duk lart në baxhë, gryka e dyfekat të xha Brahos, pastaj mëngorja, takija.* (Vepra 1, f. 173); *Kështu bënte ngahera kur vinte lumi që ta tarakste, ta kthente.* (Vepra 1, f. 171); ... *zunë vendet e mëparshme me karabaçka turçe.* (Vepra 1, f. 240); *Ago Zylali donte t'ia humbiste tragën kësaj bisede.* (Vepra 1, f. 274); ... *Dani kish gojosur emrat e ca miqve të mëdhenj, që i kishin bërë nder.* (Vepra 1, f. 285); *Me të rënë, nis t'i bjerë dudukut e të gërhasë.* (Vepra 1, f. 294); *Gratë mbanin fustane të bardhë, të kuq ose me lalë, një çepirok mbi kupën e gjurit, të ngjitur pipthi pas kofshëve, pas të gjitha të teptisurave e të funditurave, e kështu me radhë.* (Vepra 1, f. 313); *Dhe vdiq nga ofrika... Brenda në plevicë ishte mugëtirë... Ca hipën lart në brezat e razhnicave, ca u shtrinë të kapitur në dërrasat.* (Vepra 2, f. 254-255); ...*sa hëngrën nga një kafshore u firos e tëra se e hëngrën minjtë.* (Vepra 2, f.98); *Të nesërmen menatë njeriu sos i lodhur e i këputur te kulla e Mujit.* (Vepra 4, f. 98) etj.

Autori përdor edhe shumë shprehje frazeologjike dhe idiomatike, si dhe detaje të tilla tipike gjuhësore në të folurin e personazheve, të cilat janë treguese të mendësisë dhe filozofisë së tyre të jetës, të prejardhjes së tyre territoriale apo shoqërore. Ndërsa, fakti që të njëjtat njësi frazeologjike përdoren në të folme të ndryshme, tregon se ajo çka i bashkon banorët e krahinave të ndryshme është më e madhe se gjuha, tregon se ata kanë të njëjtin qëndrim ndaj ndaj familjes, vëllait, mikut, besës, ndaj atdheut, fisit, besëtarit e tradhëtarit etj., qëndrim ky i shprehur edhe përmes frazeologjizmave gjuhësorë e letrarë. Personazhet që veprojnë në trevat e Veriut, Muji, Halili, Omeri e të tjerë, ashtu si edhe personazhet banorë të trevave të Jugut, kapedan Kajua, Bendo Shapërdani, Ago Dajlani e të tjerë, kanë një thelb të përbashkët: të qenit shqiptar.

-Në veprën e Kutelit kanë prani të konsiderueshme edhe variantet fonetike krahinore: fambrikantë (fabrikantë), shtatirë (shtatore), kureshtë (kureshtje), frenjat (frenat), kondratë (kontratë), profit (profet), kaqë (kaq), kumandar (komandant), Avropë (Evropë), gërqisht (greqisht), bulku, bulqërit (bujku, bujqërit), arrimë (arritëm), qëndimë (qëndismë), rrëfenj (rrëfej), këtunë (këtu), pyetnë (pyetën), shoqin (shokun), e përzu (e përzuri), ndënë (nën); u përshëndoshën (u përshëndetën); rëndësirë (rëndim), i urtuar (i uritur) etj. Për shembull;

Si mbaruan të përshëndoshurat, Anyla u ul në një trung të luguar. (Vepra 3, f. 94); *Gjërpenjtë e dritës që javiten në qiell, më thonë se ka për të ardhur gjësend.* (Vepra 2, f. 311); *Unë e shikoja i çuditur, ndofta dhe i zemëruar.* (Vepra 2, f. 154); ... *ia shtruan më një lëndinë, pranë zjarrit: unë më të djathtë, Zyferi më të mëngjër e mustaqeverdhi në mes.* (Vepra 2, f.152-153); ... *të shpëton nga Gurët e Gjetë e nga Qafa e Thanës.* (Vepra 2, f. 144); *Arinjtë lonin valle me dajre* (Vepra 2, f. 126); ... *e mbajti kalin pranë një varri, aty mbudhë.* (Vepra 2, f. 227); ... *u kishin vënë drunë çaushëve e zaptijeve.* (Vepra 2, f. 129); *Dheu unej e ngrihej.* (Vepra 2, f. 127); *Mua seç*

më mbyti **asohere**. (Vepra 2, f. 115); ... **shërëmëtiu** sa kumboi vendi i gjithë. (Vepra 2, f. 209); Rinë-Katerinëza rrinte e **mejtuar**. (Vepra 2, f. 208); Kur e pa Kuma Marua kështu, si **rrogeç**, ia plasi gazit. (Vepra 4, f. 288); Si më shikoni pa frymë e pa zë **shtritur**, qani gjithë ju për mua ... Dhe **papandyer** më erdhi ora e frikshme e vdekjes. (Vepra 2, f. 111); **Kumandar** Sefedini bëri emër të këndohej një këngë. (Vepra 1, f. 194); Ka **vjete** që vendi është turbulluar. (Vepra 1, f. 127); **Arrimë** në megrim. (Vepra 2, f. 251); **Loni, loni** gjersa të bëhi cupa të vishni fustan. (Vepra 2, f. 251); E fjala e tij ish ta **hanje** me bukë. (Vepra 2, f. 281); ... qan e vajton nënën që vdiq nga **vojjet** e luftës. (Vepra 2, f. 113); E **rruan** e trashëguan. (Vepra 2, f. 100); Orët **qetohen** pakëz e bëjnë buzën në gaz. (Vepra 4, f. 76) etj.

Trajtat fonetike dialektore ndeshen veçanërisht te parafjalët: *kumbulla* e Ndinkës së gjatë ish shkukur nga rrënja e më kish marrë **ndënë** të. (Vepra 2, f. 188); *Plaku bën be* **mbë** zotin. (Vepra 4, f. 83); *Ndë je ti, as më dëgjo, moj, të të them një fjalë goje*. (Vepra 1, f. 221); ... **gjer** afron ditës së Shëmbitrit, një shi i ngadalshëm pat rrahur dhenë. (Vepra 1, f. 109);

Në disa raste jo të pakta, Kuteli përdor parafjalën *ne* plus një emër a përemër (*ne ura*) në vend të formave të sotme të përbëra nga parafjala *te* (*te ura*), si dhe parafjalën *pe* në vend të parafjalës *prej*. Për shembull:

Nëno, të dal dhe unë me shoqet... **Gjer ne** pragu, neon. (Vepra 4, f. 305); *Ne pragu Batuni i tha Etlevës*. (Vepra 3, f.110); ... *ia paskan shtruar ne Han' i Petres*. (Vepra 2, f. 286); ... *nuse pe* dere të parë. (Vepra 2, f.167) etj.

Në prozën e Kutelit ndodh shpesh rënia e tingullit fundor te foljet, ndonjëherë dhe te emrat, si dhe përdorimi i trajtës së pashquar të kallëzores në vend të së shquarës, gjë që i jep më tepër ritëm ligjërimit artistik dhe e afron atë me ligjërimin bisedor, për shembull:

Se, më pat dalë nga mendja t'ju them. (Vepra 2, f. 239); *Ndenj* pastaj si mënjane, pranë dasmorëve. (Vepra 2, f. 228); *Aty gjenim* ndonjë rrotkë druri nga ato të penjve, ndonjë copë basmë, që i hidhnin rrobaqepësit kur fshinin **dyqanë**. (Vepra 2, f. 250); *U nis për në shtëpi, me mallë* e njeriut të mërguar. (Vepra 2, f. 234); *U ngrit kungulli e mori gardhë*. ... *Kështu flet sot çun' i Nezos, po s'ke ç'i bën: është i ri*. (Vepra 2, f. 288); *Hej! un' i mjeri, mua m'u ngjirr zëri*. (Vepra 2, f. 280); *U mblodhë* rreth e rrotull rrogazit. (Vepra 2, f. 284); *Motn' e parë...* u fanitej të gjithëve në ëndërr. (Vepra 2, f. 281); *Mua më zu* goja lesh. (Vepra 2, f. 280); *E gur mbi gur mos mbettë...* atyre që u **lidhë** me Latinin për të djegur Shqipërinë. (Vepra 2, f. 114); *Sikur e zura qiellë* me dorë. (Vepra 2, f. 94); *Ik tej, ti i mallkuar, se do na djegësh fshanë*. Hapni **varrë**. (Vepra 2, f. 315) etj.

Ka raste, kur ndryshimet fonetike dialektore janë më të thella, që prekin jo vetëm fonemat, por vetë temën. Për shembull: *O motra lëçitëse* e ju vëllezër **lëçitës**. (Vepra 2, f. 115) etj.

Në disa raste Kuteli përdor njëkohësisht variantin fonetik dialektor dhe variantin letrar. Për shembull: *E një të blegërirë, sikur i ndiqte ulku*. (Vepra 2,

f. 153); *Beu iu hodh si **ujku** deles...* Ajo e shikoi si **ulkonjë**. (Vepra 1, f. 99); ... i nderuar qofsh **në** këtë e **nd'** atë jetë. (Vepra 2, f. 229); *Mori ca korije, ca luadhe, vuri dy **bujq** që u përblau të ardhurat. Dalngadalë **bulqit** hapën ara, shtuan gjënë e gjallë.* (Vepra 1, f. 303); etj.

Një dukuri karakteristike për prozën e Kutelit është përdorimi i mbiemrave të formuar me anë të prapashtesës me karakter dialektor –njës në vend të prapashtesës -ues: *dyshonjës* në vend të *dyshues*, *qetësonjës* në vend të *qetësues* e kështu me radhë: *bubullonjës*, *cicëronjës* *deputonjës*, *freskonjës*, *gurgullonjës*, *kërcënonjës*, *ngacmonjës*, *qortonjës*, *spastronjës*, *tregonjës*, *tringëllonjës*, *vëzhgonjës*, *xixëllonjës* etj. Duket se në këtë variant dialektor mbiemrat e shprehin kuptimin e tyre në një nivel më të përforcuar, për shembull:

*Bardhyli e shikoi me të qortuar bletarin me mjekrën të kërlëshur me flokët, u mendua një çast, ngriti gishtin **tregonjës** – të gjatë, të thatë, **kërcënonjës**.* (Vepra 3, f. 220); *Ajo dukej si një qenie nga ato të përtejmet, e mbështjellë me një pah drite **verbonjëse**.* (Vepra 3, f. 26); ... *më ç'u ngrit nga fletët një këngë kaq e ëmbël, kaq **zotëronjëse**, sa edhe vetë Kirolloi që kish dëgjuar shpesë-mjeshtë, përtej, mbajti veshin e dëgjoi.* (Vepra 2, f. 209); *U dëgjua nga jashtë zëri i tij **urdhëronjës**, i kthjellët.* (Vepra 3, f. 232) etj. Ndërkohë sjellin shprehësi të lartë mbiemrat-kompozitë të këtij tipi, si: *Atëhere u bëri shenjë jeniçerëve të tij, dhe ata e rrëmbyen qenin **atdhemohonjës**, Ballaban Badherin, e shtrinë në një trung dhe i prenë kryet.* (Vepra 4, f. 231); *Nisi të dëgjohet cicërima e kandilëve **flakëfërfëllonjës**, e përzier me atë të një bulkthi të tultur s'di se qysh.* (Vepra 3, f. 233) etj.

Prapashtesën –njës e ndeshim edhe në disa emra të tipit: *këndonjës*, *lexonjës* *mësonjës* etj. Emrat e formuar në këtë mënyrë janë kryesisht me karakter shënues, por ka dhe raste kur ata marrin edhe vlera shprehëse. Për shembull: - *Sa qepë ka tërë kurora - pyeti ajo si **mësonjëse**.* (Vepra 3, f. 434); *Na ka ardhur një **mësonjës** i ri.* (Vepra 3, f. 429); *Ti, **lexonjës**, je i pari që po mëson të fshehtën time.* (Vepra 2, f. 244) ; *A doni t'ju them o **këndonjës**.* (Vepra 1, f. 200); ... *asnjë nga këto nuk mundi të tërheqë dhe gozhdojë mendjen e **vëshgonjësve**.* (Vepra 3, f. 109) etj.

Ajo që mund të thuhet me siguri, është se jo vetëm pasuria leksikore e veprës, por edhe aftësia për të nxjerrë prej fjalëve fuqinë e tyre shprehëse dhe vlerat e nevojshme estetike, e përcaktojnë Kutelin si një njeri të madh të letrave. Ai arrin të përpunojë, të përsosë dhe të bëjë rivlerësime të tilla të mjeteve gjuhësore, të cilat e kurorëzojnë atë si shkrimtarin kryesor ndihmëtar në krijimin dhe pasurimin e shqipes letrare.

2.4. Grupet paradigmatiche

2.4.1. Sinonimet

Kuteli sjell me veprën e tij një pasuri të çmuar në fushën e sinonimisë dhe vërteton atë që thuhet se çdo fjalë, ose shprehje mund të ketë, ose mund të krijojë sinonimi. Siç dihet, sinonimet për leksikologjinë janë fjalë me kuptim të njëjtë ose të ngjashëm, ndërsa “*për stilistikën ato trajtohen në kuptim të gjerë dhe konsiderohen ndër çështjet qendrore.*”⁵⁴ Një pjesë e mirë e krahinorizmave të Kutelit kanë sinonimet përgjegjëse jo vetëm në gjuhën letrare, por edhe në dialekte dhe të folme të tjera.

Autori është këmbëngulës në gjurmimin apo krijimin e sinonimeve dhe me anë të tyre bën saktësimin më të plotë të dukurisë, apo të mendimit që përshkruan, shmang përsëritjet dhe rutinën që mund t’i sillte kjo teksti dhe rrit ndjeshëm shprehësinë dhe bukurinë e tij. Ashtu siç thotë Jani Thomai, “*begatia sinonimike e shqipes pasqyrohet në veprën e tij në një sistem të pasur e të ndërlikuar sinonimesh e mënyrash sinonimike të cilat autori i përdor sipas rastit, herë për të bërë nuancime të holla kuptimore e emocionuese, herë për mbushjen e fushës semantike dhe variacionin leksikor të frazës.*”⁵⁵ Për shembull:

Hedh sytë rreth e qark e nuk sheh veçse gurë e cungje. Afrohet e këqyr gurët e bjeshkës dhe i njeh pas shenjës kreshnikët e tij. (Vepra 4, f. 63); *Mrizet, sheshet, gurrat mbeten të jeremitur. Në mes të kësaj jeremie qëndron vetmitare, e habitur, nusja e Mujit. Veç ajo ka mbetur e gjallë, po s’di ç’të bëjë e nga t’ia mbajë.* (Vepra 4, f. 62); *Kur të dilni majë bjeshkës, do të gjeni tri mrize të mëdha. Aty ruajuni, mos lodroni, kini mendjen, mos uli të pushoni, mbani veten e mos flladiti gurrave.* (Vepra 4, f. 61); *Nuses i vanë sytë tek unaza, e njohu menjëherë dhe i shpëtuan lotët syve, iu rrokullisën sumbulla – sumbulla faqeve të kuqe, i ranë pika – pika gjirit të bardhë.* (Vepra 4, f. 45); *Kuçedra është shumë e keqe: të përvëlon, të ha, të përpin.* (Vepra 4, f. 17); *As vetë Xheladin beu nuk dinte përse ndiente një zbrazëtirë aq të madhe në zemër atij mëngjezi vjeshte të dytë. Një zbrazëtirë sa një zgërbonjë gështenje që e ka brejtur krimbi përbrenda, një shembëtirë, një turbullirë e një neveritje pa fund e pa anë.* (Vepra 1, f. 63); *Veshi më nge rrobat e kadifesë së gjelbër me vija e sumbulla argjendi, që i kish apostafat për udhë e gjah. Sheqerja u ul në bisht e i mbërtheu kopsat poshtë nën gjunjë.* (Vepra 1, f. 88); *Jo vetëm graria e fëmija, që dihet që kanë mendje çilimiu, po edhe burrat me mustaqet gjer në vesh.* (Vepra 2, f. 296) etj.

Kuteli krijon paralele sinonimike duke shfrytëzuar burime të ndryshme popullore dialektore, por më së shumti atë juglindor, duke nxjerrë prej harrimit (si rezultat mospërdorimit për arsye nga më të ndryshmet) shumë prej tyre, por edhe duke krijuar vetë neologjizma, dhe në këtë pikë duket se autori zhvillon aktivitet krijues gjuhësor, qoftë në mënyrë origjinale, qoftë duke u mbështetur tek modelet ekzistuese të fjalëformimit të shqipes.

54. Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë 2005, f. 136.

55. J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 143.

Në vështrim leksikor vërehet se ndërthurjet sinonimike krijohen më së shumti me fjalë dialektore, të cilat kanë kuptim konkret, me fjalë të cilat kanë lidhje me bimësinë, kafshët, me etnologjinë e zonës e të tjera dhe më pak me fjalë të kuptimit abstrakt. Thuajse të gjitha “*vargjet sinonimike kanë një a më shumë fjalë me shtrirje më të gjerë e që doemos, janë bërë normë, por në disa vargje dallimi i dominantes ka qënë më i lehtë për shkak të njësisë mbidialektore.*⁵⁶ Për shembull: *sem, sinor, kufi, mezhde; largqofti, qoftëlargu, djalli, xhixhima, i paudhi, i pagoji, i paemri, gojëlidhuri, gojëkyçuri; njëherë e njëkohë, qëmoti, në kohët e moçme; krye, kokë, kaplloqe; kapua, kaposh, kokosh, këndes; kanare, zhaurimë, burbujë; feste, kapë, takije, kësulë; rrëngë, rrëc, dingë, dëngës; çupë, çupërlinë, vashë, vasho, cucë, kopile, kedhe; djalli, dreqi; trastë, torbë, krahosh; kalor, kalorës; vrik, shpejt; qan, logorit, lebetitet, vajton; e bukur, bukurezë, perri, hyrije, rënëqielli; skorovod, lugat, kanxhallos, kukuth; tintëllin, tingëllin, xhingërin; koskë, kokallë, eshtër; ndrën, shndrën, vezullon, vetëtin; fillthi, fillall, vetëtimthi, rrëmbimthi, njëmenthi; atëlosh, babëlosh, babale; beriha, tevatyrë; s’ia var, s’e begenis, s’e vë në refene; komçë, sumbull, kopsanjë; një moti, një viti; i ngjeshur, dërdëng; kroçkë, dru, gdhë; vegël, qojle, orendi; shtohemi, shumohemi, shumëzohemi; ngadalë, më nge, kothere, koromane, kafshore; frymë, ffromë, shpirt, xhan; zbardh, lbardh, zbardhëllon; e bardhë, e zbardhlyët, bardhosh, bardhok; kuqëlon, kuqëron, përskuq, skuq, lkuq; shkes, shkesëtar, mbles, mblesëtar; krushqar, krushk; përkëmbej, mëkëmbej, javitej, çelej, çeledisej; fugoj, rent, harboj, gjëmoj, ngas, kaptoj; e athët, majoshe, e thartë; mastrapan, çupallkë, jamake; jeremi, vilani, përhumbje, të fikët, përdhesi; tani, tashi, tanithi; asohere, atëherë, atëkohë, atëbotë; papandyer, befas, papandehur, menjëherë, njëmend, njëmendthi, papritur, pakujtuar; shkarazi, kaluarthi, rrëshqitazi, për brinjësh; shkarrëzimë, shembëtirë, rrëzomë; kulluzmë, blatë, abuz; kërr, kërraç, pulisht; zamzane, damixhan; dimite, çitjane; barkmadh, barktul, barkor; hiç, asfare, aspak, asnjë çikë, hiçgjë, mosgjë, vëlla, byrazer, vëlasho; bret, thërret, vikat; ngamot, vit për vit, përherë. Vargjet sinonimike të mësipërm, e të tjerë të papërmendur, i shfaqin më qartë diferencat e tyre kuptimore e stilistike në përdorimet e ndryshme mikrokontekstuale e makrokontekstuale. Për shembull:*

E meqë bota s’kish përse të qahej, gjeti të qahej se s’kish grunarë e koshare ku ta derdhë këtë të uruar bukë. (Vepra 2, f. 115); ... Edhe qan e vajton babanë e tij... vrarë me plumb romak. (Vepra 2, f. 113); Po kur kthehej Shkurtua ne pinoku, dilte edhe e përqeshte në të ecur, me duar prapa, sa gajasnim që të gjithë. (Vepra 2, f. 110); Tërë Kotorret zgërdheshen, qeshen, tallen. (Vepra 4, f. 99); ...po të vijë djali, ju bën copë e grimë. (Vepra 4, f. 83); Zëri i tij çjerr ajrin e bjeshkës, gërvisht dritën e hënës. (Vepra 4, f. 77); ... është vetë shqahu Paji Harambash, i rëndë, i zyrtë, zemërak. (Vepra 4, f. 750); Doriu është i kapitur. Ymer Aga është i drobitur. (Vepra 4, f. 49) etj.

56. J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 94

Pra, siç vihet re në shembujt e mësipërm, njësitë sinonimike në veprën e Kutelit nuk thonë qind për qind të njëjtën gjë, përkundrazi, për çdo rast, ato sjellin diçka shtesë, qoftë në rrafshin kuptimor, qoftë në rrafshin stilistikor. E nisim argumentin, së pari, me një rast, ku diferencën kuptimore midis dy fjalëve sinonimike e shpjegon vetë autori: *Asohere Zefi nga lugat që ish ra e u bë kanxhallos, njëzet herë më i keq se lugati.* (Vepra 2, f. 313). Diferencime të tilla saktësuese vihen re edhe në shumë shembuj të tjerë, si për shembull: *Sado që e mbante të mbyllur në kyçe e kafaze, gjithë bota e dinte se e shoqja e Zefit ish bukuria vetë nën dhe.* (Vepra 2, f. 312). Në këtë rast të dyja njësitë e paraleles sinonimike në kyçe e në kafaze, japin idenë e mbylljes, burgosjes, por në mënyrë më të intensifikuar e shpreh atë e dyta, sepse kafazi është hapësira më e vogël e mundshme, ku mund të mbyllësh e kyçësh dike. Ndërsa në rastin: *Qante e lebetitej e shkreta grua brenda në shtëpi, me lugatin pranë, po s'kish njeri që ta mbrojë* (po aty); të dyja këto njësi sinonimike, përveç thelbit të tyre të përbashkët, kanë diferencë në ngjyresat e tyre kuptimore. Kështu lebetitej mbart një veprim njerëzor, i cili vjen prej një situatë më të vështirë, më dëshpëruese dhe më pa rrugëdalje se sa ç'mbart leksema qante, sepse njeriu mund të qajë jo vetëm kur i ndodhin fatkeqësi të ndryshme, por pse jo, shpeshherë edhe prej të kundërtës, prej gëzimit, prej suksesit etj. Më tej, mund të themi se lebetitej përdoret posaçërisht në një situatë negative, pra është i qartë roli i saj saktësues përkundrejt fjalës tjetër paralele më të. Natyrisht, rol të padiskutueshëm në sqarimin e marrëdhënieve kuptimore, por edhe stilistikore, në lidhjet sinonimike luan edhe konteksti i përdorimit të tyre, por në pamundësi për t'i bërë analizat e diferencave të të gjitha rasteve sinonimike, për arsye se vepra e Kutelit është përplot me të tilla, më poshtë po japim thjesht shembujt, ku vërehet çka u tha më sipër. Për shembull:

Kësi lugetër të mërzitur që punojnë vetëm rengje e të këqija kanë dalë e dalin ngamot në fshatin tone. (Vepra 2, f. 307); *Po ca kohë buza e lumit mbeti kërr, e zhveshur.* (Vepra 1, f. 360); *Mendothem e shtypem e s'e sjell dot në mend.* (Vepra 2, f. 304); *E si ngjallen... zënë e bëjnë trazira e zullume, si mos më keq... punojnë të një mijë e njëqindat.* (Vepra 2, f. 295); *... ranë në qef e nisën t'ia thonë këngës me këto të thirrura, me këto të buçitura, sa zëri u ngrihej qiri gjer lart te plepi.* (Vepra 2, f. 286); *Pasqyra... tregonte një burrë me lapra, brezda e sy të skuqur.* (Vepra 1, f. 74); *Një ishte Xheladin beu në atë mëngë të mbretërisë, një e me vulë.* (Vepra 1, f. 76); *Shqyen berra, çan derra e s'ngopet me gjak.* (Vepra 4, f. 297) etj.

Duke e shqyrtuar begatinë sinonimike të veprës së Kutelit, vërehet se ajo shfaqet si e tillë edhe në rrafshin fjalëformues dhe se elementet e reja të vargjeve sinonimike janë më së shumti fjalë të prejardhura dhe në një grup më të vogël janë fjalë të përbëra, për shembull:

-ndajfolje, te të cilat bie në sy prirja për sintetizim dhe për krijimin e mjeteve të reja shprehëse, si: *arithi* (ngrihem si ariu), *capthi*, *linkthi*, *fillthi*,

vetëtimthi, njëmentthi (me të shpejtë); rrokas, fytas, grykas (e zë për fyti, për gryke); qetë, qetas etj.

-emra, te të cilët përfshihen kryesisht leksema që shprehin marrëdhënie farefisnore: *babëlosh, atëlosh, babale; nënoke, none, nënë; birth, evlath; vëlla, vëllam, vëllauth, vëllaçko; çupkë, çupëz, kunatë, kunatëz* etj., të cilat marrin nuancat kuptimore të përkëdhelisë nëpërmjet prapashtesave zvogëluese përkatëse.

-mbiemra, si: *dhelperake, dhelperore; i keq, keqan; murrak, i murrte; shtrigore, shtrigushe; thatime, thatoke* etj., të cilët nuancojnë dallueshëm brenda të njëjtit spektër kuptimor. Për shembull: *keqan* është më e fortë kuptimisht se fjala *i keq*, sepse ajo e përcakton negativitetin e një individi të lindur si i tillë, ose i keq në tërësinë e tij, ndërsa mbiemri i dytë përdoret për karakterizuar një person, që është i keq në një, ose në disa aspekte të caktuara.

-folje të formuara me parashtesat *-sh, -për, -l* etj. Njësitë e krijuara prej tyre marrin kuptim më të intensifikuar dhe shprehësi më të lartë se gjegjëset e tyre sinonimike, si: *shndrit* përkundrejt *ndrit; përhub* përkundrejt *hub; lkuq, lbardh* përkatësisht përkundrejt *skuq, zbardh* etj. Veçanërisht, dy foljet e fundit, duket qartë që marrin karakter shumë më poetik se sa përkatëset e tyre.

Po kështu, i kanë shumë të theksuara dhe në mënyrë të përhershme ngjyrosjet emocionuese dhe shprehëse sinonimet në formën e kompozitave, shpesh për shkak të natyrës së tyre të metaforizuar. Ato kthehen në të tilla vetëm po të vështrohen në kontekstin e caktuar, për shembull:

Pra, fytyrat nuk i përshkruam pikërisht për shkak të këtyre të nëmosurave kapela-luadhe ose kapela-bostane, që ua fshihnin dhe ua bënë në mistershme... .. Kish leshra të prera shkurt “alla bebe” ose më saktë “alla bebekë” apo “allabebeçkë”. (Vepra 1, f. 316); Ky Beluli na kish pasur një zonjë të bukur rënë-qielli. (Vepra 2, f. 307); Kur e kur kolonel Shabedin Agua e mbledh shtabin nën rogoz, me ato kupa të mëdha përpara, me ato vozat bark-madhe aty pranë. (Vepra 2, f. 293); Ka moj motër, në botë, ca sypëgërë e syplasje që jarebi. (Vepra 2, f. 83) etj.

Në veprën e Kutelit krijohen sinonimi edhe me ndërtimet frazeologjike, proverbat, thëniet popullore, urimet, mallkimet etj., të cilat janë në përputhje me frymën e përgjithshme të gjuhës së saj, me mbështetjen në tabanin gjuhësor të popullit, me frymën e ngjarjeve të kohës e të mjedisit ku ndodhin, me psikologjinë e personazheve, dhe si të tilla i japin një pamje dinamike e krejt të veçantë ligjërimit. Shpeshësia e përdorimit të tyre është shenjë e potencialit të shqipes në këtë drejtim, por edhe e njohjes së saj prej autorit dhe e përzgjedhjes së tij cilësore, për shembull: *e hidhura me të hidhurën, e keqja me të keqen; dardha e ka bishtin mbrapa, mënon, duron, po s'harron; punon bulku, ha ulku, punon kali i barrës, ha kali i shalës; më rrofsh, të paça; me të zbardhëllyer dita, me të gdhirë; shpirt njeriu, i miri; për faqe të zezë, për turp të zotit; mbledh buzët, var hundët, var turinjte; buzë më buzë, majë më majë; ishin bërë hi e shpuzë, nuk u kish mbetur nam e nishan; i*

iku mendja, e humbi toruan; i ke paret me bisht, i ke paret me lopatë etj. Për shembull:

...Ka bërë tri dasma në një dimër. E jo dasma **sidokudo**, sa për të shkuar

radhën... E si të mos ishte kështu, o i bekuar, kur buka ra nga qielli, sa **nuk matej dot me shinik e nuk peshohej dot me kandar?** Ra njashtu siç bie shiu në vjeshtë e dëbora në dimër **plot e përplot**. Sikush në kohën e vet, të lashtat e të vonat, erdhë e **u bënë det**, sa s'dukej brenda kalori hipur mbi kale. (Vepra 2, f. 115); **Po Shkurtua nuk nxirrte zë... rrinte brenda i tulitur** si miu, se macet ishin jashtë. (Vepra 2, f. 111); ... i kollej në sy jo për gjë tjetër, po për **të ecurit e saj qibar, me kokën lart, si pisërënga**. (Vepra 2, f. 107-1080); **Ti që na bëre këtë të mirë, hap gojën e fol** çdo të të japim. (Vepra 2, f. 99); **Më tha ai t'ia rrëfej se do të më nxjerrë një pizgë të madhe, një bilbil të madh pa gdhë, e çmos e çnuk**, po unë jo e jo. (Vepra 2, f. 95); **Paji Harambash bëhet tym e mjegull**, hamullin fort e më fort. (Vepra 4, f. 76); **Pastaj, e drejta ime është sheshit se, si të ha ai, një fshat që duket, s'do kallauz**. (Vepra 2, f. 280); **Ai... është zymtuar fort, i kanë hipur në kaptinë furitë e zeza të honeve e gropave**. (Vepra 4, f. 75); **I hyn frika në palcë, i dridhet buza**. (Vepra 4, f. 448); **Mos të ka vdekur** ndonjë mik i mirë? Apo **ta ka tharë zemrën** ndonjë bir a bijë. (Vepra 4, f. 30); **E dini ç'tha kur hapi sytë e ra ndër mend**. (Vepra 2, f. 297); **Po ta bësh këtë punë s'të djeg as zjarri i xhehenemit, Xheladin bej. S'të tret dheu**. (Vepra 1, f. 95); **mbani vesh e dëgjoni**. (Vepra 3, f. 496); **Mbeta qyqe vetëm** këtu e tani po vjen nata. (Vepra 4, f. 270); **Murga Trëndelino mbeti fillthi në mal, njeri pa njeri**, midis egërsirash. (Vepra 4, f. 269); **Nxjerrin bukën nga trasta e zënë të hanë pa zë, tërë hundë, sikur t'u paskej ngrënë derri brumët** (Vepra 4, f. 491); **Jep e merr e s'di ku të futet**. (Vepra 4, f. 41); **Po vasha flet qetas, s'lot fare vendit**. (Vepra 4, f. 144); **E ngre shkëmbin dhe e ve në cep të supit, e mban lart dhe qëndron shtyllë, s'tundet fare**. (Vepra 4, f.56) etj.

Te Kuteli, sinonimia krijohet edhe duke përdorur fjalë të leksikut shqip dhe fjalë të leksikut të huaj. Për shembull: *sedërli, namusqar; maskara, dinsëz, edepsëz; tregtar, dyqanxhi; dëshmitar, shahit; skamje, qesatllëk, fukarallëk; odë, konak; birth, evlat; e premtë, e xhuma; dhëndër, bandill; e keqja, belaja; dritëzore, penxhere; parajsë, xhenet; ferr, xhehnem; mjeshtër, usta; mendje, tepelek; e përdalë, xhadi; vëlla, byrazer; flori, alltën; të këqija, alamete* etj. Në përgjithësi, fjalët e huazuara nuk sjellin ndonjë gjë të re në planin semantikor, megjithatë në kontekste të caktuara, ku ato përdoren, mund të krijojnë diferencime të karakterit stilistik, për shembull:

Shkurtua me të tijtë, Qosja me të tijtë, që të dy me nga një palë size vënë mbi hundë, psallnin e kanaqisnin në kishë. (Vepra 2, f. 111); ...*I vulosi të gjithë në ballë që të dijë bota si e qysh... jalla u përmbystë kjo dynja!* (Vepra 2, f. 288); *Bujqit, raja e harbutë, të gjithë me dorë në zemër si nuse kauri*. (Vepra 1, f. 64); *Këtë punë e bënë qehallarët, "trimat", siç u thosh*

beu, apo “lanxhot”, “larot”, “zybat” siç u thoshin me gjysmë goje ata të tjerët, vegjelia. (Vepra 1, f. 65); Nuk e harronte... as **adëmin** e madh, **të parin** e haremllekut të sulltanit. (Vepra 1, f. 65); Kjo **oda** e madhe e **konakut** të madh... i qerthullohej beut ashtu siç qerthullohen kuajt në lëmë. (Vepra 1, f. 66); Se Xheladin beu kish qënë gjithnjë, që në të ri, **njeriu i qejfit, hashari**. (Vepra 1, f. 67); **Derman pasha! Vër dorë në zemër!** Çupa është jetime. (Vepra 1, f. 81); **Baba Sulltani, mbliidhte njerëz me harxhe, paguante tink-tik alltën e argjend.** (Vepra 1, f. 91); Hëm, hëm, **xhenaze biçimi...Dy të vdekur** në një ditë... .. **Dovleti ka haznë të madhe, ka taraphanë.** (Vepra 1, f. 92); **Flije mendjen e fiqirë, Kuma Maro.** (vepra 4, f. 283); **U bëra siç thotë bota, buf e matuf.** (Vepra 1, f. 274) etj.

Julies Marauzeau shprehet se “*gjuha ka repertor shumë të gjerë mjetesh e mundësish, ndërsa shkrimtarit i mbetet të zgjedhë.*”⁵⁷ Në këtë kontekst, Kuteli përpiket të zgjedhë njësinë më të qëlluar, më të veçantë, në përputhje me atë që kërkon teksti, mikrokonteksti, me atë që kërkon përmbajtja, tema, ideja apo rrethana emocionale. Ashtu si në të gjitha rrafshet, edhe në atë sinonimik, ai di të shfrytëzojë të gjitha mundësitë stilistike dhe të krijojë një regjistër sa të pasur, aq edhe origjinal zgjedhjesh. Zgjedhjet e përzgjedhjet e elementeve gjuhësore sipas konteksteve të caktuara bëhen në përputhje me qëndrimin, me ndjenjat dhe mendimet e tij ndaj dukurive e ngjarjeve jetësore, ndaj sjelljeve të ndryshme njerëzore etj. Me anë të tyre ai përpiket ta përcjellë sa më të plotë, sa më të qartë dhe më të saktë mesazhin te lexuesi dhe gjithashtu realizon qëllimin e tij prej shkrimtari, i cili synon që shprehja gjuhësore të marrë funksion estetik. Në shërbim të këtyre synimeve është jo vetëm përzgjedhja, por edhe mënyra e strukturimit të tyre. Në këtë pikëvështrim, te Kuteli ndeshim rëndom dy lloj grupimesh:

-Së pari çiftin sinonimik që krijohet nga pranëvënia e dy elementeve të një paradigme në një sintagmë, përdorimi i shpeshtë i të cilit kthehet në një tipar karakteristik të stilit të Kutelit. Çiftet sinonimike në veprën e tij paraqiten interesante në çdo pikëpamje, por sidomos në planin semantikor dhe atë të shprehësisë. Ato sjellin përforcim semantikor dhe rritje shprehësie, pothuajse, në mënyrë të rregullt. Për shembull:

Të treqindët ndritnin e vetëtinin: rrobat i kishin të arta; edhe shpatat krejt të arta, shigjetat dhe heshtat krejt të ngrira në ar. (Vepra 4, f. 60); ... *fishkëllon era nëpër ahe, bubullojnë e vrungullojnë bjeshkët* (Vepra 4, f. 62); *Gurija priste me tmerr e krupë se çdo të ndodhte më tej.* (Vepra 1, f.71); *Xhixhe-hanëmi ish nga derë e madhe, bijë pashai e mbesë veziri, po shterpë e barkthatë...* *Ai ia kish frikën sidomos Xhixhe hanëmit, një gamile tërë koska e kokalla.* (Vepra 1, f. 79); ... *kjo Galiçica e thatë së bashku me Shëndaumin e një pjesë të liqerit, ku s’kish rënë hija e maleve, u bënë flakë e prush i gjallë.* (Vepra 1, f. 105); *Burrat si burrat, njerëz si gjithë bota: me dy duar, me dy këmbë... domosdo të rruar e të kruar.* (Vepra 1, f. 318); *Prandaj, disa ishin,*

57. Julies Marauzeau, *Précis de stylistique française*, Paris, 1946, f.10.

siç thonë ata të Shqipërisë së Mesme **bullafiqë e barkulë**, si ca gra shtatzëna në muajin e tyre gat-gati. (Vepra 1, f. 318); **Qielli ndrin i larë e i shpëlarë dhe lart**, në kupën e qiellit, vetëtin vetë zoti diell... **Ndrit e shëndrit** tërë bota e në mes të kësaj bote **ndrit e shëndrit** e vogla. (Vepra 4, f.441); **Unë jam Paji Harambash... që pres e shtyp e vras e pres**. (Vepra 4, f. 76); ... **gjeti të qahej se s'kish grunarë e koshare** ku të derdhë këtë të uruar bukë. (Vepra 2, f. 115); **Po kur sosën të vjelat... vozet e këllbrat, koshat e kofinat** nuk nxinin veçse gjysmën e pemës. (Vepra 2, f. 117); **Do të shkoj... të bëj vëllamë e kumbarë e pastaj të kthehen**. (Vepra 4, f. 25);

Në veprën e Kutelit përbëjnë një grup të madh dhe tepër karakteristik, me vlera të veçanta shprehëse e stilformuese çiftet sinonimike, ku fjalët e reja si njësi përbërëse të tyre, krijohen me anë të parashtesës *-stër* dhe në një numër më të paktë me parashtesat *-sh*, *-për* etj.; rregullisht, në to nuk mungojnë ngjyrimet semantikore e stilistikore, si: *lëng, stërlëng; pyet, stërpyet; kuçkë, stërkuçkë; ndrijnë, vetëtijnë; humb, përhumb; tundet, shkundet; vesh, përvesh; u tha, u përtha; e qeshi, e përqeshi* etj., ose formohen me prapashtesa, ose të kombinuara: *shtrigë, shtrigore; dhelpërake, dhelpërushe; thatime, thatoke; i murr të, murrak; fill, fillthi; skuq, lkuq; më pas, pasandaj; rrudhat, dërrudhat* etj. Për shembull:

... *U martua me bijë pashai, mbesë veziri, baxhanakë e tërbaxhanakë sulltani*. (Vepra 1, f. 83); *Krushqit ia sollën nusen në shtëpi me suvarinj, me salltanet të madh me allallajka e stërrallallajka prapa, po pa çupëri*. (Vepra 1, f. 84); *I zoti dyqanit na ish një rondokop i ngjeshur e stërrngjeshur me sy të bardhë*. (Vepra 4, f. 485); *Bardhoku shtypet e përshtypet*. (Vepra 4, f. 480); *Çupa është bukuroshe, llërëplotë, pulpëbardhë. E kolme, e përkolme*. (Vepra 4, f. 477); *E futën në një thes copa-copa, koka veç, dora veç, krahu veç, dyqind fela e fërtela*. (Vepra 4, f. 423); ... *i madhi fryn e shfryn, nxjerr gjuhën një pëllëmbë, si qen i ngordhur*. (Vepra 4, f. 414) etj. Gjithashtu, nivel të lartë shprehësie dhe emoconaliteti ndeshim edhe në rastet, kur njëri element i çiftit sinonimik, në pikëpamje të fjalëformimit, është krijuar me anë të prapashtesës *-ore*: *Allah-bir, janë frëngë e frëngore*. (Vepra 1, f. 317) etj.

Së dyti, në veprën e Kutelit zënë jo pak vend vargjet sinonimike, të cilat krijohen nga vendosja radhazi e disa sinonimeve. Vërehet, se në këtë rast hyjnë në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që nuk janë të tilla dhe me to krijohen tufa përfitesash të gjera, të cilat janë të ngarkuara me ngjyresa kuptimore dhe me vlera të larta shprehësie. Me hollësitë që sjellin, ato nxisin një qëndrim aktiv të lexuesit për të mos mbetur një pjesëmarrës sipërfaqësor, por të hyjë në thellësitë e kumteve të veprës. Në vargjet sinonimike nuk mungojnë edhe shkallëzimet stilistike, të cilat e bëjnë tekstin më tërheqës e më artistik, për shembull:

Të dy ishin kërmë: shpirtzinj, nakarmëdhenj, gjakatarë. (Vepra 4, f. 428); *Ky ra pas qejfeve e ahengjeve, pas grave, pas zullumeve*. (Vepra 1, f. 83); *Rënkonte, gulçonte e shfrynte nëpër hundë e nëpër gojë*. (Vepra 2, f.

305); Një pjesë të madhe të udhës, e zinte një grua e **plotë** dhe **stërplotë**, **deng me dhjamë**, **më** e **ngjeshur nga shoqet**... ...me ca krahë **dërdëngë**. (Vepra 1, f. 314); Ah, **këpucët**, ose më saktë **këpuckat**, **skërpinjkat**, ishin vepra të vërteta arti. (Vepra 1, f. 314); Kam frikë se mos më zërë derën ndonjë **kobeshë**, **çotillë** e **mish në mashë**, për të trembur laraskat. (Vepra 4, f. 477); Një ditë, dy, tri, **kapiten**, **taraksin**, **bien** e **dergjen** të sëmura. (Vepra 4, f. 441); Ajo ndrit, të motrat **murtohen**, **zymtohen**, **nxihen** sikur t'i paskej djegur rrufeja e kulmeve. (Vepra 4, f. 441); E madhja **marroset**, e mesmja **xhindoset**: ... Ti, naprane, i **ke bërë magji** yllit, e **ke shushatur** hënën, e **ke budallepsur** diellin. (Vepra 4, f. 440); Aty sheh një **kutullaç** të qepur si majmun pas çengelit... **Lugat** shkuar **lugatit!** **Tartakut**. (Vepra 4, f. 419); ... i shihje pragjeve e udhës, nëpër **pluhur**, **të dregosura**, **të qurrosura**, **të palara**. (Vepra 1, f. 75); ... po ju shoh se si **shtypi** e **përshtypi**, **vrisni mendjen**, **varni vetullat** e nuk më jepni dot përgjigje. (Vepra 1, f. 175); Këtë punë duhet ta marrim shtruar: **ta shkoqim**, **ta shoshim**, **ta sitim**. (Vepra 2, f. 13... të gjitha rrinë tulitur, në errësirë, nëpër **strofulla** e **gufu**, nëpër **brima** dheu e **brima** drurësh, nëpër **çerdhe**, **shkurre** e **degë**. (Vepra 4, f. 74) e **E në s'ka shok**, **ka flamur**, **ka nishan**, **ka taraf**. (Vepra 2, f. 293) etj.

Kuteli përdor gjerësisht sinoniminë kontekstuale, gjë që flet për aftësinë e tij për të bërë përzgjedhje stilistike, por edhe për atë që dihet se sinonimia, në fund të fundit, shfaqet e hetohet shumë më mirë në kontekste të caktuara. Për shembull:

Çuditej një botë e tërë e thosh: **kroçkë** paska qënë, **gur**. (Vepra 2, f. 130); **Hiqte** e **vuante** po nuk epej: gjithnjë **kroçkë** e **gdhë**. (Vepra 1, f. 165); **Punojnë ditë e natë**, **derrçe**, me **djersën** e ballit. (Vepra 4, f. 481); **Ne vegjëlia** apo **çocërrit** e **ugareve**, siç na thoshin me të qeshur, s'dinim ç'ishte "i sotmi". (Vepra 2, f. 125); **Njëra nga çupat** ... nisi të na rrëfente **me zë të platitur** (**zë nate!**), **shtruar-shtruar** një përrallë. (Vepra 2, f. 130); **Tani u veshe**, **u ngjeshe**, bëre shtëpi të reja, mban edhe zybat me bukë. (Vepra 4, f. 412); **Fundi i fundit**, përse ata të mbeteshin **faqekuq** si molla, kurse ai, beu hanedan, të **zverdhej** e të **thahej** dita ditës. (Vepra 1, f. 66-67); **E jo dasma sidokudo**, sa për të shkuar radhën, po dasma nga ato që **ha qeni petulla** e **kërcasin trarët** e **shtëpisë**. (Vepra 2, f. 115); **Koçanët** mbeteshin **lakuriq**, **jetimë**. (Vepra 2, f. 117) etj.

Sinonimet kontekstuale, pra emërtimet e tjera për të njëjtin emërtim gjuhësor, e çojnë Kutelin, ashtu si edhe shkrimtarët e tjerë deri te metaforizimet, sepse ato e sjellin dukurinë në një këndvështrim të ri, duke ndriçuar edhe karakteristika të tij. Për shembull: **Më shumë nga të gjithë** e **thumbon atë**, **emërharruarin**... **Trambalukun**, **dudumin**, **krushkun**. (Vepra 3, f. 415). Fjala **krushk** zëvendësohet katër herë me trajta dialektore në vargun sinonimik dhe përmes sinonimisë kontekstuale kjo leksemë asnjëherë apo leksemë bazë kalon në lidhje metaforike me to. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shembujt e mëposhtëm: **Ti je Thana** e **ilirëve**, **perëndesha** e **gjahut**

dhe e grigjeve, tmerri i ujkut dhe të paudhit, shëmbëlltyra e hënës. (Vepra 3, f. 13); *Florinjë ish in bërë qymyr i zi, të flamosurit, viranët.* (Vepra 2, f. 159) etj.

Teksti estetizohet në nivel më të lartë, sidomos, kur elementet e vargut sinonimik krijojnë lidhje fjalësore të figurshme, si për shembull: *Ka të drejtë Agatoni i Athinës që thotë se dashuria u sjell heshtjen erërave, qetësinë deteve, pushimin dhe gjumin brengave, paqen njerëzve.* (Vepra 3, f. 12); *Buçimat e përrenjve, gurgullimat e kronjve dhe zhaurima e erës nëpër gjethet mbytnin hapat e vrapit, por nuk mbytnin dot thirrmat e përgjigjet.* (Vepra 3, f. 15) etj

Në aspektin leksiko-gramatikor, rastet më të shumta i shënojnë emrat, të cilët pasohen nga mbiemrat, foljet dhe më pas ndajfoljet, ndërsa në vështrim të përgjithshëm paradigma sinonimike në veprën e Kutelit paraqitet e pasur dhe e shumëllojshme dhe, si e tillë, mbetet e hapur për studime të mëtejshme.

2.4.2. Antonimet

Pasuria e krahnorizmave dhe dialektalizmave në veprën e Kutelit gjen shprehje edhe në paradigmen antonimike. Dihet se antonimia ndërtohet mbi bazën e kundërvënies kuptimore të fjalëve, por, sidoqoftë, për ta analizuar sa më mirë atë, duhet të kemi parasysh edhe elemente të tjera siç është situata ligjërimore, shkalla e kundërvënies kuptimore, ndërtimi i tyre etj. Kuteli është shkrimtari që i përdor gjerësisht dhe me një shumëllojshmëri tipash antonimet, duke rritur përmes tyre shprehësinë e tekstit, për shembull:

Gjënë e gjallë e veron lart në mal dhe e dimëron poshtë në Drimonë, ku moti është më i butë. (Vepra 3, f. 22); *Në hënë të re magjistricat hyjnë në varre kaluar mbi maçokë të egër e marrin dhe e eshtër të vdekuri për të mbyllur e për të çelur, për të lidhur e për të zgjidhur, për të mbërthyer e për të zbërthyer. E si mbarohet puna, dalin lugetërit me thes në kokë e ia krisin valles me daulle e zurna, sa dridhet e vdes çdo gjë e gjallë që ndodhet aty pranë... Si mjerë udhëtari i huaj që rastis të shkojë asohere mbudhë: mbetet kufomë e bëhet një nga lugetërit e fshatit tonë.* (Vepra 2, f. 300-301); *Në Amerikë, bir-o, në Amerikë të Zezë: gjashtë muaj ditë, gjashtë muaj natë, njerëz me bisht e me një sy në ballë, hanë breshka e nepërka... Shëndaum i 'rgjëndë e pastë kujdes! Shërmëria e sjelltë shëndoshë! Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, gjyshja ndërroi prapë fletën.* (Vepra 1, f. 108) etj.

Në veprën e Kutelit vërehet afrimi i antonimeve me njëri-tjetrin, afrim që bëhet për të vënë në dukje anë të qenësishme të sendeve a dukurive, anë të cilat i interesojnë folësit, por edhe rritjes së shprehësinë së tekstit dhe, siç shprehet Xhevat Lloshi, “për këtë kërkohet mbështetja edhe e mjeteve të tjera të tekstit, si p.sh, ndërtimi sintaksor, situata e përgjithshme e kontekstit ose befasia e kundërvënies. Jep dorë për të theksuar diçka sidomos kalimi i menjëhershëm nga një pol te tjetri dhe nxjerrja në pah e një kundërvënieje që

zakonisht nuk vihet re. Figura që përftohet atëherë quhet antitezë.”⁵⁸ Te Kuteli gjejmë plot raste të antitezës, çka e përforcon artistikisht tekstin, për shembull:

Ç’të keqe mund të na bëjë kjo vashë e nusëruar po e pamartuar, sikur t’i tregojmë fuqinë? Ajo është **njeri**, ne jemi **zana**; ajo e dheut ne të **qiellit** e të dheut; ajo **robinjë**, ne **zotëresha**. (Vepra 4, f. 67); Fundi i fundit, përse ata të mbeteshin **faqekuq** si molla, kurse ai, beu hanedan, **të zverdhej e të thahej** dita ditës? Ata të **rronin** e ai të **vdiste** ë? Kështu bëri edhe Xheladin beu: i sollën një çupë të mitur (sa më e mitur, thoshin, aq më e mirë është për bejnë, se të miturat e kanë gjakun e **hollë**, **të valë**, dhe gjaku **i hollë** dhe **i valë** e hollon, e ngroh dhe e pastron gjakun e **trashë**, **të ftohtë**. (Vepra 1, f.67); Jo **nuk e rrëmbeu**, po **u rrëmbyen**. Çupa desh e iku. (Vepra 1, f. 200); Të mirë e **kam**, po të mirë mos e **paça!** Eshtë e mbyllur, domuze, s’i qesh buza. (Vepra 3, f. 418); Pra sikush të shikojë punën e tij: unë **mbi dhe**, ti **nënë dhe**. S’kam kohë të vdes, se dua të mbloj çupat e botës: **të shaj të bukurat**, **të lëvdoj të shëmtuarat**, se këto i kanë sëndyqet plot me pajë. (Vepra 3, f. 457) etj.

Antonimet në veprën e Kutelit, siç thamë më lart, janë të larmishëm, por do t’i analizojmë vetëm në dy aspekte: në aspektin strukturor dhe në aspektin e shkallës së kundërvënies duke u ndalur veçanërisht në nëntipat më të parapëlqyer të tij.

a. Antonimet sipas aspektit strukturor:

-Në prozën e Kutelit mbizotërojnë antonimet me bashkërenditje, ku më së shumti lidhjet realizohen me anë të lidhëzave këpujore *-e, -dhe* dhe më pak me lidhëzat kundërshtuese *por, kurse, prandaj*, apo me lidhëzat veçuese *a, apo, ose* etj. Për shembull:

- Me lidhëzat *e, edhe*: Në fillim galat **u trembën dhe u ngritën** me krokërima, **po pas pak u doli frika dhe zbritën** prapë, pas kermës. (Vepra 1, f. 140); Udhës u ranë pas shumë njerëz, **të mëdhenj e të vegjël**, që pyesnin: “Ç’është ky kapedan me dyfek të gjatë si njëherë e një kohë. (Vepra 1, f. 162); Domosdo, kishin edhe dasma, **të hyra e të dala**, që donin shumë miell për bukë. (Vepra 1, f. 165); Edhe kur Gjatollinjtë hidhnin rromuze **posht e lart**, duke thënë se i kish buzët me qumësht e nuk mund të matej me ta. (Vepra 1, f. 183); ...Gjatollinjtë vozitnin pa drojtje mes për mes Shëmërtisë së Sipërme, **tundu e shkundu**, me armët e Sefedinit në krah e në brez. (Vepra 1, f. 186); U lëkunda sa u lëkunda midis **gjumit e pagjunit** në përrallën e atyre tri çupave të mullixhiut. (Vepra 2, f. 131); U gëzua gjithë miqësia, **afër e larg**. (Vepra 1, f. 186); Shko burrë në Korçë, të shikosh pazarin e qepëve, **si shiten e si blihen**.(Vepra 3, f. 479) E shponin në zemër, si tryelë, gozhdat e opingave të Gjatollinjeve , që **shkonin e vinin** aty, mbi udhë, me armët e Sefedinit në sup. (Vepra 1, f. 188); Kështu tërë ditën, **ngjit e zbrit**, qëkur dilte dielli tutje në det, sa një rrotë i kuq, e gjer perëndonte, gjene sa një rrotë, gjene i kuq, po në fushë. (Vepra 3, f. 483); Unë kam ardhur këtu **të marr e jo të jap**. (Vepra 3, f. 489); ...ata luajnë me ju, ju luani me ta, **lodhi e çlodhi**. (Vepra 3, f. 82); Ama

58 . Xhevat LLoshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë 2005, f. 134.

as vetë s' di se kujt ia ka frikën më shumë: hijes lozonjare të lisit që **paloset e shpaloset** nëpër skërka, apop hijes së plakut që tretet në plloçë. (Vepra 3, f. 457); Bëjnë të **fluturojnë e s'fluturojnë** dot. (Vepra 4, f. 70); E kështu, **hyr e dil, bjerë e ngrahu**, të lodhur nga noti (Vepra 2, f. 259); Po Korobeshi s' e le të mbarojë fjalën: **kapsit e ç'kapsit sytë, bën be e rrufe**. (Vepra 4, f. 477); Sa për dinin, që thua ti, **e kam e s' e kam**, se jo vetëm që s' falem, po edhe e pi rakinë. (Vepra 1, f. 274); Asllani nuk u përgjigj. Tundi kryet; **edhe merrte vesh, edhe s' merrte**. (Vepra 1, f. 304); ...kështu e shtyn të veprojë jo **mendja por çmendja, marrëzia**. (Vepra 3, f. 39); I bir, i mbret më kërkon çupën nuse. **T'ia jap a të mos ia jap**. (Vepra 4, f. 450) etj.

-Me lidhëzën as: Kur e kur zonja dhelpër i thërret: "**Në të djathtë, o im zot! Jo në të mëngjër! As në të djathtë, as në të mëngjër**, shko përpara. (Vepra 4, f. 307); Me bejnë s' isha **as mirë as keq**. (Vepra 1, f. 302); Kur s' kish kë të pyeste i afrohej pragut e thosh me zë **as të lartë, as të ulët**: Nëno! Ku je? (Vepra 1, f. 136); Ndoni ishte një fshatari im: **as i mirë as i keq, as i pashëm as i papashëm, pra as kështu as ashtu** – dua të them njeri si gjithë bota. (Vepra 1, f. 326); Beu s' ia prishi **as një rës palë, as tjetrës**. (Vepra 1, f. 303) etj.

Në rastet kur në vend të lidhëzave e dhe dhe përdoret viza lidhëse, dy fjalët antonimike funksionojnë si një fjalë e vetme, si për shembull:

Në Thesali babai kish punuar shumë vite. **Vinte-kthehej; vinte-kthehej**. (Vepra 1, f. 138); **Mustaqet i fryhen e i shfryhen në dritën e kandilit, lart-poshtë, lart-poshtë**. (Vepra 1, f. 294) etj.

Në disa kontekste kundërvënia del edhe nëpërmjet lidhjeve bashkërenditëse të togjeve antonimikë. Shprehësia e tekstit në këto raste rritet, kur lidhjet antonimike të fjalëve krijojnë trope, si për shembull:

E ëmbël është e bardha rini, e hidhur është e zeza pleqëri. Sepse rinia çan stuhitë me hovin e shpirtit e të krahut, **shemb të keqen e larton të mirën, e bën të mundur të pamundurën**.

Rini, të falem.

E **bardhë** je, e **bardhë** qofsh! (Vepra 4, f. 136); **Mbeç shëndoshë, Halil! – Vafsh shëndoshë, qyqe**. ... Shporru moj qyqe, **qofsh e zezë!** ... Fol, qyqe, **qofsh e bardhë!** (Vepra 4, f. 183); Grumbulli- **gratë përpara, si ca pata, burrat prapa, si ca patokë, dhe fëmijët sehixhinj pas tyre –ktheu në të djathtë, në cep të kopshtit të Lakes e ia mori tatëpjetë**. (Vepra 1, f. 322); **Rropatu, o plëncbosh; llup, o plëncplot** (Vepra 1, f. 302); Ajo mbeti gjithë asaj nate, **më shumë pa shpirt se me shpirt**. (Vepra 2, f. 310); E pinte ditë për ditë e çast për çast, si thotë ai që bën vjersha, me dy pagure të mëdha që i mbante në brez si kobure karadaklli: **një zbrazej e tjetra mbushej**. Në lëmën e rakisë kjo koburja çifteli shkante kazan më kazan për të dhjetën: **shkante bosh e kthehej plot**. (Vepra 2, f. 281); Ia merr vrages. **Një kaproll i prin përpara, një kaprolle i vjen prapa**. (Vepra 4, f. 453); Ata e duan mbretin e tyre plak, sepse, thonë është i drejtë, dorëgjërë e zemërbardhë, **i pari në sulm dhe i fundit në**

tërheqje. (Vepra 3, f. 144); ... *kjo e dinte vetë udhën me të ngjitura e me të zbritura dhe plot të kthyer mbi shkëmbinj e nën shkëmbinj.* (Vepra 3, f. 150); ... *Xha Martini fillon të na tregojë ca ngjarje nga të moçmet – as shumë të afërme po as shumë të largme.* (Vepra 1, f. 207); *U end shumë kohë si gjysmëlypsar duke bluar me zë e pa zë, me mendje ndonjë varg misogjin të Hesiodit.* (Vepra 3, f. 44) etj.

Në veprën e Kutelit shfaqen edhe lidhjet sintagmatike me nënrenditje, ndonëse në një numër më të vogël. Për shembull:

... *i pasuri që ish i varfër fort.* (Vepra 2, f. 216); *Kur ish për të lindur një foshnjë, nusja ra e vdiq.* (Vepra 2, f. 307); *Të mëdhenjtë bënë buzën në gas, ndërsa ne vegjelia gajasëm, sepse të qeshurat e të qarar i kishim në xhep, të përziera e i nxirrnim lumë me shkak e pa shkak.* (Vepra 2, f. 128) etj.

Nuk mungojnë antonime e lidhura në mënyrë asindentike. Për shembull:

Komi ra përdhe gjysmë i gjallë, gjysmë i vdekur. (Vepra 2, f. 307); *Pasnesër do të nisemi pa gdhirë: ti përpara, unë prapa.* (Vepra 4, f. 306) *Unë, ore, ju flas me të drejtën e zotit, me dorë në zemër, se ja, u thinja e sot jam, nesër s'jam, e s'dua të shkoj matanë me një gur mulliri në qafë.* (Vepra 1, f. 175); *Fija u ngrys, u çel sërish. Sytë i qeshën.* (Vepra 3, f.442); *Ehu, sa Amerika ka në botë. E bardha një, e zeza dy.* (Vepra 3, f. 486); *E thërresim me përgjërator në vogëli, e thërresim me mall në të ri, e thërrasim me dhembje në pleqëri, sidomos atëhere kur vuajmë.* (Vepra 1, f. 140); *Ajo mbush, ai zbraz; ajo mbush përsëri, ai zbraz përsëri, gjersa dora nuk i dridhej fare e syri nuk i gabonte.* (Vepra 1, f. 187) etj. Në shembujt e mësipërm vërehet se lidhjet realizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa praninë e ndonjë fjale tjetër ndërmjet tyre, por ka dhe raste të lidhjes së jodrejtpërdrejtë, pra, kur midis fjalëve antonimike hyjnë gjymtyrë të tjera.

Antonimet shndërrohen në stilema, pra rrisin vlerat e tyre stilistikore sidomos, kur ato vendosen pranë njëra-tjetrës, për shembull:

Mirëpo shkuan vjetët njëri pas tjetrit, kaloi e bardha rini, kaloi e bujshmja burrëri, pllakosi e zeza pleqëri. (Vepra 4, f. 136); *Në hënë të re magjistricat hyjnë në varre kaluar ... për të mbyllur e për të çelur, për të lidhur e për të zgjidhur, për të mbërthyer e zbërthyer.* (Vepra 2, f. 300); *Ditën rrinte në varr, me të vdekurit, natën në shtëpi, ne e shoqja. Javitej sapo errej e tretej në mugëtirë. Fshati tërë, i madh e i vogël, rrinte ndajnatave e mëngjeseve në dritare të shikojë si vinte e si shkonte Zefi. Herë si flakë, herë si napë e bardhë, herë si njeri.* (Vepra 2, f. 312); *Plaka ra në të thella: e hodhi e priti me mendje, dha e mori natën e ditën.* (Vepra 1, f. 189); *Si mund të rrinte duarkryq në mes të kësaj bote, ai, djalë i njomë, po zemërfortë, që e kish zbrazur kaq herë dyfekun.* (Vepra 1, f. 190); *Të nesërmen, toga me kumandar Sefedinin në krye u ngrys e s'u gdhi.* (Vepra 1, f. 200); *Se kështu është kjo botë merr këtej e jep andej, në do të marrësh, duhet të japësh.* (Vepra 1, f. 249); *Qenka e bukur si Hëna. Mua Hënë më duhet, se Diell jam*

vetë. Mirëpo çupa rri tërë ditën brenda, **vish e zhvish fustanët e mëndafshhtë.** Unë **digjem e përvëlohem** në qiell, ajo **dëfren** poshtë e **s'ma var fare.** Si t'ia bëj hallit. (Vepra 3, f. 447) e **Të pata ditur e nuk të pata ditur.** (Vepra 3, f. 171) etj.

Te Kuteli nuk mungojnë as oksimoronet, rastet “kur fjalët antonime vendosen jo pranë, por në lidhje gramatikore me përshtatje apo varësi.”⁵⁹ Për shembull: Tete Ngjelua ishte një **plakë e pamplakur**, ndonëse afër të gjashtëdhjetave. (Vepra 3, f. 415); Natën **vëzhgoi i pavëzhguar**, i erdhi qark shtëpisë. (Vepra 3, f. 42) etj.

Antonimia është e pranishme edhe në sentencat, në proverbat apo urimet e mallkimit: **I miri me të mirin, i ligu me të ligun.** (Vepra 3, f. 304); **Mishit të piqet, helli të mos digjet.** (Vepra 3, f. 48); **A mos ky është lajmi që sollën galat e krillat? Ky qoftë, tjetër mos qoftë.** (Vepra 3, f. 50); **I pari në sulm, i fundit në tërheqje.** (Vepra 3, f. 144); **Po të gjesh udhës një gjarpër dhe një kobtar – gjarpriin fale, kobtarin vraje.** (Vepra 3, f. 216) etj.

b. Antonimet sipas shkallës së kundërvënies

Duke u mbështetur “në karakterin ose në shkallën e kundërvënies së kuptimeve nga ana semantike, fjalët antonime shqipe mund të jenë të mirëfillta ose jo të mirëfillta.”⁶⁰ Dihet, gjithashtu, se nuk ekziston një kufi i prerë midis këtyre dy grupeve. Kuteli, nga ana e vet shfrytëzon mjeshtërisht mundësitë pa kufi të gjuhës për të krijuar kundërvënie konceptesh, idesh, kundërvënie ngjarjesh e dukurish, kundërvënie gjendjesh etj., të cilat janë aq të pranishme në jetën e njeriut dhe të universit në përgjithësi. Ai krijon kundërvënie të mundshme, qoftë në rrafshin e leksikut, qoftë në atë të semantikës, po kështu mënyra se si ai i aktualizon në prozën e vet, flet për aftësitë e tij të veçanta edhe në këtë drejtim. Antonimia shfaqet e pasur jo vetëm si sasi, por edhe si larmi dhe si cilësi. Ajo shpreh marrëdhënie semantike të kundërvënies jo vetëm në rrafshin leksikor, pra ndërmjet fjalësh, por edhe ndërmjet shprehjesh e situatash të ndryshme gjuhësore. Është pikërisht shtrirja e gjerë antonimike, mosmbetja në kufijtë e frazës, ajo që i bën mbresëlënës blloqet e teksteve kuteliane. Duket se për Kutelin mundësitë e kundërvënies janë të pafundme, ndaj provon të antonimizojë në kontekste të caktuara, deri edhe fjalë të cilat përbërësi kuptimor i përbashkët është i largët, madje i skajshëm.

Prania e antonimeve sidomos atyre kontekstuale rrit shprehësinë dhe cilësinë artistike të ligjërimit dhe këtë e tregojnë shembujt e mëposhtëm:

... **Xheladin beu kish në dorë bukën e kopaçen.** (Vepra 1, f. 65); **Drithë bluajmë, bukë s'gatuajmë.** (Vepra 1, f. 301); **U dëgjua një zhuzhërimë e butë dhe pastaj një trokëllimë e thatë.** (Vepra 3, f. 13); **Dheu unjeje e ngrihej, unjeje e ngrihej, si një lundër e madhe ndër valë. Malet herë binin poshtë, fundoseshin sa s'dukeshiun fare, herë kërcenin lart, si ca pela të hazdisura,**

59. Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f.135.

60. Miço Samara, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985, f. 178.

me kripfat në erë. (Vepra 1, f. 126); Si **mbaroi** punë, i **hipi** mushkës thundërmadhe dhe **ngau** për në Enkelanë. Digjte djelli i verës, digjte djersa e valë, po bletari nuk e çlironte mushkën që t'ia merrte me hap. Përballë tij **vinin** kalorës që **iknin** si shigjetë; nga rrapa **vinin** të tjerë kalorës me kuaj më të shpejtë se sa mushka – e **arrinin**, e **linin**. Bletarit të lodhur i buçisnin veshët, i digjej fyti, i visheshin sytë, që ia përvëlonte djersa e kripur. Dhe nuk e **ndalte** mushkën. Në këtë **vrap** të çmendur **xhingërinin** pa pushim filipët e artë dhe të argjendë. **Sa i bukur ishte vendi, po sa i zymtuar ishte shpirti i Anylës!** Ai, njeriu paqësor, që një jetë të tërë **kish rritur me dashuri bletë**, vetëm bletë (dhe kur u këputej filli i jetës nuk thosh “ngordhën”, po “vdiqën” tani **kish vrarë njerëz** dhe nuk i kish bërë tërr veshi. (Vepra 3, f. 153); Hej, hej! **Dashuri**, të qofsha falur. ...Ka të drejtë poeti që thotë se dashuria është perëndia më e fortë se të gjitha perënditë. Dhe pas pak: “Oh, dashuri, dashuri! Ti je si zjarri. **Brenda teje njeriu digjet; larg teje – mardh e bëhet akull.** Unë jam **djegur dikur dhe tani kam mardhur i tëri.**”

Nga **poshtë u dëgjuan** edhe dy a tri **britma** të tjera: “Etleva!” “Enkeleu” – pastaj **heshtje**.

Befas Edipi **u err**, ndaj pa **lart** mbi brinjët e malit, një tufë galash që kaluan duke krakëritur e duke përpjekur krahët si hije **ferri**. “Oh, - tha, - pas **gazit të madh** do të kemi një **hidhërim më të madh**. Kështu thotë fluturimi dhe krokërima e shpesëve. (Vepra 3, f. 17); Për **këtlëkun** e këtyre të mallkuarve lekë qahen mushterinjtë e, meqë s’kanë nga t’ia mbajnë ia nxjerrin dufin Tilit e i thonë “spicer”, “frëng” e sa e sa nofka të tjera. Dhe, meqë qahen ata që kanë, pra qahet dhe Ago Zylali, që **ka sa të çahet** dhe **vë pare të reja** mbi të **vjetrat**. (Vepra 1, f. 264-265) etj.

Ndër tipat antonimikë më interesantë, për shkak të vlerave stilistikore që mbartin, janë lidhjet ndërmjet fjalëve të përbëra, si: **kokëlartë – kokëvarur**, **gojëkyçur**, **gojëmbyllur – gojëhapur**, **zemërgur – zemërgjerë**, **barkplot – barkbosh**, **plëncplot – plëncbosh**, **mullëmadh – mullëvogël**, **shpirtnjeriu – shpirtdrej**, **dorëngushtë – dorëdhënë**, **faqezi – faqebardhë**, **laga – thata**, **duarplot – duarthatë**, **sisëplot – sisëvarur**, **kiskëhollë – kiskëtrashë**, **gojëprishur – gojëmbël** etj.

Vlerat estetike të buruara prej antonimisë kontekstuale rriten veçanërisht, kur ajo merr karakter sintaksor, pra, kur strukturohet në formë fjalish apo frazash, për shembull: **Kur s’e priste njeri, u hap dera e hyri shlllop-shlllop Loli me Lolevicën: ai thatok, i shkurtër, i parruar, i përcëlluar, me rroba të shamshallo, me opinga llastiku; ajo e gjatë, e plotë, e bardhë, e bukur, veshur me lezet.** (Vepra 4, f. 476); **Ai bën qymyr të zi, por zemrën e ka të bardhë.** (Vepra 3, f. 144); **Po u punonte mendja: Të paqënë e bejëjnë të qënë, të pabërën - të bërë.** (Vepra 3, f. 266) etj.

Në përfundim, themi se antonimet kontekstuale në veprën e Kutelit kanë përparësi në krahasim me antonimet e mirëfillta, dhe kjo është më se e natyrshme, po të kemi parasysh qëllimet stilistike të tij. Edhe në fushën e

antonimisë, ai shfaqet si shkrimtar që ka njohje të thella të gjuhës, si shkrimtar që di të rrisë nivelin ideo-artistik të veprës së vet, duke përdorur përveç modeleve të njohura edhe modele origjinale kundërvëniesh kuptimore, duke kontribuar kështu në pasurimin e shqipes.

2.5. Dialektalizmat e huazuar

Është e qartë se gjuha shqipe mbart në vetvete një numër të konsiderueshëm fjalësh të huaja, kjo jo për dobësi të saj, jo për mungesë aftësie për t'ju përgjigjur realiteteve e zhvillimeve, por si rezultat i natyrshëm i marrëdhënieve të saj të ndërsjella me gjuhët fqinje, apo si rezultat i një bashkëjetese të gjatë për arsye pushtimesh, siç ishte pushtimi turk. Kështu, “*në fjalorin shpjegues të shqipes (1980) gjejmë afërsisht 8000 fjalë të huaja.*”⁶¹ Gjithashtu, fqinjësia bën që shumë fjalë të huaja të hyjnë e të gjallojnë në nivel krahnor e dialektor, ndaj në veprën e Kutelit ato do të jenë të pranishme, por gjithmonë në masën e duhur, pa teprime, në varësi të temave dhe subjekteve të tregimeve të tij, në varësi të kontekstit të tyre historik, të origjinës, kulturës, psikologjisë dhe mendësisë së personazheve etj. Për shembull ka një sasi më të madhe të fjalëve të huaja (turqizmeve) në prozën “*Vjeshta e Xheladin beut*”, se sa në prozën “*Lumi i madh*” apo “*Xinxifillua*” e kështu me radhë. Sipas sasisë së përdorimit, në vend të parë në veprën e Kutelit qëndrojnë orientalizmat, të ndjekura sipas radhës nga sllavizmat, greqizmat, neolatinizmat, fjalët arumune etj., të cilat shfaqin më shumë interes në përdorimin e tyre në funksion të efekteve stilistike. Fjalët e huaja kthehen në përftesa e i rrisin koloritin ligjërimit kutelian, sidomos, kur përdoren të grumbulluara me shumicë në një kontekst të caktuar, për shembull:

Ja këtu ky Moni i Dhores që i kollej në sy (jo për gjë tjetër, por për të ecurit e saj qibar, me kokën lart, si pisërënga), ja aty ky Nuni i Zados që rrinte ta ruajë, që së largu, kur hyn e del në skoli (për njetë bufanton e saj si korje gjemie) e sa e sa të tjerë axhami e pleqëri.

Këto të gjitha janë sende që i mësova më vonë e që as më shkonin në mend kur mësoja alfavitat (Vepra 2, f. 108); Shiko, shiko, efnm, ç'bereqet bëka çifligu i Këlpishtes e unë s'ditkam gjë. Hyrije e zbritur nga xheneti! Po t'ia dërgoj padishahut më bën menjëherë pasha. Jo, s'më duhet pashallëku! Imja është e do ta mbaj vetë. Do ta marr që tani! Sonte në jatak. (Vepra 1, f. 94); Harbutët hahen bashambash me parësinë. Shkon një çunak në Tiranë për të bërë ushtrinë e kthehet azgan, si qen me katër sy, mban botën nëpër gojë: jo po ky merr rryshfet, jo po tjetri vjedh. (Vepra 1, f. 288); E meqë ra fjala për shlivën më ka rënë në vesh se ka nxjerrë ai igumeni i Shëndaumit një shlivë tri herë të zier, që sa e pi, të duket vetja kral e sikur fluturon përmbi Drim e gjer mbi Mal të Thatë. Se Papallazua e ka këtë të mirë: ujin e ka për najazmë,

61. Emil Lafe, *Vendi i orientalizmeve ndër huazimet e shqipes*, Studime filologjike, 1-4, 1993, f. 35

shlivën për të pirë. Po kurrë nuk i përziën të dyja bashkë. Shliva veç, uji veç – ti zgjidh ç’ të duash. Nuk përzihet njëra me tjetrën, si nuk përzihet xheneti me xhehnemin, as dita me natën e as tregtari me njerinë e drejtë. (Vepra 2, f. 270); “Vllahia u ka mbetur syleshëve të Mokrës, që shkojnë kumpanjë Shëngjergjit, me çekan e me mistri në dorë e me tri kacidhe në qese, që s’bëjnë as për të larë borxhet e udhës”, - thosh fshati.

Po as unë, as Çuli me pantallonka si shallvare halldupi, nuk ishim syleshë!

Veç kësaj:

“Ç’ të kërkoni, o burra, në Vllahi, kur e di gjithë bota se Vllahinë e ka bërë batall vetë Trifun-Kasapi, që i ka mustaqet si presh, gjer në vesh, dhe mban në silahe pesë thika e dy masatë nga ata të Stambollit. (Vepra 2, f. 238) etj.

Orientalizmat, ndër to kryesisht turqizmat, zenë vendin e parë në leksikon e shqipes për arsye të pushtimit të gjatë pesëshekullor turk. Shumë prej tyre janë bërë pjesë fundamentale e shqipes, por neve nuk na intereson kjo kategori. Me interes janë ato orientalizma, të cilat kanë fjalët gjegjëse në gjuhën shqipe dhe që në letërsinë artistike përdoren për të krijuar vlera stilistike-shprehëse. Te Kuteli, vlera të tilla krijohen nëpërmjet kundërvënies stilistike, si: *bisedoj-llafosem, vëllam - byrazer, sevda – dashuri, pazar – treg, vegla - qojle, i varfër - fukara, fytyrë - surrat, i vrenjtur - domuz, trim - azgan, shpirt – xhan, birth – evlat, i shëmtuar – batall, bark - plënc, fjalë – llaf, botë – dynja, shëronjës – xherah* etj. si dhe nëpërmjet antonimisë.

Në veprën e Kutelit gjenden dendur turqizma, të vëna si në gojën e personazheve, ashtu edhe në gjuhën e autorit. Të vëna në gojën e personazheve, ato shërbejnë për karakterizimin e tyre, duke pasur parasysh këtu origjinën, kulturën, shkollimin, punësimin, mendësinë, psikologjinë apo filozofinë e tyre, ndërsa arsyeja pse ato vihen në gojën e autorit, është sepse dhe ai “ndihet i detyruar” t’i përshtatet atmosferës së përgjithshme gjuhësore. Nga ana tjetër atij i duhet t’i përdorë turqizmat si mjete gjuhësore në përshkrime apo portretizime personazhesh, si dhe për ngjyrosje historike. Për shembull:

*-Në gojën e autorit: **Beu** mbajti pranë tij vetëm disa pak burra nga parësia, me **qosteqe** e pafta argjendi në gjoks e “**peqepeqe**” në gojë. Këtyre u hodhi vëp e vëp nga një cigare të **hazërtë**, që ishin shumë të mira sepse i kish dredhur vetë Sheqerja me pështymën e saj. (Vepra 1, f. 91); U desh Olloman beu t’i dërgonte **imdate** e **peshqeshe** **Baba Dvletit**, **vezirit** a **pashait**, që ta forconte vulën, një muaj të tërë. Kërciste dita me ditën **dajaku** mbi kurriz të **rajasë – kurbetlinj, zanatçinj, tyxharë, bulq** – që t’i kthenin **mahmudetë** e **mexhitet** e bardha me turrën e **dvletit**, se tërë paraja e tërë vendi, mal e fushë qenkëshin të **sulltanit** edhe ai ua lënka sa kohë të dojë vetë njerëzisë e ua marrka kur t’i shkrepë qejfi. Edhe pastaj, kur njerëzia rrinin brenda që të shëronin plagët, gjysmat e parave shkonin me karvan në **haznë** të Stambollit,*

së bashku me **qojlet** e me nja dy a tri vasha të bukura majë kalit. Këta i kishin rrëmbyer **zybat** e beut me urdhrin e beut, që ia dërgonte **peshqesh padishahut**. Edhe, si shpërblim, i vinte një **ferman** i madh nga Stambolli që ia forconte rrënjët e ia madhonte vulën. (Vepra 1, f. 212)

-Në dialogjet ndërmjet personazheve: *Dhe këtë punë agai ia mban vëth në vesh. “Edepsëz njeri! – thotë – Hajvan për të lidhur në grazhd. Mua të më kërkojë paret në dorë? Më ka marrë erzin ditën e pazarit, përpara gjithë botës.* (Vepra 1, f. 265); *Kardashër, mos dëgjoni dinsëzët e imansëzët.* (Vepra 1, f. 144); *Ush, gjeçi belanë, se u vonuam* (Vepra 1, f. 265); *Rri, o Ago Hajro, sonte, të llafosemi.* (Vepra 2, f. 300); *Vallahi, mua s’më ke këtu, o Postol.* (Vepra 3, f. 353); *- Pse, a s’më hëngri një vit kaq okë qepë? ...Senetet i mban sikush në xhep, ata nuk digjen kollaj.* (Vepra 3, f. 424); *Po qemerë si e ka* (Vepra 3, f. 464); *Ç’t’i pyes, ç’t’i viranos.* (Vepra 3, f. 478); *Ke xheza nëntë kupa.* (Vepra 2, f. 290); *Hej, unë i mjeri, mua m’u ngjirr zëri së foluri, e ata më nxjerrkan nafaize.* (Vepra 2, f. 280); *Mbaje vëlla se na u bë rakia bajat.* (Vepra 2, f. 277); *S’bëri hair në Vllahi, do të bëjë këtu.* (Vepra 3, f. 481); *S’janë gjë, hallexhinj: kasaballinj fshatarakë. Ndofta, kanë ardhur të qahen. - Të qahen, efnm? U thuaj të flasin me Zykon. Sot jam zaif.* (Vepra 1, f. 87) etj.

Për të treguar kulturën, origjinën, psikologjinë e personazhit, disa herë, Kuteli vendos në gojën e tij fjali të tëra në turqisht, për shembull;

Buçet zëri i Onbashit: “*Hazër-oll!!!*”, “*Rahat-oll*”, “*Saabak*” dhe pastaj: Dhe përsëri: “*Hazëroll! Ilderem, marsh!*”. ...Turqit këndojnë: “*Ordumëz eti jemin / Titraqi haq i-zimin*”. (Vepra 1, f. 130-131) etj.

Në prozën e Kutelit përbëjnë një grup të rëndësishëm termat orientale politiko-administrativë, apo termat që lidhen me luftën, me anë të të cilave ai arrin të japë me vërtetësi e besnikëri realitetin e kohës për të cilin shkruan, të tilla janë: *adëm, asqer, bimbash, bumbashir, dhjetar, dyfek, çauash, ferman, grosh, hyriet, jeniçer, kadi, kaza, kordhë, mahmude, mexhit, myteber, nizam, padishah, redif, sefer, sultan, tabor, terxhuman, veqil, vergji, xhelep, zadrazem, zaptije* etj., të cilat janë të vjetruara dhe tashmë konsiderohen si historizma.

Një grup tjetër turqizmesh përbëhet nga fjalët e ligjërimit bisedor, të tilla si: *afedersën, ashiqare, bedel, birinxhi, biçim, darovë, defter, derexhe, derman, domuz, dyme, çingi, efëndëm, gazep, gjyzel, haber, hair, hallall, hanedan, hile, ishallah, jarebi, javash, kabull, qosele, katarr, lepe, mashallah, muhabet, niqa, peqe, qafir, rahat, rromuz, safi, sagllam, tekayt, tepelek, xhahil, zaif* etj. Huazimet e lartpërmendura, në shumicën e rasteve, marrin nuanca të forta emocionuese vlerësuese, si tallje, sharje etj. Për shembull: *Përpara çanin udhë pesë a gjashtë biçim burrash.* (Vepra 1, f. 313) etj.

Te Kuteli nuk mungojnë as njësitë leksikore që kanë të bëjnë me kulturën islame, si: *avdes, rahmet, xhehnem, xhenaze, xhenet* etj.

Jani Thomai shprehet se “*në letërsinë artistike e humoristike turqizmat hyjnë si elemente të ligjërimit dialektor dhe shpesh përdoren për të*

arkaicizuar gjuhën, si kërkesë stilistike.”⁶² Në këtë funksion përdoren edhe fjalë të tjera orientale të vjetëruara, si: *asgan, ashik, asllan, bandill, selvi, sevda* etj. Për shembull:

Ago Zylali ...me mendje tha: - **Medet**, ç’u prish bota! Të rinjtë s’ua varin pleqve; **harbutët** hahen **bashambash** me parësinë. Shkon një çunak në Tiranë për të bërë ushtrinë e kthehet **azgan**, si qen me katër sy, mban botën nëpër gojë: jo po ky merr **rryshfet**, jo po tjetri vjedh. (Vepra 1, f. 288) etj.

Në veprën e Kutelit sjellin vlera stilistike dhe ngjyresa emocionuese e vlerësuese edhe fjalët turke të krijuara me anë të prapashtesave *-eshë -llëk, -xhi* etj., si: *agallëk, arallëk, atllar, axhamillëk, delenxheshë, delenxhi, duvaxhi, kallauzllëk, kasaballëk, kumarxhi, këtlëk, pazarllëk sehirxhi, seitllëk, toptanxhi, turqllëk, tuxharllëk, xhymertllëk, zaptillëk* etj. Për shembull:

Zaptije ka qenë, **zaptije** ka mbetur. **Zorraxhi** ka qenë, **zorraxhi** ka mbetur. (Vepra 1, f. 323); Për **këtlëkun** e këtyre të mallkuarve lekë qahen **mushterinjtë**. (Vepra 1, f. 264-265) etj.

Si të tilla, dallohen edhe disa fjalë me nuanca të qarta të përçmimit e talljes, si: *edepsëz, halldup, jezit, kodosh, qafir* etj. Për shembull: *Mbetën ta zgjatin vetëm krushkat, me Pasikën e nusëruar e me atë katandisëz maçok.* (Vepra 2, f. 172) etj.

Grumbullimi në tekst i shumë turqizimeve, pra, përdorimi në tufë i tyre, rrit akoma më tej vlerat stilistike e shprehësinë e tij. Për shembull:

Gjyshi ynë ishte **furrxhi** e mirësia vetë. i jepte bukë të miri e të ligu, me **grosh** e pa **grosh**, me çetele e pa çetele, me gjysmë fjale. Bota i thosh me të qeshur “**furrxhiu i hapsanikëve**”, se me të vërtetë mbante me bukë shumë nga ata që **kajmekami** e **kadiu** i kishin hedhur në **hapsanë**. I dërgonte fjalë ndonjë nga ata që i mbante brenda: “O **furrxhi**, unë jam **filani**, i biri i **filanit** nga **filan** fshat. **Hyqymeti** më ka futur **haps**, se gjoja paskam qenë **jatak** e i paskam dhënë bukë **filan kapedani**, që ti ndofta e njeh, ia ke dëgjuar emrin. Mua më kanë thënë se ty të kam mikun e mikut të mikut. Mbamë me bukë ca kohë, pa kur të dal të paguaj. Në mos dalça të paguan djali a ndonjë tjetër...” Edhe gjyshi i dërgonte ditë për ditë një a dy **karvane** bukë sipas punës. Kur i kish dora i dërgonte edhe ndonjë mëshere djathë, një poçe me fasule të ziera në **furrë**, ca qepë e piperka, një këmbë mish të pjekur, për të nxjerrë mallin e stanit. Po **hapsanikët** s’ishin një e dy. Ishin të shumtë. Ca i kishin marrë se s’paguanin **xhelep**, ca të tjerë se s’paguanin **yshyr**, ca për duhan **kaçak**, shumë për **jatak** e për **borxhe** – e të gjithë se u kishin vënë **dylfekun zaptijeve** të turkut e i kishin gërmuar si lopët nga fshati, nga stani. Më vonë s’di se si **Hyqymeti** e kish zënë me të pabesë, **gafil**, kur kishin zbritur **teptil**, për të shitur e për të blerë, a për ndonjë mall tjetër, e i kish hedhur brenda. Domosdo, në këtë punë kish pasur gisht **hafija** e **kallauzi**, që shpirt mos paçin. (Vepra2, f. 119) etj.

62. J.Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 44-45.

Turqizmat mund t'i gjejmë edhe në disa proverba apo urime të tilla, si: *Fshati që s'duket s'do kallauz* (Vepra 2, f. 280); *Paraja heq paranë* (Vepra 1, f. 286); *Hallall e paç* (Vepra 1, f. 295) etj.

Përsa i përket sllavizmave dhe greqizimave, dihet që ato kanë karakter më të ngushtë krahinor, sepse lidhen me fqinjësitë gjeografike të krahinave të ndryshme. Një rol të rëndësishëm për praninë e tyre në veprat letrare të Kutelit luan detyrimisht vendlindja e tij, si dhe raporti i tij me gjuhën. Kështu, në veprën e Kutelit paraqesin më shumë interes sllavizmat e greqizmat që kanë karakter të theksuar krahinor (të cilat në çdo rrafsh diskutimi janë më të shumta në numër), se sa ato që i kanë kapërcyer këta kufij. Si të tilla janë sllavizmat: *astragaç, belbicë, belicë, belushkë, branë, dobrovoliat, gallof, galë, glavinë, gllavinë jaz, kllanik, lesë, lisnik, listopadh, lubis, opingë, rabeckë, rakitë, rebrë, robtohem, selishtë, shlivë, stërvinë, travinë, voshtin, ulicë* etj. Këto fjalë dalin si emërtime të dukurive, sendeve, gjallesave të cilat nuk njihen në krahinë të tjera dhe, prandaj realizojnë një ngjyrosje të koloritit mjedisor lokal.

Ndonjëherë përdoren edhe sllavizma të deformatuara qëllimisht nga autori për të bërë ironi: *U bë puna si në kohë të Serbit të parë, kur e bënë preshanik Vasil-dhaskalë*. (Vepra1, f. 273). Këtu, sllavizmi *presdenik*, që do të thotë *kryetar bashkie*, është kthyer në *preshanik*. Nuancat vlerësuese keqësuese dalin qartë, po të analizojmë mënyrën e fjalëformimit të këtij neologjizmi: *pres* + *prapashtesa -nik*.

Në prozën e Kutelit vijnë si krahinorizma edhe greqizmat, por në një numër më të vogël. Edhe ato përdoren ashtu si huazimet e tjera për të krijuar efekte stilistikore, për të karakterizuar personazhin, për të ironizuar etj., si të tilla janë: *llukando, filaqi, barbier, allonar, psomi, skoli, alfavitat, dhaskal, hetairë, dhogë* etj. Për shembull:

Dushk për gogëlla, qir Kiço – i thashë. (Vepra 3, f. 504); Në s'kish Shkurtua asnjë këngë, **dhaskalica**... kish dy këngë ... *Kur shkante Qirija rrugës, vërc e vërc me atë ombrellë, dëgjohej si këndojnë çupëria: Hithrat u thanë / Qirijen e vranë*. (Vepra 2, f. 106-107); *Dy dhaskalë mbante në një kohë fshati: Qosen një, Shkurton dy*. (Vepra 2, f. 105); *Them, nuk di në janë dy vëllezër këta dy dhaskaj, a në janë që të dy një njeri*. (Vepra 2, f. 108) etj. Notat ironizuese shtohen në trajtën e shumësit të fjalës *dhaskal* dhe në krijimin e fjalës së re *dhaskalicë* me anë të prapashtesës - *icë*.

Kuteli është gjurmues këmbëngulës edhe në drejtim të huazimeve, ai di të luajë trillshëm me to, duke i kthyer në mjete specifike, në mjete përmes të cilave sjell një spektër ngjyresash gjuhësore dhe vlerash stilistikore.

2.6. Leksiku i figurshëm dhe mjetet gjuhësore të krijimit të tij

Vepra e Kutelit shquhet për një sistem të pasur e tepër të larmishëm të figurshmërisë, diktuar nga pasuria tematike, nga pasuria e ideve, ballafaqimeve, këndvështrimeve të shumta të jetës, të fateve njerëzore, nga depërtimi në psikologjinë e filozofinë e tyre. Ngjyrat e jetës dhe natyrës shpërfaqen ylbërshëm përmes figurshmërisë, e cila për të “është një rrugë e veçantë për përvetësimin artistik të botës, një modelim specifik i saj, në të cilin dukuritë materiale e njerëzore zbulojnë reciprokisht vetitë e tyre përmes një prizmi të ri.”⁶³ Ajo që bie në sy është origjinaliteti, cilësia, njohja e mjeteve të stilistikës gjuhësore. Ai arrin të shfrytësojë maksimalisht këto mjete në të gjitha rrafshet, si në atë fonostilistik, leksikostilistik, sintaksostilistik dhe semantostilistik. Bota shqiptare jepet në lëvizje me figurshmëri konkretizuese, e kombinuar me imazhe dëgjimore e imazhe pamore piktoriale. Të gjitha këto është e pamundur të trajtohen në mënyrë të shterur, ato kërkojnë një studim të gjerë më vete, ndaj ne do të ndalemi vetëm në disa prej tyre.

Kuteli shquhet për krijimin e mjeteve të reja me ngjyrim stilistik, si dhe vendosjen e fjalëve të përdorura më parë në kontekste të reja e origjinale. Si magjistari i fjalës, ai zbulon fuqinë dhe vlerat e saj, duke u mbështetur në gjithë përdorimet e mundshme, në gjithë leksematikën dhe lidhjet e shumta sintagmatike dhe veçanërisht me neologjizmat stilistikore ai sjell prurje cilësore, që pasurojnë sistemin e figurshmërisë.

Figurshmëria e neologjizmave-përftesa zbulohet më mirë brenda kontekstit të caktuar të përdorimit, ndaj jo më kot disa stilistë e shohin kontekstin “në rolin e normës, karshi së cilës përcaktohen vlerat stilistike të njëjësive të caktuara gjuhësore.”⁶⁴ Konotacioni pasurohet dhe efekti artistik rritet me vendosjen e tyre në sintagma, apo togfjalësha, të cilat në vetvete konsiderohen përftesa stilistike, por sidoqoftë “përdorimi i tyre mund të kuptohet dhe të përjetohet estetikisht vetëm në rastet, kur njihet makro e mikro konteksti.”⁶⁵ Për shembull: **brazdon liqerin** (Vepra 4, f. 169); **lingëri fjalësh**, **qielli i cingërimtë**, **kohëra të trazirta** (Vepra 1, f. 242-243); **rrënjë hidhatake** (Vepra 4, f. 331); **perënditë janë trillesa** (Vepra 3, f. 272); **heshtje**, **shtangësi**, **gjumë** (Vepra 4, f. 74); **thonë hidhshëm** (Vepra 4, f. 77); **pulpët e zëmbakta** (Vepra 1, f. 71); **të tre syqiellitë** (Vepra 4, f. 475); **zë mbrëmësor** (Vepra 3, f. 119); **nusja freskoshe** (Vepra 4, f. 499); **kopilja miturake** (vepra 1, f. 70) etj.

Leksikut të figurshëm i shtohen dhe disa përftesa që krijohen mbi mbiemrin **i(e) madh(e)**: **fjalëmadhe**, **fustanmadh**, **kokëmadh**, **kusurmadh**, **lavdimadh**, **nakarmadh**, **nazemadhe**, **poteremadh**, **romuzmëdhenjtë**, **sqimëmadhe**, **trirëmadhe**, **xhybemadh**, **zemërmadh**, **zulmëmadh**, **zëmadh** etj. Të kësaj natyre janë po ashtu dhe përftesat e tjera që krijohen mbi të njëjtat tema formuese: **syqiellitë**, **sypëgërë**, **syzi**, **symadh**, **sylarme**; **derëthyer** **duarthyer**,

63 . Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe gramatika*, Tiranë 2005, f. 142.

64 . Zdenko Lesic, *Jezik i knjizevno djelo*, Sarajevë, 1971, f. 176.

65. Shefkije Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë 2000, f.144.

krahëthyer, këmbëthyer, zemërthyer; paloarvanitë, paloburrë palogjuhë etj., të cilat zgjerojnë semantikën e gjuhës letrare.

Kuptime të figurshme lindin në shumë njësi leksikore, përmendim si të tillë:

- emrat abstraktë, si: *cingunëri, çupëri, djemurlli, drizëri, fismëri, gojtari, harbutëri, lingëri, lirësi, maçokëri, mizëri, ndragësi, ndyrësi, shtangësi*, si dhe emra të tjerë, si: *dekunë, hiçërit, zezonë*; foljet: *kaptoj, kasnecoj, kuqëron, lashtoj, lbardh, lkuq, zyntohem etj.*, ndajfoljet: *arithi, fillthi, njëmenthi, qirithi qokthi*; mbiemrat: *krekoz, thatok etj.*

Rikuptimësimi i figurshëm, ku shquhet sidomos ngjyrimi shprehës emocionues gjendet edhe në fjalët e zbuuara, si: *atëlosh, bardhaçkë, bukurezë, djalth, dyzë, fjalëzë, gegëuc ketërush, kunatëzë, lakove, lalush, linjëzë, (e) mjerëz, motërzë, mysafirkë, ombrellkë, pantallonka, pëllumbth, rrogushkë, shoqezë, Tekiçkë, torbëzë, trimosh, vashëzë, virankë, vëlasho etj.*, me anë të të cilave shprehet dashuri apo ironi sipas kontekstit.

Dendësimi, intensifikimi kuptimor është një tipar i përftesave-neologjizma në veprën e Kutelit, sidomos i ndajfoljeve, si: *capthi, fyta, gogolçe, hovshëm, rrokas, vrullshëm zotërisht, zuzarthi etj.*; i mbiemrave të përbërë, si: *bardhëzezë, flakëfurfullonjës, kuqzikuq, kërcithatë, rrezikmadh, rromuzmadh etj.*, apo i mbiemrave të emëruar, si: *dorëthati, emërshuari, kusurmadhi, këmbështrembri etj.* Për shembull:

...sheh të bukurën e tij të veshur me petk nusërie, me xhubletë bardhëzezë, me kaçurrelat derdhur ballit, me vështrimin e ëmbël. (Vepra 4, f. 154); *...e kish çarë kësaj here udhën rrezikmadhe për në Turqi.* (Vepra 3, f. 346); *Dëgjoni se ç'bën nusëtrimja.* (Vepra 4, f. 155); *Pse s'dolën fshaçe me kosa e lopata.* (Vepra 4, f. 335); *Krisi gjëmë e madhe, se martohet gjëmëmadhi me gjëmëmadhen.* (Vepra 4, f. 382), *E gjithë këta korrozinj e korrozeza vinin e mbushnin ujë të rrahur në tre mullinj.* (Vepra 4, f. 90) etj.

Si pjesë e leksikut të figurshëm janë edhe emrat në shumës, të krijuar jashtë normës letrare, me anë mbaresash të tilla, si *-ra*, për shembull:

Donomara. Dreka e darka ... Mishra të pjekura, bakllavara, më the të thashë. (Vepra 1, f. 240); *Atje zunë të kumbojnë këmborë koperash dhe sëpata druvarësh* (Vepra 4, f. 19); *...t'i faleshin kësaj dhe t'i sillnin flira.* (Vepra 3, f. 204) etj.

Në funksion të rritjes së figurshmërisë së tekstit, Kuteli përdor mjeshtërisht edhe dukurinë e polisemisë, duke e pasur të qartë pasurinë e shqipes në këtë rrafsh. Për këtë mjafton të kujtojmë analizën e J. Thomait, sipas të cilit “*mbi 50 përqind e fjalëve të shqipes kanë më shumë se një kuptim.*”⁶⁶ Vepra e Kutelit do të shquhet si për poliseminë shumë të pasur gjuhësore, ashtu edhe për atë stilistike. Krijimet e tij janë në frymën e gjuhës, duke bërë “*atë që gjuha përpiqet ta bëjë në vazhdimësi*”⁶⁷: kërkimin e

66 . J. Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 84.

67. Eduart Sapir, *Gjuha – hyrje në studimin e ligjërimin*, Prishtinë, 1980, f. 255.

ngjashmërive midis dukurive, objekteve, të cilat bëhen shkas për lindjen e kuptimeve të reja polisemike dhe përdorimi i tyre, në shumicën e rasteve, në kuptim të figurshëm. Për shembull:

Ç'të bëjmë që të mbajmë muret më këmbë. (Vepra 4, f. 12); *E kujt je moj ftujake e njomë?* (Vepra 1, f. 195); *...faqet i ka me gropëza, vetullat kularë.* (Vepra 4, f. 286); *Sefedinit iu ndez gjaku* (Vepra 1, f. 191); *Dy të tjerë, që kishin qëruar udhën prisnin më tutje.* (Vepra 1, f. 190); *Po me një të shikuar vasha e mbërtheu në vend.* (Vepra 4, f. 18); *Pa më t'ia kriste këngës ai Yzeir evgjiti, bilbil e shkuar bilbili.* (Vepra 4, f. 91); *...ndenjem aty gjer afër zemrës.* (Vepra 2, f. 259) etj.

Në veprën e Kutelit ndeshim një figuracion sa të pasur, aq dhe origjinal e të shumëllojshëm: figura fonetike, figura të leksikut, figura sintaktike. Karakteristike për të janë dendësia e figuracionit, por dhe shfrytëzimi mjeshëtor i parimeve të mjeteve të stilistikës gjuhësore e letrare në të gjitha nivelet. Në tërësi, ato meritojnë një studim më vete, ndaj në vazhdim do të ndalemi vetëm në disa prej tyre.

2.6.1. Metafora

Xhevat Lloshi shprehet se “*shprehësia çon në stilema dhe si rrjedhim fjalët marrin domethënie plotësuese*”⁶⁸, pra stilema mbart kurdoherë diçka që nënkuptohet. Numri i kuptimeve të krijuara mbi bazë ngjashmërisht të Kutelit është shumë i madh dhe ato na çojnë drejt atyre figurave letrare që quhen trope. Duket se Kuteli e ka shumë mirë parasysh atë që thekson Dymarseja, “*se gjuha e figurshme e përfaqësuar kryesisht nga tropet, e zbukuron ligjërimin, e bën atë më fisnik*”⁶⁹, prandaj i drejtohet shpesh metaforës, lidhjeve fjalësore jo të zakonshme, lidhjeve të befta e të papritura, të cilat sjellin zhvendosjen e fjalëve nga kuptimet e tyre të zakonshme. Në prozën e tij gjejmë zhvendosje kuptimore, të cilat janë kthyer në dukuri leksikore, ose, thënë ndryshe, në metafora të shuara, por nuk do të merremi me to. Duke e pranuar sintagmën si njësinë minimale, ku realizohet kuptimi i figurshëm, po paraqesim më poshtë një analizë gramatikore, strukturore e semantike të sintagmave metaforike të pranishme në veprën e tij. Vërehet se Kuteli dallohet veçanërisht në krijimin e metaforave - emra, prej të cilëve më së shumti metaforizohen emrat e parmë dhe shumë më pak ata të prejardhur.

Një marrëdhënie mbi të cilën ndërtohen më shpesh strukturat e figurshme emërore në prozën e Kutelit është marrëdhënia përcaktore, ku gjymtyra e dytë e sintagmës përcaktore mund të jetë një emër në rasën gjinore

68. Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë 2005, f. 139.

69. Cituar sipas M. Le Guern “*Semantique de la metaphore et de la metonymie*”, f. 70.

të të dyja trajtave, një emër në rasën rrjedhore të pashquar, një emër me parafjalë.

Sintagmat emërore me marrëdhënie përcaktore përbëjnë një pjesë të madhe të sintagmave në prozën e Kutelit. Ato formohen nga lidhja e figurshme e dy gjymtyrëve, të cilat janë:

a) Emër + emër në rasën gjinore: dikeli i skllavërisë, bandrat e robërisë, zjarri i dashurisë, lulja e moshës, nusja e ujërave, mikun e zemrës, qenari i liqenit, ngushticat e vdekjes, errësira e shestimeve, vendbanimi i hijeve, nëna e Lebetive, prehri i bregores, shparga e mendimeve, vallja e zjarrit, mjegullishtja e tymit, kërthiza e Gjurgjokut, fisi i ngjalave, zjarri i punës, zëri i lumenjve, kandari i zjarrit, dera e zemrës, dëbora e vdekjes, barku i kulerës etj.

b) Emër + emër në rasën rrjedhore: breshër heshtash, shigjetash, rrofatah, hamullimë zërash, rrugajë heshtash, lingëri fjalësh, valle çmendurie, fasha jargavani, gjumë humbëtire, vilar drite etj.

c) Emër + mbiemër: *ëndërr e trishtuar, mendim i sapozgjuar, gojëdhënë e mjegullt, ajër i ëmbël, arë e pikëllueshme, klithmë e dëshpëruar, fjalë fluturake, zanat pëllor, fjalë të hidhura, breshër heshtash* etj.

Në prozën e Kutelit sjellin vlera të shtuara stilistike veçanërisht sintagmat metaforike, në të cilat mbiemri është një fjalë e përbërë, si për shembull:

Vitin e nëntë u hap e mori dhenë fjala gjëmëmadhe. (Vepra 4, f. 36); *Ai ka zgjedhur këtë natë lemerimadhe për të dalë bjeshkëve.* (Vepra 4, f. 75) etj.

Dihet se ndërtimet e figurshme të tipit emër + emër në gjinore përdoren shpesh nga shkrimtarët dhe, si të tilla, kanë rrezikun të tingëllojnë si konvencione dhe gjedhe të njohura dhe në këtë rast metaforat nuk tingëllojnë dhe aq poetike, por mund të themi se te Kuteli ka shumë syresh që dallohen për një përdorim me shije dhe me efekt estetizues.

Për të ndërtuar kuptimin e figurshëm në këto sintagma, shfrytëzohet pjesa më e madhe e marrëdhënieve që vendosen në gjuhën “e drejtpërdrejtë” ndërmjet gjymtyrës bosht dhe përcaktorit. Duke i paraqitur të radhitura sipas dendurisë së përdorimit, ky i fundit mund të shënojë: emra që lidhen me dukuritë e natyrës, emra nga bota bimore, emra pjesësh, gjymtyrësh a organesh të një gjallese, një send në kuptimin e gjerë të fjalës, vend, lëndë, procese a gjendje shpirtërore, fizike e psikike të njeriut etj. Për shembull:

E kish derën e zemrës të hapur. (Vepra 2, f. 172); *Fisnikun Kaligjen të Tebës zuri ta brejë krimbi i dyshimit për të shoqen, të bardhën Megaklea.* (Vepra 3, f. 42); *Sapo i vinte ai dorën mbi dorë, mbi sup a mbi flokë, sikur kredhej në një liqer lumtërie.* (Vepra 3, f. 36); *Ishin munduar ta joshnin me tinguj fyejsh e kumbime psherëtimash.* (Vepra 3, f. 35); *...s'ka më të bukur se sa këto male të larta midis tri liqereve të kaltra, në zemrën e Enkelisë.* (Vepra 3, f. 31); *...valët thyheshin brigjeve, bashkoheshin rishtaz, ktheheshin e*

përplasheshin me një hov, për **gaz të zgalemëve** që silleshin rrotull përsipër me kushtrim lufte. (Vepra 3, f. 23); Befas Edipi u err, ndaj pa lart mbi **brinjët e malit** një tufë galash. (Vepra 3, f. 17); Poshtë, në Drimonë, kish ardhur vera; lart në malet ishte ende pranverë. Dhe jo **pranverë** sidokudo, po **bujëmadhe...** ...pushonte **mbreti i zogjve** këngëtarë. (Vepra 3, f. 7); ...hëna si një drapër shkonte në **luadhet e qiellit**. (Vepra 2, f. 40); ...po përtpnim sikush në vetëvete **regëtimat e fundit të këngës** së Petrushit. (Vepra 2, f. 39); E ia merr një **gjumë i ëmbël**, si gjumë afioni. (Vepra2, f. 271); Na hipën **mendime çapraze** për Xhoxhin. (Vepra 2, f. 26); **Natë e ëmbël** vere. Natë Enkelie. (Vepra 2, f. 133); **Vdekje më e ëmbël** dhe më **e lehtë** s'ish parë kurrë. (Vepra 4, f. 41); ... u ngjit edhe lart, në ato **faqet e zhveshura të dikurshme të Përroit** të Gjinos. (Vepra 1, f. 360); Tutje, në mes të një **ngazëllimi drite, vagëllonin malet** e Mokrës, që **vërtiteshin njëri mbi tjetrin** si ca kuaj të harlisur. (Vepra 3, f. 511); Si mund të të zerë gjumi në një natë të tillë kur je në **lulen e moshës**. (Vepra 4, f. 126); ...dilte Olloman beu pazarit me dyzet a pesëdhjetë trima të zgjedhur me **kandar të zjarrit**. (Vepra 1, f. 209) etj.

Në prozën e Kutelit gjenden në një numër jo të vogël edhe sintagmat metaforike me lidhje kallëzuesore. Folja këtu mund të jetë në veprë jokalimtare, ose joveprë pësore, bashkim ku semat e emrit nuk përputhen me kufizimet përzgjedhëse të foljes: *qesh buza, lëpin era, qesh fati, grisët nata, gurgullon urrejta, mprehet vdekja, flakërojnë sytë, pjell mendja, loton mëngjesi, erret mendja, qeveris qepët, kullot syri* etj. Për shembull:

...Kur frynte stuhia **dasmonin kaponjtë** e egër dhe pulat pikalore. (Vepra 3, f. 8); Tërë ditën e ditës, që kur **regëtime mëngjesi** e gjersa zbriste të mugëtit, punonim e punonim pareshtur. (Vepra 2, f. 32); Miku është der' e xhenetit! **Valon hatri...** U **ndezën gjakrat**. (Vepra 1, f. 306); **Flinte tërë Drimona** bashkë me **faltoren** e bardhë të Thanës majë shkëmbit, mbi liqer. (Vepra 3, f. 132); Po **doli kënga** që shkon si një yll drite nëpër shekuj **për të kënduar** trimërinë e vëllait dhe dashurinë e motrës, fismërinë e shpirtit të madh bujar. Dhe **kënga** nuk **vdës** kurrë. (Vepra 4, f. 41); **Dëgjo, o zog** verdhë se dua të të jap një amanet ... **i thuaj varrit**. (Vepra 4, f. 30); Kur hiqeshin urat e Maliqit, **çifligjet turreshin** më tej. Pastaj **prapseshin**. (Vepra 3, f. 511); **Vraje vdekjen**. (Vepra 3, f. 311); **Vaji i saj stolisej** me fjalë. (Vepra 1, f. 224) etj.

Nga pikëpamja leksikore foljet që lidhen me emrat në sintagma metaforike kallëzuesore shënojnë:

a) Një gjendje a një veprim që e kryen njeriu a një frymor tjetër: *bërtet, dridhet, dëgjon, ecën, hesht, luan, lëngon, pi, pikëllohet, puthet, përgjumet, përqafohet, trishtohet* ëndërron etj.

b) Veprim që e kryejnë jofrymorët në kuptimin e gjerë të fjalës: *avullon, bleron, bluan, brazdon bubullon, fiket, fërmon, gërryen, hollohet, kullon, kyçet, regëtin, ndreq, numëron, përflak, rrokulliset, tretet, ushton* etj. Për shembull:

...**Hëna** e bardhë, **rri** lart mbi krye të tyre e **këqyr** ndaj kuvendojnë. **Hija** e shkëmbit të madh **nis** e **zgjatet** prapa, mbi gremina. Në bjeshkë **del** e **hyn flladi** i freskët i natës. Shushurijnë gjethet e aheve, **këndojnë krojet** e flohta e ua **mbajnë** zërin lumenjve që hidhen prag më prag. (Vepra 4, f. 57); Ngrihej menatë, sapo zinin të **faleshin yjet** e të **vagëllonte drita**. (Vepra 4, f. 54); **Valët thyhen** njëra pas tjetrës në breg. (Vepra 4, f. 50); Ish muaji gusht, **ziente gjinkalla**. (Vepra 1, f. 332); **Ama poçet**, **misurët** e **stomnat** e Ndonit **shpinin** gëzim nëpër fshatrat. (Vepra 1, f. 331); **Po guzat** e shqipkat tek nxinin anës **thoshin** se s'ish pranverë, po vjeshtë. (Vepra 3, f. 512); **E ëma s'ia ushqe** fjalën më tutje. (Vepra 3, f. 513); Në fushëtirë dhe gjer tej, në **prehër të bregores**, jashtë mureve **shtrihej një qytezë** e tërë me shtëpi të vogla e kasolle. (Vepra 3, f. 255) etj.

Në prozën e Kutelit vërehen edhe sintagma foljore me marrëdhënie objektore, të cilat formohen nga lidhja e figurshme e një foljeje me një emër në rasën kallëzore a dhanore pa parafjalë, ndonëse të pakta në numër, si për shembull: *gris qetësinë, shes shpirtin, zbus mallin, derdh brengën, flas me të vdekurit, përshëndetem me shkëmbin, shpoj heshtjen, zgjoj mërinë, i skuqen faqet mollës* etj.

Veprës së Kutelit nuk i mungojnë as strukturat me më shumë se një lidhje sintaksore, në të cilat gjymtyrët janë lidhur ngushtë rreth të njëjtit element leksikor. Këto struktura përbëhen nga dy ose më shumë marrëdhënie të figurshme dhe, si të tilla, ato paraqesin interes të veçantë. Të tilla janë lidhjet: kryefjalë + kallëzues + kundrinë e drejtë/e zhdrejtë, me parafjalë apo rrethanorë të ndryshëm, për shembull:

Kur sheh se vdekja mpreh shpatën të të bjerë, këputja kryet. (Vepra 3, f. 311); *Atje luftojnë numrat, që ta gëlltasin njëri - tjetrin. Dhjeta e gëlltit pesën e fryhet. Qindi i gëlltit të gjitha dhjetat e pesat e fryhet më shmë. Mija i përllan qindet. Milioni hap gojën e i llupit mijat. Bam-bum! U bien mijërat milionëve me dyfek, po nuk i vrasin dot. Bam-bum! - ua kthejnë këta me top, pastaj i hanë. Mirëpo edhe milionat luftojnë njëri me tjetrin, që të bëhen qindra milionë e miliardë.* (Vepra 3, f. 507); *...vala e lodhur lëpinte rërën e ngjeshur e ngjeshur.* (Vepra 3, f. 512); *Po kopilet që e kishin zemrën me krunde, ia mbyllën portën.* (Vepra 2, f. 211) etj.

Figurshmëri të lartë sjellin në vepër edhe të ashtuquajturat ekuacione metaforike të tipit: *Rrobat i kanë shkrumb... zemrat – fole nepërke.* (Vepra 4, f. 441) etj.

Në përfundim, së pari, themi se metaforat emër+ folje zenë vendin e parë te Kuteli për nga denduria e përdorimit të tyre, ndërsa duke i parë në tërësi del se ato janë formuar nga lidhja e figurshme e dy emrave, mbiemrave a foljeve me sema të përgjithshme që nuk përputhen, si të tilla ato vishen me domethënie e nënkuptime dhe aktualizohen e shpjegohen brenda tërësisë së organizimit letrar.

Së dyti, në vepër gjejmë vërtet edhe metafora të njohura më parë, por ajo më e rëndësishmja është se ka edhe shumë metafora origjinale, lidhje të freskëta e befasuese fjalësh, të cilat arrijnë të estetizojnë edhe fjalët e zakonshme dhe, në një kuptim më të gjerë, krejt prozën kuteliane. Jo rrallë mund të ndeshësh fragmente të tëra me aq shumë poezi brenda, sa mund të ishin të denja për antologjitë më të mira poetike të çdo kohe.

Burim figurshmërie në prozën e Kutelit përbëjnë të gjitha llojet e tropeve, por ne do të ndalemi më tej vetëm te krahasimi dhe epiteti.

2.6.2. Krahasimi

Krahasimi mbetet i lidhur me metaforën, sepse kjo e fundit është parë si një krahasim eliptik, pra si një krahasim ku mungojnë lidhëzat krahasuese, por në fakt midis tyre ka dallime të cilat nuk prekin vetëm formën. Ndryshimi qëndron te mënyra e veçantë e perceptimit të raporteve të ngjashmërisë. Kështu, “*krahasimi është një pasqyrim krejtësisht logjik, që vë në dukje raportin e dy realiteteve të ngjashme, ai është ilustrativ madje dhe demonstrativ, ndërsa metafora është një kalim kuptimor që prek drejtpërdrejt ndjenjat dhe imagjinatën e lexuesit apo dëgjuesit, duke shprehur një lidhje të menjëhershme afektive dhe përshtatet më pak me një kuptim logjik.*”⁷⁰ Madje abstragimi kuptimor në planin krahasues të dukurive apo objekteve në rastin e metaforës mund të jetë i tillë, saqë prej tij të mund të lindin figura në të cilat është e vështirë të dallosh kalimin nga kuptimi fillestar në atë të figurshëm, ndërsa te krahasimi gjithnjë ka një logjikë më të thjeshtë, e cila bazohet te ngjashmëritë më të qarta dhe më konkrete të tyre. Krahasimet kuteliane krijojnë menjëherë imazhe të gjalla, të perceptueshme lehtësisht për shqisat e lexuesit. Për shembull:

Kryefaltari hungëroi si derrkuc kur i ve thikën në fyt. (Vepra 3, f. 160); *Nga lart po vithiseshin si një rrugajë e turbullt kalorës e këmbësorë të huaj.* (Vepra 3, f. 170); *Asaj i rrihte zemra tak-tak, tak-tak si ajo trokashka e mullirit.* (Vepra 2, f. 245); *...doli që brenda ky Kirolloi bandilli, si rusp e shkuar ruspi.* (Vepra 2, f. 207); *Njeriu e sheh vetveten në raki si në pasqyrë.* (Vepra 2, f. 272) etj.

Krahasimi te Kuteli nuk ka vetëm funksion logjik, ai shërben edhe për t’u shprehur më me ndjenjë dhe më estetikisht, përmes krijimit të raporteve të reja midis objekteve e dukurive nga çdo fushë e jetës, shërben për të karakterizuar personazhet, pamjen fizike, gjendjen shpirtërore, psikologjike, shërben për të përshkruar mjedise, ngjarje etj. Të gjitha këto mbeten të gjalla në mendjen e lexuesit edhe për arsye të përdorimit të natyrshëm e mjeshtëror të krahasimit. Për të ilustruar çka thamë, po shkëpusim një fragment nga “Xha

70. Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë 2009, f. 14.

Brahua i Shkumbanores” për të parë se si me anë të dy krahasimeve autori qartëson figurën negative të të huajit dhe ndjesinë e frikës që ju shkakton ai fëmijëve: ...*u duk ai, dora vetë në anën e sipërme të mullirit, midis shelgjesh. Qëndroi një çast, shikoi i ngrysur, u koll thatë, pastaj shkuli një purtekë gardhi e u lëshua si ulk nëpër kalldrëmin e ngushtë të vragës, që zbriste në mulli. Ne kërcyem e u përndamë si një tufë rabeckash kur u sulet skifteri.* (Vepra 1, f. 168).

Dihet se krahasimet janë dy llojesh, të thjeshtë dhe të zgjeruar (similitudë), por më dendur në vepër ndeshim llojin e parë. Për t’i ndërtuar përdoren kryesisht emra konkretë, çka nxit përfytyrimin e lexuesit. Po japim disa shembuj krahasimesh të thjeshta:

Ai tjetri iu qep si rrodhja. ...Kur i sheh i vëllai madh togjet me mangërë turret si i çakërditur e zë të mbushë torbën. (Vepra 4, f. 412-413); *Mbeti brenda si miu në çark.* (Vepra 4, f. 417); *Aty sheh një kutrullaç të qepur si majmun pas çengelit.* (Vepra 4, f. 419); *Gollupët rrinin si të ngrirë, si të lidhur me magji.* (Vepra 4, f. 422); *Vring! Koka që rrokulliset si kungull.* (Vepra 4, f. 423); *Edhe dheu i zi u bë i errët si nata.* (Vepra 4, f. 22); *Borxhi shtohet e rritet si troska, fajde mbi fajde.* (Vepra 1, f. 306-307); *...një të tretën, e zinte një grua e plotë dhe e stërplotë si deng me dhjamë ... lëshonte një klithmë të hollë, si cihatje rike të pushtë.* (Vepra 1, f. 315) etj.

Në vepër ka edhe krahasime të zgjeruara, si: *Zhveshin shpatat e hidhen kundër shoqi-shoqit si ata të dy malet e përrallës që përpiqen kokë më kokë ... Në atë grimë dëgjohet një bubullimë e madhe sa tundet dheu: ashtu si gjëmon deti kur ngrihen dallgët, ashtu si vrungullon qielli kur shkrepin retë e vjen tufani.* (Vepra 4, f. 118); *Mbreti kërceu si uthull i thartë kur e hedh tutje koçankën.* (Vepra 4, f. 386); *Kjo syzezë i kish hyrë menjëherë në zemër e ia kish bërë mendjen lesh e li, si atë Kashtën e Kumtrit, që furfuran lart në qiell, në vjeshhtë të thatë.* (Vepra 4, f. 369); *Leshrat i kish bubuzhele, të ngatërruara si ato gjembat e dëllinjës së zezë, sa thua se brenda kishin bërë fole minjtë e Ugarit.* (Vepra 3, f. 83) *Neziri i Zi duket si rrozgë e nxirë, që e ka përzhitur cingërima.* (Vepra 1, f. 308); *...zonjushat gjysmë të veshura e gjysmë të zhveshura, përkundeshin si ato gjemitë e liqerit tonë kur i rrahin valët e shkumbëzuara.* (Vepra 1, f. 314) etj.

Në një përpjekje për t’i grupuar krahasimet në bazë të përmbajtjes dhe të funksionit të tyre artistik, natyrisht pa pretenduar t’i shterim, do të kishim:

-në vend të parë, për nga sasia e përdorimit janë krahasimet e ndërtuara sipas gjedheve të njohura të ligjërimit të përditshëm dhe të ligjërimit popullor, të cilat i gjejmë si në gjuhën e autorit, ashtu dhe në gojën e personazheve, gjithnjë në përputhje me idetë e parashtruara në vepër. Natyrshëm, në strukturën e tyre gjenden shumë fjalë dialektore, krahinore si dhe të leksikut të përgjithshëm, si të tilla janë: *si uthull i thartë, si s’ka mbi dhe, si Mançja i Gorricës, si gjithë pleqtë, si të ketë pirë verë, si hije, si qengj, si i mekur, si beben e syrit, si gogla dushku, si dritën e syve, si zog, si zog me krahë, si miza*

pas mjaltit, si qeni, si bar, si petrit, si zanë mali, si vëllezër, si i vdekur i pakallur në varr, si qëmoti, si zjarr, si sytë e ballit, si burrë, si re, si kripa në ujë, si çakall, si ujk, si i vdekur, si yll, si lubi, si fëmijë, si rrodhe, si peshku pa ujë, si kungull stambolli, si muzgu, si ulliri, si dëbora, si gjarpër, si skifter, si gavyell i ndryshkur, si kukudh, si loti i syrit, si tutkune, si ari, si mace e lagur, si biskonjë, si mollë, si dardhë, si cingël, si kaprolle mali, si thikë në fyt, si derr i egër, si kllongjir akulli, si dordolec, si cingël etj.

Kuteli i gjurmon dhe i përpunon hollë këto lloj krahasimesh dhe arrin të rrisë peshën e tyre semantike si dhe efektet artistike, duke i kthyer ato në mjete tepër mbresëlënëse të lexuesi, si për shembull:

Ti je e mirë si buka e ngrohtë. (Vepra 4, f. 193); *Ai është kreshnik që bën trimëri e lufton si burrë në shesh të burrave.* (Vepra 4, f. 88); *Mirëpo fjala e urtë e Arnaut Osmanit, i hyn Hysos si heshtë në zemër.* (Vepra 4, f. 168); *...të vlon gjaku si uji që gurgullon në krua.* (Vepra 4, f. 126); *Derri vinte si ortek mali.* (Vepra 3, f. 24); *Xha Dalipi vështronte i qetë, i qeshur, si një diell në të perënduar.* (Vepra 1, f. 311); *Rrinin të heshtur si ca lundra të mbytura.* (Vepra 1, f. 311) etj.

Autori krijon jo rrallë dhe me mjeshtëri edhe vargëzime krahasimesh, të cilat rrisin më tej vlerat emocionuese dhe stilistikore të tekstit, si për shembull:

Qysh më le kështu, si vatër pa zjarr, si krua pa ujë. (Vepra 4, f. 134); *...zgjdh vetë një kalë, cilin të duash; merr atë të zinë si ulliri, merr atë të bardhin si dëbora, apo atë pikëluarin si gjarpri.* (Vepra 4, f. 43); *...shkëlqente i tëri: bojalli me japi, ballaban si top gjalpi Vërçe, i bardhë, i kuq, kokën lart si deve Misiri, me një bastun në dorë* (Vepra 1, f. 307); *grumbulli – gratë përpara, si ca pata, burrat prapa si ca patokë...ktheu në të djathtë.* (Vepra 1, f. 322); *Trupin e ka si të breshkës, me zhguall, këmbët si të bretkut, sytë si të dockës* (Vepra 4, f. 425) etj. Në shembullin e fundit përemri i pacaktuar *ca*, pranëvënë emrave, shton ngjyrimet emocionuese e vlerësuese dhe mund të thuhet se Kuteli shquhet shpesh për aktualizime të tilla, gjithmonë në varësi të kontekstit.

Kuteli dallohet për krahasimet vetjake emocionale, të cilat poetizohen përmes fjalëve të përzgjedhura dhe ndërthurjes së mjeteve e mundësive shprehëse gjuhësore, gjë që e afron prozën e tij me tekstin poetik, për shembull:

...Hyri brenda dhe shtangu qirithi si lis në mot të qetë. (Vepra 3, f. 231); *Qëndrojnë të dy ballë për ballë, kaluar, Omeri i bukur si agsholi kur ndrit malet; bajlozi i shëmtuar si muzgu kur err botën.* (Vepra 4, f. 146); *...e ka lëkurën të bardhë si qumështi, e ka dorën të hollë si gjethëza e ahut në pranverë, e ka vështrimin të ëmbël si flladi i prilli.* (Vepra 4, f. 142); *Kurmet e tyre të larë e shpëlarë në ujërat e Lyhnidës e të përcëlluar nga dielli i allonarit flakëronin si zemra e valë e verës dhe mbanin erë vajzërie.* (Vepra 3, f. 80); *...dukeshin si në pëllëmbë të dorës të tre liqeret e Enkelisë: dy të mëdhenjtë*

dhe i treti, i vogli që llambarisnin në diell si tri qelqe me ujë të kulluar të futura në suazat e arta të grynjave të pjekura dhe blerimeve. (Vepra 3, f. 8); ...thotë ai tjetri duke qeshur si dielli kur shkrep majë malit. (Vepra 1, f. 308) etj.

Krahasimet i ndeshim edhe në njësitë frazeologjike dhe në frazeologjizmat letrarë, ku mbizotërojnë lidhëzat krahasuese *sa, si, sesa* etj., të cilat të vëna në gojën e personazheve, disa herë të përpunuara dhe aktualizuara, përveç ngjyrimëve emocionuese shërbejnë edhe për tipizimin e tyre stilistik. Si të tilla përmendim: *si miza në qyp, si buka që hamë, si kripa në ujë, sa frëngu pulën, sa për të thënë* etj. Për shembull:

Zëri i Malush agait, që zakonisht *qe si bar për plagë, tani qe egërsuar si një përrua mali, kur zbret poshtë, vjeshtës, shkëmb më shkëmb*. (Vepra 1, f. 216); *borxhi hipi ditë për ditë, u ngjit lart, si themi ne, si ajo e Zeqos majë thanës*. (Vepra 1, f. 308); ... *ne, na punonte mendja si flakë e zjarrit*. (Vepra 1, f. 157) etj.

Mënyra mjeshtrëse se si autori i krijon dhe përdor krahasimet ndihmon në pasqyrimin më të qartë dhe më konkret të jetës, në pasqyrimin e qartë të ideve, në krijimin e vlerave të veçanta stilistikore dhe kjo përbën padyshim edhe një tipar dallues në prozën e tij. Nënvizojmë se karakteristikë vetjake e Kutelit mbetet edhe grumbullimi i disa krahasimeve pranë njëritjetrit, ndërlihdja e tyre me figura të tjera, si epiteti, metafora etj., çka i çon vlerat stilistikore, që ato mbartin, në shkallën më të lartë.

2.6.3. Epiteti

Epiteti përbën një figurë tjetër me vlerë gjuhësore dhe letrare, që ndikon dukshëm në rritjen e shprehësisë dhe figurshmërisë së prozës së Kutelit, sidomos, kur ai është i lidhur me figura të tjera, në mënyrë të veçantë me metaforat dhe krahasimet. Ai ka vlera jo të pakta në tipizimin e personazheve, në përshkrimin e gjallë të mjediseve dhe ngjarjeve të ndryshme, duke i konkretizuar e vlerësuar ato semantikisht e stilistikisht. Për shembull:

- Portretizim personazhi: *Pranë shtatores të Nevolës plakë e gungaçe, dukej një shtatore tjetër, që ndante si dita me natën nga ajo e Nevolës. Kjo shtatore e gdhendur gjithë në gur të bardhë si në të verdhë tregonte tregonte një vajzë të gjatë, të hollë, shtathedhur, veshur me një petk të hollë, nën të cilin spikatnin gjinjte e fryrë, kofshët e gjata, të forta. Edhe qafën e kish të gjatë, të drejtë, fytyrë të lëmuar, flokë të kthyer e të hedhur mbi krye, të mbledhura në majë*. (Vepra 3, f. 105) etj.

-Përshkrim mjedisi: *Gjithë natën fryu erë, buçitën dallgët, u përkundën e gumëzhinë pemët, gagaritën gazmend shpesët e shumtë, të ujit – shpresëtarë dhe ndjellës të motit të freskët. Në mëngjes pushuan të gjitha: era, buçimat, gumëzhimat. Shpesët u strukën në kulluzmat e errëta të Drimit të Vogël tek gurgullonin burimet e ftohta të nënujshme. Në qenarin e liqerit - rrëzë shkëmbinjve dhe buzës së zallishtes - shkumba u tret, lëmizhdar ranë poshtë,*

uji gjelbërosh u kullua, ndryshoi ngjyrën, u bë i tejdukshëm dhe i kaltër gjithë hapësira e Lyhnidës. **Hëna e zbehtë** dhe **e cunguar** vonoi dhe një copë herë në cepin tjetër... Malet u veshën me **qiqërimë të përhime të përndritur**. Nëpërarat dhe luadhet **dheu i munduar** nxirrte sumbulla **afshi të krirtë**. (Vepra 3, f.117-118) etj.

Në veprën e Kutelit gjejmë shumëllojshmëri epitetesh për nga forma, përbërja, volumi etj., por së pari, bien në sy dy lloje: epitete të rëndomta dhe epitete të rralla, të cilat mbajnë vulën e tij vetjake. Duke u përpjekur të zbulojë anë të reja të dukurive të natyrës, të sendeve e të botës njerëzore, ai krijon lidhje të pazakonta e befasuese, stilema të goditura, të cilat krijojnë vlera në rrafshin semantik e stilistik. Disa nga këto janë: *lis vishkullor, nuse freskoshe, zë mbrëmësor, vrap i vrulltë, valë e prushtë, kithi i krirtë, vesë e akullt, fjalë e moçme, shok syqiehtë, sy të qiellitë, xham shëndritës, kumbullat majhoshe, shtat i eshkët, pahu i bryllët, ujë i shkumbëzuar, mjegull e zbardhlyët* etj.

Së dyti, epitetet në veprën e Kutelit paraqiten të larmishëm dhe në pikëpamje të fjalëformimit dhe, në këtë drejtim, janë interesante për t'u analizuar sidomos epitetet e shprehur me mbiemra jo të parmë, sepse ata shprehin figurshmëri më të lartë. Vërehet se janë të shumtë dhe të arrirë mjaft mirë artistikisht epitetet e realizuara nga ana gjuhësore me mbiemra të prejardhur, prej të cilëve, denduri më të lartë kanë ata që janë formuar me anë të prapashtesimit. Të tillë janë epitetet-mbiemra të formuar me prapashtesat -ak,-aq,-or,-sor,-tar,-th osh etj., për shembull:

Artana qamatare...kësaj here rrinte e ftohtë. (Vepra 3, f. 108); *...i pëlqente më fort Homeri dhe poetët e tjerë të hollë gaztarë*. (Vepra 3, f. 112); *...Të kalojmë bashkë këtë mbrëmjeë që na e falën perënditë mëshirëtare*. (Vepra 3, f. 113); *Prema begatore dhe Thana vrapëtare na qofshin ndihmë*. (Vepra 3, f. 133); *... i fliste me zë të thellë mbrëmësor*. (Vepra 3, f. 119); *Etleva baloshe u gjend pranë Enkeleut gështenjë, Artana gështenjë pranë Enkeleut balosh*. (Vepra 3, f. 130); *këtë flakërimë s'patën kohë ta shuanin ...në ujin e gjelbërth të Drimit të Vogël*. (Vepra 3, f. 118) etj.

Nuanca të veçanta vlerësuese dhe stilistikore marrin epitetet të shprehur gjuhësisht me mbiemra lëndorë dhe të tjerë të formuar me prapashtesat -të dhe -ët, si: *Etleva shtyri derën e dushkët*. (Vepra 3, f. 88); *...vajzat panë një zhelan ...veshur me rrecka të kërpta*. (Vepra 3, f. 83); *Artemidori i Ambrakisë zuri me të dy duart , për vegjesh, kupën e drunjtë*. (Vepra 3, f. 143); *...shtypësja e vjetër e bunghtë i qe prishur*. (Vepra 3, f. 93); *...e hedhur në vrap të vrulltë*. (Vepra 3, f. 107); *...do ta ftojme në dasmë me kulaç të grynjtë*. (Vepra 3, f. 105) etj.

Një dukuri gjuhësore karakteristike për veprën e Kutelit krijojnë epitetet në formën e mbiemrave të formuar me anë të prapashtesës fjalëformuese -njës. Shembujt e mëposhtëm janë marrë nga volumi i tretë i serisë së veprave të tij: *gisht tregonjës* (f. 95); *sy depërtonjës* (f. 110); *zot bubullonjës* (f. 114) *palat fërfëllonjëse* (f. 186) *Pllaka xixëllonjëse*,

tringëllonjëse (f. 186) *zjarr flakëronjës* (f. 195) *gjak gurgullonjës* (f. 197) *shpatë spastronjëse* (f. 217); *kukumale vezullonjëse* (f. 223) etj.

Me vlera më të larta shprehësie e figurshmërie vjen grupi i epiteteve të formuar nga mbiemra të përbërë, të cilët mbartin në vetvete nuanca përcaktuese, vlerësuese dhe ndihmojnë në karakterizimin artistik të frymorëve, kafshëve dhe shpendëve. Si të tilla përmendim: *kokë flokëkashtë*, *peshk luspargjendë*, *kshetëz leshgjatë*, *gjinjtë bulekaltër*, *zhelan kokëmadhi*, *çotillë krahëzhveshur*, *burrë shtatmadh*, *centaur gjëmëmadh*, *Menda dorëftohtë*, *mushkë potkuamadhe*, *njeri kokëngjeshur*, *kandil flakëfërfëllonjës*, *sarikë majëndritur*, *Bardhyl jetëgjati* etj.

Shprehësia e tekstit rritet dhe karakterizimi artistik bëhet dhe më i plotë në rastet kur Kuteli përdor një varg epitetesh të përbërë, si për shembull: ...shtiret si *burrë i mirë*, *njeridashës*, *perëndilutës*, *therorsjellës* dhe na fut thikën nga *prapa*, *papritur*, *në t'errët*. (Vepra 3, f. 222); *në prag u dukën njëri pas tjetrit tre roje gjumashe*: një *Spartan thatim*, *qafëgjatë*, *mjekërzi*, *po pa mustaqe*, *ca me veshë si krahë lakuriqi nate*, një thesprot *fytyrëgjatë*, *hundëhollë*, e *sykaltër*, *me këmishën e bardhë të lëshuar kinda-kinda*. (Vepra 3, f. 248); ...*flinë e madhe e kish bërë*: një *dem të majmë qimebardhë e brifortë*. (Vepra 3, f. 215) etj.

Te Kuteli përbëjnë një grup të konsiderueshëm, ndoshta më të madhin, mbiemrat e leksikut popullor të shprehur me mbiemra, të cilët shprehin qëndrimin e personazhit apo autorit dhe, si të tillë, marrin ngjyresat shtesë të familjaritetit, simpatisë, keqardhjes etj. Për shembull: ...*ata e duan mbretin e tyre plak...* *dorëgjërë*, *zemërbardhë*. (Vepra 3, f. 144); *Po kur e pa foshnjëzën e djepit ...me ato duar qumështuar*. (Vepra 2, f. 213); *Hyn e del një sorkadhe syzezë e llërëbardhë*. (Vepra 4, f. 338); *Ngjesh me grusht ato mustaqet bubuzhelka*. (Vepra 3, f. 415); *Ç'të bëjë ajo ditëzeza*. (Vepra 4, f. 447); *S'di se si atë grimë Etlevës i shkoi mendja tek ai lypsari kokëmadh, mjekërdrizë, e sypëgjërë, që e kish parë afër shtëpisë* (Vepra 3, f. 165); ...*këndonin këngë lëpërdhare*. (Vepra 3, f. 257); *E fjala e nëmosur e fermanit naa kish mbushur dhenë* (Vepra 2, f. 47); *Ja, më erdhi një krushqar mustaqepresh*. (Vepra 4, f. 496); ...*se një dhëlpër dhëlpërushe më koboi* (Vepra 4, f. 333); ...*zbriti latini këmishëzi e shpirtreq*. (Vepra 1, f. 347) etj.

Fuqia poetike e e epiteteve rritet më shumë në rastet, kur shoqërohet edhe me përmbysje të rendit të gjymtyrëve, pra kur mbiemri vendoset para emrit, për shembull:

Pastaj e mori fjalën *vlukmadhi* Amua i Lynkestës. (Vepra 3, f. 307); ...*kaloi e bardha rini*, *kaloi e bujshmja burrëri*, e *pllakosi e zeza pleqëri*. (Vepra 4, f. 136-137); ...*ishte fisi i të fismit Kaligjen*. (Vepra 3, f. 46); *Gëzohu, moj e bukura arbëreshë!* (Vepra 4, f. 255); ...*kish shkuar drejt te shatorrja e trimit arbër*. (Vepra 4, f. 262); *U shkurtua e bardha ditë*, *u zgjat e zymta natë*. (Vepra 4, f. 336); *Of! i gjori unë*, *of, i mjeri unë*. (Vepra 4, f. 417) etj.

Ndonëse më rrallë, te Kuteli gjejmë edhe epitete të shprehur me emra: *Nuk ua kalonte askush në punë cingunërie.* (Vepra 3, f. 256) etj.

Në fund themi se ligjërimi kutelian është i mbushur përplot edhe me trope të tjera, si metonimia, hiperbola, simboli, aliteracioni etj., të cilat bëjnë që gjuha shqipe të jehojë në penën e tij, që lexuesit të marrin kënaqësi të vërteta estetike. Figurshmëria në përgjithësi dhe pasuria e figurave letrare në veçanti meritojnë vëmendjen e mëtejshme të studjuesve. Në analizën tonë ne u ndalëm vetëm në ato mjete të figurshme, të cilat përdoren më dendur në prozën e Kutelit dhe që na u dukën më të rëndësishme për të.

2.7. Një përqsasje e leksikut të veprës së Mitrush Kutelit me leksikun letrar dhe pasqyrimi i tij ndër fjalorë të shqipes

Vepra e Mitrush Kutelit vërteton njëkohësisht se “*gjuha e jonë burimin e vet të pashtershëm e ka në popull*”⁷¹ dhe se shkrimtarët janë miqtë më të mëdhenj të saj. Për këtë mjafton të kujtojmë emra të tillë, si Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Jakov Xoxa, Ismail Kadare etj. Lista është më shumë se kaq, por ne do të ndalemi te Kuteli, për të cilin studjuesit tashmë e kanë thënë fjalën e tyre, duke e cilësuar si shkrimtarin kryesor, që ndihmoi në hedhjen e bazave të gjuhës letrare shqipe, si prozatori, te i cili “*vihet re një harmonizim i natyrshëm ndërmjet ligjërimin të vetvetishëm dialektor, të cilin autori e nje mirë, dhe përpunimit të vetëdijshëm, të kujdesshëm dhe me shije të lëndës gjuhësore*”⁷². Në këtë realizim madhor, Kutelin e ndihmojnë jo vetëm konceptet e tij për gjuhën amtare, por sidomos fakti se ai është njohës i shkëlqyer, dashatar e gjurmues i pashoq i mjeteve gjuhësore të njohura e të panjohura, të hershme e të freskëta, me vlera kumtuese e me vlera shprehëse. Ai ka sprovuar “*në lëmin e krijimit, të përtëritjes dhe begatimit të shqipes, qoftë me fjalë të reja të krijuara prej vetë atij, qoftë nëpërmjet prurjes e fisnikërimit të fjalëve të bukura që ka dëgjuar nga goja e popullit*”⁷³ dhe mund të thuhet se krijon në një mënyrë të tillë, e cila sjell zgjerimin e kufijve të gjuhës letrare.

Është pranuar tashmë se origjinaliteti i shkrimtarit varet nga raporti që ai ndërton me gjuhën dhe Kuteli është padiskutim rasti që e vërteton më së miri këtë, sepse ai di t’i “qepet” fjalës shqipe në tërësi dhe fjalës së vendlindjes në veçanti, duke e funksionalizuar atë në shtresat kuptimore të tregimeve dhe rrëfenjave të tij. Vepra e Kutelit është në vetvete një shkollë gjuhësore dhe prirja e tij kah gjuha letrare kombëtare nuk është aspak e rastësishme, përkundrazi, ajo realizohet në mënyrë të vetëdijshme, përmes një përpunimi të hollë, duke ju nënështuar një sistemi rregullash të rrafshëve të ndryshme gjuhësore: fonetike, gramatikore, leksikore, sintaksore etj.

71. Ernest Koliqi, *Vepra 5*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 297.

72. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 143.

73. Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë 2008, f. 163.

Duke qenë se Kuteli, siç është vërejtur, në thelbin përmbajtësor të veprës së vet pasqyron strukturën e Shqipërisë së përjetshme, e Shqipërisë që mbetet, që ekziston sot e nga mot, pavarësisht kohërave e sistemeve, atëhere edhe materializimi gjuhësor i saj ruan në të njëjtën kohë karakterin arkaik dhe modern, madje mund të thuhet se pikërisht arkaizmi bëhet burim i modernizmit të tij gjuhësor. Në rrjedhë të këtij arsytimi, është e natyrshme edhe prania e njësisve leksikore, strukturave sintaksore, frazeologjizmave etj., të cilat kanë një shtrirje më të gjerë kohore dhe që i kapërcejnë natyrshëm kufijtë e ngushtë krahinorë, duke u bërë pjesë e një leksiku më të përgjithshëm. Kuteli priret për ta ngritur gjuhën e veprave të veta në nivelin e gjuhës letrare kombëtare, duke e përzgjedhur dhe përpunuar atë jo vetëm si shkrimtar, por edhe si një gjuhëtar profesionist, prandaj bashkëjetesa harmonioze e diagonaleve të ndryshme gjuhësore është elementi kryesor, që e shënon prozën e tij si të parën prozë moderne shqiptare e njëkohësisht të papërsëritshme në llojin e vet. Po ta përqasim vlerësimin për gjuhën me metodat artistike krijuese, do të thoshim se ai sjell në letrat shqiptare një lloj realizmi magjik gjuhësor, një rrëfim gojor që kalon në rrëfimin letrar modern, përmes të cilit pasqyrohen ambiente të mbushura me ngjarje që tregojnë ngjarje të tjera dhe shpalosen fate personazhesh e jetë brezash njerëzore që nga ilirianët dhe në vijimësi, në kohët moderne.

Në veprën e Kutelit, pikësëpari, mbizotëron përshkrimi i ambientit rural, ambient i mbushur me ngjarje që kanë lidhje me të kaluarën, me mërgimin, me heroizmin dhe atdhedashurinë, por edhe me probleme të përjetshme të racës njerëzore siç janë ballafaqimi i së mirë me të keqen, i dashurisë me urrejtjen, i jetës me vdekjen etj. Gjithnjë në përputhje me këtë përmbajtje dhe me stilin e veprës, Kuteli do të bëjë një punë të madhe në përzgjedhjen dhe pasurimin e fjalëve, duke i estetizuar e veshur ato me përbërës kuptimorë plotësues, duke i ngjyrosur stilistikisht e duke mos munguar të krijojë dhe fjalë të reja sipas gjedheve të njohura të shqipes e pse jo edhe në mënyrë origjinale. Pra, ky autor shfaq edhe parapëlqimet e tij ndaj kategorive fjalësore apo fjalëformuese, çka përbën dhe një tipar të stilit të tij, tipar që i jep origjinalitet dhe e bën krejtësisht të dallueshëm nga shkrimtarët e tjerë të mëdhenj. Ai ka fjalorin e vet dhe fjalët e veta më të dashura, që i japin frymë dhe gjallëri ideve të tij të mëdha, ballafaqimeve të rëndësishme e bazike dhe kundërthënieve jetësore të personazheve të tij dhe jo pak të tilla bëhen stilformuese në veprën e tij. Sjellja gjuhësore e Kutelit ngjan me delikatesën e kopshtarit të dashuruar mbas çdo lule e bimëze, mbas çdo rrënje e sythi, mbas çdo degëze të përgjumur apo të harlisur; sjellja e tij gjuhësore tenton “hirin i fjalës”, fuqinë e saj biblike dhe ja del më së miri.

Në veprën e Kutelit vërehet qasja e tij e fortë drejt gjuhës letrare, jo vetëm për ta pasqyruar atë, por edhe për të dhënë ndihmesën e tij në pasurimin dhe freskimin e saj me mjete të reja. Përgjatë rrugëtimit të tij krijues, Kuteli i ka shpërthyer kufijtë krahinorë, duke shkuar gjithnjë e më shumë drejt gjuhës

kombëtare, drejt zgjerimit të saj dhe për ta vërtetuar këtë mjafton të ndalemi disa çaste të krijimi të saj i mëvonshëm “Nga Dyrakioma në Bardhonë”. Ky krijim, krahasimisht me krijimet e tjera të mëparshme, është në nivel fare afër gjuhës letrare, i pastruar nga krahinorizmat, nga fjalët e huaja, veçanërisht nga turqizmat. Të gjitha këto i kanë lënë vendin fjalëve të moçme shqipe, që shfaqen si ca nuse të shpërgjumura dhe historizmave, neolatinizmave të cilat shërbejnë për të krijuar koloritin gjuhësor kohor, të tilla si: *fallafore, fellëtirë, heshtë, mbroth, namëna, shigjetë sindozot* etj. dhe çka është më e rëndësishme një numri të konsiderueshëm neologjizmesh, të cilët më së shumti janë neologjizma stilistikë.

Kuteli ndihmoi në shtrirjen e gjerë të shqipes së shkruar në disa drejtime: në leksik, në fjalëformim, në shprehjet frazeologjike, në togfjalësia e mënyra shprehjeje të goditura, në drejtim të figurshmërisë etj., por veçanërisht, në drejtim të leksikut, sepse ndryshe nga rrafshet e tjerë gjuhësorë, leksiku dihet që mbetet një portë e hapur për t’u futur fjalë të reja, për të riaktivizuar fjalë të vjetra apo për të rikuptimësuar fjalë të ndryshme.

Pavarësisht, se Kuteli njihet si shkrimtar me prirje të fortë drejt leksikut krahinor, ai di të lëvizë gjuhën në të gjitha shtresat e veta dhe ta verë atë mbi baza letrare kombëtare në shumë e shumë mënyra, të cilat do të përpiqemi të ndalemi konkretisht:

Kuteli zgjedh fjalën e duhur edhe përtej mjedisit të tij gjeografik, duke i bërë vend në veprën e vet leksikut ndërdialektor, futjes së shumë fjalëve, të cilat janë karakteristikë e trevave të tjera, duke i dhënë kështu veprës së tij një frymëmarrje mbarëshqiptare. Ai e di mirë se “*thesari i gjuhës shqipe është i thellë dhe perlat e tij mund t’i shtien në dorë vetëm ata lëvrues të artit të fjalës, që shtegtojnë ngaherë nëpër trojet dhe mjediset e atdheut*”⁷⁴, ndaj dhe kjo dukuri ndodh jo vetëm në krijimet që vijnë me tematikë nga eposi apo krijimtaria tjetër popullore, të cilat prania e leksikut ndërdialektor është, si të thuash, edhe e detyruar, por edhe në krijimet që lidhen mirëfilli me vendlindjen e autorit. Përmendim disa të tilla, si: *aht, amëz, bacë, bret, bërlyket, bështinë, cub, cucë, dakikë, diellishtë, drangë, falmeshëndet, faroj, fiskajë, gjog, gjysmëterr, kaptinë, karpë, kashais, katua, kryet, kukamë, kullë, lartoj, log, loke, lëmashk, mazgallë, mjegullinë, mriz, mrizoj, ndezulli, ndoresh, nëmë, petka, pshon, qoftëlargu, quar, rruginë, shkluhë, thurimë, tatem, vajtores, vasho, vashë, vikamë, vrugëllon, vullajë, vëllam, zezonë* etj.

Tregues tjetër i kulturës së gjerë të Kutelit, i intuitës së tij të hollë, jo vetëm prej krijuesi, por edhe prej gjuhëtari, tregues që ai nuk është thjesht një fanatik i leksikut popullor të krahinës së tij, por edhe një dashatar i madh i gjuhës gjithëkombëtare, është dhe futja në ligjërim e një grupi fjalësh të leksikut arbëresh, si: *adunarem, e mungët, gjegji* (për *dëgjoj*), *marvazezë, noteshë, radë, shkluhë* etj.

74 . Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2009, f. 37.

Kuteli sjell njësi të vjetra, të qëmoçme (përdorëm këtu një nga arkaizmat e përdorur dendur në prozën e tij), të cilat kanë lidhje me mjedisin gjeografik, me leksikon e Liqenit të Ohrit, me bujqësinë, me blegtorinë, me fenë, me etnografinë, me etnozoolojjinë, me etnobotanikën e zonës dhe përtej saj, por meritë e tij është se kur këto fjalë janë të panjohura, ai i vendos në kontekste të tilla që ato të bëhen të kuptueshme për lexuesin. Si të tilla mund të përmendim: *anagjore* për *po ashtu*, *damf* për kundërmimin e rakisë, *derrpë* për pyllin shumë të dendur me driza, *kalpëtoj* për zë plasat e një fuçie a voze, *klisyrë* për grykë mali, *kulluzmë* për një vend ose tip foleje që ndodhet midis bimësh të egra të ndërlikuara, *këltyrë* për kapak, *lakove* (fjalë përkëdhelëse) për vëlla, *lavomë* për plagë, *qiqërimë* për mjegullën e lehtë që mbulon tokën në verë, *ushë* për kasollen e vogël të ndërtuar me degë e fletë ku fshihet gjahtari, *rrëzall* për pjesën e rrënjës me gjithë fije apo kallinj, *sumbull* për kopsë, *lolis* për shaj dikë etj. Për shembull:

*Disa me rroba bojë hiri prej stofe... disa mbanin këpucë të bardha... më të shumtit kishin bastunka të hollë... Midis kësaj **lyshtrë** shquhej një burrë mesatar nga trupi. (Vepra 1, f. 318-319); *Ariu zemërohet. Kthehet e i bie njërit një **shukretë**, e hedh tutje; i bie tjetrit dhe e le në vend. (Vepra 1, f. 260-261); **Kalori** mustaqeverdhë ktheu në të djathtë pelën barsë dhe mori udhën e Lagjes së Poshtme. (Vepra 1, f. 250); ...po brendapërbrenda zien si kazan me avull, që mundohet të hedhë tutje **këltyrën**, të shpërthejë jashtë, të lajë e shpëllajë çdo ndyrësi. (Vepra 1, f. 248); *Mbathej... me opinga të lehta të bëra me dorën e saj, lidhur me **ovgjala** ndënë gju. (Vepra 1, f. 223); *Atëhere vëllai i Xinxifilos hedh prapa pasqyrën dhe **namëta** bëhet një det i madh pa fund, pa anë (Vepra 4, f. 366); *U mblodha **lakove** ca luleshtrydhe. (Vepra 3, f. 60) etj.*****

Veprën e hijeshojnë me praninë e tyre një sërë fjalësh të rralla për gjuhën letrare, si: *agshol*, *blerishtë*, *burbujë*, *damf*, *dekunë*, *vetëmfillthi*, *lyshtrë*, *rrugajë*, *shukretë*, *imshtë*, *qiqërimë*, *shkarrëzimë* etj.

Kuteli jep një ndihmesë të madhe për pasurimin e shqipes letrare veçanërisht përmes fjalëformimit, duke krijuar fjalë, të cilat, qartas, duket se burojnë prej gurrës popullore. Gjedhet krijuese janë të larmishme:

-me prapashtesim: *ajkësinë*, *barkul*, *begator*, *bërtimë*, *darkëtar*, *dashatar*, *delmator*, *drejtar*, *gojtare*, *gostiar*, *kalor*, *krushqar*, *lagëtyrë*, *muziktar*, *mëshirtar*, *pagëtyrë pjellëtore*, *përgjëratë*, *shërimtar*, *zemëratë*, *zezulinë* etj.

-me anë të kompozimit: *brirëheshtë*, *bujëmadh*, *buzëbardhë*, *dhëmbërruazë*, *dorëbardhë*, *fustanëbardhë*, *gojëlidhuri*, *panxhërendë*, *hejmprehtë*, *kuqzikuq*, *këmishëgjatë*, *lemerimadhe*, *mustaqepresh*, *nakarmëdhenj*, *nusetrimja*, *shkumëbardhë*, *syqielltë*, *veshoputë*, *vetëmfillthi*, *zëmadh* etj.

- me anë të përngjitjes: *asfare*, *asqë*, *hiçgjë*, *mosgjë*, *sidokudo*, *sindozot* etj.

Të zgjedhura me kujdes dhe të vendosura në kontekstet përkatëse këto fjalë “*kthehen në mjete të plotvlershme e kalojnë jashtë caqeve të gjuhës së letërsisë, dalin në lëmin e gjerë të stileve funksionale e të gjuhës së folur të përditshme dhe në mënyrë të veçantë kjo mund të thuhet për rastet kur fjala dialektore vjen e plotëson ndonjë mungesë të gjuhës letrare duke dhënë mundësi të plotësohet fondi aktiv i fjalorit ose të përtërihet ai duke nxjerrë jashtë përdorimit fjalë të huaja të panevojshme.*”⁷⁵

Një kategori tjetër fjalësh, të cilat mund të sjellin pasurim duke u përfshirë në fjalorë, janë edhe ato që i kanë gjegjëset e tyre në shqipen letrare, si për shembull: *bulitë* (bulirë), *bërtimë* (bërtitje), *drangu* (shuli), *fërmon* (fryn), *gëmbër* (shkëmb i madh, rrasë), *i brydhët* (i bryllët), *kalor* (kalorës), *kanare* (kërdi, kasaphanë), *karpë* (shkrep), *marmaros* (nguros), *murtar* (i murrinë, i nxirë), *pallajsë* (pallat), *skorovod* (lugat, kanxhallos) etj., të cilat sjellin ngjyresa kuptimore dhe shërbejnë si stilkrijuese. Si stilkrijuese shërben edhe përdorimi me denduri të lartë i disa njësisve të leksikut popullor, si p. sh. i emrit *çap* (i) në vend të emrit *hap*; i foljes *sos* në vend të foljes *mbaroj*, *arrij* etj.

Brenda veprës së Kutelit ka vlerë të veçantë për gjuhën letrare edhe leksiku i figurshëm. Duhet thënë se Kuteli tregon ndjeshmëri të lartë artistike ndaj gjuhës, sepse ai arrin të figurativizojë edhe fjalët më të zakonshme të saj, siç janë për shembull mbiemrat lëndorë: *i bungtë*, *i dushkët*, *i grynjtë*, *i kërptë*, *i sedeftë*, *i shkëmbtë*, *i shëllirtë*, *i zëmbaktë* etj.; të mos flasim pastaj për përdorimin vetjak të disa mbiemrave të poetizuar përmes prapashtesimit, si: *avulloshë*, *bardhoshe*, *begatore*, *bryllët*, *freskoshe*, *hidhatake*, *majoshe*, *mbrëmësor*, *miturake*, *pjellëtore*, *thinjoshe* etj., të cilët gjithashtu ndihmojnë në krijimin e një stili gjuhësor origjinal, për shembull:

Njëri e pëlqeu me sy të zes, tjetri me sy të blertë, i treti me sy të qielltë, (po, po, Bardhoshi s’hoqi dorë nga sytë e qielltë), u martuan, bënë nga një palë fëmijë, rruan e trashëguan gjer arrinë pleq mjekërbardhë. (Vepra 4, f. 501); ...i dukej sikur dëgjonte Enkeleun, që i fliste me një zë të thellë mbrëmësor. (Vepra 3, f. 119) etj.

Kuteli realizon rikuptimësimin e figurshëm e vlerësues të shumë fjalëve abstrakte, si për shembull: *cingunëri*, *djeguri*, *djelmuri*, *drizëri*, *fismëri*, *lingëri*, *lirësi*, *logori*, *shtangësi*, *stërstërnipëri*, *trillesë*, *turqëri*, *ujqëri*, *vashëri*, *çupërlinëri* etj. Për shembull:

Ja, krushqari u fut në një drizëri e rri e përgjon, po veshët i kanë mbetur jashtë. Qilimi me ata të katër po i vjen rrotull drizërisë. (Vepra 4, f. 500); I sheh edhe hëna ato të dy motrat aë rrinë e përgjojnë në dritare, me sytë të kërcyer jashtë: ndofta nga habia, ndofta nga zemërqnësia. (Vepra 4, f. 439); Dhe zemrat gufonin në mes të djegurisë që u dukej kaq e ëmbël. (Vepra 3, f. 119) etj.

75. Gjovalin Shkurtaj, *Pesha e gjuhës shqipe*, Tiranë 2009, f. 3.

Në prozën e Kutelit gjenden modele të sintetizmit, të ekonomizimit gjuhësor veçanërisht te ndajfoljet e krijuara me anë të prapashtesimit, si: *arithi, capthi, derrçe, dyzash, fyta, gogolçe, hidhshëm, krahënderë marrtas, maçokçe, rrokas, vrulltas, zuzarhi* etj.

Ai rikuptimëson edhe një grup fjalësh me natyrë popullore të krijuara ose të rikrijuara me anë të prapashtesave zvogëluese: *-kë, -q, -th, -ush, -z* etj., duke marrë përveç kuptimit bazë edhe nuanca të tjera të ironisë, talljes apo përkëdheljes, sipas rastit, si: *atëlosh, e bukurëz, burrkë, burrth, i gjelbërth, i hollëz, lalush, i vogëlith, vëlasho, zonjëz* etj. Për shembull: *I japin një si rrogushkë e nuk e venë në bukë të madhe.* (Vepra 1, f. 291); *Felaqi feluqi, fiton hatëruqi.* (Vepra 1, f. 306); *...vinin kanistrat me gështenja avulloshë, arrat, kajkushkat, dardhat.* (Vepra 2, f. 118) etj.

Kuteli krijoi një varg foljesh mbi tema fjalëformuese emërore, të cilat bien në sy për figurshmërinë e tyre, si: *farkoj, hirosem, kosarit, llamburin, përkëmbet, vegëloj* etj.

Ai zgjeroi dhe pasuroi sinoniminë e gjuhës letrare në të gjitha tipat e saj, veçanërisht ata stilistikë me burime të ndryshme, si për shembull: *dhemkë* (dhembje), *djallore* (djallëzore), *e qëmoçme* (e moçme), *qamatare* (qaramane), *shtrigore* (shtrigë), *syqielltë* (sy ngjyrëqielli), *thatimë* (e thatë) etj.

Zgjeroi dhe përpunoi variantet stilistike sinonimike dhe ndërtime të tjera të ngjashme të tipit: *atëkohë, asokohe, asohere; e poshtme, e rëposhtme; fillthi, vetëmfillthi, fillikat; robërshë, robinjë; shtrigë, shtrigore, shtrigushe; skllaveshë, skllavinjë; tani, tanithi; thatime, thatoke; vrullshëm, vrulltas* etj.

Zgjeroi e zhvilloi antoniminë leksikore, stilistike e semantike të shqipes letrare, duke plotësuar në sistem strukturën leksikore të saj, si për shembull: *barkplot – barkbosh, degëvarur – degëngritur, dorëborë – dorëzezë, dorëngushtë – dorëgjerë – dorëhollë, gjuhëhollë – gjuhëtrashë, gojëprishur – gojëmjaltë, mustaqebubuzhel – mustaqepresh, pizgëtrashë – pizgëhollë, zemërgurësi – zemërgjerësi* etj.

Kuteli ka sjellë pasuri me veprën e vet edhe në fushën e polisemisë, duke pasuruar fjalët me kuptime të reja. Për shembull, për njësinë leksikore *shkrepje* ai sjell një kuptim të ri: *krunde*, ndërkohë që në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980, janë pasqyruar tri kuptime: *shkrepje* për shkrepjen e armës, *shkrepje* për zhurmën që shkakton ajo dhe *shkrepje* për më shkrepni në mendje, m'u tek. Po kështu për njësinë leksikore *fil*, po ky fjalor jep tre kuptime: *fil* për elefant, *fil* për secilën nga dy figurat që vendosen anash mbretit dhe mbretëreshës dhe që lëvizin cepazi në të gjitha kutitë e fushës, *fil* për të emërtuar buzën në të dy anët e kuvertës së anijes. Ndërsa Kuteli e përdor në një kuptim tjetër: u bë *fil*, për u shërua nga ndonjë sëmundje ose u qartësua mendërisht.

Fakti më domethënës për afrimin e Kutelit me gjuhën letrare, mbetet pasqyrimi i gjerë i leksikut të veprës së tij në fjalorët e shqipes, duke filluar që me shtresën e leksikut bisedor, leksikut krahinor të trevës juglindore, si dhe

atij ndër-dialektor, leksikut të huazuar dhe leksikut letrar dhe vetëm një pjesë e vogël, e pakonsiderueshme në tërësinë e njësive leksikore të veprës kanë mbetur jashtë tyre.

Duke u ndalur te fjalorthet shpjeguese me të cilat është pajisur seria e veprave të Kutelit, jemi përpjekur të hetojmë konkretisht pasqyrimin në fjalorët e shqipes të atyre njësive leksikore, të cilat i takojnë një fondi të lashtë leksikor ose që kanë karakter ngushtësisht krahinor dhe, del se gati 60 përqind (ose diçka më shumë) e tyre janë të pasqyruara në fjalorin e 1980-ës dhe 40 përqind jo. Mbeten pa u përfshirë, kryesisht njësi dialektore, të cilat emërtojnë elemente të veshjeve të hershme, objekte të vjetra, të cilat sot ose kanë dalë nga përdorimi, ose përdoren shumë rrallë, si për shembull: *bulitë, çepurkë, dajandë, daniskë, garan, gëmbër, jekuce, kllongjir* (të cilën Kuteli e përdor për spicat e akullit, ndërsa në fjalor kjo fjalë jepet për të emërtuar një lloj kërpu dhe), *krazë, leckarkë, mastrapan, matare, molla e kuqe, mollaqe, mollokof, mëregë, mërezhë, otra, pashmangë, pepellashkë, pepellashkë, peristil, pllashhtë, pod, pojatë, poshtagë, prapapash, qakapikë, shkurtelkë, shpargë, steren, tallamaz, tatrivan, telik* etj. dhe përfshihen të tilla si: *bulirë, çetur, damaluk, hordop, jatak, komçë, mazgallë, mballomë, palare, plevicë, shajkë, shaneshin, stringël, tabut, torbë* etj.

Pasqyrohen në fjalorët e shqipes edhe një grup njësish të leksikut krahinor që emërtojnë dukuri natyrore, frymorë, veprime etj., si: *agshol, brrac, buljareshë, bungishte, byrazer, cubar, dashtra, frëngjyzë, fërtymë, imshtë, lolis, ngjellkë, zograftis* etj. dhe mbeten jashtë tyre njësi të tilla leksikore, si: *laskandur, sahishtë, skorovod, drethkë, fërmon, kamai, kanare, krezhë, marmaros, ngrafis, namëna, tërhas, traminë, zgëllij, xhaftoj, sinjak* etj. Disa prej këtyre fjalëve kanë gjegjëset e tyre letrare e disa nuk i kanë, por sidoqoftë disa syresh vlen të pasqyrohen në fjalorë, si për shembull fjalët: *karabatak, torozhan*, të cilat emërtojnë lloje zogjsh karakteristike të krahinës, apo fjala *damf*, që emërton aromën dehëse të rakisë e të verërave etj.

Duket si më e prirura për të hyrë ndër fjalorët e shqipes veçanërisht kategoria e fjalëkrijimeve të tilla, siç janë emrat: *burrth, bërtimë, dekunë, delmator, drekëtar, gostiar, hobetar, mëshirtar, mysafirkë, ndragësi, nënurdhës, pagëtyrë* etj.

Si fjalëkrijim interesant do të veçonim leksemën *nënurdhës*, të cilën duket se autori e ka krijuar sipas gjedhes së fjalës *nënkëmbës*, por e veçanta është se ajo ndryshe nga e dyta, përveç vlerës shenjuese, mbart edhe një ngarkesë ironie e talljeje për ata tipa njerëzish të cilët i rrinë gatitu për çdo gjë personave, që kanë pozicione hierarkike lart tyre, si për shembull: *Qyqja... po grishte për drekë nënurdhësit e Kuma Maros*. (Vepra 4, f. 323).

Do të ishte me interes për fjalorët e shqipes edhe përfshirja në ta e disa neologjizmave në formën e mbiemrave, të cilët më së shumti janë stilistikorë, të tillë, si: *begatore, i bryllët, i bungtë, i bërlyktë, i krirtë, i murrtuar, i ndërdyshëm, pjellëtore, vrapëtare* etj.

Po kështu mund të diskutohet edhe për disa fjalëkrijime në formën e ndajfoljeve, të cilat shprehin një kuptim më të intensifikuar, apo më të ekonomizuar, si: *gogolçe, maçokce, njëmenthi, qetas, zuzarçe* etj., si dhe për disa fjalëkrijime onomatopeike, siç është rasti i fjalës *dang* (u), (megjithëse kjo e ka fjalën e saj gjegjëse *shul*), si dhe e disa të tjerave, si: *tërtëllashkë* (femër që flet shumë e pa brumë), *dëdëckat* (të dridhurat), *zhingërin* etj. Gjithashtu, mund të përfshihen ndër fjalorë edhe disa kuptime të reja fjalësh polisemike për të cilat folëm më lart.

Në përfundim, mund të thuhet se Kuteli hyn në ata shkrimtarë cilësorë që “*i kanë dhënë hov përparimi gjuhës me veprat e tyre, tue e lavrue e tue e pasunue.*”⁷⁶

Përmbledhtas, mund të thuhet se ndihmesa më e madhe e Kutelit në pasurimin e gjuhës letrare shqipe qëndron, së pari, te prurjet në fushën e leksikut të veçantë si ai në fushën e etnografisë, në fushën e etnobotanikës e të etnozologjisë për të cilin folëm edhe më herët; së dyti, në prurjet e leksikut të fushës së fjalëformimit dhe së treti, prurjet në fushën e figurshmërisë dhe frazeologjisë. Me vlerën dhe bollshmërinë e këtyre të fundit nuk u ndalëm meqenëse do të merremi hollësisht në kapitullin tjetër.

76. Xhevat Lloshi, *Silistika dhe pragmatika*, Tiranë 2005, f. 129

KREU III

FRAZELOGJIA POPULLORE NË VEPRËN E KUTELIT

Kuteli, si mjeshtër i fjalës shqipe, i sheh njësitë frazeologjike si një mundësi e shkëlqyer për ta pasuruar dhe hijeshuar gjuhën e veprës së tij, për faktin se ato *“i përkasin gjuhës së gjallë dhe kanë më shumë ngarkesë dhe figurshmëri.”*⁷⁶ Shprehje e këtij vlerësimi është numri i madh (rreth 700), si dhe tipologjia e tyre e larmishme.

Siç dihet njësia frazeologjike është përkufizuar *“si tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barazvlershme me fjalë të vetme”*⁷⁷, por, për të analizuar njësitë frazeologjike në një vepër letrare, në radhë të parë, duhet të kemi parasysh vlerat e tyre të mëdha diferencuese, emocionuese, shprehëse e stilistike, prandaj dhe *“barazvlera”* me fjalët duhet parë gjithnjë në raporte sinonimie. Pra, kur themi *“se një njësi frazeologjike është e barazvlershme me një fjalë, kemi parasysh kuptimin e tyre të përgjithshëm dhe atë kategorial, aftësinë për të shprehur diçka nga realiteti dhe jo një përputhje të plotë në përmbajtjen e tyre konkrete, të veçantë.”*⁷⁸ Peshën më të madhe të njësive frazeologjike të Kutelit e zenë ato me karakter popullor, por ajo që duhet nënvizuar, që në fillim, është se autori përdor jo vetëm frazeologjinë krahinore, e cila qartësohet si e tillë nga prania e shënuesve dialektorë e krahinorë, por edhe atë që shkon përtej këtyre kufijve, njësi frazeologjike me karakter të gjerë kombëtar. Kjo lidhet me vetë synimin dhe prirjen e autorit drejt gjuhës kombëtare. Realizimi i këtij synimi është rezultat i përmbajtjes së gjerë të veprës, e cila ka të bëjë me identitetin shumëplanësh të popullit shqiptar dhe i profilit të autorit si një krijues që e njeh shumë mirë gjuhën shqipe në tërësinë e saj.

Duke u nisur nga fakti se gjuha shqipe ka një pasuri të madhe në fushën e frazeologjisë dhe mundësitë të pashtershme për një pasqyrim sa më të nuancuar dhe me një ndjeshmëri artistike të lartë të mendimeve, ndjenjave, psikologjisë së personazheve dhe të mjedisëve, Kuteli i përdor dendur ato, me cilësi dhe me origjinalitet.

77.. J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981, f. 17

78. J. Po aty, f. 29.

Vepra e tij paraqitet e begatë përsa i përket leksikut popullor, prandaj, natyrshëm, ajo s'kish se si të mos vinte e tillë edhe në këtë fushë dhe, për më tepër, duket se ai e ka të qartë se frazeologjia është një mundësi më shumë për pasqyrimin e gjallë të jetës, të mjedisit gjeografik në të gjithë larminë e tij, për pasqyrimin e plotë të pasurisë kulturore, të filozofisë, të riteve, zakoneve, etikës etj., të krijuara nga breza të ndryshëm. Frazeologjia përdoret me frytshmëri edhe për të dhënë ngjyresat historike, mjedisore etj.

Kuteli përdor me sukses njësi frazeologjike frazeologji të larmishme si në përmbajtje dhe në tipologji. Vetë gjerësia e përmbajtjes së veprës, shtrirja e saj tematike dhe kohore, dikton njësi frazeologjike të pasura në ide, në figuracion dhe në ngjyrimet e shumta emocionuese dhe vlerësuese, aq sa është krejtësisht e pamundur të gjesh faqe të veprës së tij pa praninë e tre-katër njësisive frazeologjike, disa herë edhe mbi dhjetë të tilla. Njësitë frazeologjike hasen jo vetëm në gojën e personazheve, por edhe në gojën e tregimtarit. Ato janë në funksion të tipizimit të personazheve, të cilët janë jo vetëm të shumtë në numër, por, ç'është më kryesorja, me profile të ndryshme shoqërore. Njësitë frazeologjike, që ata përdorin në bashkëbisedim me njëri-tjetrin, apo në monologun e brendshëm, ndihmojnë drejtpërsëdrejti në zbërthimin e identitetit të tyre, se cilët janë, prej cilës shtrese shoqërore vijnë, ç'përvoja jetësore mbajnë mbi supë, çfarë formimi arsimor e kulturor kanë etj. Njësitë frazeologjike në veprën e Kutelit shërbejnë gjithashtu, edhe për tipizimin e mjedisit, ku personazhet jetojnë dhe veprojnë, si dhe në funksion të krijimit të vlerave të veçanta stilistikore. Për shembull:

Tha kështu e pastaj zuri të vrasë fqirë: "Po sikur ta vesh çupën djalë që të mos e njohë?". Kështu tha, kështu bëri: e veshi Xinxifillon si djalë, me një fustan të bardhë tërë kinda, me tirq e çepkene, i mbathi një palë opinga telatine, me xhufka, i vuri në kokë një takije të bardhë për shtatë palë qejfe, i futi në brez një fyell shtogu që të dukej si bir bariu.

Kur e pa Kuma Marua kështu, si rrogeç, ia plasi gazit me bërtimë të madhe, sa i bënë dëng-dëng tërë rropullitë e ment i dolën sytë si gogla dushku. Oshëtiu mali grykë më grykë. Piku e la sëpatën dhe e pyeti cinxëlleshën levorashe: "Ç'po bëhet kështu moj zonjë e madhe?". Po zonja e madhe vuri gishtin majë hundës e i tha: "Ssst... pusho se na dëgjon Kuma Marua, zoti i malit..." dhe u tultitën të dy nëpër degë e gjethe. Ashtu bënë edhe gjithë nënkëmbësit e tjerë të mbretërisë së Kuma Maros. Ndërkaq, ky qe ngopur nga të qeshurit dhe po murmuriste: "Edhe sikur në bri të buallit të futesh, moj Vesemblla, prapë s'më shpëton nga dora. Nuse e lalës të bëhesh, do të të kap, rabeckë të bëhesh, do të të zë. Unë e dua punën me të mirë, se, përndryshe bëj si di vetë."

Iu afrua Xinxifillos: ai sa një mal, ajo sa një cinxëlleshë, dhe e pyeti tërë hundë:

-Hë, moj Vesemblla, a i the ç'të pata thënë? Xinxifillua harroi se ish veshur djalë, e ia ktheu me zë të hollë:

-*Mua s'më thonë Vesemblla...*

-*Po si të thënkkan?*

-*Xin-xi-fi-lo!*

... *Mirë qofsh shëndoshë kështu si je, këtë punë do ta shohim, kur të na vijë uji në mulli.* (Vepra 4, f. 288) etj. ...*më mirë të mbulojë balta baltën, se na nxive, na bëre për faqe të zezë. E ç'të rrojë një njeri që s'është i zoti të nxjerrë bukën e gojës, hë? Pse s'mbytesh në pështymën tënde? Thuaj: "hapu dhe të futem!"* Në s'të pëlqen dheu, shko mbytu në kënetë. (Vepra 4, f. 402). Në shembullin e fundit, nëpërmjet njësisive frazeologjike që përdor autori, sqarohet mendësia dhe karakteri i personazhit të vëllait të vogël te tregimi "*Hapu, malore! Mbyllu malore!*", sipas të cilit, nuk është dinjitoz, nuk është burrë, madje nuk ia vlen të jetojë, kush nuk është i zoti të sigurojë mjetet materiale të jetesës për familjen dhe veten e vet.

Pasuria frazeologjike në veprën e Kutelit zbulohet edhe thjesht duke analizuar tekste të shkurtra, siç janë fjalitë dhe frazat në të cilat gjen shpesh mbi tre-katër njësi frazeologjike, për shembull:

U hodh menjëherë më këmbë e në brekë e në këmishë, rendi si langua, sa ment i doli shpirti edhe, sa hap e mbyll sytë, ish ku duhej – mur pas muri, derë pas dere e kyç më kyç. (Vepra 2, f. 217-218) etj.

Në prozën e Kutelit merr vlerë të veçantë ajo që shkruan Ali Jashari, se frazeologjia është pjesë e pandashme e formës së shprehjes dhe se ashtu "*si leksiku popullor në përgjithësi, edhe frazeologjia mbart vlera shënuese, shprehëse dhe emocionuese, që i vijnë në ndihmë autorëve të pasurojnë dhe të zhdërvjelltësojnë gjuhën e tyre, e sidomos, të realizojë synimet ideoestetike me mjete stilistikisht të fuqishme.*"⁷⁹ Njësitë frazeologjike në veprën e tij janë pjesë e rëndësishme e tharmit gjuhësor, sepse, duke e njohur shumë mirë këtë pasuri, di ta përdorë atë jo vetëm ashtu të gatshme, por në të shumtën e rasteve të përpunuar, si në përmbajtje dhe në formë, në varësi të asaj për çka ai shkruan. Ai shfaq edhe në këtë drejtim origjinalitetin dhe guximin e tij krijues në përpunimin dhe modelimin e tyre, në risitë që sjell, duke pasuruar ndjeshëm gjuhën shqipe edhe në këtë rrafsh, për shembull:

Ama kjo dridhet si fleta e plepit, lotët i rrjedhin kalivar, ia njomin llucën e rreshkur të faqeve e rrëkëllehen poshtë rruaza-rruaza... Sa të thuash një, dy, tri, e madhja bëhet veri, e mesmja bëhet jug, përzihen të dyja bashkë e bëhen drethkë që fryn e bubullon si në pisk të kollozhekut. (Vepra 4, f. 441); *I Malos je ti o djalë? A mos të thonë Rrapo? - Vetë dora.* (Vepra 2, f.124)...i *kisha krekuar veshët për të dëgjuar se çdo të thosh frëngu.* (Vepra 2, f. 133); *Ai s'bënte zë. Zë nuk bënte, po ndieja se ishte aty nga të lëvizurit e dorës.* (Vepra 2, f. 188); *Fjalën se ha bukë ia paska hapur Tarja i zi.* (Vepra 2, f. 199); *Nuk di si është atje imzot, se as syri më ka parë, as këmba më ka shkelur.* (Vepra 2, f. 209) etj.

79 . Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 1.

Jo rrallë, Kuteli e prish renditjen fillestare të gjymtyrëve të njësisë frazeologjike për të nënvizuar më me forcë idenë që ajo mbart, por, më kryesorja, në funksion të realizimit të një ndërtimi sintaksor më interesant dhe në funksion të kërkesës së tij të lartë stilistike, për shembull:

Po Fijes as tërr si bëri veshi (si bëri veshi tërr); ...*agai shikonte t'i vejë drejt tymi* (t'i vejë tymi drejt). (Vepra 2, f.50); *Prisnin me zemër në dorë* (prisnin me dorë në zemër). (Vepra 1, f. 193); *Si të mos gëzohem! Mal më bëhet zemra* (më bëhet zemra mal). (Vepra 4, f. 279) etj.

Kjo dukuri bëhet më e prekshme, veçanërisht, në urime dhe mallkime, si për shembull: *Më qafë ju kam unë!* (Vepra 4, f. 374); *Burrë u bëfsh, trim u bëfsh, e gjakun mos e harrofsh kurrë!* (Vepra 1, f. 186) etj.

Duke qenë se, siç thamë më lart, njësitë frazeologjike janë shenjuese të identitetit të personazheve, shenjuese të komuniteteve e mjediseve rurale në rrafshin historik, shoqëror dhe gjuhësor, është i natyrshëm karakteri popullor i tyre, gjë që pasqyrohet edhe në gjymtyrët e tyre përbërëse, të cilat më së shumti janë:

- pjesë të trupit të njeriut, si: *marr vesh*, *i merr krahun*, *i jep dorën*, *me dorë në zemër*, *nguli sytë*, në *pëllëmbë* të dorës, *i kthen kurrizin*, *var vetullat*, *ngrysi ballin*, *e shkel me këmbë*, *theu qafën*, *zë kokën* me *dorë* etj.

-fjalë që shënojnë kafshë, shpendë, objekte, sende me të cilat njeriu ka të bëjë në jetën e përditshme, si: si *pulë e lagur*, *ashtu i do mushka drutë*, *s'ja ha qeni shkopin s'ia vari torbën* etj. Njësitë frazeologjike që shfaqin më shumë interes janë ato të ndërtuara nëpërmjet metaforës dhe krahasimit, si: *krisi e iku*, *ia preu mendja*, *si flaka e zjarrit*, *si buka e ngrohtë*, *si kokë mërene*, *si peshku në të thatë*, *si rrip daulleje* etj.

Proza e Kutelit shquhet jo vetëm për praninë e madhe të njësive frazeologjike, por edhe për larinë tipologjike; kështu, për shembull, ato me funksion emërtues dhe me funksion vlerësues, ku do të vihej re menjëherë mbizotërimi i tipit të dytë; grupime të tjera mund të kishim duke u nisur nga ndërtimi etj. Pasuria dhe larmia e njësive frazeologjike të përdorura në vepër e vështirëson trajtimin e tyre, prandaj ne do të përpiqemi t'i analizojmë ato vetëm në disa aspekte të veçanta:

3. 1. Karakteristika të lidhjeve brendësore të njësive frazeologjike

Sikurse u shprehëm më lart, Kuteli shquhet për përdorimin vetjak dhe për risitë që sjell në përdorimin e njësive frazeologjike, në funksion të synimeve përmbajtësore dhe estetike, ndër to më interesantet janë: bjerja (reduktimi) e gjymtyrëve, variantet leksikore e sinonimike, rrethi i lidhjeve të ndryshme leksiko-sintaksore etj.

3.1.1. Bjerja e gjymtyrëve të njësisë frazeologjike

Në ligjërimin artistik të Kutelit është e pranishme dukuria e bjerjes së gjymtyrëve në strukturën e njësisë frazeologjike, e cila i shërben atij “për të rritur ritmin e ligjërimin, duke përqendruar vlerat kuptimore dhe shprehëse në një gjymtyrë dhe duke bërë organizime dhe lidhje të reja sintagmatike.”⁸⁰ Mospërsëritja e trajtës së plotë të njësisë frazeologjike është në përputhje me synimin e autorit për ekonomizimin gjuhësor. Për shembull:

Dhe foli e foli.

Ai s'ia vari: nuk i tha as “kacek me nepërka” as “breshkë moçali” as “nënë e djajve” – siç i thosh gjithë bota. (Vepra 4, f. 425); *Ky bënte sikur s'e shihte, s'ia varte fare, u shfrynte robinjave që vinin e shkonin.* (Vepra 4, f. 400) etj. Në të dyja rastet është paraqitur e rrëgjuar njësia frazeologjike *nuk ia vari torbën*, e cila është e barabartë kuptimisht me foljen (s'e) përfilli. Rrëgjimi, në këtë rast, e ruan të paprekur kuptimin leksikor dhe emocionues dhe ndërkohë rregullon ritmin e ligjërimin duke e përshpejtuar atë.

Këtë radhë i kish ardhur ujët në vijë edhe Llambit të Dangos edhe Tares së zi që t'i zbutin kurrizë atij mikut edhe s'kish njeri që t'i dalë zot. (Vepra 2, f. 204). Njësia frazeologjike *t'i zbutin kurrizë* është përdorur e rrëgjuar përkundrejt formës së saj të plotë: *ia bëri kurrizin më të butë se barkun*. Edhe në këtë rast, me më pak mjete gjuhësore, jepet më shumë informacion. Gjithashtu, mund të themi, se kjo futet në kategorinë e atyre njësisë të reduktuara, të cilat si rezultat i përdorimit të gjatë si njësi të rrudhura, kanë fituar një përdorim të pavarur; njësi të tilla frazeologjike te Kuteli gjejmë plot, si: *ia mbathi, u dha këmbëve* (ia mbathi me të katra, u dha këmbëve me të katra), *ia mblodhi* (ia mblodhi këmbët në një këpucë), *ia këndoi* (ia këndoi këngën); e hëngri (e hëngri sapunin për djathë), *ka lojtur* (ka lojtur mënc, ka lojtur krerësh), *e shkeli* (shkeli në dërrasë të kalbur) etj. Në këto raste, e gjithë pesha kuptimore e togut të plotë bie mbi gjymtyrën e mbetur, për shembull:

...erdhën armiq të na shkelin dhe ne të gjithë dolëm të luftojmë. (Vepra 4, f. 23) *... rrinin të heshtur, të ngrysur, tërë hundë.* (Vepra 1, f. 247); *S'le gur pa luajtur për të hapur ndonjë bisedë po nuk i ndezi.* (Vepra 1, 267) etj.

Në veprën e Kutelit disa njësi frazeologjike rrëgjohen për t'i shpëtuar ngadalësimin të ritmit, çka do t'i sillte mërzë lexuesit dhe duket se kjo dukuri bëhet më se e nevojshme edhe prej përdorimit të shpeshtë të tyre, për shembull:

“Kushedi se çdo të më punojë. Hëngërt kokën e vet!” Të nesërmen i vete në shtëpi e gjen tërë hundë e i thotë: hap sytë vëlla, mos shko në malore se kushedi ç'e keqe të gjen. (Vepra 4, f. 416); *...nuk ia prishim dot nuses.*

80 . A. Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 11.

(Vepra 4, f. 153); *Ajo dhe të vëllezërit prisnin që Xheladin beu të hidhte topin - kështu apo ashtu dhe t'i përulanin pasurinë.* (Vepra 1, f. 80) etj.

Trajtat e reduktuara janë karakteristike për njësitë frazeologjike foljore dhe jo për të tjerat. Kjo është e natyrshme, sepse “*gjymtyra foljore ka aftësi të mbartë gjithë peshën kuptimore e ngjyrimin emocionues dhe, në këtë mënyrë, folësi nuk e ndien të nevojshme të përmendë gjymtyrën e dytë.*”⁸¹ Në këtë përfundim të çon edhe analiza e njësive të tjera frazeologjike të reduktuara të përdorura nga Kuteli.

Në veprën e tij nuk mungojnë ndërtimet e tipit fjalë shërbyese + fjalë shënuese, të tilla si: *me një fîromë, nën mustaqe, pas krahëve, pa të thënë, prapa diellit, për hundësh, në tym, pa teklif, nër sy, nën urdhër, nën mustaqe* etj., për të cilat ka mendime të ndryshme nga studiuesit e frazeologjisë. Kështu, Jani Thomai, duke u nisur nga përkufizimi “*se njësitë frazeologjike gjuhësore janë togfjalësha në përbërjen e të cilëve hyjnë jo më pak se dy fjalë emërtuese*”⁸², i lë këto raste jashtë frazeologjisë, me argumentin se këto ndërtime nuk kanë dy fjalë tilla, prandaj për të ato “*janë lokucione vërtet me karakter idiomatik, por jo njësi frazeologjike*”⁸³ dhe se ato “*janë pothuaj që të gjitha rrjedhim i një reduktimi, pjesë prej ndërtimesh të plota frazeologjike*”⁸⁴, ndërsa Ali Jashari i quan këto ndërtime “*një tip sui generis sintagmash idiomatike, por jo njësi frazeologjike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.*”⁸⁵ Për shembull:

... për punë të mëdha duhen pare nën dorë. (Vepra 1, f. 286); *Ndenji nën këmbët e tij.* (Vepra 1, f. 284); *Ky qeshi nën mustaqe e tha: “Mirë, mirë, po do të vijë një ditë...”* (Vepra 1, f. 356) etj.

Si rezultat i rrudhjes, pra i rënies së gjymtyrëve, krijohen lidhje të reja leksiko-sintaksore dhe mund të ndodhë, që njësia e plotë frazeologjike të degëzohet në dy sintagma të cilat mund të funksionojnë si dy njësi frazeologjike më vete në kontekste të caktuara, për shembull:

na shkelën dhe na morën nëpër këmbë. (Vepra 2, f. 252). Në këtë rast kemi: *shkel me këmbë* në kuptimin e shtyp, e dhunoj dhe *marr nëpër këmbë*, në kuptimin e tall, e nënçmoj.

Pra, si përfundim, reduktimi i njësive frazeologjike përbën një dukuri të zakonshme në veprën e Kutelit, e cila përdoret prej tij kryesisht me synimin artistik, për të krijuar nivel të lartë figurshmërie të tyre në veçanti, si dhe të tekstit në përgjithësi, gjë që e realizon mjeshtërisht.

81. A. Jashari, *Rredh përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 19.

82. *Studime mbi leksikun mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, 1, Tiranë, 1972, f. 356.

83. Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981, f. 128.

84. Po aty.

85. A. Jashari, *Rredh përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 17.

3.1.2. Përsëritja e gjymtyrës së njësisë frazeologjike brenda një konteksti

Një dukuri tjetër që bie në sy te vepra e Kutelit, është përsëritja e njërës gjymtyrë të njësisë frazeologjike në të njëjtën fjali, apo në të njëjtin kontekst, gjithnjë në funksion të synimit të autorit për ta transmetuar qartë dhe me forcë kumtin apo veprimin, si dhe për të rritur shprehësinë e tekstit etj. Për shembull:

Njerëzit qahen e thonë se do ta shpien bulmetin e lëkurët në Lisos. Unë ju them të presin gjersa të merremi vesh. Po, po, do të merremi vesh. (Vepra 3, f. 342); *Dinë ta punojnë dyfekun. Punoi e punoi ky dyfek i Sefedinit gjersa tre Gjatollinj mbetën shtrirë.* (Vepra 1, f. 184); *Do t'ju shuajmë fare, do t'ju shuajmë nga faqja e dheut.* (Vepra 1, f. 198) etj.

Duke u nisur nga kohët që merr folja gjatë përsëritjes në njësitë frazeologjike, mund të gjykojmë për disa raste:

- veçimi dhe përsëritja e gjymtyrës foljore njëherë në kohën e shkuar dhe njëherë në kohën e ardhme: *Hapmë udhë, se po s'më hape ti, do ta hap vetë.* (Vepra I, f. 355); ... *Ndoni e kish pasur syrin pishë, kur bridhte nëpër Mokër e Gorë dhe kështu do ta kish, sepse për xhaxhon këngëtar Zallorët e shpinin gjakun gjer mbi gju.* (Vepra I, f. 342); ... *mjaft e kam ngarkuar qafën. Nuk do ta ngarkoj dot më shumë.* (Vepra 1, f. 303) etj.

- Përsëritja e gjymtyrës foljore njëherë në kohën e tashme të lidhores dhe njëherë në kohën e shkuar (e kryer), për shembull: *Qofsh shëndoshë, moj bijë, e të na e zbardhësh faqen siç na e ke zbardhur.* (Vepra 3, f. 94) etj.; siç duket edhe në shembujt e mësipërm, në disa raste nuk mungojnë edhe aktualizuesit (ndajfoljet), të cilët kryejnë të njëjtin funksion që kryen veçimi e përsëritja.

Në përgjithësi, njësia e plotë frazeologjike jepet në fillim dhe më pas ndodh përsëritja e gjymtyrës foljore, e cila e vë më në dukje veprimin, për shembull:

I thonë myftiut të Korçës: Myfti, të hëngërt morti!” Dhe e hëngri. (Vepra 1, f. 127); *Ti s'e ke në dorë... ndofta e ke po s'do.* (Vepra 1, f. 249) etj.

Në veprën e Kutelit përsëritet dendur gjymtyra foljore e njësisë frazeologjike, por nuk mungojnë edhe rastet e përsëritjes dhe perifrazimit të gjymtyrëve të tjera. Për shembull:

...e *nuk i trembej syri as nga mbreti, as nga hasmi. Gishti e syri i tij bënin çudira.* (Vepra 1, f. 183); *iu shiti si në ëndërr - ama ëndërr nga ato me sy hapur.* (Vepra 1, f. 185) etj.

-Përsëritja e gjymtyrës foljore të njësisë frazeologjike në të njëjtën kohë, vetëm se në këto raste lidhjet janë mohuese, për shembull:

Asllani nuk u përgjigj. Tundi kryet: edhe merrte vesh edhe s'merrte. (Vepra 1, f. 304); *U prisha e s'u prisha menç nga gëzimi.* (Vepra 2, f. 94) etj. Përfshijmë këtu edhe rastin, kur njësia frazeologjike fillestare përmban një

veprim në formë urdhëri, si për shembull: **Jepu këmbëve, jepu!** (Vepra 4, f. 449) etj.

Në veprën e Kutelit ndeshet shpesh edhe përsëritja e plotë e njësisë frazeologjike, e cila e bën më interesant tekstin. Për shembull:

Ajo i hyn në zemër atij, ai i hyn në zemër saj. (Vepra 4, f. 339); *Gjin Bardhela i nxiu faqen vetes, i nxiu faqen të vëllait, i nxiu faqen gjithë arbërit.* (Vepra 4, f. 207); *Unë s'të marr vesh, o djalë, - tha Ago Zylali me një farë pikëllimi, - s'të marr vesh si je bërë kështu, kaq i prapë?* (Vepra 1, f. 287); *Dardhojmeli s'hiqte dorë nga e tija, Mrikalemi nuk e donte e s'hiqte dorë nga e saja.* (Vepra 4, f. 189) *Duhet t'i vemë gishtin kokës si vëllezër që jemi. I vënë këta gishtin kaplloqes dhe e pleqërojnë mirë punën.* (Vepra 4, f. 480) etj. Në shembullin e fundit, zëvendësimi i njësisë standarte *kokë* me njësinë dialektore *kaplloqe* të njësia e dytë, rrit edhe më shumë shprehësinë.

Te Kuteli kemi dhe raste të mospërsëritjes së një gjymtyre të njësisë frazeologjike, për shembull: *...unë s'ju pyes për trima sidokudo, për kokëshkretë, nga ata që s'i merr as kandari, as kalemi, po për trima të vërtetë.* (Vepra 1, f. 175) etj. Folja *merr* këtu hyn në lidhje me dy emrat *kandar* dhe *kalem*, duke krijuar një lloj përshkallëzimi kuptimor, ndërsa, të marra veçmas, do të krijonin secila njësi frazeologjike më vete, por natyrisht me lidhje të ngushtë midis tyre.

Edhe në disa raste kur personazhet dialogojnë dhe rimarrin të njëjtën njësi frazeologjike, e bëjnë këtë në mënyrë të reduktuar, për shembull:

-Hasha më thertë! – *ia preu gjyshja e qeshi me burbujë shpelle, se e ngiste gjithnjë duhani.*

-E pse hasha, moj guguçe...

-Hasha, e më thertë tylbja e Shën Kostandinit se ke qenë ndonjëherë i ri! (Vepra 2, f. 141); *Me gjithë këto të mira që zumë në gojë e ato që nuk i zumë fare.* (Vepra 1, f. 65) etj.

Nga sa pamë më lart, mund të thuhet se Kuteli, si mjeshtër i përdorimit e përpunimit të njësisë frazeologjike e përdor po mjeshtërisht përsëritjen apo mospërsëritjen e një gjymtyre të njësisë frazeologjike, gjithmonë sipas kontekstit dhe se ndryshimet strukturore sjellin edhe ndryshime kuptimore e stilistike dhe pasurim të gjuhës edhe në këtë drejtim.

3.1.3. Variantet leksikore sinonimike në frazeologji

Në prozën e Kutelit shfaqen shpesh variantet leksikore në njësitë frazeologjike; kështu e njëjta njësi ndryshon gjymtyrë me fjalë, të cilat janë në raporte sinonimike (jashtë njësisë frazeologjike mund të mos jenë të tilla) me njëra tjetrën, gjë që tregon, nga njëra anë, mundësitë e mëdha leksikore të shqipes dhe, nga ana tjetër, aftësinë e autorit për t'i shfrytëzuar ato maksimalisht dhe për të sjellë risi dhe pasurim të mëtejshëm. Variantet leksikore janë të shumëllojshme:

-Gjymtyra foljore zëvendësohet nga një tjetër folje: *Del në treg e jep e merr me mendje*. (Vepra 4, f. 487); *E hedhin e presin me mendje*, veç e veç: “Ç’na ish kjo? (Vepra 4, f. 438); *Po ngadalë nis të marrë veten dhe e pleqëron kështu me mendje*. (Vepra 4, f. 281); *Unë kisha në mendje të të thosha se tërë pasurinë time desha t’ua le fëmijëve të tu*. (Vepra 4, f. 411); *Si s’po e sheh i thotë mendja se mos ka shkuar në malore*. (Vepra 4, f. 424); *Aty fshin djersët e vret mendjen i shushatur*. (Vepra 4, f. 406) etj. Në shembujt e dhënë ndryshon gjashtë herë gjymtyra foljore dhe megjithëse sinonime (vetëm brenda njësave frazeologjike) ato shprehin shkallë të ndryshme të intensitetit të veprimit, në përputhje me kontekstin. Kështu, në këtë këndvështrim, ato mund t’i ndajmë në dy grupe: *pleqëroj, kam, thotë*, të cilat shprehin një proces të menduarit disi më të zbehtë dhe, nga ana tjetër, treshen *jep e merr, e hedhin e presin, dhe vret*, të cilat shprehin një proces më intensiv, më të përforcuar, si dhe me vlera emocionuese më të forta.

Ndërkëmbimi i gjymtyrëve foljore mund të shërbejë edhe për të krijuar shkallëzim kuptimor dhe emocionues, gjë që vihet re edhe në njësitë e mëposhtme:

Muji e ndjek me sy gjersa s’shihet më. (Vepra 4, f. 66); *...hedh sytë rrotull oborrit e s’sheh njeri*. (Vepra 4, f. 92); *...hap dritaren e kullës e lëshon syrin rrotull fushës*. (Vepra 4, f. 78); *...ia qepa sytë një druje të njomë*. (Vepra 4, f.398); *...i vete syri ne qilimi që ish mënjanë*. (Vepra 4, f. 482). Shkallëzimi i gjymtyrëve foljore të vëna në raporte sinonimike ndjek linjën: *vete, hedh, lëshoj, ndjek, qep*, duke shënuar si pikën më të lartë foljen e fundit.

- Gjymtyra emërore zëvendësohet me një tjetër emër, për shembull:

Atëhere Bardhua e mbledh veten. (Vepra 4, f. 483); *Nejse, e mblodhi mendjen*. (Vepra 4, f. 415); *Mblidh fiquirë, o i mirë*. (Vepra 4, f. 388) etj. Ndryshueshmëria e emrave në shembujt e mësipërm është në përputhje me rrethanën e ligjëritimit. Te njësia frazeologjike që ka në strukturë emrin *fiquirë*, ngjyresat emocionuese janë më të spikatura, sesa te dy të parat dhe duket se autori e ka përzgjedhur atë edhe në funksion të krijimit të rimës me fjalën *i mirë*.

Këmbimi i emrave bëhet i diktuar nga rrethanat e ligjëritimit dhe synimi për të rritur shprehësinë e tekstit. Kjo duket qartë edhe në shembujt e mëposhtëm: *E madhja var hundët ... E mesmja var buzët*. (Vepra 4, f. 439). Duke dhënë të njëjtën gjendje shpirtërore të dy motrave, autori shmang rutinën varfërinë leksikore duke zëvendësuar emrin *hundë* me emrin *buzë*. Ndërsa në shembujt e mëposhtëm shprehen nuancime kuptimore apo vlera shprehësie: *T’i vëmë gishtin kokës... ...t’i vëmë gishtin kaplloqes*. (Vepra 4, f. 480); *...bubullon një zë që të kall datën*. (Vepra 4, f. 406); *...i kishin kallur tmerrin gjithë Kralisë*. (Vepra 4, f. 104); *dëgjohet një tingëllimë e madhe sa tundet dheu!* (Vepra 4, f. 118), *Dasmë e madhe sa u tund bota!* (Vepra 4, f. 383); *Sheqeres i qeshi fytyra*. (Vepra 1, f. 87), *Sa e pa i qeshi dhëmbi*. (Vepra 4, f. 290), *Beu e shikoi gjithë epsh dhe i qeshi buza*. (Vepra 1, f. 70); *...dhe mori*

arratinë... ..atij ia kish frikën dhe ariu i madh dhe merrte **malet** kur ia dëgjonte emrin. (Vepra 4, f. 340); ...*lajmi mori dhenë*. (Vepra 4, f. 316) etj.

Variantet sinonimike të gjymtyrëve të njëjësive frazeologjike realizohen duke përdorur krijime të të folmeve e dialekteve të ndryshme, si dhe nëpërmjet përpunimit vetjak. Kjo vërehet në shembujt e mëposhtëm:

...*Gjin Bardhelës iu err fare mendja*. (Vepra 4, f. 206); ...*ata thoshin se i çalonte mendja*. (Vepra 4, f. 380); *Aty i madhi e humb mendjen fare*. (Vepra 4, f. 413); *Përpiqej t'ia merrte mendtë*. (Vepra 4, f. 499); *krushqari ia mori mendjen*. (Vepra 4, f. 478)...*po të vish, do të lozësh mënç kur të shikosh*. (Vepra 4, f. 79); ... *të vinte mendja qerthull nga era e mirë*. (Vepra 4, f. 309); *Po çudia e çudive ishte shpella brenda ...me ato stolira që të luajnë mend e kresë*. (Vepra 4, f. 309) etj.

Karakteristikë për Kutelin është realizimi i variacionit leksikor “përmes përdorimit të shumtë të fjalëve sinonime në kontekste të caktuara dhe në përputhje me veçoritë e situatës ligjërimore, duke krijuar kështu “çerdhe” sinonimesh frazeologjike.”⁸⁶ Për shembull:

...*ngjit me të katra shkallët e gurta*. (Vepra 4, f. 357); ...*ia merrnin me të katra drejt shatrivanit*. (Vepra 4, f. 377); ...*lëshoi një britmë, sa u tund tërë lajthishta e u dha këmbëve* (me të katra). (Vepra 4, f. 291); ... *e nget kalin me të katra e zhduket me gjithë nuse*. (Vepra 4, f. 165); ...*u lëshua me të katra ta zerë ta mbytë*. (Vepra 4, f. 513-514); *Kuajt ikin me të katra nëpër ferra e gjemba*. (Vepra 4, f. 473); ...*të gjithë ua mbathën me të katra*. (Vepra 4, f. 58); *Të tjerët... ua japin këmbëve e ikin fluturimthi*. (Vepra 4, f. 339) etj. Siç shihet, te ky shembull këmbehen jo pak, por tetë folje, gjë që tregon qartë aftësinë e tij për t'i përdorur ato në funksion të nuancimeve të holla kuptimore.

Në veprën e Kutelit bie në sy pasuria e varianteve leksikore veçanërisht te njësitë frazeologjike që shprehin gjendje të fortë emocionuese, për shembull:

Neve na e dërrmoi zemrën, prandaj u fikëm. (Vepra 4, f. 134); ...*Mujit iu thye zemra e vajton*. (Vepra 4, f. 133); *Atij do t'i plasë zemra nga dhimbja e do të dalë nga kulla*. (Vepra 4, f. 126); ...*mëmës iu këput zemra dhe lëshoi një shërëmëtimë*. (Vepra 4, f. 21); ...*diç do t'i ketë ndodhur Dizdar Osman Agës e shokëve të tij... Dhe i pikoi në zemër*. (Vepra 4, f. 113). Lidhjet e njëjësive foljore dërrmoj, thyej, këput dhe pikoj janë në lidhje metaforike me gjymtyrën e përbashkët emërore zemër dhe ngjyrimi emocionues shënon pikën kulmore te njësia e fundit. Kjo mund të thuhet edhe për shembujt e mëposhtëm:

Ato do të kthehen në strofkë që t'ia marrin me gjumë. (Vepra 4, f. 408); ...*edhe kësaj here i zuri gjumi*. (Vepra 4, f. 438), *S'vuri gjumë në sy*. (Vepra 4, f. 112), ...*gjumi e preu mirë e mirë aty nga mëngjesi*. (Vepra 4, f. 354); *Flije mendjen*. (Vepra 4, f. 416), *Nejse, e mblodhi mendjen* (Vepra 4, f.

86 . Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 31.

415); *Mos qaj se të preu e zeza.* (Vepra 4, f. 446), *Pusho se na hëngri e zeza po na dëgjuan atje poshtë.* (Vepra 4, f. 413) etj.

Variacioni leksikor në frazeologji i lejon Kutelit realizimin e ndërtimeve të reja me anë të cilave rrit shprehësinë ligjërimore dhe pasuron më tej shqipen në këtë drejtim. Ndërtimet e reja letrare, të ngritura mbi njësi frazeologjike të njohura për ligjërimin bisedor, karakterizohen nga kuptime të figurshme të krijuara në raportet midis gjymtyrëve të njësive frazeologjike, për shembull, duke u bazuar te struktura e njësisë *me shpirt ndër dhëmbë* (Vepra 4, f. 493), Kuteli sjell një variant të përpunuar *me shpirt në gojë* (Vepra 4, f. 165); ose, duke u bazuar te njësia e njohur frazeologjike *e ka shpirtin në majë të gjilpërës*, krijon dy variante sinonimike të një njësie të re, në të cilën figurshmëria është mjaft e lartë: *...jemi nga ata që e kemi shpirtin në majë të ushtës.* (Vepra 4, f. 470); *...se unë e kam shpirtin në majë të heshtës.* (Vepra 4, f. 349) etj.

3.1.4. Rrethi i lidhjeve leksiko-sintaksore të njësive frazeologjike

Rrethi i lidhjeve leksiko-sintaksore në mikrokontekste të ndryshme në një vepër letrare përbën një terren të mirë për çdo shkrimtar për të sjellë risi në fushën e frazeologjisë dhe për ta bërë më interesant materializimin gjuhësor të ideve apo emocioneve. Edhe në këtë pikë vepra e Kutelit ka begati dhe risi, duke u mbështetur fort te mundësitë e pakufishme që i ofron gjuha mëmë dhe duke e pasur të qartë se konteksti ndikon në njësinë frazeologjike, sikurse në njësinë semantike dhe, si rrjedhojë, ato mund të shpërfaqin një spektër më të gjerë të vlerave të tyre stilistiko- emocionuese.

Duke e ditur se rrethi i lidhjeve të reja leksiko-sintaksore varet kryesisht nga tipi leksiko-gramatikor i vetë njësisë frazeologjike, atë do ta marrim si pikënisje për analizën e tyre.

Duke analizuar njësitë frazeologjike në veprën e Kutelit, vërehet se denduri më të madhe kanë **njësitë frazeologjike me vlerë ndajfoljore**. Për të argumentuar këtë po marrim njësinë *sa të hapësh dhe të mbyllësh sytë*, e cila në prozën e Kutelit, përdoret në bashkëvajtje me foljet *ndryshoj, çatis, hyj, sos, marr, ndërroj, hidhem, mbetem, dyndem, bëj, shtrihem, shkulem* etj., duke zbuluar kështu të gjitha nuancat e saj kuptimore dhe vlerat emocionuese, për shembull:

Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, moti ndryshon: dynden retë e zenë diellin. (Vepra 4, f. 86); *...Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, Kotorret e reja marrin flakë fund e majë.* (Vepra 4, f. 102); *Sa të hapësh e të mbyllësh sytë sofrë mbeti e zbratur, pa një thërrime për të ngjëruar miqtë.* (Vepra 4, f. 352); *Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, kafshët që duan mish e gjak u hodhën e i bënë fertile.* (Vepra 4, f. 319); *Sa të hapësh e të mbyllësh sytë Gjeto Basho*

Muji **u hidhet** shpatëzhveshur shokëve të Kreshto Kapedanit. (Vepra 4, f. 186); **Sa të hapësh e të mbyllësh sytë**, çatisi lumi. (Vepra 1, f. 357); **Sa të hapësh e të mbyllësh sytë... shkulën** shpatat dhe i grinë. (Vepra 3, f. 307); **Sa të hapësh e të mbyllësh sytë**, toga e Epokilit të Pelës ishte shtrirë përdhe. (Vepra 3, f. 194); **sa të hapësh e të mbyllësh sytë** përballë turqërisë **u derdh** një rrëke kalorësish. Arbër. (Vepra 4, f. 239) etj.

Njësinë frazeologjike **sa të hapësh e të mbyllësh sytë** e gjejmë të lidhur edhe me njësi të tjera, çka e bën ndërtimin dhe më interesant. Për shembull: **Sa të hapësh e të mbyllësh sytë**, gjyshja ndërroi prapë fletën. (Vepra 1, f. 108); **sa të hapësh e të mbyllësh sytë**, kërcyen më këmbë gjithë shqiptarët! (Vepra 1, f. 149) etj.

Po kështu, njësia frazeologjike me vlerë ndajfoljore **ballë për ballë** krijon rrethin e lidhjeve me folje të ndryshme, si: *dal, qëndroj, flas, them, luftoj* etj.; njësia frazeologjike **pikë e vrer** bashkëlidhet me foljet: *bëhem, shkoj, ik, kthehem, flas, gjej, lë* etj.

Në varësi të lidhjeve të reja leksikore, mund të kemi edhe kuptime të reja të njësisë frazeologjike, për shembull: *me mustaqet pizgë përprjetë*. (Vepra 1, f. 266), ka kuptimin: është krenar, është me kokën lart; ndërsa në shembullin: *me veshët përprjetë*. (Vepra 4, f. 286) kuptimi është krejt tjetër: dëgjonte gjithshka me vëmendje.

Me funksion kuptimdallues është edhe konteksti. Si shembull po marrim njësinë frazeologjike *me dorë në zemër*:

- *Gjyshe, a nuk më thua tashti, se po të pres me dorë në zemër, ku ndodhet Argjiri i teto Marinës sonë* (Vepra 1, f. 107); njësia frazeologjike këtu ka kuptimin *pres me padurim*.

- *Shëndetin e kish pasur grurë: burrë i ngjeshur, dërdëng, ta çaje ta bëje katër; kamjen të rëndë, shumë brezash, sa as vetë s'ia merrte dot radhën me të numëruar e me kalem; bujqit, raja e harbutë, të gjithë me dorë në zemër, si nuse kauri; s'guxonin t'i thoshin as me emër, as ta shikonin në dritë të syrit* (Vepra 1, f. 64); në këtë kontekst njësia në fjalë shpreh kuptimin: tregohet i bindur, i gatshëm.

- *Nxirr tashi divitin e bëj hesap ... Në mos me divit bëje me dorë në zemër* (Vepra 1, f. 123); këtu njësia frazeologjike *me dorë në zemër* merr kuptimin e kryerjes së një veprimi *me drejtësi* ose *me dashuri*.

Njësitë frazeologjike me vlerë foljore në veprën e Kutelit përdoren si njësi me lidhje të shumta leksikore e sintaksore.

Në strukturën e njërive frazeologjike foljore bën pjesë një emër i shumëpërdorur, si: *kokë, këmbë, krah, rrugë, besë, bisht, buzë, dhëmb, gisht, gojë, hundë, mendje, qafë, sy* etj. Për shembull, emri *zemra* është gjymtyrë në një sërë njësisish frazeologjike me vlerë foljore, të tilla, si: *iu mbush zemra, iu këput zemra, i qan zemra, i bëhet zemra mal, i doli zemra nga kraharori, i del nga zemra* etj.

Në rrethin e lidhjeve leksiko-sintaksore, që sjellin vlera të reja kuptimore e emocionore të njësive frazeologjike, bien në sy ato që shprehin mënyrën e kryerjes së veprimit, për shembull: *Atit i mbushet zemra plot dritë.* (Vepra 4, f. 141); *...po ma mbush zemrën me vrer.* (Vepra 4, f. 198); *...i mbushet zemra me gaz.* (Vepra 4, f. 166); *...i mbushet zemra me të keqen.* (Vepra 4, f. 467) etj.

Në tërësi, njësitë frazeologjike në veprën e Kutelit hyjnë në lidhje me fjalë e togfjalësha duke zbuluar vlerat e tyre të plota kuptimore e stilistike, gjithnjë në funksion të asaj që autori dëshiron të shprehë, si dhe të vetë përmbajtjes së tyre.

3.2. Karakteristika të lidhjeve të jashtme të njësive frazeologjike

Meqenëse njësitë frazeologjike në veprën e Kutelit janë të shumta në numër dhe mbajnë peshën kuptimore në kontekste konkrete, është i drejtë përkujdesi i tij për një përdorim të qëllimshëm të tyre, gjë që duket në mënyrën se si ai i përpunon dhe se si i lidh ato me njëra tjetrën, duke mos munguar edhe prurja e risive në këtë fushë.

3.2.1. Shkrirja e njësive frazeologjike në sintagma

Dihet se “kontaminimi është shkrirja, bashkimi, përzierja ose ndërthurja e dy a më shumë njësive frazeologjike në një ndërtim të vetëm.”⁸⁷ Kontaminimi është në funksion të kërkesës përmbajtësore dhe estetike, ai sjell ekonomizim të mjeteve gjuhësore dhe shprehësi të tekstit dhe nuk është vetëm kërkesë e shprehësisë së informimit. Për shembull:

Hidhu e më merr krahun. (Vepra 3, f. 461); këtu mendojmë se janë kontaminuar dy njësi frazeologjike: *përvesh krahët* “ia hyj punës me zell e me të gjitha forcat” dhe *marr krahun* “e përkrah dikë, bëhem me të”. Mospërsëritja e gjymtyrës së përbashkët *krahët* shënon shkrirjen e këtyre dy njësive frazeologjike, duke na krijuar një strukturë të re me më pak mjete gjuhësore dhe më intensive për nga përmbajtja dhe shprehësia.

Struktura e re e lindur nga shkrirja e dy njësive frazeologjike sjell rritje të peshës kuptimore dhe emocionore në krahasim me rastin kur ato përdoren veç e veç, për shembull: *ta përpijë me gjithë leckë, lapra e kokalla.* (Vepra 3, f. 449); *të mbajmë fjalën e besën.* (Vepra 3, f. 226) etj. Gjymtyrët e dyta emërore *lapra e kokalla* dhe *besën* shtojnë vlerat kuptimore mbi të parat. Ndonëse të përdorura brenda një sintagme, ato do të ruanin të njëjtin kuptim me tjetrën. Në shembujt e mëposhtëm shohim se ato sjellin edhe vlera të përforcuara emocionore dhe shprehëse:

87. A. Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 61.

...do t'ju mbajmë në pëllëmbë të dorës me pekule. (Vepra a, f. 270); këtu janë shkrirë njësitë frazeologjike *mbaj në pëllëmbë të dorës* dhe *mbaj me pekule*, ku gjymtyra emërore *pekule* më shumë se rritje kuptimore, sjell përforsim të ngjyrimin emocionues e shprehës. Të njëjtën gjë mund të themi edhe në shembujt në vijim: *kishte zi e zibiti*. (Vepra 1, f. 260); *të boj shesh e londinë*. (Vepra 1, f. 227); *të bëhi vegla e qojle*. (Vepra 1, f. 216); *s'i merr as kandari as kallmri*. (Vepra 1, f. 175); *u bë urë e gur*. (Vepra 1, f. 171); *nuk u qe ndier nami e nishani*. (Vepra 1, f. 64); *në mos me divit, bëje me dorë në zemër*. (Vepra 1, f. 122) etj.

Vërehet se në veprën e Kutelit mbizotërojnë shkrirjet e njësive frazeologjike të tipit folje + emër, të cilat kanë të përbashkët gjymtyrën foljore dhe që nga ana kuptimore janë sinonime, për shembull:

të paqenën e bëjnë të qenë, të pabërën të bërë. (Vepra 3, f. 266); *bëhet hi e fani*. (Vepra 3, f. 459); *krisja me kosë, me sopatë e ç'të të zerë dora*. (Vepra 1, f. 247); *në ke mend e kokë*. (Vepra 1, f. 227); *bëjnë shumë dredhira e djallëzira*. (Vepra 4, f. 125); *nuk ia merrte dot radhën me të numëruar e me kalem*. (Vepra 1, f. 64); *flas me të drejtën e zotit, me dorë në zemër*. (Vepra 1, f. 175) etj.

Te Kuteli kemi shkrirje të njësive frazeologjike, të cilat, megjithëse e kanë të përbashkët gjymtyrën foljore, nuk janë sinonime, por funksionojnë si të tilla brenda një konteksti të caktuar. Për shembull: *Zemrën e ke të bardhë, gojën brisk*. (Vepra 3, f. 407); *...i hipin në kokë gjithë xhindet e xhindeshat*. (Vepra 4, f. 459); *varte hundët e krahët*. (vepra 3, f. 26); *bënte be e rrufe për të gjitha perënditë e Olimpiti*. (Vepra 3, f. 256); *e lidhur pas rrënjëve, jo pas degëve*. (Vepra 3, f. 475); *Unë sikur nis të marr vesh, në tym*. (Vepra 3, f. 509); *s'ish rënë prej qielli s'ish as për të qeshur*. (Vepra 1, f. 113) etj.

Disa njësi frazeologjike i gjejmë në dy forma, si: *Xheladin beu s'guxoi të bënte as gëk as mëk*. (Vepra 1, f. 84) edhe në formën e tyre të thjeshtë si: *s'e lenë të bëjë gëk*. (Vepra 1, f. 334) etj.

Ka raste kur shkrihen dhe dy njësi frazeologjike që kanë të përbashkët gjymtyrën emërore, ndërsa gjymtyrët foljore mund të jenë sinonime të mirëfillta, sinonime kontekstuale ose antonime, si: *shtrohu e rri si në shtëpinë tënde*. (Vepra 1, f. 222); këtu janë shkrirë dy njësitë *shtrohu në shtëpinë tënde* (mos ik andej-kënde, mblidhu) dhe *rri si në shtëpinë tënde* etj.:

...*qe mbledhur vreri lëmsh në zemër*. (Vepra 1, f. 329), në këtë rast janë shkrirë dy njësitë *iu mblodh vreri në zemër* dhe *iu bë një lëmsh në zemër*; *ia kishin bërë lëkurën dy pare*. (Vepra 1, f. 283), shkrihen njësitë *ia bëri lëkurën shoshë* dhe *i vlen lëkura dy pare*; *Të vret në gjumë me dorën e tjetrit*. (Vepra 1, f. 266), kontaminohen njësitë *të vret në gjumë* dhe *të vret me dorën e tjetrit*.

Te Kuteli nuk mungojnë rastet e shkrirjeve origjinale, të cilat sjellin një njësi të re si nga ndërtimi, ashtu dhe nga kuptimi, njësi, e cila ruan lidhjet me dy njësitë frazeologjike prej të cilave është përfuar. Për shembull:

...*beu bëhej si i thonë, qumësht e mjaltë.* (Vepra 1, f. 68), në këtë rast njësia e re frazeologjike *qumësht e mjaltë*, mendojmë se është krijuar nga shkrirja e njësive *qumësht dallandysheje* “ushqim shumë i zgjedhur, i rrallë e i shtrenjtë; diçka shumë e rrallë, që nuk mund të gjendet” dhe *si miza pas mjaltit* “të gjithë përnjëherësh e me kënaqësi për të përfituar nga diçka e mirë”; ... *ishte si ata të ligj që të hanë nga prapa.* (Vepra 1, f. 68). Kjo njësi e re mendojmë se mund të jetë krijuar si rezultat i shkrirjes së njësive *ia hëngri kokën* “e shkatërroi krejt, e asgjësoi pa mëshirë, e zhduku përfundimisht, e vrau me egërsi”, dhe *punon prapa krahëve* “(dikush) sillet e vepron, fshehurazi, është tinëzar”.

Ndezi një cigare esëll që t’ia priste vrundullin e rrotullimit e ta mbante mendjen në vend. (Vepra 1, f. 67), njësia e re *ta mbante mendjen në vend* mund të jetë krijuar nga njësitë *mbaj mendjen* dhe *nuk lëvizi nga vendi*. Ndërsa në njësinë frazeologjike *kish zënë sharra gdhenë* mendojmë se autori ka shkrirë njësitë *s’ha të gdhendur* “(dikush) nuk i pranon fare këshillat dhe qortimet, nuk merr vesh sado t’i flasësh, nuk ndreqet” dhe *i zuri sharra në gozhdë* “(dikujt) i doli përpara një vështirësi e pakapërcyeshme dhe e paparashikuar, ngeci”.

Ma mbylle derën me ferrë. (Vepra 4, f. 114) është njësi frazeologjike për të cilën mendojmë se është krijuar me anë të shkrirjes të njësive *e mbylli derën* “(dikush) vdiq pa lënë njeri pas nga gjaku a nga familja e tij, s’la pasardhës a trashëgimtar” dhe *i vuri ferrën* “nuk la njeri pas, e shoi me tërë familjen, e fiku krejt, e shkretoi”.

Ndërsa në shembullin: ...*prapë vjen një kohë e të bie në sy druri i shtrembër.* (Vepra 4, f. 383), njësia frazeologjike *bie në sy druri i shtrembër* ka mundësi të jetë krijuar prej dy njësive të njohura: *bie në sy* “(dikush) bën diçka që tërheq vëmendjen e të tjerëve; duket, e shohin; diktohet; dallohet a shquhet nga të tjerët, veçohet për një veti, për aftësi; tërheq vëmendjen” dhe *dru i shtrembër* “njeri i edukuar keq, me vese, që prish edhe të tjerët” etj.

Shkrirja e dy njësive në një sintagmë është një dukuri e rëndësishme në veprën e Kutelit e cila flet qartë dhe për ndihmesën e tij në pasurimin e frazeologjisë shqipe.

3.2.2. Lidhje të dy njësive frazeologjike brenda një konteksti

Në veprën e Kutelit gjejmë shpesh përdorimin e frazeologjizmave në lidhje dyshe, pra në çifte që ndodhen pranë njëra tjetrës dhe që shërbejnë për ta shprehur dhe qartësuar më mirë idenë, mendimin, për ta fuqizuar tekstin dhe për ta bërë atë më interesant dhe më estetik. Për shembull:

Dhe kuçedra u zhduk e nuk doli më: ndofta u dogj e u bë hi, ndofta u fut në fund të dheut. (Vepra 4, f. 19); *Vetëm hap gojën e bëj urdhër se mua gati më ke.* (Vepra 4, f. 75); *Të vëllezërit e kishin halë në sy, se u bënte për*

faqe të zezë oxhakun e mbretërisë. (Vepra 4, f. 380); ...*ç'e do këtë zanat kur të bie bretku e s'bush dot barkun me bukë.* (Vepra 4, f. 404) etj.

Lidhjet dyshe të njërive frazeologjike në veprën e Kutelit mund të ndahen në dy grupe: sipas llojit të marrëdhënieve kuptimore dhe sipas marrëdhënieve gramatikore. Ndalemi në fillim te grupi i parë, ku lidhjet janë disa llojesh:

- *Çifte sinonimike të mirëfillta*, të cilët, ashtu si edhe njësitë leksikore, janë të tilla edhe jashtë kontekstit në të cilin janë përdorur, për shembull:

Edhe këtij i bëri be edhe këtij i dha besën. (Vepra 4, f. 302); *Jep e merr me vete, e mati detin me filxhan.* (Vepra 4, f. 289); *Ama Kuma Maros as gjurmë nuk iu duk, as emri nuk iu dëgjua.* (Vepra 4, f. 284); *Si shkonte buka, s'i qeshej buza.* (Vepra 4, f. 313); *Ne jemi miq të vjetër: ngrohur në një diell, larë në një ujë.* (Vepra 4, f. 477); ...*sikujt i duket bregu shesh e deti kos.* (Vepra 4, f. 278); *Rrapua ia kish prishur kuvendin, ia kish prerë fjalën.* (Vepra 2, f. 137) etj.

-*Çifte sinonimike kontekstuale*, të cilat janë më të shumta në numër në veprën e Kutelit krahasuar me çiftet sinonimike të mirëfilltë. Ato mund të shprehin kuptime të përafuara ose shkallë të ndryshme të forcës së veprimit. Për shembull:

Beut i hipi gjaku në kokë e mend i ra pika. (Vepra 1, f. 214), këtu njësia e dytë *i ra pika* shpreh një shkallë më të lartë të intensitetit të veprimit sesa njësia *i hipi gjaku në kokë*. Në të njëjtën mënyrë mund t'i analizonim edhe shembujt e tjerë: *Ka lojtur krerësh; është bërë për në Shëndaum ... po hap sytë, veri gishtin kokës, se do të të shpien lidhur në Tiranë me gjithë gomar* (Vepra 3, f. 510); *Çupa s'ish rënë prej qielli, nuk ish as për të qeshur.* (Vepra 1, f. 113) etj.

Sinonimia te lidhjet dyshe përforcohet, kur dy njësitë frazeologjike kanë gjymtyrë të njëjtën folje, për shembull:

Sikujt i duket bregu shesh e deti kos. (Vepra 2, f. 278); *Ki mendjen të shikosh nga fryn era e nga ngroh dielli.* (Vepra 1, f. 69); *t'i marrim punët shtruar e me radhë* (Vepra 1, f. 342); *Të buta, të egra si të t'i dojë dhëmbi e zemra.* (Vepra 4, f. 300) etj.

Dy njësitë përbërëse të një çifti frazeologjik kanë të njëjtin kuptim kategorial, pra kanë vlerën e një emri, foljeje, ndajfoljeje ose mbiemri, *ndërsa rasti i kundërt, që do të bënte përjashtim, nga ky rregull, duhet vështruar si përdorim me vlerë stilistike*. Në këtë rast, njësitë frazeologjike të përdorura në çift do të shërbenin për të realizuar idenë që përcjell teksti në mënyrë më të diferencuar dhe më të nuancuar stilistikisht. Duke u nisur nga ky funksion, mund të kemi:

-*çifte sinonimike në të cilat njësia e dytë frazeologjike jep një veprim më të intensifikuar; këto zënë vendin më të madh në veprën e Kutelit*. Për shembull: ...*rrija me kryen të anuar e laja me lot dhenë e kurbetit.* (Vepra 1, f. 119); *Ra e vdiq e iku fir.* (Vepra 1, f. 113); *Mbreti plak e zhdredh qesen, e bën*

fora. (Vepra 4, f. 465) ...Ky Matua vdiq me lot në sy e me zemër të zhuritur. (Vepra 2, f. 42) Do ta mbaj në pëllëmbë të dorës, me gjithë të mirat. (Vepra 4, f. 278) bëri sikur nuk mori vesh e nuk u tund nga vendi. (Vepra 1, f. 325); I dilte për zot çdo të mjeri e i merrte krahun (Vepra 4, f. 152); Ja po i vjen vërdallë fshatit ditë më drekë e nuk i trembet syri fare. (Vepra 4, f. 341); Krushqari ia mori mendjen, ia mori edhe fjalën. (Vepra 4, f.478); ...e kam mbajtur në pëllëmbë të dorës Xinxifillin, e kam ruajtur si sytë e ballit. (Vepra 4, f. 344); Më lidhej goja, më vinte bota qerthull. (Vepra 2, f. 242) etj. Format përfaqësuese të njësive frazeologjike të përdorura më sipër janë: *me kryet anuar, e laj me lot, bie e vdes, ikën fir, e zhdodhi qesen, e bëri for a, me lot në sy, me zemër të zhuritur, (e mbaj) në pëllëmbë të dorës, (e mbaj) me gjithë të mirat, merr vesh, (nuk) tundet nga vendi, i dal (për) zot, i marr krahun, ditën për drekë, (nuk) i trembet syri, i merr mendjen, i merr fjalën, (e mbaj) në pëllëmbë të dorës, e ruaj si sytë e ballit, i lidhet goja, i vjen bota qerthull.*

-çifte frazeologjike sinonimike, që lidhen për të shpjeguar, për të plotësuar kuptimin e njëra tjetrës: ...*iknin natën ku sytë këmbët e nuk kthenin kokën prapa ... ia forconte rrënjët e i madhonte vulën.* (Vepra 1, f. 212); *Mblidhni mendjen e mbani dorën, mos u vrini për të huajin* (Vepra 1, f. 179); *Fjala shkoi gojë më gojë e i ra në vesh edhe Pjetër Shinit.* (Vepra 4, f. 249); *...ruaju që turku të mos të shtjerë në dorë të gjallë e të na mbyllë derën.* (Vepra 4, f. 342); *Ushqimet shkonin dorë më dorë gjersa katandisej kokoshi një thelë.* (Vepra 1, f. 285); *...i mori nën krahun e tij...dhe u lidhi rrogë të madhe.* (Vepra 4, f. 202); *Ku të ka vajtur syri, kë të do zemra, që të dërgojmë ta kërkojmë.* (Vepra 4, f. 381) etj. Format përfaqësuese të njësive frazeologjike të sipërpërmendura janë përkatësisht: *nga (ku) sytë këmbët* “iku me vrap nga një vend në drejtim të pacaktuar a të panjohur, për të shpëtuar; iku rrokopujë e nga të mundë”, *ka lëshuar rrënjë* “ka zënë vend përgjithmonë diku, është ngulur përgjithnjë”, *i shkon vula* “është me pozitë, i shkon fjala, gëzon fuqi e respekt”, *e mblodhi mendjen* “vendosi për diçka, pasi s’kishte ç’të priste më ose të shpresonte për një gjë; u mendua mirë e u bind të kthehej në rrugë të mbarë”, *mbaj dorën* “përmbaj veten që të mos e rrah dikë a të mos bëj një veprim tjetër të gabuar”, *gojë më gojë* “duke ia thënë a duke ia treguar njëri-tjetrit me gojë; duke kaluar nga njëri brez në tjetrin me gojë a me të treguar në mënyrë gojore; goja-gojës”, *më bie (më vjen) në vesh* “dëgjoj diçka rastësisht a kalimthi”, *më ra në dorë* “e solli rasti që të kem mundësinë të bëj ç’të dua me dikë”, *iu mbyll dera* ‘dikush u shkatërrua krejt, mbaroi me gjithçka; i vdiqën të gjithë, u shkretua’, *dorë më dorë* “duke kaluar nga njëri te tjetri, varg”, *mbeti (katandisi) kokoshi (kaposhi) një thelë* ‘mbeti shumë më pak nga ç’ishte a nga sa duhej; duke hequr pak e nga pak, duke harxhuar pjesë-pjesë etj., u zvogëlua a u pakësua shumë diçka, katandisi fare pak”, *e marr nën krahë* “e mbroj, e përkrah e kujdesem për dikë”, *i lidhi rrogë* “e paguaj dikë çdo muaj pa punuar”, *ia vuri syrin (dikujt)* “e zgjodhi midis të tjerëve për t’i ngarkuar një punë, për ta caktuar në një vend, për t’u fejuar a për t’u martuar me të etj.”, *ma*

do zemra “(diçka) e dëshiroj shumë, dua me shpirt që ta kem, më pëlqen shumë”,

-çifte sinonimike, ku njësitë frazeologjike ndryshojnë për nga niveli i ngarkesës emocionuese: *Unë po të pres me zemër në dorë si ujin e ftohtë*. (Vepra 4, f. 306); *Ago Zylali që të shtie ujin nën rrogos të vret në gjumë me dorën e tjetrit*. (Vepra 1, f. 266); *S’kish ndenjtur me duar në gji, kish mbledhur shumë miq nga ata që të marrin gjak në vetull*. (Vepra 4, f. 432) etj. Në shembujt që dhamë vërehet se njësia e dytë frazeologjike sjell ngjyrim emocionues (kryesisht negativ) më të fortë se sa e para, megjithatë nuk mungon edhe diferencimi kuptimor. Ndërkohë, trajtat përfaqësuese të këtyre njësive frazeologjike janë: *me zemër në dorë* “me drejtësi, pa anësi; me dëshirë të mirë”, *(e prët) si ujët e ftohtë (e paktë)* “e prët dikë me dëshirë të madhe e me padurim, mezi prët që të vijë dikush a diçka ose të ndodhë diçka, ka mall të madh për të, do që ta shohë sa më parë”, *ta çon ujin nën rrogos* “(dikush) ta hedh fshehurazi e pa e kuptuar, ta punon me dredhi, është dinak i madh”, *të vret në gjumë* “të dëmton, të shkatërron pabesisht”. *me dorën e tjetrit* “vepron mbi dikë, zakonisht për keq, duke mos vepruar vetë drejtpërdrejt, por nëpërmjet një individi tjetër”, *mbeta me duar në gji* “mbeta pa njeri, fill i vetëm”, *të merr gjak në vetull* “është trim i madh; është guximtar e s’i trembet askujt e asnjë rreziku”.

Në veprën e Kutelit përdoren shpesh edhe çifte frazeologjike me marrëdhënie antonimike, te të cilat dallohen dy grupe të rëndësishme:

-çifte frazeologjike me kundërvënie kuptimore të mirëfilltë, si për shembull: *Më pate dhënë fjalën... dhe e shkele këtë fjalë*. (Vepra 4, f. 231); *...edhe në bri të buallit të futeshin... beu i gjente pas erës*. (Vepra 1, f. 68); *Gjahtari nis e numëron me gojë e me duar po nuk ia del në krye*. (Vepra 4, f. 287); *Çahen të dy së thirruri po s’merren vesh*. (Vepra 4, f. 358); *Këta kanë dhënë dorë njëri me tjetrin e duan të na hanë të gjallë*. (Vepra 4, f. 293) etj. Format përfaqësuese të këtyre njësive janë: *i jap fjalën* “e lejoj a e ftoj dikë të flaes; i premtoj dhe e siguroj dikë për diçka”, *ia shkel (e ha) fjalën* “e mohon atë që ka thënë, e dredh; nuk e mban premtimin, gënjen; nuk është i besës”, *u fut në bri të buallit* “u fut në një vend shumë të fshehtë, ku mendon se nuk e gjen dot asnjeri; u fsheh mirë diku nga frika”, *i bie në erë* “e diktoj dikë, kam gjetur shenja për ta zbuluar”, *(flet) me gojë e me dorë, ia dal në krye* “arrij ta përballoj një vështirësi a ta përfundoj një punë; e kryej, e mbaroj”, *çahem së thirruri* “thërret me zë të lartë për një kohë të gjatë e nuk e dëgjon askush”, *merrem vesh* “kuptohem mirë me dikë”, *jap dorën* “zotohem të zbatoj ose të plotësoj një marrëveshje, një premtim etj.; jap fjalën e besës”, *e hëngri të gjallë* “e mundoi shumë dikë, s’e la të qetë gjithë jetën; e mërziti shumë me fjalë, me kërkesa etj., duke u sjellë keq me të”.

- çifte antonimike kontekstuale, të cilat përbëjnë grupin më të madh: *...të bie bretku e s’mbush dot barkun me bukë*. (Vepra 4, f. 404); *Ditën ti rri mban kuvend, këtu shet mend*. (Vepra 1, f. 267) etj.

Krahas çifteve frazeologjike më raporte bashkërenditëse, në veprën e Kutelit nuk mungojnë edhe ato me raporte nënrenditëse. Njësitë e një çifti frazeologjik mund të vihen më së shumti në raporte shkak-pasojë dhe kusht-rrjedhje, të cilat është e vështirë t'i ndash dhe që, ose shprehen me mjete gjuhësore, siç janë lidhëzat *se, kur, gjersa, prandaj* etj., ose nënkuptohen, por edhe në raporte të tjera me anë lidhëzash ffilluese, kohore, vendore etj. Për shembull:

-Njësi frazeologjike në lidhje nënrenditëse ffilluese: *Ariu e merr vesh se dhelpira ia kish punuar.* (Vepra 4, f. 513); *Bëri emër që t'ia ziejmë gazit.* (Vepra 2, f. 37) etj.

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse shkakore: *buka nuk shkelet se të ze sytë.* (Vepra 2, f. 123); *Prandaj kush i binte me dorë dilte tagar e shoshë.* (Vepra 2, f. 108); *Meqë më vutë në valle do të loz pas gajdes.* (Vepra 2, f. 143); *Ai s'do të më shohë me sy se ka frikë mos ndjell tersin.* (Vepra 4, f. 402); *Ne s'e bënim fjalën dy se lugën e kishim në brez* (Vepra 2, f. 179); *Si do t'ia gjesh gjurmën asaj që të ther mes për mes.* (Vepra 4, f. 300) etj.

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse vendore: *Tashi po e marr vesh se ku shtie dyfeku i gjatë.* (Vepra 2, f. 128) etj.

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse kohore: *...ngjit male e zbrit male gjersa të të zerë veshi bubullimën e livareve.* (Vepra 4, f. 343); *Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, gjyshja ndërroi prapë fletë.* (Vepra 1, f. 108);

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse lejore: *E pa me lot në sy, ndonëse mundahej të vinte buzën në gaz.* (Vepra 4, f. 313) etj

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse qëllimore: *...duhej të dilja në shesh të luftës që t'i zbardhja faqen babait plak.* (Vepra 4, f. 148); *Kuma Marua ia merr këngës për të nxehur gjakun.* (Vepra 4, f. 359); *Më dërgoi fjalë me një mik që të mbledh mendjen* (Vepra 1, f. 118); *Ishin marrë vesh të mos i binin më qafë shoku shokut.* (Vepra 1, f. 307) etj.

-Njësi frazeologjike me lidhje nënrenditëse kushtore: *...ia krisja kokës atij që do të më binte më qafë.* (Vepra 1, f. 268) etj.

Për mënyrën se si lidhen njësitë frazeologjike në lidhjet dyshe mund të flitet shumë, por e rëndësishme është të vlerësohet mjeshtëria e autorit për t'i përpunuar e përdorur ato në funksion të qëllimeve semantike e stilistike të tekstit. Jo në pak raste ai është mjaft origjinal në përdorimin e tyre dhe një risiprurës edhe në këtë drejtim.

-Vargjet frazeologjike

Me varg frazeologjik kuptohen “*strukturat e mëdha me njësi frazeologjike dhe shprehje të tjera, që radhiten brenda një konteksti të ngushtë dhe që kanë lidhje kuptimore e stilistike, organizohen rreth një ideje a karakterizimi e plotësojnë njëra-tjetrën nga anë të ndryshme. Pra vargu frazeologjik krijon një unitet të menduar njësisht frazeologjike dhe jo të*

rastit.”⁸⁸ Nga ana sasiore, vargu frazeologjik mund të përbëhet nga tri, ose më shumë njësi frazeologjike.

Në veprën e Kutelit haste shpesh prania e vargjeve frazeologjike, ku përmes përdorimit dhe lidhjeve të tyre të ndryshme leksiko-sintaksore, kontaminimit etj., autori i ngre më lart vlerat kuptimore dhe stilistike të veprës.

Vargjet frazeologjike të afërta kuptimisht, ashtu si edhe lidhjet dyshe, mund të sjellin vlera të shtuara mbi kuptimin e tyre themelor, të tilla si:

1. Vlera shkallëzimi, i cili në vetvete mund të jetë:

-Përshkallëzim emocional pozitiv, si për shembull: *Mbreti plak e zhdredh qesen, e bën fora, që të hajë qeni petulla.* (Vepra 4, f. 465); këtu kemi një shkallëzim ngjithës të veprimit nëpërmjet tri njësisve frazeologjike: e *zhdredh qesen* “pagoi me dorë të lirë, nuk i kurseu paratë, u tregua dorëlëshuar a bujar”, *ia bëri fora* “1. Tregoi trimëri e guxim të rrallë; bëri një punë a një veprim që i çuditi të gjithë; 2. Bëri shpenzime të mëdha, shpenzoi shumë” dhe *ha qeni petulla* “është një gjendje ekonomike shumë e mirë, ka bollëk të madh, ka një mirëqenie të lartë, me tepri të mirash”. Ndërsa në shembullin: *Ja, i vjen vërdallë fshatit ditë më drekë e nuk i trembet syri.* (Vepra 4, f. 341); përdoren tri njësi frazeologjike: *vjen vërdallë* “vjen rrotull”, *ditën më drekë* “në mes të ditës” dhe *s’i trembet syri* “nuk ka frikë fare nga dikush a nga diçka, nuk do t’ja dijë prej askujt e prej asnjë rreziku, është trim e guximtar i madh, nuk trembet”. Me anë të tyre përshkallëzohet tipari i guximit të një personi dhe boshti semantik materializohet më shumë te dy njësitë e fundit frazeologjike.

- Përshkallëzim emocional negativ, si për shembull: *Shiko se po u vajti fjala në vesh vijnë e të zhufin e të bëjnë pestil që të mos e mbledhësh veten një mot të tërë.* (Vepra 4, f. 268) etj.; këtu njësitë frazeologjike *më vjen në vesh* “e dëgjoj diçka rastësisht a kalimthi”, *e bëri pestil* “e rrahu shumë, e zhdëpi në dru, e shqepi” dhe *(nuk) e mbloodhi veten* “u bë më mirë, doli nga një gjendje e vështirë a e keqe” krijojnë një varg të përbërë frazeologjik me dy boshte semantike të dallueshme kuptimisht deri në thelb, të cilat janë të lidhur midis tyre në raportet shkak-pasojë. Ndërkohë dy njësitë e fundit krijojnë përshkallëzim të intensitetit të veprimit, kulmin e të cilit e shënon njësia: *(nuk) mbloodhi veten.* Pra, lëndimi fizik është aq i madh, sa do t’i duhet një kohë e gjatë për t’u shëruar.

Ka raste, kur boshti semantik është i njëjti në të gjitha njësitë e vargut frazeologjik, si për shembull: *Ata e duan si sytë e ballit, e mbajnë në pekul, betohen për kokën e saj.* (Vepra 4, f. 458); *Atëhere ia nis me gojë e me duar, me sy e me këmbë, përmbys dhenë e qiellin.* (Vepra 4, f. 473)...*edhe i morën që të gjithë së bashku me djalthin e vogël për ne ajo botë tjetër, ku s’ka dhembje e brenga, ku maji s’ka të sosur e lulja s’ka të shkundur, në jetën e jetës, në jetën e jetëve.* (Vepra 2, f. 215) etj.

88. Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 94.

2. Vlera përforcuese, si më poshtë:

Ju shoh se qysh shtypi e përshtypi, vrisni mendjen, varni vetullat e nuk më jepni dot përgjigje. (Vepra 1, f. 175); të tri njësitë frazeologjike *shtypet e përshtypet* “mendohet, është në mëdyshje”, *vrasi mendjen* “mendohem shumë, përpiqem shumë për të zgjidhur diçka; e arsyetoj dhe e rrah nga të gjitha anët diçka” dhe japin të njëjtin veprim, që në këtë rast është një proces i të menduarit, i reflektimit rreth diçkaje të vështirë, por duke e përforcuar njëra-tjetrën.

Në shembullin: *...të shtie ujin nën rrogos, të vret në gjumë me dorën e tjetrit.* (Vepra 1, f. 266); rasti është edhe më interesant për shkak të kontaminimit, por ajo që do të nënvizojmë është se edhe këtu të tri njësitë frazeologjike kanë të njëjtën bërthamë kuptimore: *vepron pabesisht.*

3. Vlera plotësuese, si:

Flet e flet sa i vete goja gjer në vesh, e gjer prapa veshit, i dalin sytë si gogulla, i hipin djersët. (Vepra 4, f. 478-479); megjithëse kanë një thelb kuptimor të përbashkët: *u lodh*, nuk mungojnë nuancat dalluese: *i vete goja gjer në vesh e prapa veshit* ka kuptimin “u lodh së foluri”, sa iu deformua goja; *i dalin sytë si gogulla* ka kuptimin “u lodh së foluri sa ju shqyen sytë” dhe *i hipën djersa* ka kuptimin “djersiu prej të folurit të tepërt”. Të kësaj natyre janë dhe shembujt në vijim: *...çupa mezi mban këmbët, mezi mban shpirtin, i hyn frika në palcë, i dridhet buza.* (Vepra 4, f. 448); *...nxjerr shkëndija nga sytë, zjarr nga goja e tym nga hundët.* (Vepra 4, f. 334); *Shikohen sy ndër sy, e mbledhin buzët, s’i zënë besë.* (Vepra 4, f. 489); *Thonë se malarja do të hapet edhe njëherë kur të bëhen dy ditë bashkë, kur të bëjë plepi mollë dhe të hajë qeni petulla.* (Vepra 4, f. 435); *Rrinë këta të tre kokëvarur, vrasin mendjen, e kthejnë kështu e kthejnë ashtu, zbraz e mbush detin me kupë e s’dinë nga t’ia mbajnë.* (Vepra 4, f. 480) etj.

4. Vlera të figurshmërisë, të cilat dalin më mirë në vargjet e përbërë frazeologjike, të cilat kanë më shumë se një bosht kuptimor. Për shembull:

Po Korobeshi s’e lë të mbarojë fjalën: *Kapsit e ç’kapsit sytë, bën be e rrufe “Ç’ke ti më qafë të kam unë, ne jemi miq të vjetër: ngrohur në një diell, larë në një ujë...” Shkurt ia bën mendjen dhallë.* (Vepra 4, f. 477). Siç duket, njësitë e çdo grupi në shembullin e mësipërm nuk janë sinonime të mirëfillta, por kanë një ide të përbashkët rreth së cilës sillen, dhe njësitë frazeologjike e bëjnë tekstin më shprehës.

Kuteli i përdor vargjet frazeologjike për qëllime të ndryshme stilistike, disa prej tyre janë:

-për të shprehur gjendje të ngarkuara emocionuese të personazhit, si për shembull: *Kuma Maros i zien gjaku në gllavinë, ngjit me të katra shkallë e gurta, i bie derës sa i shkrepin sytë shkëndija larushe dhe lëshon bërtimën.* (Vepra 4, f. 357); *Ju betohem me be të madhe se unë nuk do t’i bija prapa, po të mos më vinte keq t’ia nxija faqen Jutbinës e Krahinës.* (Vepra 4, f. 99) etj.

-për të shprehur veprimet kryesore në një situatë të caktuar ligjërimore: *Ajo i bëri be për perënditë e dhelprave dhe të kunadheve, i dha besën e dhelprave e të kunadheve, po lepuri u fsheh atje ku dinte vetë dhe z'bëri zë.* (Vepra 4, f302) etj.

-për të shprehur tiparet themelore të realieve, të dukurive, të veprimeve: *Ne e ndjekim këmba këmbës maleve, e kur të na duket se e kemi mbërthyer e do ta shtiem në dorë, shfaqet prapa nesh, na kllapos grykave, na korr me shpatë; është kaq i shpejtë sa të vjen të thuash se fluturon me krahë e godet atje ku s'e presim.* (Vepra 4, f. 248) *Lëshona një sy, o djalë, e shikona mirë: ajo është më e bukura ndër ne, ajo që s'ngre sytë të shikojë e s'hap gojën të flasë – ajo është nusja e vëllamit tend.* (Vepra 4, f. 164) etj.

Kuteli përdor dendur dhe në mënyrë të qëllimshme strukturimin e njësive frazeologjike në vargje të thjeshtë dhe në vargje të përbërë, duke i vendosur në lidhje të ndryshme sinonimike, antonimike, shkakësore etj. Ai ka aftësinë që, nëpërmjet përpunimit të kujdesshëm, nëpërmjet kontaminimit si dhe nëpërmjet lidhjeve të njësive frazeologjike, jo vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me fjalë të kontekstit, t'i kthejë ato në mjete të rëndësishme gjuhësore të shprehësisë.

3.2.3. Lidhjet e njësive frazeologjike me kontekstin

Dihet se për njësitë frazeologjike është i rëndësishëm konteksti i ngushtë apo mikrokonteksti “për të vendosur drejt lidhjet e përmbajtjes së njësisë frazeologjike me realitetin”⁸⁹ dhe se zgjerimi me fjalë të tjera, apo shpërndarja e gjymtyrëve të togfjalëshit frazeologjik brenda fjalisë “e ngarkojnë njësinë frazeologjike me nuanca të reja emocionuese e plotësojnë përmbajtjen me elemente të rrethanave të reja.”⁹⁰

Në prozën e Kutelit, përveç të tjerash, shfaqet shpesh edhe dukuria lidhjes të njësive frazeologjike e cila, siç e përkufizon Ali Jashari, është “*pranëvënia e fjalëve të tjera përpara, në mes ose pas gjymtyrëve të togfjalëshit frazeologjik, për ta lidhur më ngushtë me situatën konkrete të ligjërimin, me idetë e ngjarjet, me personat e çështjen për të cilën shkruhet, me kohën a vendin për çka bëhet fjalë në kontekstin e dhënë.*”⁹¹. Lidhjet e njësive frazeologjike me kontekstin përmes aktualizimeve të ndryshme janë të larmishme.

Fjala aktualizuese vihet në pozicione të ndryshme në raport me njësinë frazeologjike:

-kur aktualizuesit vendosen para njësisë frazeologjike, gjë që sjell përmbysjen e rendit të zakonshëm të fjalëve, duke theksuar kështu më mirë mendimin a idenë që përcillet: ...*mirë të paska vajtur mendja.* (Vepra 4, f.

89. Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981, f.281.

90. Po aty, f. 66.

91. Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 117.

384); **Aty për aty** e kthen mendjen. (Vepra 4, f. 347); ngahera e kam mbajtur në zemër. (Vepra 4, 369); **Hëpërhë** s'kam ndërmend të martohem. (Vepra 4, f. 386) etj.

-kur aktualizuesit vendosen në mes të njësisë frazeologjike, për shembull:

M'i jep mua në dorë ata derra bulq. (Vepra 1, f. 215); ...nuk shkel **dot këmba** e njeriut. (Vepra 1, f. 155); ...kish dalë **fare** nga mendja. (Vepra 1, f. 124); *Ta kam ty fjalëzën në torbëzë.* (Vepra 1, f. 114); *Nuk e zë askush në gojë.* (Vepra 4, f. 153); ...e vë **prapë** buzën në gaz. (Vepra 4, f. 157); ...më ka zënë **fort** malli. (Vepra 4, f. 163); ...i erdhi **pothuaj** zemra në vend. (Vepra 4, f. 285); *Kur mori ngjarja dhenë.* (Vepra 4, f. 250); ...ia njihnin **dhelprës** tërë dhëmbët e dhëmballët. (Vepra 4, f. 303); ... i desha **të tre** si dritën e syve. (Vepra 4, f. 324) etj.

-kur aktualizuesit vendosen në fund të njësisë frazeologjike, për shembull:

S'më mbante dheu gjëkundi. (Vepra 1, f. 121); ...ia mbathën kokën **mirë**. (Vepra 2, f. 279); ...e kish marrë malli shumë. (Vepra 4, f. 302); ...zunë të hedhin vallen **e shpatës**. (Vepra 4, f. 226) etj.

-kur në njësinë frazeologjike marrin pjesë më shumë se një aktualizues:
Bajrakët u përkulën, ranë bashkë me bajraktarët nën thundrën e kalit të Skënderbeut. (Vepra 4, f. 240) etj.

Përsa u përket gjymtyrëve me të cilat shprehen aktualizuesit e njësisë frazeologjike, vërehet se ato janë të larmishme:

-aktualizues të shprehur me mbiemra:

Kam bërë be të madhe. (Vepra 4, f. 161); ...gjer të zbardhë **e bardha** dritë. (Vepra 4, f. 455); ...i shpëton nga ajo dora **e rreshkët**. (Vepra 4, 446) etj.

-aktualizues të shprehur me emra të rasës gjinore:

Po të jap besën e burrit. (Vepra 4, f. 167); *Ju jap besën e zotit.* (Vepra 4, f. 163); *S'ka dalë në dritën e diellit e të hënës.* (Vepra 4, f. 151); ...i zure besë **të pabesit**. (Vepra 4, f. 208); ...i dal në shesh **të luftës**. (Vepra 4, f. 177); *Shpresat i kish lënë në dorë të fatit të shiut.* (Vepra 1, f. 234) etj.

-aktualizues të shprehur me ndajfolje:

...ia sjell fjalën **zvarrë**. (Vepra 4, f. 167); *Mos u bëni kurrë bisht sëpate.* (Vepra 4, f. 241); *S'u shkante fare mendja.* (Vepra 4, f. 310); *Mendja e saj punonte vetëtimthi.* (Vepra 4, f. 303); ...u bë rrozgë **fare**. (Vepra 1, f. 170); ...e mori **prapë** veten. (Vepra 1, f. 100) etj.

-aktualizues të shprehur njëkohësisht me disa lloje gjymtyrësh, me përemra, me emra, mbiemra:

...ia preku **atë thërrime** zemër. (Vepra 4, f. 257); ...ta lajë **vetë** turpin me gjak. (Vepra 4, f. 167); ...i shpëton nga **ajo dora e rreshkët**. (Vepra 4, 446) etj.

Në veprën e Kutelit bien në sy aktualizimet gramatikore “të cilat realizohen kryesisht duke ndryshuar e zgjeruar paradigmen e njësisë

frazeologjike dhe të shprehjeve të tjera.”⁹² Ndryshime të tilla pësojnë veçanërisht gjymtyrët foljore (ndonëse nuk mungojnë edhe ndryshimet e gjymtyrëve emërore) të njësive frazeologjike, për shembull: ...*më ka ngrënë në besë ... e hëngri në besë*. (Vepra 4, f. 166); ...*i prenë udhën*. (Vepra 1, f. 103); ...*ua preu udhën*. (Vepra 4, f. 158); ...*i marrin krahun*. (Vepra 1, f. 130); ...*i mori krahun*. (Vepra 1, f. 182); ...*ia merrte krahun*. (Vepra 1, f. 259); ...*mundohej të vinte buzën në gaz*. (Vepra 4, f. 313) etj.

Me anë të aktualizimit Kuteli arrin të krijojë njësi frazeologjike cilësisht të reja edhe kuptimisht, si për shembull: ...*Zbardhi e bardha ditë* e krijuar me anë të aktualizimit të njësisë frazeologjike *zbardhi dita*. Zgjerimi me aktualizuesin mbiemëror *e bardha* sjell ndryshime të tilla kuptimore, sa mund të merret si njësi e re frazeologjike. Me anë të zgjerimit të tyre me aktualizues krijohej dy njësi të reja frazeologjike *i zuri besë të pabesit* dhe *i dha besën e zotit*, të cilat rrjedhin përkatësisht nga njësitë e njohura frazeologjike *i zuri besë* dhe *i dha besën*, pra duket se lindjen e këtyre njësive e përcakton pjesëmarrja e aktualizuesit *të pabesit* tek e para dhe aktualizuesit *e zotit* tek e dyta.

Interesante janë aktualizimet e disa njësive frazeologjike me anë të zëvendësimit kryesisht të gjymtyrëve të dyta me një fjalë tjetër në përputhje me situatën konkrete ligjërore, për shembull: *Ti më pate dhënë fjalën se kësaj here do t'i shtroje arbrit e tu nën këmbët e mia*. (Vepra 4, f. 231), këtu bëhet fjalë për njësinë frazeologjike *nën këmbët e hasmit* ku emri *hasmit* është zëvendësuar me përemrin *e mia* për ta përshtatur me situatën e caktuar ligjërore. Po kështu, në shembullin: ...*rrinin e dëgjonim të magjepsur avazin e blatës*. (Vepra 1, f. 111) ku në njësinë frazeologjike *avazi i Mukes*, gjymtyra e dytë, që në këtë rast është emër i përveçëm, është aktualizuar me anë të zëvendësimit të tij me një emër të përgjithshëm, *blatës* “vend me dhe të përzier me ujë”.

Në prozën e Kutelit nuk mungojnë format mohuese të njësive frazeologjike, të cilat ajo aktualizohet përmes mjeteve të ndryshme gjuhësore, si: *pak, me zor, mos, fare, hiç* etj. Për shembull: ...*priste a mos i zbutej pak zemra të madhit; Ky bënte sikur s'e shihte, s'ia varte fare*. (Vepra 4, f. 400); *Jam pak si i trashë...* (Vepra 4, f. 286); ...*nuk e gënjente hiç syri*. (Vepra 1, f. 70) etj.

Pra, nga sa shtjelluam më lart vijmë te përfundimi se Kuteli përdor forma të larmishme aktualizimi në funksion të një ligjërimi të caktuar, në përputhje me synimet e tij ideore dhe artistike, duke i kthyer mjetet aktualizuese në mjete të fuqishme origjinale të përpunimit dhe të shprehjes artistike, duke ndihmuar ndjeshëm në pasurimin e tyre.

92. Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 127.

3.2.4. Tekste të figurshme frazeologjike

Duke qenë se njësitë frazeologjike kanë në thelbin e tyre figurshmërinë, është e natyrshme që ato të shërbejnë si mjete për të ndërtuar tekste të figurshme, tekste ku të spikasin më fort vlerat stilistike. Dhe në këtë pikë nuk mungon origjinaliteti i Kutelit, i cili krijon tekste të figurshme duke pasur në qendër njësitë frazeologjike dhe duke i plotësuar ato me mjete të tjera, siç janë aktualizuesit, identifikatorët semantikë, perifrazimet etj., të cilët, të gjithë së bashku krijojnë një “unitet kuptimor e formal i dallueshëm nga kontekstet e tjerë dhe si i tillë, ai ka organizimin e vet të brendshëm dhe mënyrat e veta të ndërtimit.”⁹³Për shembull:

E sado druhesha të mos e shoh, gjithë piqeshim sy më sy. Piqeshim ne burimi, kur vinte për ujë; piqeshim në rem’ e jazit; piqeshim ne ur’ e lumit, midis shelgjeshe e kulprash të gjalla. Desha ta lë udhën e saj për sytë e botës, po zemra më thosh: shko e një herë, shko e dy e tri gjer t’i shikoj qoshen e shamisë e nurin e ballit. (Vepra 1, f. 116). Njësia bazë në këtë rast është *sy më sy*. Figurshmëria këtu zgjerohet, së pari, sepse përzgjidhet një fjalë me ngjyrim të fortë emocionues në vetvete me të cilën njësia frazeologjike krijon lidhje leksiko-sintaksore, siç është fjala *piqeshim* (në vend të fjalës *shiheshim*); së dyti, me anë të përsëritjes së saj: *piqeshim në rem’ i jazit, piqeshim ne ur’ e lumit* dhe, së treti, me praninë e një njësie tjetër frazeologjike, e cila ka në në përbërjen fjalën e saj vatër *sy: sytë e botës* dhe, së katërti, edhe me praninë e fjalës të së njëjtës fushë: *shikoj*. Të gjithë këta elementë së bashku zgjerojnë figurshmërinë dhe e bëjnë tekstin si një të tërë.

Përsa u përket mënyrave të organizimit dhe ndërtimit të teksteve të figurshme, në veprën e Kutelit hasim shumëllojshmëri tipash, disa prej të cilave do t’i trajtojmë përmes shembujve të mëposhtëm:

-Me anë të perifrazimit ose përsëritjes së njëres gjymtyrë të njësisë frazeologjike, si dhe zgjerimit me fjalë e togfjalësha, të cilët lidhen me të, gjë që e pasuron tekstin me vlera të mëtejshme stilistike dhe figurshmërie. Për shembull:

-Tashi ç’të do zemra, o bir?

-Dua të të jap një selam.

-Ja dhashë selamnë në lule të ballit. Hipa pelën e ika. (Vepra 1, f. 122).

Në këtë tekst ndodhen dy njësi frazeologjike *ma do zemra* “(diçka) e dëshiroj shumë, dua me shpirt që ta kem, më pëlqen shumë” dhe njësia frazeologjike *i jap një selam* “(dikujt) i dërgoj një peshqesh në shenjë mirënjohjeje; kryej një veprim hakmarrës ndaj atij që më ka bërë keq”. Te njësia e parë përsëritet gjymtyra përbërëse *do (dua)*, ndërsa te njësia e dytë përsëritet gjymtyra vatër *selam*. Shprehësinë e tekstit e rrit edhe prania e njësisë frazeologjike *ia dha në lule të ballit* “e qëlloi me armë për vdekje”.

93 .Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 133.

Mendimet, sapo i shkrepnin në tru, treteshin përsëri si ai avulli i hollë i pranverës në një faqe mali, kur i zvarrit era, e çepkat, e dagëndis, dhe, fundja e tret. (Vepra 1, f. 123). Njësia frazeologjike këtu është *më shkrepni në tru* “1.Më erdhi papritmas një mendim për diçka etj.2. Më hipi në çast për të bërë diçka pa u menduar shumë, më erdhi papritur një mendim a një dëshirë për diçka”. Ndërkohë, perifrazimi i saj me anë të krahasimeve pasuron tekstin me vlera të mëtejshme figurshmërie.

-Tekste të figurshme, të cilat ndërtohen me anë të lidhjeve të reja leksikore të vatrës semantike. Për shembull:

Ma nxive zemrën, o çun i Smail Brahos. Ma bëre purë, qymyr të zi. (Vepra 1, f. 169). Në këtë rast gjymtyra vatër e njësisë frazeologjike *ma nxivu zemrën* “(dikush) më hidhëroi shumë, më pikëlloi, më dëshpëroi pa masë”, krijon lidhje të reja leksikore, si: *ma bëre zemrën purë* dhe *ma bëre zemrën qymyr*, të cilat krijojnë vlera të mëtejshme stilistike.

S’e nxinte më as lëkura, as konaku, as tërë vendi. I ziente zemërimi në zemër, sindozot zien jashtë fërtyma e kolozhekut. (Vepra 1, f. 214-215) etj. Njësia frazeologjike bazë është *nuk e nxë lëkura* “1.Është shumë i shëndoshë.2.Nuk duron dot, është shumë i shqetësuar a i inatosur dhe duket sikur do të shpërthejë; është fryrë e do të pëlçasë nga inati”. Gjymtyra vatër e saj krijon lidhje të reja leksikore me fjalët

-Tekste të figurshme, që ndërtohen duke ngërthyer disa njësi njëherësh, të cilat nuk jepen në formën e tyre të plotë. Për shembull:

Të prisja të më zbardhësh ditët në pleqëri, të të shoh në radhën e burrave, që të na kenë zili bota, po ti më nxive...Ik që këtu, në ke shpirt. (Vepra 1, f. 170); *S’e nxinte më as lëkura, as konaku, as tërë vendi. I ziente zemërimi në zemër, sindozot zien jashtë fërtyma e kolozhekut.* (Vepra 1, f. 214-215) etj. *Në atë kohë në vendin tonë nuk lindte e nuk rronte me kartë, divit a kalem kallmri, po me shpatë e me hutë. Se po të paskeshin pasur edhe njerëz të atillë, nuk do të kishim sot një kartë të madhe sa fusha e Domuzovës që në Urakë e gjer në Rrajcë e që aty gjer poshtë në Përrenjës e në Lëngajcë, të mbushur dinga me rrëfimet e trimërive të burrave tanë.* (Vepra 1, f. 178-179); *...nuk i trembej syri as nga mbreti, as nga hasmi. Gishti e syri i tij bënëin çudira, se e kish trashëgim nga gjyshstërgjyshi të shtinte një e të vriste dy.* (Vepra 1, f. 183); *E shponin në zemër, si tryelë, gozhdat e opingave të Gjatollinjve, që shkonin e vinin aty, mbi udhë, me armët e Sefedinit në sup.* (Vepra 1, f. 188); *Nuk lëngoi po u këput e ra si lisi kur i bie rrufeja.* (Vepra 1, f. 272) etj.

-Tekste të figurshme, që ndërtohen duke përdorur krahas njësive frazeologjike edhe togje të lira si identifikues të tyre semantikë. Për shembull:

Selmani i Nures mori nuse motrën e Sefedinit dhe u bënë pat e pat: një dhanë, një morën. (Vepra 1, f. 201); njësinë frazeologjike *pat e pat*, e cila ka kuptim të figurshëm, e bën më të kuptueshëm togu i lirë me kuptim asnjënjës *një dhanë, një morën*.

Më poshtë po japim një shembull se si ideja e forcës që zotëron një njeri, që mishërohet te njësia frazeologjike të *vriste me sy*, bëhet ideja mbizotëruese, e përforcuar kjo edhe me disa aktualizues: *kish një sy të fortë që e vriste trimin me një të parë. Syri i tij bënte sa për njëqind dyfeqe...Edhe e shikoi me një sy kaq të fortë, sa beu, nga ulk na u bë qingj i butë.*

-Në ke ardhur ndryshe, e mira e së mirës është të mos bësh një çap përpara, se...

-Olloman beut iu drodh xhufk' e festës fër-fër, si dridhet maja e kallmërit kur fryn era. Pastaj, dalngadalë, e mblodhi veten, u hodhi një sy trimave, që prisnin urdhër e tha: kam ardhur si kam ardhur kjo është puna ime. (Vepra 1, f. 216). Këtu tekstin e organizon gjymtyra kryesore *sy* e cila është gjymtyrë emërore dhe, si e tillë, dihet që ka më shumë mundësi për t'u lidhur me pjesë të ndryshme brenda kontekstit.

Në tekstet e figurshme frazeologjike kuteliane gjenden të ndërthurura njëri me tjetrin rrafshi i drejtpërdrejtë dhe rrafshi i figurshëm dhe ndodh që rolin e identifikuesit semantik ta luajë një shprehje proverbiale, që vendoset në krye të tekstit. Për shembull: *Paraja është punë e djallit. Të zë sytë, bëhet zot e të bën rob. Fiti beu ishte çoban, po çobenëve të mushkave nuk u jepte hakën e qirasë. As punëtorëve të sharrës. Ra edhe pas fajdesë, nxorri njerëz në diell, la jetimë udhëve. Pastaj Rrapush beu ia mori të gjitha Fiti beut.* (Vepra 1, f. 302); në rolin e identifikuesit semantik këtu është shprehja *paraja është punë e djallit*. Po kështu, në shembullin *Borxhi rritet e shtohet si troska, fajde mbi fajde. Mjerë ai që lë t'i hypë troska në arë: lëshon rrënjë, ta mbyt grurin e misrin. Na vrau buka, na hëngri kripa, gazi, opinga, e dhjeta, xhelepiu. Shtrenjtë. Një okë kripë bën një okë mjaltë. Ku të shkojmë, ku të mbytemi.* (Vepra 1, f. 306-307); identifikuesi semantik është vendosur në krye: *borxhi rritet si troska*, ndërkohë gjymtyra emërore *troska* “një lloj bari që përhapet shumë në formë sipërfaqësore, duke lëshuar rrënjë pas rrënje” vendos lidhje të shumanshme që krijojnë sintagma të qendrueshme të figurshme, si: *troska lëshon rrënjë pas rrënje, troska mbyt grurin, misrin*. Edhe sintagmat metaforike të mëpasshme: *na vrau buka, na hëngri kripa, gazi* etj, janë mjete të tjera me të cilat pasurohet teksti duke I dhënë atij nuanca të shumta stilistike-emocionuese.

Në përfundim mund të themi se, në përputhje me thelbin përmbajtësor dhe me synimet artistike, njësitë frazeologjike në veprën e Kutelit shpërfaqin begati të madhe, veçanërisht ato me burim popullor. Ato sjellin më shumë vlera kuptimore, emocionuese, shprehëse e stilistike, sesa fjalët sinonime me to. Njësitë frazeologjike hasen jo vetëm në gojën e personazheve, por edhe në gjuhën e autorit, çka e përsos edhe më shumë gjuhën e veprës. Ato janë në funksion të tipizimit të personazheve, të profilizimit të tyre shoqëror dhe të ngjyrosjeve mjedisore dhe historike. Shtresa më me interes e njësive frazeologjike në veprën e Kutelit është ajo që lidhet me elemente krahinorë, sepse mund t'i shërbejë pasurimit të frazeologjisë shqipe në përgjithësi. Kuteli

dëshmon njëkohësisht sesa e pasur është gjuha shqipe në frazeologji dhe se çfarë mundësish të jashtëzakonshme i falin ato një shkrimtari të talentuar për të thelluar origjinalitetin e veprës së vet. M. Kuteli shquhet për përdorimin vetjak dhe për risitë që sjell, duke shkuar deri në krijimin e njësive të reja frazeologjike.

3. 3. Fjalorthi frazeologjik i veprës i veprës së Mitrush Kutelit

Anë - *Pa anë e pa krye*: diçka që nuk dihet ku fillon e ku mbaron. “Namëta bëhet një heshtje e madhe, si brenda në pus a në ndonjë thellëtitirë *pa anë e pa krye*” (Vepra 4, f. 273).

Në anë të dheut: kudo, gjer në fund të botës. “Kur binin këto daulle, bubullima dëgjohej *gjer në anë të dheut*” (Vepra 4, f. 367)

S’ua gjen anën: nuk ke ku e kap, është bërë copë-copë. “Kish ara, kish vreshta, kish pemëtore. Ecje ditë e ditë e s’ua gjeje anën” (Vepra 4, f. 379)

Anë e kënd: kudo, gjithandej, anembanë; “Prej njëzet e tetë vjet pareshtur po i bie botës *anë e kënd* e asgjëkund nuk e mban për të mbajtur, as dheri, as deti”. (Vepra 1, f. 108)

Më të katër anët: ngado, gjithandej; “...i priste palla *më të katër anët*”. (Vepra 1, f. 209)

Arrëzë - *Theu arrëzën e qafës*: iku, e pësoi. “Tha kështu ariu dhe *theu arrëzën e qafës* nëpër male e gurë” (Vepra 4, f. 355)

Bar - *Është bar për plagë*: është ilaç shërues; “...zëri Gjonomadhëve siç thoshin të gjithë, *ishte bar për plagë*”. (Vepra 1, f. 199)

Bark - *S’mbush barkun me bukë*: është i varfër; “...ç’ e do këtë zanat kur të bie bretku e *s’mbush dot barkun me bukë*”. (Vepra 4, f. 404)

I hapet oreksi sa për katër barqe: i hapet oreks shumë i madh; “...mezetë e shijshme *ia hapën oreksin sa për katër barqe*”. (Vepra 1, f. 91)

Barrë - *Nuk e mban barra qiranë*: nuk ja vlen; “...*nuk e mbante barra qiranë* t’i shpinte më tutje”. (Vepra 1, f. 358)

Ballë - *S’i bën ballë*: s’e përballon dot, s’i reziston dot; “Dhe këngës *s’ke si i bën ballë* as ti, as miku”. (Vepra 2, f. 275)

I bën ballë: e përballon, reziston; “Pranë tij e ndiente zemrën të ngrohtë e më të ngrohtë, gati për t’i bërë *ballë* çdo stuhie”. (Vepra 4, f. 217)

Ballë për ballë: hapur; Kuteli e përdor në kuptimin: njëri tjetrin; “- Jo! – thirri Vllastari, -- Arbër isha, arbër jam! Nuk do të luftojmë *ballë për ballë*, po krah për krah, për dheuthin tonë”. (Vepra 4, f. 199)

Baltë - *Baltë e zotit*: njerëz të krihuar nga zoti. “Të gjithë jemi *baltë e zotit*”. (Vepra 3, f. 392)

Mbulon balta baltën: mbron i ndyri të ndyrin; “Trimat të vrasin vërtet, po më mirë të *mbulojë balta baltën*, se na bëre për faqe të zezë”

E le në baltë: e la keq, i doli i pabesë, e la vetëm; “Latini s’ka besë e të *le në baltë*”. (Vepra 1, f. 229)

Be - *Bën be*: betohet; “Edhe këtij *i bëri be*, edhe këtij *i dha besën*”. (Vepra 4, f. 302)

Bela - *Gjeç belanë*: e pësosh; “Ush, *gjeçi belanë*, se u vonuam”. (Vepra 1, f. 265)

Berihaj - *Lëshon berihanë*: thërret me zë të lartë; “Edhe luga e vogël pa bisht *lëshoi berihanë*: - Heeej, Kuma Maro! Të iku Xinxifillua”. (Vepra 4, f. 356)

Besë - *Jep besën*: betohet; “*Ju jap besën* e zotit, se ja e sjell këndeji, në vithe të kalit, nusen e Arnaut Osmanit, ja lë kryet në bjeshkë të Jutbinës”. (Vepra 4, f. 162)

E hëngri në besë: e tradhëtoi; “...Hyso Radoica...*më ka ngrënë në besë*”. (Vepra 4, f.166)

I zë besë: e beson; “*I zë besë* fjalës së djalit të fismë”. (Vepra 4, f. 147)

Nuk i zë besë: nuk i beson; “Malush agai *nuk i zuri besë* e nuk shkoi të luftonte për mbretin”; (Vepra 1, f. 218)

S’ka besë: është i pabesë; “...dëbora është si uji: *s’ka besë*”. (Vepra 1, f. 203)

E kanë bërë me besa besë: janë betuar, i kanë dhënë fjalën njëri-tjetrit; “*Ne e kemi bërë me besa-besë* që vasha të më presë nëntë vjet enëntë ditë”. (Vepra 4, f. 49)

Shkel besën: tradhëton, del nga fjala e dhënë; “...shqiptari vdes e nuk e *shkel besën*”. (Vepra 4, f. 49)

Lidh besën: bëjnë një marrëveshje për të cilën betohen se do t’i qëndrojnë besnik; “E kam parë kur *kishin lidhur besë* me kralinë”. (Vepra 3, f. 88)

Bir - I biri i botës: dikushi; “...që thua ti *i biri i botës* vjen e më kobon”. (Vepra 1, f. 296)

Bisht - I rritet bishti: i bëhet qejfi; “...i thosha: kalimera, barba Koço, Kalispera, barba Koço. Pos ise, barba Koço?” atij i rritej bishti”. (Vepra 3, f. 488)

E mbledh bishtin: tërhiqet; “...bletari i qe kreshpëruar dhe e kish bërë *të mbledhte bishtin*, të futë shpatën në mill”. (Vepra 3, f. 219)

I bën bisht: i dredhon, i ikën një pune; “Vëri nusët në punë, mos i kurse...kursehen vetë, *i bëjnë bisht*”. (Vepra 3, f. 416)

Bretk - *I bie bretku*: lodhet shumë, kapitet; “...mbjell, prashit, korr, shij, punoj, mundohem sa *më bie bretku*”. (Vepra 1, f. 286)

Bri - *I mbush brirët*: pin shumë alkool, dehet. “*T’i mbush brirët* nga lart e t’i zbraz nga poshtë, gjersa të më bëhet mali fushë e të më duket se flasin këta gurë të ftohtë”. (Vepra 3, f. 90)

Hyri lekunë bri të buallit: u bë shumë e vështirë të fitosh lekë. “S’po shkojnë; vendi s’i ble, se sikush ka të tijat. Korça s’i heq; as Tirana. *Hyri leku në bri të buallit*”. (Vepra 3, f. 423)

Budalla - *Budalla me brirë*: budalla i madh; “Këtë mund ta bësh vetëm po të jesh *budalla me brirë*”. (Vepra 1, f. 233)

Bukë - *Harram bukën* (mallkim): të shkoftë dëm ndihma që të kam dhënë; “...Malush agai I mori gjithë ata trima... - Jua bëj *harram bukën*! - u thirri beu trimave trimave”. (Vepra 1, f. 217)

Ha bukë veç: është njeri i virtytshëm, i fisëm, ose është shumë trim; “Unë s’ju pyes për trima sidokudo ... po për trima të vërtetë, për burra që *hanë bukë veç*”. (Vepra 1, f. 175)

Për këtë bukë (betim): mos paça kurrë bukë nëse nuk e mbaj betimin, ose nëse kjo gjë nuk është e vërtetë; “Se ta dish, po erdhi Selmani, të vret në vend, ja për këtë bukë”. (Vepra 1, f. 200)

Nuk i qajnë fëmija për bukë: nuk ka probleme, ka me se t’i ushqejë fëmijët; “Kish mall e gjë në fshat e ara në mal e në fushë e sido që të vinte puna, *nuk i qanin fëmija për bukë*”. (Vepra 1, f. 108)

Me bukën shtruar: Me ushqime të përgatitura, të bëra gati për të ngrënë; “...ky i priste *me bukën shtruar* e me fjalë të mirë”. (Vepra 1, f. 214)

Buqe - *Lidhe buqen*: Mbylle gojën; “*Lidhe buqen* se do të të dalë nam i keq në fshat”. (Vepra 3, f. 444)

Burrë - *Burrat e dheut*: thuhet jo për gjininë por për virtytet, mençurinë, trimërinë; “Edhe kur ka dëgjuar për trimëritë që ka bërë, është ngritur më këmbë, ka përpjekur duart e ka thënë: “u lumtë *burrave të dheut*”. (Vepra 1, f. 178)

E ndjen veten burrë: ndihet i zoti, ndihet i rritur; “...sa e *ndienin veten burrë*, meshkujt e kësaj dere martoheshin”. (Vepra 1, f. 178)

Në je burrë: nëse je trim, nëse nuk ke frikë; Dil sheshit *në je burrë!* - thirri Sefedini”. (Vepra 1, f. 185)

Burrë burrë: jam burrë; “*Burrë burrë*, po edhe plagët plagë... dhembin të shkretat”. (Vepra 1, f. 185)

Vdekje burri: vdekje heroike, trimërore; “Meshkujt e Gjonomadheve... kanë vdekur të gjithë *me vdekje burri*”. (Vepra 1, f. 176)

Si bie burri: si trim; “...ran ë luftë si bien burrat”. (Vepra 1, f. 230)

Buzë - *Vë buzën në gaz*: buzëqesh; “Dhe sa lezet i kish kur *vinte buzën në gaz*”. (Vepra 1, f. 199)

I qesh buza: gëzon; “Erdhën djemtë: Naqua, Gaqua e Taqua, të tre bashkë. Nuseve *u qeshi buza*”. (Vepra 3, f. 435)

Buzë më buzë: plot; “...të tre kthyen tri herë kupat të mbushura *buzë më buzë*”. (Vepra 3, f. 116)

Mbledh buzët: nuk i pëlqen; “Fija vazhdon: - E ëma *mbledh buzët*”. (Vepra 3, f. 444)

Buzë e hundë: I mërzhitur; “Fija bënte sikur rrinte *buzë e hundë*, po në gropëzat e faqeve i furfurinte një dritë e ëmbël”. (Vepra 3, f. 454)

I ka buzët me qumësht: është fëmijë; “Ju i keni edhe *buzët me qumësht*, megjithëqë thoni se ju ka ardhur koha t’i njomni me verë”. (Vepra 1, f. 210)

Shpie buzën në gaz: nënqesh; “Nja dy *shpunë buzën në gaz*, sa për t’i bërë qefin”. (Vepra 1, f. 260)

Bëj - *Bëri të hyjë*: u përpoq; “...u mundua dhe *bëri të hynte* prap në grynjat tek skuqnin paparunat”. (Vepra 1, f. 197)

Bërlok - *bëhet bërlok*: varfërohet; “Ne të tjerët u bëmë bërlok, ti vure dhjamë, pare të thatë”. (Vepra 1, f. 310)

Byk - *Është byk fare*: është keq; “Me skelat si jeni? *Byk fare*”. (Vepra 3, f. 377)

Copë - *Është bërë copë e gojë*: është shqyer, rreckosur; “Ajo ka parë këta vjetet e fundit, që kur u prish Turqia, asqerët e thyer të uritur e të rreckosur të Xhavit pashës, (që atëhere ka mbetur në fshat shprehja: “qenke bërë si asqer i Xhavit pashës”, që i thuhet ndokujt kur *është bërë copë e gojë*”. (Vepra 1, f. 237)

Çap - *Çap pas çapi*: në çdo hap; “Megjithatë, pengohet *çap pas çapi* nëpër gurët”. (Vepra 1, f. 250)

S'i dëgjohet çapi: ecën lehtë, pa u ndjerë zhurma e këmbëve; “Ecën e *s'i dëgjet çapi*, shkel e s'lë gjurmë”. (Vepra 1, f. 184)

Çare - *I bën çaren vetes*: gjen zgjidhje për veten, i del zot vetes: “Në je mbretëri, *bëja çaren vetes*. Puno, rrit gjë të gjallë, bëj stan e gjalpë e djathë”. (Vepra 1, f. 332)

Çekan - *Ku bie çekani*: për çfar bëhet fjalë; “More vesh ti *ku bie çekani*”. (Vepra 3, f. 416)

Çelo - *Ia jep si Çelua*: ia jep se s'bën, nuk ka asnjë mundësi që të mos ia japë; “Do t'ia japësh si *Çelua*, në mos me të mirë me të keq”. (Vepra 4, f. 292)

Datë - *Të kall datën*: të tremb, të frikëson; “Thërriste sa të *kallte datën*”. (Vepra 3, f. 483)

Degë - *Nuk është i lidhur pas degëve*: nuk ka të bëjë me njerëz të parëndësishëm ose nuk jepet pas gjërave të parëndësishme; “Unë *jam i lidhur pas rrënjëve*, jo pas degëve”. (Vepra 3, f. 475)

Derr - *Derr në thes*: pa e njohur; “Unë nuse dua, jo *derr në thes*”. (Vepra 4, f. 477)

Derr me zile: i keq, i mbrapshtë; “*Derr me zile* ka qënë. Ashtu rrinte ngahera: në brekë e në këmishë”. (Vepra 4, f. 277)

Derr me kreshtë: i keq, i pabindur; “Kështu, rrinte derri majë kotecit, sin ë tatrivan, mbi lumë, edhe gau-gau tërë ditën, të thoshe se *s'ishte derr me kreshtë*, po zog me pendë, i vënë në kafaz për të kënduar”. (Vepra 1, f. 350)

Të gjithë derrat një turi kanë: të gjithë të ligjtë janë të ngjashëm; “

Dell - *Është në dell të mirë*: është në qejf, është në të mirat; “Xheladin beu *ishte në dell të mirë*, bëntë i gëzuar, “ohoho!” e “ahaha”, jepte e merrte me vete”. (Vepra 1, f. 89-91)

Derë - *Mbetet në derë*: mbetet pa martuar; “...do të dalë name i keq në fshat e *do të na mbetesh në derë*”. (Vepra 3, f. 444)

Iu mbyll dera: mbetet pa trashëgimtarë; “...mbetem qyqe, pa djalë, *më mbyllet dera*”. (Vepra 4, f. 334)

Iu hap dera: erdhën trashëgimtarët e gjakut; “Unë dua që Qamili të vijë në shtëpi, *të më hapë derën*, të mos më shuhet fara”. (Vepra 1, f. 164)

I shuhet dera: nuk mbetet asnjë trashëgimtar; “Pra puna e nderi e donte që të vritej Sefedini, të shuhej e të mbyllej dera e Gjonomadheve”. (Vepra 1, f. 196)

I zë derën: nuk i ndahet, nuk ikën, nuk hiqet qafe; “Ne mezi i mbajmë me bukë e me mish këto që na kanë zënë derën”. (Vepra 3, f. 277)

Gaz për derë: gëzim për çdo familje; “Loni e këndon, gaz për derë”. (Vepra 3, f. 473)

Troket në derën e shurdhit: ankohet aty ku nuk e dëgjojnë, ku nuk ja zgjidhin hallin; “Paguaj si të thonë, pastaj shko e qahu ku të duash, me fjalë të tjera trokit në derën e shurdhit”. (Vepra 1, f. 236)

Ia mbyll derën me ferrë: e le pa trashëgimtar dhe të turpëruar; “Hajt, gremisu, moj bijë. Kjo është udha që ke dashur ti vetë. Ma mbylle derën me ferrë. Të mos kthehesh kurrë prapë”. (Vepra 3, f. 97)

Det - *E mat detin me filxhan*: Mendohet gjatë edhe për detajet më të vogla; “Kështu, jep e merr me vete, e mati detin me filxhan. Kur po vagëllonte mëngjesi mendja iu ndriçua”. (Vepra 4, f. 289)

I duket deti kos: i ngjan e lehtë, ka optimizëm të tepruar; “Sikujt i duket bregu shesh e deti kos”. (Vepra 2, f. 278)

Bëhet deti kos: pështjellohet puna; “Ta djegim një herë si në Domokos, pa le të bëhet deti kos”. (Vepra 3, f. 352)

Di - *S’do t’ia dijë*: nuk e vret mendjen; “- Ah, në të shtënça në dorë, s’do të të lë as bisht, as çallmë! Po pupa s’do t’ia dijë”. (Vepra 4, f. 329)

S’di ku të futet: s’di ku të fshihen prej frikës; “Ca njerëz bëjnë zemër e dalin me sforcë e sopata, po kur shohin arinë...s’dinë ku të futen”. (Vepra 4, f. 297)

Diell - *Nga ngroh dielli*: nga përfiton, nga i bëhet mirë; “Ki mendjen të shikosh nga fryn era e nga ngroh dielli”. (Vepra 1, f. 69)

Mbetet në diell: mbetet pa gjë, pa një dyshkë; “...ka lënë tapinë e shtëpisë e mbetet në diell”. (Vepra 1, f. 252)

Prapa diellit: shumë larg, në fund të botës; “Ç’të kërkojmë prapa diellit”. (Vepra 3, f. 394)

Si dielli kur del nga retë: Shkëlqen fort; “Sytë i shkëlqyen si dielli kur del nga retë. - M’i ndriçin eshtrat e shpirtit në këtë e në atë jetë Malush agait”. (Vepra 1, f. 214)

Djall - *Punon për djallin e për dreqin*: punon për të njerëz të këqinj, punon keq; Shpesh punojmë për djallin e për dreqin e s’na paguajnë fare”. (Vepra 3, f. 361)

Vafsh në djall: e pësosh, le të bëhet ç’të dojë me ty; “Haj në djall të vesh. Të mbajmë hatrin se je zotëri, ndryshe do të të flakim në bodrum”. (Vepra 3, f. 403)

Njëri djalli, tjetri dreqi: thuhet për dy njerëz të cilët janë njëloj të këqinj; “...që të dy ishin ortakë: njëri djalli, tjetri dreqi”. (Vepra 1, 211)

Ditë - *Ia zbardhi ditën*: ia bëri ditën të gëzueshme, të bukur; “Të prisja të më zbardhje ditët në pleqëri”. (Vepra 1, f. 170)

Ditët e mia në të tuat (urim): të të shtohet jeta, ditët e jetës sime t’i marrësh dhe t’i jetosh ti; “Ta marrtë të keqen Sheqerja bej. *Ditët tona në të tuat, bej*”. (Vepra 1, f. 69)

Luftë ditën, luftë natën: luftë pa pushim; “*Luftë ditë, luftë natë*, iu pakësua krahu turkut”. (Vepra 1, f. 230)

Djersë - *I venë djersët lumë*: djersin shumë; “Çupës *i venë* lotët çurk e *djersët lumë*”. (Vepra 4, f. 444)

Dreq - *E merr dreqi*: e pëson; “Pastaj pëlcastin të gjithë, *i merr dreqi*”. (Vepra 3, f. 509)

Dolli - *T’ia pish dollinë*: shumë i mirë, i fisëm; “Ndofta, pijanik, po nga ata që *t’ia pish dollinë* tri herë rresht, me fund”. (Vepra 1, f. 208)

Dorë - *Hoqi dorë*: nuk përzihet më në një punë, nuk e do më atë gjë. “Një herë e kish mbrehur, po kish dalë si pulë e rrjepur, pastaj *kish hequr dorë*” (Vepra 1’ f. 333).

Me dorë në zemër: megjith shpirt, sinqerisht. “Trimat e pritën *me dorë në zemër*, e u hodhën ta ndihnin t’i hipte pelës” (Vepra 1, f. 89).

Mbaj dorën: mos e prek, mos e godit. “...*mbaj dorën*, mre, e mos vra fëmijët” (Vepra 1, f. 230).

Të kësaj dore: të këtij lloji. “...t’u shtrojnë drekë e darkë e shumë të tjera *të kësaj dore*” (Vepra 1, f. 235).

Dora e zezë: njerëz të këqinj, vrasës. “...ua preu udhën dyfeku i Themistokliut me shokë: *Dora e Zezë!* U prapsën e ikën si lopët” (Vepra 1, f. 128).

Ndyn dorën: godet, rreh, vret një person. “Ik or djall në punën tënde, mos më bëj *të ndyj dorën*” (Vepra 3, f.402).

I ka duart e thata: nuk i zinte dora, s’dinte të bënte asgjë. “*Të thata i kish duart* që nuk vishej e zhvishej vetë” (Vepra 4, f. 384).

Zuri kokën me dorë: futet në telash, s’di nga t’ia mbajë. “Kur e mori vesh *zuri kokën me dorë*, po unë paratë i kisha futur në xhep” (Vepra 3, f. 504)

Me dorën e tij: një gjë e bërë nga vetë personi, pa me ndihmën e të tjerëve: “Sillmi vetë, *me dorën tënde*”. (Vepra 4, f. 416)

Dora e djathtë: ndihmësi kryesor. “Ajo, këmbëkuqja, zjarri i skëtërrës, *dora e djathtë* e Kuma Maros për të këqija”. (Vepra 4, f. 335).

I dha dorën: e ndihmon dikë. Po më dhe fjalën, *të jap dorën* të ngrihesh”. (Vepra 4, f. 282).

I priten duart: nuk ka fuqi për të bërë një punë të caktuar, është pesimist, i pamotivuar për të vepruar. “*I priten këmbët e duart*, mezi mbahet”. (Vepra 4, f. 418).

I merr dorën: e pyet, i merr mendim, i merr lejë. “Të gjithë janë shëndoshë e mirë, Ago Zylal. *Të marrin dorën*”. (Vepra 1, f. 251).

Shkon nga njëra dorë tek tjetra: kalon nëpër shumë njerëz, sa tek njëri, tek tjetri. “Paraja nuk humbet, nuk bie në gjol a në pus; *shkon nga njëra dorë te tjetra*”. (Vepra 1, f. 256).

Me ç’i zë dora: me çdo mjet. “Kur s’ke dyfek krisja në lule të ballitme mykë e me hej të sëpatës, me kosë, me kopaçe, me *me ç’të të zerë dora*”. (Vepra 1, f. 247); këtë frazeologjizëm Kuteli e përdor edhe në një kuptim tjetër: përvetëson, e bën të vetën gjithçka që prek, që pëlqen: Unë *kam ç’më sheh syri e ç’më ze dora* (Vepra3, f. 451).

Ja merr dorën: e mësoi zanatin, aftësohet të bëjë një punë të caktuar. “Pastaj *ja mora dorën* zanatit, u bëra murator”. (Vepra 3, f. 483).

I zgjidhet dora: godet dikë. “...kam frikë se ndonjë ditë *do të më zgjidhet dora*, që të më vejë name anembanë, si asaj vjerrës të qëmoçme që i rrihte nuset me vastangarkë”. (Vepra 3, f. 419).

Dora vetë: përdoret për të konfirmuar një peëron. “Apollodori, babai Filotas? *Dora vetë*”. (Vepra 3, f. 331)

I dorës së parë: shumë i mirë, shumë cilësor: “Ata kanë sjellë mall të dorës së parë”. (Vepra 338)

I dorës së dytë: rang i ulët shoqëror, jo shumë i rëndësishëm, jo shumë cilësor. “Se ish der’ e unjtër, nga *dor’ e dytë*” (Vepra 1, f. 118)

Ka dorë të lirë: ka të drejtë të veprojë siç do vetë. “*Do të kesh dorë të lirë* të vrasësh e të presësh kë të duash e sat ë duash”. (Vepra 4, f. 228)

E shtie në dorë: e kap. “Si *e shtinë në dorë* me të pabesë Pjetër Shinin, turqit e munduan shumë”. (Vepra 4, f. 250)

Nuk i mund dora e thoi: Nuk është në gjendje të veprojë. “Ama tërë udhës ajo nuk i preu mallkimet... siç e ka graria, kur *nuk i mund dora e thoi*”. (Vepra 4, f. 283)

E mori në dorë: merr përsipër të realizojë një detyrë, një punë. “Dashkan të marrin qeverinë në dorë, dashkan t’ua ndajnë tokën hiçërve”. (Vepra 3, f. 505)

Vë dorë: ndihmon, ndërhy, rregullon, sistemon. “...i lartmi rri e shikon që atje ku oshtë. E si shikon, *vë dorën*, i paçim uratën”. (Vepra 1, f. 227)

Nën dorë: fshehurazi, në mënyrë korruptive, të jashtëligjshme. “...për punë të mëdha duan pare të madhe *nën dorë*”. (Vepra 1, f. 286)

Me të dy duart: shumë, pamasë. “...vjedhin *me të dy duart*, zgrapin, zhgrapin”. (Vepra 1, f. 286)

E shkruar nga dora e zotit: e vendosur nga fati, nga një forcë jashtë njeriut. “...shumë nga mysafirët e të afërmit ishin sëmurur, po kësaj s’ke ç’i bën: sikush si *ta ketë shkruar nga dora e zotit*”. (Vepra 1, f. 66)

Me duar bosh: nuk sjell asgjë, asnjë dhuratë. “Asnjë nuk vinte *me duar bosh*”. (Vepra 1, f. 78)

Dy duar për një kokë: të bësh gjithçka për të shpëtuar veten. “Prandaj secili duhet të mbrohet vetë – *dy duar për një kokë*”. (Vepra 4, f. 504)

I hahen duart: mbetet pa duar, lodhet; "...i bëjnë bisht punës, kanë frikë mos *u hahen duart*". (Vepra 3, f. 416)

S'ka gjë në dorë: s'ka pushtet, s'bën dot gjë; "...*s'ka gjë në dorë*; punëtor si ne të gjithë"

S'i shpëton nga dora: nuk e lë t'i ikë, e mban me çdo kusht; "Edhe sikur në bri të buallit të futesh, moj Vesemblla, prapë *s'më shpëton nga dora*". (Vepra 4, f. 288)

Ka dorë të lirë: ke të drejt të bësh ç'të duash; "*Do të kesh dorë të lirë* të vrasësh e të presësh kë të duash e sat ë duash". (Vepra 4, f. 228)

Në dorë të fatit: thuhet për diçka që varet nga forca jashtë njeriut; "...shpresat i kish lënë në dorë të fatit të shiut që ishalla-mashalla mund të jepte zoti". (Vepra 1, f. 234)

I mban dorën: e pengon; "...vriteshin e priteshin si donin vetë e sa deshën vetë e s'guxonte njeri *t'u mbante dorën*". (Vepra 1, f. 182)

Dru - *la vënë drunë*: e përzënë; "Edhe çupat kundër meje. Edhe gruaja, Shko fito! *Më vunë drunë*". (Vepra 3, f. 502)

Dushk - *Dushk për gogla*: Fjalë të thëna kot, fjalë pa lidhje; "*Dushk për gogla*, Ilo vëlla. Një herë ustai, një herë agai". (Vepra 1, f. 295)

Dërrasë - *Çan dërrasa*: flet fjalë të kota, flet gjepura; "Pastaj rënke të flesh *zënke të çash dërrasa*". (Vepra 1, f. 295)

Dyfek - *Ku shtie dyfeku*: ku e ka fjalën; "Xha Dalipi e mori vesh se *ku shtinte dyfeku* e tha: peqe, peqe. Ja tani". (Vepra 1, f. 288)

Dyme - *Mban dymenë*: shikon punën e vet, ia mban anën dikujt, mban drejtimin; "...po o burrë, nd'je turk, *mbaj dymenë*". (Vepra 2, f. 12); ose: "...*mbante dymenë* më të mëngjër". (Vepra 1, 110)

Dynja - *I vjen dynjaja rrotull*: i merren mëntë, nuk është rregull nga mendja; "Mua sikur *më vinte dynjaja rrotull* nga gëzimi". (Vepra 3, f. 499)

Llamba e dynjasë: thuhet me ironi për dikë që e konsideron veten shumë të rëndësishëm për mbarëvajtjen e njerëzve; "...mbreti i osmanllisë është "*llamba e dynjasë*" dhe se ata, redifët, duhej të jepnin jetën e tyre për këtë "*llambë*". (Vepra 1, f. 142)

Dykatsh - E ndan më dykatsh: e ndan më dysh, e ndan në dy pjesë; "...i hoqi ca shkopinj vitheve, një këtej, një andej, sa veshgjati mend u palos *më dykatsh*". (Vepra 2, f. 201)

Dhe - *Thahet mbi dhe*: nuk vdes; "Pse më le të *thahem mbi dhe*". (Vepra 1, f. 272)

Merr dhenë: përhapet gjithandej; "...lajmi *mori dhenë*". (Vepra 4, f. 316)

I ikte dheu: i merreshin mendtë; "U bëra kockë e lëkurë, s'çapesha dot. Më dridheshin këmbët, *më ikte dheu*". (Vepra 3, f. 301)

Dhjamë - *Për dhjamë qeni*: kot; "...do të punosh *për dhjamë qeni*, si skllav". (Vepra3, f. 405)

Dhëmb - *Me shpirt ndër dhëmbë*: me shumë mundim; “Pra burri... arrin me shpirt ndër dhëmbë gjer rrëzë lisit”. (Vepra 4, f. 406)

I armatosur gjer në dhëmbë: shumë i armatosur; ...dilte Olloman beu me dyzet a pesëdhjetë trima të zgjedhur me kandar të zjarrit, të armatosur gjer në dhëmbë”. (Vepra 1, f. 209)

S’ia ha dhëmbi: nuk e merr dot, nuk e mposht dot; “Nejse, ta lëmë të bëjë si të dojë, se s’na e ha dhëmbi”. (Vepra 3, f. 443)

I njeh dhëmbë e dhëmballë: e njeh shumë mirë; “Këtë ma ka treguar miku i zemrës, Batuni I Drimonës, që u njihte dhëmbë e dhëmballë”. (Vepra 4, f. 230)

Dhëmbët si dhëmbë dykeli: dhëmbë të shtrembër; “...dhëmbët e çupës si dhëmbë dykeli”. (Vepra 3, f. 444)

Mpreh dhëmbët: bëhet gati për të ngrënë diçka; “Vasha e trimi iu afrua kuçedrës. Kjo zuri të mprehë dhëmbët”. (Vepra 4, f. 18)

Emër - *As emri nuk iu dëgjua*: u zhdruk; “Ama Kuma Maros as gjurma nuk iu duk, as emri nuk iu dëgjua”. (Vepra 4, f. 284)

Ia thonë emrin: e quajnë; “Si ia thoshin emrin atij gjahtarit, o tatë”. (Vepra 4, f. 340)

Bën emër: urdhëron; “...vuri një mish në hell e bëri emër t’ia ziejmë gazit”. (Vepra 2, f. 37)

Erë - *kish marrë erë*: nuk mbeti njeri pa dëgjuar për këtë punë, e kanë marrë vesh të gjithë. “Megjithëqë jepja shumë rryshfet, puna kish marrë erë, qe ndërruar shefi i policisë” (Vepra 3, f. 304).

I kish rënë era: e kish kuptuar, e kish nuhatur. “Më kish rënë era se po vinte kriza e madhe” (Vepra 3, f. 505)

Bie erë: duket se kush është autori. “ - Po paratë”? - Ia mori e shoqja, që kish pasur gisht në vrasje. U martua me një grek që mbante një llokandë tjetër kumara. Policia e mbylli punën se binte erë”. (Vepra 4, f. 486)

Kollovitet në erë: tundet; “Nis tani e kollovitet në erë”. (Vepra 2, f. 290)

Bëhet erë: zhduket; “Etleva u ngrys. Ëndrrat e saj ishin bërë erë”. (Vepra 3, f. 36)

Erz - *Ia merr erzin*: e turpëron; “Më ka marrë erzin ditën e pazarit, përpara gjithë botës”. (Vepra 1, f. 265)

Faqe - *E fshin nga faqja e dheut*: e zhdruk, e vret; “Do t’u shuajmë fare, do t’u zhdrukim nga faqja e dheut”. (Vepra 1, f. 198)

E zhdruk nga faqja e dheut: e shfaros, e vret; “...tani donte ta zhdunkte nga faqja e dheut”. (Vepra 3, f. 44)

E bën për faqe të zezë: e turpëron; “Përtesa të bën për faqe të zezë”. (Vepra 3, f. 112)

Për faqe të zezë: për turp; “...na mbetën kapule, për faqe të zezë”. ((Vepra 3, f. 415)

Ia zbardhi faqen: e nderoi; “Përpiqi të ma zbardhni faqen”; (Vepra 3, f. 211)

Faqebardhë - *E nxjerr faqebardhë:* e nderon; “Na rruat kali që na nxorri faqebardhë”. (Vepra 4, f. 255)

Farë - *I shuhet fara:* zhduket, nuk i mbetet asnjë prej fisit të vet; “...nuk i kish mbetur njeri në shtëpi, po i shuhej fara, se po i shembej mulliri i Shkumbanores e s’kish kush t’ia punonte selishtën”. (Vepra 1, f. 163)

S’i shuhet fara: nuk zhduket, i mbeten pasardhës të gjakut; “Unë dua që Qamili të vijë në shtëpi, të më hapë derën, të mos më shuhet fara”. (Vepra 1, f. 164)

Ferrë - *I zë ferra këmbët:* i dalin pengesa; “Sot më zuri ferra këmbët të rrit edhe fëmijët e fëmijëve”. (Vepra 3, f. 417)

Çan ferrat: ikën fshehurazi; “...do të më rrëfente se si kish shpëtuar gjyshi, Gjergua, nga çengeli i Sinan beut, se si kish çarë ferrat natën, me fëmijët, se si kish sosur natën në Zaum”

Fill - *S’merr fill:* s’merr drejtim; “Fjala s’merrte fill, ashtu siç nuk merr zjarr kashta e lagur”. (Vepra 1, f. 246)

Fiqir - *Mbledh fiqirë:* Mbledh mendjen, qartëson mendimet; “Mblidh fiqirë, o i mirë. Vëri gishtin kokës, o i lig”. (Vepra 4, f. 388)

Fir - *Bëhet fir:* mbaron; “Në motin e zisë, kur u bë fir gjysm’ e botës...u javit në Liqeras një plakushe e veshur krejt në të bardha”. (Vepra 2, f. 221)

Fjalë - *Dërgon fjalë:* i dërgon dikujt një mesazh. “Hysua i dërgoi fjalë vashës: “O vashë e bardhë! Unë të kam dashur fort e tani të dua dhe më fort”. (Vepra 4, f. 152)

Jep fjalën: premtan. “Po më dhe fjalën, të jap dorën të ngrihesh”. (Vepra 4, f. 282)

U hap fjala: u përhapën gjithandej fjalë rreth një një ngjarjeje, një dukurie, u përhap një thashethem etj. “U hap fjala fund e kënd gjersa i ranë në vesh një plaku të uruar nga Çermenik’ e madhe”. (Vepra 4, f. 314)

I thotë një fjalë në vesh: i thotë fjalë dikujt për ta manipuluar, për të rregulluar apo zgjidhur ndonjë punë. “Po edhe ti i thuaj një fjalë në vesh Myrto beut: se e ke mik të vjetër”. (Vepra 1, f. 249)

Ia prish fjalën: ia ndërpret fjalën ose e kundërshton. “Guxoi t’ia prishte fjalën, bile, edhe Ago Zylalit, që është goxha aga”. (Vepra 1, f. 254)

S’ka fjalë e kuvend: është shumë e vërtetë e nuk ka diskutim. “Der’ e mirë kjo e Belortasë, s’ka fjalë e kuvend”. (Vepra 1, f. 113)

I bën fjalë: i kërkon. “...i biri na kish sjellë një pelë nga Myzeqeja, na i kish rënë në vesh Kahreman beut e ky i bën fjalë t’ia japë peshqesh. I biri i Nestorit s’do”. (Vepra 1, f. 113)

S’e bën fjalën dy: nuk e kundërshton, e zbaton një kërkeë pa asnjë diskutim. “Ne s’e bënim fjalën dy, se lugën e kishim në brez”. (Vepra 2, f. 179)

Ja prët fjalën me sopatë: ia ndërpret fjalën në mënyrë të vrazhdë, me të keq, me forcë. “Miqësia miqësi, po babait s’i pëlqeu se Rrapua ia kish prishur kuvendine ia kish prerë fjalën me sopatë”. (Vepra 2, f. 137)

Doli fjala: u vërtetua. “Doli fjala jote. Erdhi ai”. (Vepra 3, f. 15)

E hodhi fjalën: kur thuhet një fjalë ngacmuese që lë nënkuptime. “Mirëpo Mërtiri kish hedhur atë fjalën e vrazhdë, “haraç”. (Vepra 3, f. 379)

Fjalën ta kemi fjalë: mbaje fjalën që the, mbaje besën. “Ama fjalën ta kemi fjalë: sot s’punojmë”. (Vepra 3, f. 381)

Ja përpin fjalët: e dëgjon me vëmendje, me kënaqësi. “Mjeshtrit e shikojnë në gojë, ia përpijnë fjalët”. (Vepra 3, f. 377)

S’e mban fjalën: nuk qëndron besnik, e thyen besën e dhënë. “Atyre të tjerëve që s’e mbajtën fjalën, ua mora hakun”. (Vepra 4, f. 299)

I vete fjala në vesh: e dëgjon këtë fjalë. “...po u vajti fjala në vesh, do të na nxjerrin në diell”. (Vepra 3, f. 449)

Fjalë burri: fjalë me mend, fjalë që mbahet. “Ke të drejtë Muj. Fjalë burri ke thënë”. (Vepra 4, f. 152)

Me një fjalë goje: shumë thjesht, shumë lehtë, vetëm me një fjalë, me pak gjë; “Me një fjalë goje, banka i numëron tink-tink një mijë të verdha”. (Vepra 3, f. 358)

E kanë bërë me fjalë: janë marrë vesh, kanë vendosur; “...të fton t’i vesh për gëzim si mik, ashtu si e keni bërë me fjalë natën e dasmës”. (Vepra 2, f. 231)

T’i nxjerr fjalët me darët e nallbanit: t’i nxjerr fjalët me forcë; “Hej, ç’më gjeti me këtë hundëleshe...Kjo t’i nxjerrka fjalët me darën e nallbanit”. (Vepra 3, f. 450)

Ku e ka fjalën: për çfarë po flet; “Kalakulët e morën vesh se për ku e kish fjalën”. (Vepra 3, f. 474)

Dua fjalën: dua të më japësh besën; “Unë dua fjalën”. (Vepra 4, f. 282)

S’i kthen fjalën: nuk e kundërshton; “Kështu më thotë edhe mua beu. S’ia kam kthyer kurrë fjalën”. (Vepra 4, f. 301)

Lidhin fjalë: vendosin; “Pas nëntë ditësh do të martohet vasha e Ymer Agës, siç e kishin lidhur fjalën bashkë”. (Vepra 4, f. 48)

Ja dëgjon fjalën: e merr parasysh çfarë thotë, bën çfarë i thotë, i bindet; “...ia kam dëgjuar fjalën: ku më ka dërguar - kam vajtur, ku ka dashur - kam luftuar”. (Vepra 4, f. 48)

Si i thonë një fjale: siç thuhet; “...si i thonë një fjale, po të rrosh me ujë - duhet të ulëris”. (Vepra 4, f. 318)

E sjell fjalën: e çon bisedën atje ku do; “...e shoqja e sillte si e sillte fjalën dhe e bënte të qeshte”. (Vepra 4, f. 193)

E gëlltet fjalën: thuhet kur dikujt i vjen për të thënë një fjalë, por nuk e thotë; “Tete Ngjelua diç u mat të thotë por e gëlltiti fjalën”. (Vepra 3, f. 474)

Dy fjalë: përdoret kur do të thuash shumë shkurt diçka të rëndësishme; “Urdhëroni e dëgjoni dy fjalë”. (Vepra 1, f. 176)

E rëndoi në fjalë: E fyeu; “Kështu, Qamili zuri ta rëndojë shumë e më shumë në fjalë”. (Vepra 1, f. 169)

Flas - *flet-e-qesh*: e qeshur; “...ty të ndizet gjaku për ndonjë ndonjë fustan mbi gju, pika-pika, a për ndonjë *flet-e-qesh*”. (Vepra 2, f. 278)

Fletë - *kthen fletë*: ndërron mendim; Kur pa se *qe kthyer fleta*, Olloman beu ktheu kalin e mori poshtë në mes të bataveve të dyfeqeve”. (Vepra 1, f. 217)

Fora - *Ia bëri fora*: la nam, bëri diçka të madhe, një veprim që i çuditi të gjithë. “...*ia kish bërë fora*, andej në pashallëkun e babait” (Vepra 1, f. 84).

Foshnjë - *Dridhet foshnja në barkun e nënës*: thuhet kështu për të cilësuar një situatë tepër të frikshme; “Kur dilte Olloman beu pazarit me dyzet a pesëdhjetë trima të zgjedhur me kandar të zjarrit...*dridhej foshnja në barkun e nënës*”. (Vepra 1, f. 209)

Frikë - *I hyn frika në palcë*: frikësohet, trembet shumë; “Njerëzve *u ka hyrë frika në palcë*, dridhen”. (Vepra 4, f. 341)

Frëng - *E bën si frëngu pulën*: e paraqet si një mall shumë më të kushtueshëm se ç’është; “Saraf i madh, thotë, spicer nga ata të Korçës, na *e bën si frëngu pulën*”. (Vepra 1, f. 265)

Frymë - *Jep frymën*: vdes; “Bufi, para se të *japë frymën*, i nguli në fyt atë sqepin e kthyer si kanxhë e s’ia hoqi më”. (Vepra 4, f. 319)

Fshesë - *I vë fshesën*: e përzë; “...*ne do tu vemë fshesën* gjithë atyre që rrojnë në kurriz të të tjerëve”. (Vepra 3, f. 408)

Fund - *Merr fund*: mbaron; “...*puna merr fund*”. (Vepra 1, f. 249)

Pa fund e pa krye: e ngatërruar, lëmsh; “...na shqisnin përpara qepallave të pulitura ëndrra të ngatërruara, *pa fund e pa krye*”. (Vepra 1, f. 205)

Furtunë - *U bë furtunë*: iku me vrap, iku si era; “Xheladin beu i nguli mamuzet pelës, ngriti kamxhikun, e goditi. *Pela u bë furtunë*”. (Vepra 1, f. 103)

Gaz - *Ia zjen gazit*: feston; “...*t’ia ziejmë gazit* si në gosti të parë”. (Vepra 2, f. 37-38)

Ia plas gazit: qesh fort, gëzon fort; “Ata burrat e Bardhonës *ia plasën gazit*”. (Vepra 3, f. 326)

Hidhet nga gazi: gëzohet, shpërthen në gëzim; “Ai e sheh pupën që *hidhet nga gazi* në një degë të zhveshur”. (Vepra 4, f. 329)

Gazi i gazeve: thelbi i gazeve; “Pastaj kish ardhur fejesa - *gazi i gazeve*”. (Vepra 3, f. 27)

Gojë - *Hap gojën*: folë; “Kush druan e nuk zë besë, le të ngrihet e të *hapë gojën* se unë jam i zoti t’i them si e qysh”. (Vepra 2, f. 266)

S’e ze në gojë: nuk e përmend; “...as që duhet *ta zemë në gojë*, se merret vesh që nën pjergull I kanë varret”. (Vepra 2, f. 267)

E ka gojën brisk: është i zoti i fjalës; “Zemrën e ke të bardhë, *gojën brisk*”. (Vepra 3, f. 407)

I shket goja: thotë një gjë që s’duhet thënë; “Mos ma merr për të keq, o kapedan, se unë jam plakë e mund të më shkasë goja”. (Vepra 3, f. 450)

Sa u tha goja: sa deshën, sa kërkuan; “...u dhamë sa u tha goja”. (Vepra 3, f. 415)

I lëshon goja lëng: e pëlqen shumë një ushqim; “Nuk zgjati dorë të merrte ndonjë kokërr, megjithëqë i lëshonte goja lëng”. (Vepra 3, f. 63)

Mban botën nëpër gojë: përflet të tjerët; “...mban botën nëpër gojë: jo po ky merr rryshfet, jo po tjetri vjedh”. (Vepra 1, f. 288)

E prish gojën: thotë fjalë të ndyra; “Sa për Marijen... Ptu, ment prisha gojën”. (Vepra 1, f. 287)

Mbyll gojën: mos folë më; “Mjaft lehe! Mbyll gojën”; (Vepra 1, f. 267)

Mbeti me gojë hapur: U çudit, u hutua; “...kush e vështronte mbetjet me gojë hapur”. (Vepra 1, f. 343)

Gojë mbas goje: ka mbetur duke kaluar gojë pas goje e nuk është shkruar; “Gojë pas goje i paska ronë në vesh mbretit të Turkut se kostandini i Bubullimës me dyzet copë fshatra s’hap udhë për nga deti ku oshtelatini me kreshtë derri”. (Vepra 1, f. 229)

Ç’ t’i thosh goja: gjithë ç’kërkonte; “Sot dëgjoje se zaptoi një koriye të re, nesër një mulli, një luadh, një han e ç’ t’i thosh goja”. (Vepra 1, f. 208)

Hap gojën e kërko: kërko sa të duash; “Ti veç hap gojën e kërko e mbaj dorën të ti numërojë mexhitet”. (Vepra 1, f. 345)

Zë në gojë: e përmend; “...në atë shelgun degëvarur që zumë në gojë, mblidhen njerëzit për të vënë në udhë punët e fshatit”. (Vepra 1, f. 235)

Nuk e zë në gojë: nuk e përmend; “Vetëm Hysen Kraposhnikun nuk e zë askush në gojë”. (Vepra 4, f. 153)

Ia rrëmben thelën nga goja: i merr pa të drejtë dikujt diçka, tamam në momentin kur e ka realizuar e duhet ta shijojë; “...Ai e kuptoi sakaq se miku i tij i ngushtë, Aristomaku, donte t’ia rrëmbente thelën nga goja”. (Vepra 3, f. 339)

S’ia mban gojën botës: nuk i ndalon fjalët që thonë të tjerët, që thotë bota; “Le të zienin sa të donin harbutët, se unë s’ia mbaj gojën botës”. (Vepra 3, f. 493)

Me një gojë: kur dy ose më shumë veta thonë njëherësh të njëjtat fjalë; “...hëngrën meze turshi, hodhën e pritën, pastaj thanë me një gojë: “ky djalë ka marrë plevit në mëlçinë e bardhë”. (Vepra 4, f. 373)

I merr gojën: i heq aftësinë për të folur; “...ky iu hodh mbi sup e iu qep si plasja, i mori gojën e zuri t’i bjerë me këmbë brinjëve”. (Vepra 2, f. 298)

Të lumtë goja: urim i cili ka brënda aprovimin dhe kënaqësinë dhe i drejtohet njeriut që flet mirë dhe drejt; “Ashtu të lumtë goja, xha Dalip”; (Vepra 1, f. 302)

Për çdo gojë: për të gjithë; “Ku ka drekë mbreti pa mish? Me mish shumë dhe të mirë për çdo gojë”. (Vepra 4, f. 315)

Ia merr hajen nga goja: ia rrëmben ushqimin; “Kushedi ç’nomatisin e na e marrin hajen nga goja”. (Vepra 4, f. 314)

Nuk e çel gojën: nuk flet; “Sa për përgjigjen, po të jemi të zotët - do të ta japim, po të mos jemi - nuk do çelim gojë”. (Vepra 4, f. 151)

Nxjerr zjarr nga goja: është shumë i inatosur, lëshon fjalë që shprehin zemërim; “Ai s’është si arinjte e tjerë, po i fortë e i djallëzuar sa për shtatë, zemërak. Nxjerr shkëndija nga sytë, zjarr nga goja”. (Vepra 4, f. 334)

Gojën e ka sa për katër: është i zoti i fjalës; “Unë e çalë jam, vërtet, po gojën e kam sa për katër”. (Vepra 4, f. 356)

Ndërron gojën: ha një ushqim të ndryshëm nga ai rutinë; “Mblidh o kapedan, edhe ca gështenja boçka e fshihi ku di vetë, që të kesh se ç’të brehësh në dimër e të ndërrosh gojën”. (Vepra 4, f. 327)

Mbetet pa gojë: trembet aq shumë sa nuk flet dot; “Po sa I vrazhdë ish ky njeri! Më I vrazhdë se sa vetë ariu. Trëndelinua mbeti pa gojë”. (Vepra 4, f. 278)

Të gjitha ato që i duhen gojës: të gjitha ato që i hahen; “...i qe tekur për një gosti të mirë, me të gjitha ato që i duhen gojës”. (Vepra 4, f. 314)

E ka gojën të madhe: flet shumë, është llafazan; “Lëre, bir-o, fshanë t’i thotë sit ë dojë, se fshati e ka gojën të madhe”. (Vepra 1, f. 107)

Gur - *S’lë gur pa luajtur:* i përdor të gjitha mënyrat; “Ky s’la gur pa luajtur, po kësaj here ish zënë ngushtë: prefekti nuk i zgjati dorën”. (Vepra 3, f. 404)

Nuk lë gur mbi gur: bën çdo gjë, lëviz çdo gjë, përmbys çdo gjë; “...nuk do të lërë gur mbi gur: do të djegë, do të vrasë, do të marrë skllëvër dhe pre”. (Vepra 3, f. 148)

Gëk - *S’bën as gëk as mëk:* s’nxjerr asnjë zë, s’thotë asnjë fjalë; “...xheladin beu s’guxoi të bënte as gëk as mëk”. (Vepra 1, f. 84)

S’e lë të bëjë gëk: s’e lë të flaës, të kundërshtojë; “...e mbërthejnë në vend yzbashin, s’e lënë të bëjë gëk”. (Vepra 1, f. 334)

Gisht - *I vë gishtin kokës:* mendohet mirë; “Veri gishtin kokës, se do të të shpien lidhur në Tiranë me gjithë gomar”. (Vepra 3, f. 510)

Ka gisht: është përzier; “...kur i zhdukej ndokujt gjurma si uji në ujë, ta dish se kish pasur gisht Olloman beu”. (Vepra 1, f. 209)

Me gisht në gojë: pa gjë; “Që të paguanin këtë xhelep, duhej të paguanin më shumë se gjysmën e gjësë së gjallë e të mbeteshin me gisht në gojë”. (Vepra 1, f. 333)

Të futësh gishtin në mjaltë e të mos lëpish: të kesh në dorë një gjë të mirë e të mos hash; “...Ago Zylali, anëtar i kryepleqësisë së fshatit, ndante ujin dhe si qënka e mundur të futësh gishtin në mjaltë e të mos lëpish”. (Vepra 3, f. 233)

Gomar - *E nxjerr gomarin nga balta:* është i zoti, e zgjidh punën; “Ejani, o të mënçur të Athinës, të Elesit dhe të Apolonisë të ma nxirrni gomarin nga balta”. (Vepra 3, f. 269)

Gjak - *Iu ndez gjaku*: është në kulmin e zemërimit. “Sefedinit *iu ndez gjaku*. U ngrit krah për krah me dibranët dhe i vuri dyfekun katraveshit me opinga derri” (Vepra 1, f. 191)

Iu nxeh gjaku – u inatos, u acarua shumë. “Kuma Marua ia merr këngës për të nxehur gjakun” (Vepra 4, f. 359)

I hyri në gjak: i është bërë si mish e shpirt, si një gjë e pandashme. “Pas tri ditësh fillova prapë me Marikën. *Më kish hyrë në gjak*, më kish helmuar. Nuk ndahesha dot” (Vepra 1, f. 147)

I ngriu gjaku: u frikësua shumë. “*Të ngriu gjaku?* Mos ki frikë” (Vepra 3, f. 74).

I ra gjaku: u qetësua. “Mbretit *i kish rënë gjaku*, po kur dëgjoji se i biri i tha “baba” e s’i tha “babambret”, sit ë tjerët, vari vetullat” (Vepra 4, f. 385).

Ka derdhur gjak: është përpjekur, ka luftuar shumë. “...ne kemi derdhur djersë e gjak për Shqipëri” (Vepra 3, f. 505).

Të merr gjak në vetull: është shumë trim. “...solli me vete dy të bijtë, trima që të merrnin gjak në vetull”. (Vepra 4, f. 317)

I punon gjaku: është vital, plot jetë. Në dimër e pi njeriu...që t’i punojë gjaku, se pa raki, zoti na ruajt, *nuk punon gjaku*” (Vepra 2, f. 271)

S’ngopet me gjak: është shumë mizor, s’pushon së vrari. “Shqyen berra, çan derra e s’ngopet me gjak”. (Vepra 4, f. 297)

Vete gjaku lumë: vriten shumë. “*Vajti gjaku lumë*.Vrau i biri t’anë, se ish ushtar, i jati rebel” (Vepra 3, f. 482)

Ra në gjak: u fut në hasmëri; “Ai vetë s’na hyn në punë...*biem në gjak*. Ti e di Dardon”. (Vepra 3, f. 282)

I lutet me gjak të zemrës: i lutet nga thellësia e shpirtit; “ I vogli priste sa priste, pastaj *i lutej me gjak të zemrës*”. (Vepra 4, f. 400)

Janë një gjak: janë të një trangu, të një fisi; kanë lidhje gjaku; “E di po ne *jemi një gjak*”. (Vepra 4, f. 401)

Gjaku ujë s’bëhet: njeriun tënd s’mund ta shpërfillësh, ta konsiderosh të huaj; “...*jemi një gjak. Gjaku ujë s’bëhet*”. (Vepra 4, f. 401)

E çon gjakun gjer në gju: u derdh shumë gjak, u vranë shumë; “ Po ta dijë se unë do ta çoj gjakun gjer në gju”. (Vepra 4, f. 165)

I lag me gjak: i vret; “Marr njëqind burra nga ata që kam nën urdhë, zbres në Shëmërtinë tuaj, e nuk lë gur mbi gur. *I lag të gjithë me gjak*”. (Vepra 1, f. 199)

Ndizet gjak i ri: hapet hasmëri e re; “Thonë se për këtë të pabërë *u ndez gjak i ri?* Jo, *nuk u ndez gjak i ri*, po u shua edhe i vjetri”. (Vepra 1, f. 200)

Shuhet gjaku i vjetër: mbyllet hasmëria e vjetër; “Jo *nuk u ndez gjak i ri*, po u shua edhe i vjetri”. (Vepra 1, f. 200)

Gjallë - *Gjallë a vdekur*: patjetër, domosdoshmërisht; “Unë e dua Aplon e Beosit. *Gjallë a vdekur*”. (Vepra 3, f. 240)

Në të gjallë: që kur është në jetë, kur s’ka vdekur; “...i kishin nxjerrë këngë që në të gjallë”. (Vepra 1, f. 214)

E ha të gjallë: i bën keq, e torturon, ia merr jetën; “Këta, - tha ajo me mendje, - *do të më hanë të gjallë* bashkë me time bijë”. (Vepra 4, f. 292)

Gjemb - *Rri si në gjemba*: rri në siklet, jo rehat; “*Rrinin si në gjemba*, të mërztur, të vrejtur”. (Vepra 1, f. 233)

Gjoks - I vë gjoksin: i përkushtohet totalisht një pune punon shumë; “Unë *i vura gjoksin* shtëpisë, punova sa për katër”. (Vepra 3, f. 417)

I bie gjoksit: mburret, lëvdohet; “*I binin gjoksit* e thërrisnin: - “Ne kemi lëftuar për Shqipëri, ne kemi derdhur djersë e gjak për Shqipëri”. (Vepra 3, f. 505)

Gjuhë - *E mban në majë të gjuhës*: e ka një fjalë, një përgjigje gati; “Atëherë Ago Zylali e thumboi si grerë me atë fjalën që *e mban në majë të gjuhës*”. (Vepra 1, f. 266)

Gjumë - *Bën gjumin e shqerrave*: fle i qetë; “Fëmijët *bënin gjumin e shqerrave*”. (Vepra 3, f. 313)

Merr një sy gjumë: fle pak; “Haj, *merr një sy gjumë* se po gdhihet”. (Vepra 3, f. 381)

Ia merr me gjumë: fle; “Tani po mendon *t’ia marrë me gjumë* posa të shtrohet dëborë në pyll”. (Vepra 4, f. 328)

Nuk vë gjumë në sy: nuk fle; “Po të jetë vashë *nuk do të vërë gjumë në sy*, pot ë jetë djalë do të flejë i qetë”. (Vepra 4, f. 144)

E zë gjumi: fle; “Vashën e *zë gjumi* menjëherë, djalin nuk e zë”. (Vepra 4, f. 144)

Gjurmë - *Ia gjen gjurmën*: e gjen, e dallon se ku është; “...thuamë shpejt si *do t’ia gjesh gjurmën* asaj që më theri mes për mes”. (Vepra 4, f. 300)

E humb gjurmën: nuk e gjen dot se ku është; “...unë do t’i vë vashos ndonjë emër tjetër, që *t’ia humbas gjurmën*”. (Vepra 4, f. 282)

I zhduket gjurma si uji në ujë: s’ka asnjë shenjë prej dikujt; “...kur *i zhdukej ndokujt gjurma si uji në ujë*, ta dish se kish pasur gisht Olloman beu”. (Vepra 1, f. 209)

Hak - *E merr hakun*: ve të drejtën në vend; “Atyre të tjerëve që s’e mbajtën fjalën, *ua mora hakun*”. (Vepra 4, f. 299)

Hall - *Ashtu e ka hallin*: nuk është mirë; “Mos qesh me arinë e gjorë se *ashtu e ka hallin*”. (Vepra 4, f. 287)

Halë - *E ka halë në sy*: e ka inat, e ka zët: “Serbët - që *i kishin halë në sy* shqiptarët - e njohën menjëherë”. (Vepra 1, f. 240)

Harresë - *E përpin harresa*: harrohet; “Emrin e këtij *e ka përpirë harresa*”. (Vepra 4, f. 249)

Havaz - *I mban havazin*: i mban anën, e përkrah; “...gjarpërinjtë do t’u bien fyejve, zhabat e zhabikët do t’u bien pizgave e zurnave, bollat do t’u bien daulleve, gjithë të tjerët *do t’u mbajnë havazin*”. (Vepra 4, f. 444)

Helaq - *E bën helaq*: e bën pis; e tall, e shan; “...jepi radhën tënde këtij të ngopet me ujë, se *na bëri helaq*”. (Vepra 1, f. 287)

Hesap - *S'ka hesap*: s' del llogaria, s' fiton gjë; “Pse e mbante mullinë kur *s'kish hesap*”. (Vepra 1, f. 299)

Hi - *Bëhet hi e fani*: zhduket; ...e korbi s' duket më: *bëhet hi e fani*”. (Vepra 3, f. 459)

Hiç - *Një hiç bir hiçi*: një askush; “Vete në qeveri, e kallëzoj se bën turbullirë. *Një hiç bir hiçi*”. (Vepra 1, f. 288)

Hu - *I hurit e i litarit*: është vetë dreqi, sle gjë pa bërë; “Në të dyja ishin mbledhur të gjithë të hurit e të litarit, ata që donin të nxirrnin pare shumë me të ndenjtur”. (Vepra 1, f. 304)

Hundë - *Tërë hundë*: I inatosur; “...rrinin të heshtur, të ngrysur, *tërë hundë*”. (Vepra 1, f. 247)

Hundë e buzë: të mërzhitur, të zemëruar; “Ata të shtatë rrinin të heshtur, *hundë e buzë*”. (Vepra 1, f. 247)

Si nëpër hundë: me zë të paqartë, sikur i nxjerr fjalët nga hundët; “...flisnin shqip, po *si nëpër hundë*, duke i këputur fjalët”. (Vepra 1, f. 193)

Ia nxjerr nëpër hundë: e bën të paguajë për diçka që e ka marrë padrejtësisht, e dëmton; “Kollaj kur hytë në luftë e na shtuat pagesën? Tashi *do t'ua nxjerrim të gjitha nëpër hundë*”. (Vepra 1, f. 306)

I del për hundësh: paguan; “*Do të më dalin për hundësh* kërpudhat me gjithë shkarpa”. (Vepra 4, f. 283)

Ia thyen hundën: e turpëron, ia godet mëndjemadhësinë; “...do të priste me gëzim ndihmën vëllazërore nga Iliria, që *t'ia thyente hundën* Atenës së mburrur”. (Vepra 3, f. 141)

I vdekuri - *Nxjerr të vdekurin nga varri*: është shumë i zoti; “Uf, kjo çupë *nxjerr edhe të vdekurit nga varri*”. (Vepra 3, f. 460)

Jaran - *I ndërron jaranët si fustanët*; thuhet për një femër pa moral që bredh sa tek njëri tek tjetri; ajo ia kish bërë fora andej në pashallëkun e babait, *duke ndërruar jaranët si fustanët*”. (Vepra 1, f. 84)

Kalë - *Nuk i shkon kali në udhë*: nuk bëhet ajo që kërkohet nga dikush; “Kur sheh se *nuk i shkon kali në udhë*, ime re kthen e thotë: “Bëni sit ë doni, unë nuk zotohem t'i lidh, se i kam fëmijët kërthinj fare”. (Vepra 3, f. 416-417)

Kalem - 1) *S'e merr kalem*: s' shkruhet dot; “...bota shkulej së qeshuri me shakatë e tij, që *s'i merr dot kalem*”. (Vepra 2, f. 195) 2) *S'e merr kalem*: s' llogaritet; “Kish fshati im edhe ca si hane të dorës së dytë...e ca të tjerë, po këta *s'i merr kalem* se më fort na turpëronin fshanë se sa e nderonin”. (Vepra 1, f. 343)

Kallmër - *Është hazdisur si kallmri në kënetë*: është rritur shumë; “...kishin mbjellë së dyti misër, që *ish hazdisur si kallmri në kënetë*”. (Vepra 1, f. 233)

Të ha me një kalem: të merr pasurinë, lekët e të tjera me një veprim të bërë me laps; “...*ta hante me një kalem* javën e punës”. (Vepra 3, f. 485)

Kalldrëm - *e ka qesen me aspra, sa t'i bëjë kalldrëm*: ka aq shumë aspra sa mund të shtrojë me to rrugën si me kalldrëm; E ç'nuk na kish ky në këtë botë! *Qese me aspra sa t'i bëjë kalldrëm*". (Vepra 2, f. 216)

Kandar - *S'ngre kandar*: nuk ka peshë, është e parëndësishme; "...në shtëpinë e Gjonomadhëve u bënë dy Nurije, vjehrra e nusja, po kjo *s'ngre kandar*, sepse në Shëmërti s'e kanë zakon t'u thonë nuseve e nënave me emër". (Vepra 1, f. 201)

S'peshon shumë në kandar: nuk ka ndonjë vlerë, nuk është ndonjë gjë e madhe; "...agai kish qënë zaptije turku, po kjo *s'peshon shumë në kandar*; ashtu kish qënë koha, ashtu kish bërë". (Vepra 1, f. 281)

S'i merr kandari: janë të parëndësishëm, të pavlerë; "Unë s'ju pyes për trima sido-kudo, për kokëshkretë, nga ata që *s'i merr kandari* e kalemë, po për trima të vërtetë". (Vepra 1, f. 175)

Në kandar të zjarrit: në peshoren e luftës; "...dilte Olloman beu pazarit me dyzet a pesëdhjetë trima të zgjedhur *me kandar të zjarrit*". (Vepra 1, f. 209)

Rëndon kandari në anën tënde: ke të drejtë ti; "Kahreman bej, të them për emrin e zotit se *kandari rëndon nga ana jote*". (Vepra 1, f. 122)

Kapë - *E ka kapën mbi sy*: e ka në në terezi, i ka gjërat në vijë; "Domosdo, dhjetar nuk bëhet kushdo, po kush ka harka të madhe, taraf të fortë, *kapë mbi sy*". (Vepra 1, f. 236)

Kapistall - *I heq kapistallin*: nuk merret më, e lë të bëjë si të dojë; "*Ja kam hequr fare kapistallin*, e kam lënë sallma të dalë ku të dalë". (Vepra 3, f. 422)

Kartë - *Ta këndon kartën në xhep*: është shumë i mprehtë, merr vesh çfarë ke të fshehtë; "Bota që *ta këndon kartën në xhep*, thonë se mbreti i Turkut kur paske parë këtë burrë sa një lis, u paske mahnitur e paske dashur t'i thotë vëlla". (Vepra 1, f. 229)

Katër - *Punon sa për katër*: punon shumë, sa për katër veta bashkë; "Unë i vura gjoksin shtëpisë, *punova sa për katër*". (Vepra 3, f. 417)

Kaptell - *S'i çan kaptellin*: s'e mërzit; "...a s'do kish qënë më mirë të *mos më çaje kaptellin* e mua të më paguaje të drejtën e enëve". (Vepra 2, f. 195)

Kazmë - *I vë kazmën*: e shkatërro; "Jo, mbret, nuk *i vë unë kazmën* vendit, nuk përçaj unë fiset dhe njerëzit". (Vepra 3, f. 224)

Këngë - *Me këngë në gojë*: duke kënduar; "...ia nisën valles *me këngë në gojë*". (Vepra 4, f. 320)

Ia merr këngës: nis të këndo; "...Kuma Marua *ia merr këngës* për të nxehur gjakun". (Vepra 4, f. 359)

Keq - *Nuk ja merr për keq*: thuhet kur një veprim apo një fjalë e thënë në dëm të një personi nuk llogaritet si e tillë prej tij; "Fjalën *nuk jua marr për keq* se e di që e thoni me zemër të mirë". (Vepra 3, f. 87)

Kockë - *Është kockë e lëkurë*: është i dobësuar; “*U bëra kockë e lëkurë, s’çapesha dot*”. (Vepra 3, f. 301)

I hedh një kockë: i jep diçka të vogël sa për ta kompromentuar dikë, për ta bërë për vete; “*Ama unë i hodha një kockë, ia zura gojën të mos lehë*”. (Vepra 3, f. 505)

Gjer në kockë: thuhet për një veprim që të përfshin në çdo qelizë, thellë, të tërin; “...u qullëm *gjer në kockë*, po nuk u larguam nga kumbullat e Zykos”. (Vepra 1, f. 173)

Kokë - *Dy duar për një kokë*: secili bën gjithçka për të mbrojtur veten e vet “...sa vë re dhe ti, po *dy duar për një kokë* janë. A kemi vdekje”. (Vepra 2, f. 15)

Ia ruskos kokën: ia prët kokën; “...një mylazim me një kordhë në dorë, a nuk *ia ka ruskosur kokën* me një të hequr si e prët kosa barë”. (Vepra 2, f. 14)

I vjen vërdallë në kokë: mendim që nuk i ndahet; “Ja, këto gjëra *i vinin vërdallë në kokë* së bijës së Nures”. (Vepra 1, f. 196)

E ha kokën: vdes; “Po më e mira do t’ëish *të hanin kokën* të dy palët”. (Vepra 1, f. 240)

S’çan kokën: nuk e vret mendjen, nuk shqetësohet; “Asnjë *s’çante kokën* se lumi është lumë që rrjedh nga lart poshtë”. (Vepra 1, f. 349)

Me kokë në torbë: në rrezik jete; “I sillnim fshehur, *me kokë në torbë*, se të vrisnin hafijet e Abdul Hamitit”. (Vepra 3, f. 484)

Nuk e sjell kokën: nuk vjen; “...*nuk do ta sjellësh kokën* këtu, nuk do të hysh më në këtë portë”. (Vepra 3, f. 253)

Të ka bërë kokën: të ka sjellë në jetë; “Të mbrojmë dhenë. Vend, ky! *Të ka bërë kokën*”. (Vepra 3, f. 161)

E ka mik me kokë: e ka mik të vërtetë; “Unë *e kam mik me kokë* Mahir benë”. (Vepra 3, f. 468)

I merr koka erë: i prishet mendja, nuk i peshon gjërat mirë; “Sumbua s’ka qënë burrë i keq, po tani *i ka marrë koka erë*”. (Vepra 3, f. 287)

Lë kokën: është i përkushtuar, i dashuruar; “Ai ishte njeri që *linte kokën* pas gjësë së gjallë”. (Vepra 3, f. 287)

Ia ha kokën me të mirë: e bëj për vete me të mirë; “Duhet *t’ua ha kokën me të mirë*, pastaj bëj si di vetë”. (Vepra 4, f. 293)

E nxjerr kokën: duket, shfaqet; “Sapo largohej Skënderbeu, armiku *nxirrte kokën* përsëri”. (Vepra 4, f. 237)

Ia di kokën: e njeh; “...e shikoi me bisht të syrit, po nuk iu përgjigj; s’ia mbajti...*ia dinte kokën*”. (Vepra 1, f. 268)

I merr kokë për kokë: i numuron një për një; “Po t’i merrje kokë për kokë binin nëntë me një”. (Vepra 1, f. 179)

Kokë më kokë: , grumbull, bashkë, ngjitur me njëri tjetrin; “Më *qënki mbledhur kokë më kokë* e ruaki vendin”. (Vepra 1, f. 163)

Kokosh

Kosë - *I vë kosën*: i zhduk, i fshin; "...ariu ish gati t'u vinte kosën gjithë kafshëve e shpësëve të pyllit". (Vepra 4, f. 312)

Krah - *I merr krahun*: e mbështet, e ndihmon, i mban anën; "...i dilte për zot çdo të mjeri, i merrte krahun, luftonte". (Vepra 4, f. 152)

Nën krah: në mbrojtje; "...sulltani i mori nën krahun e tij feudalët". (Vepra 4, f. 202)

Përvesh krahët: bëhet gati për punë; "...përvesh krahët: shkund, fshun, spastron, e bën shtëpinë dritë". (Vepra 4, f. 454)

Iu prenë krahët: s'ka fuqi; "...Duam e s'mundim. Na u prenë krahët, bijë". (Vepra 3, f. 416)

Hidhet në krahët e vdekjes: vdes, shkon në një situatë të rrezikshme, ku vdekja është e pashmangshme; E sa më shumë zgjaste lufta...burrat hidheshin në krahët e vdekjes".

Krerë - *Luan krerësh*: çmendet; "*Kjo ka lojtur krerësh*: është bërë për Shëndaum." (Vepra 3, f. 510)

Krimb - *I ha krimbi zemrën*: bëhet i keq; "Kjo ishte mjaft që ta bënte t'i hajë krimbi zemrën". (Vepra 2, f. 218)

E bren krimbi i dyshimit: dyshon; "...zuri ta brejë krimbi i dyshimit për të shoqen". (Vepra 3, f. 42)

Kripë - *Kanë ngrënë bashkë një barrë kripë*: kanë kaluar një kohë të gjatë bashkë, e njohin njëri tjetrin; "ndie zot t'ët atë e kam pasur mik të ngushtë... kemi ngrënë bashkë një barrë kripë". (Vepra 4, f. 344)

Krua - *Të shpie në shtatë kronj e s'të jep ujë të pish*: të gënjen, të sjell vërdallë, bën sikur do të të japë diçka, të cilën nuk ta jep; "Ky është tamam frëng, ja për këtë ujë. Frëng nga ata të frëngjisë. *Të shpie në shtatë kronj e s'të jep ujë të pish*". (Vepra 1, f. 277)

Krye - *Nuk ia del në krye*: nuk e përfundon, nuk e mbyll një punë, një çështje; "Gjahtari nis e numëronme gojë, me duar, po nuk ia del në krye". (Vepra 4, f. 287)

Lë kryet - vdes; "...ja e sjell këndeje nusen e Arnaut Osmanit...ja lë kryet në bjeshkë të Jutbinës". (Vepra 4, f. 162)

Mos ngri krye: mos u rebelo, mos kundërshto; "...shko puno siç ke punuar, mos ngri krye". (Vepra 1, f. 303)

E ka në krye e sipër: e çmon shumë, e nderon, respekton; "...e kam pasur si baba, në krye e sipër". (Vepra 1, f. 217)

kuç

Kujë - *Me kujë e bujë*: Me zhurmë; "Ata shkuan me kujë e bujë, po mbetën gurishtave e rrëpirave". (Vepra 4, f. 388)

Kurriz - *Ia bën kurrizin më të butë se barkun*: e rran, i jep dru; "...ia bënte çunit të Qipros më të butë kurrizin se barkun". (Vepra 2, f. 201)

Rron mbi kurriz të të tjerëve: rron duke shfrytëzuar punën e të tjerëve; "...ne do t'u vemë fshesën gjithë atyre që rrojnë mbi kurriz të të tjerëve". (Vepra 3, f. 408)

I ktheu kurrizin: e braktisi, e tradhëtoi; “Atëhere disa nga trimat e beut *i kthyen kurrizin* Olloman beut, lu afruan Malush agait”. (Vepra 1, f. 217)

Kuvend - E prish kuvendin: e prish bisedën, e ndërpret, thotë fjalë që s’duhen thënë; “...babait s’i pëlqeu se Rrapua *ia kish prishur kuvendin* e ia kish prerë fjalën me sopatë”. (Vepra 2, f. 137)

Ndizet kuvendi: Bëhen të të forta, të zjarrta diskutimet, debatet; “*Kuvendi po ndizej mirë e mirë*”. (Vepra 1, f. 280)

Këmbë – *Ja vë këmbët në një këpucë*: ja mbledh, e nënështron, e bën të mos kundërshtojë dot. “Bashkë vrisnin, bashkë grabisnin, bashkë i danin të gjitha: edhe keçat, edhe drithin, edhe haraçet. *Ja vunë këmbët në një këpucë gjithë kazasë*”. (Vepra 3, f. 461)

Vë këmbën: shkel. “Kush të dha lejën *të vesh këmbën* nëpër rrozgat e mia”. (Vepra 3, f. 449)

S’i lagen këmbët: nuk e gjen gjë, nuk vuan. “Kurt ë të dërojnë djemtë paret, lan borxhin e rri më lart se shokët. *S’të lagen këmbët*”. (Vepra 3, f. 4260)

Si këmbët e dhisë: njëlloj, të njëjtë, të ngjashëm. “Një qënkemi ti e unë, ë? *Si këmbët e dhisë*”. (Vepra 4, f. 292)

Ua dha këmbëve: vrapoi, iku me vrap. “Pastaj Kuma Marua lëshoi një britmë, sa u tund tërë lajthishta, e *ua dha këmbëve*”. (Vepra 4, f. 291)

Mezi heq këmbët: ec ngadalë. “Çupa kapitet, *mezi heq këmbët*, mezi mban shpirtin”. (Vepra 4, f. 449)

I puth këmbë e dorë: i lutet, i përulet, i përgjërohet. “Gjer dje ai z batharak *më puthte këmbë e dorë* që t’i jap një shoshë gëzhuta nga ato të pulave, e tani mbajtkja me bukë lypsarët e botës”. (Vepra 4, f. 411)

Mban këmbët: ndalon. “Ariu e cjapi, domosdo, *mbajnë këmbët* buzë lumit”. (Vepra 4, f. 364)

I rrëshqet këmba: gabon. “Mjaft sa *t’i rrëshqasë* një herë *këmba* njeriut, pastaj s’mbahet dot”. (Vepra 1, f. 306)

Ia ther këmbëve: ikën me vrap; “Ai fshihej ndënë rusë, po ne të tjerët s’kishim tjetër veç se *t’ia thernim këmbëve*”. (Vepra 2, f. 178)

Ua mbath këmbëve: vrapon; “...kapërceva shtegun dhe *ua mbatha këmbëve*”. (Vepra 2, f. 190)

Ia mori këmbën: u mësua, vazhdon të bësh të njëjtën gjë që kanë bërë të tjerët më parë; “Po shkuan që asohere vjete shumë edhe tani të tjerë *ia muarr këmbën*”. (Vepra 2, f. 288)

Mos mbiftë këmbë: mos shkeltë kurrë; “*Mos mbiftë këmbë* dhjetari, jarebi”. (Vepra 1, f. 252)

Kërceu më këmbë si cingël: U ngrit përnjëherë më këmbë; “Papritur Artana *kërceu më këmbë si cingël*, iu vërvit Artanës”. (Vepra 3, f. 76)

E prët me këmbët e para: e prët keq; “Nuk shkoj grua, se *më prët me këmbët e para*”. (Vepra 4, f. 402)

E lidh këmbë e duar: e lidh të gjithin: "...beu e kish lidhur këmbë e duar". (Vepra 1, f. 299)

I zë këmba dhe: gjen një vend ku të qëndrojë; "Kur më zuri këmba dhe (more gur, jo dhe) e gjeçë veten në një kube me qemer". (Vepra 2, f. 27)

S'i shtyhen këmbët: nuk i shkohet diku; "Shkoj, po s'më shtyjnë këmbët". (Vepra 4, f. 400)

I jep këmbëve: ik; "Jepu këmbëve e mbushu". (Vepra 4, f. 401)

Ku nuk shkel këmba e njeriut: një vend i vështirë, ku s'mundet të mbërrijë njeri; "...ca xhufka bari të thatë...kishin dalë brinjëve aty-këtu, ku nuk shkelte këmba e njeriut". (Vepra 1, f. 234)

S'bën këmbë: s'lëviz; "...s'bënim më këmbë përtej mezhdës". (Vepra 1, f. 166)

Rron më këmbë, jo më gjunjë: jeton me kokën lart, me dinjitet, jo duke duke u zvarrisur; "Meshkujt e Gjonmadhëve kanë rrojtur, që të gjithë më këmbë, jo më gjunjë, me shpatë në dorë". (Vepra 1, f. 176)

Ku kale këmbët të rënçin dhëmbët: në shtëpinë ku u fute, ku u martove ta kalosh jetën derisa të plakesh; "...u trashëgoftë, u plaktë, "ku kalli këmbët i rënçin dhëmbët". (Vepra 1, f. 244)

I ve këmbët vatrës: ulet pranë vatrës për të ngrohur këmbët; "...nxori opingat e ngrita, çliroi liqet e tirqve, u mbështet e i vuri këmbët vatrës". (Vepra 1, f. 206)

Këngë - *Me këngë në gojë*: duke kënduar; "Daësmorët nisen e shkojnë me këngë në gojë". (Vepra 4, f. 153)

Kërçel - *Rrëkëllen kërçelë*: flet fjalë të vrazhda; "...kur s'i vjen për mbarë, të rrëkëllen ca kërçelë si ata që shkul e sjell përroi në vjeshtë". (Vepra 3, f. 416)

Kërthizë - *Në kërthizë të Gjurgjokut*: në mes të Gjurgjokut; "Ka dymbëdhjetë palë shtëpi të mëdha mu në kërthizë të Gjurgjokut". (Vepra 3, f. 358)

Laj - *Të larë e të shpëlarë*: të pastër; "...zbriti në fshat, i lehtësuar, me zemrën të larë e të shpëlarë" si ato guriçkat e anës së liqenit pas dallgës, në mëngjes". (Vepra 1, f. 330)

Laraskë - *E ku ka mbetur laraskë pa bisht*: nuk ka mbetur njeri pa e gjetur shokun e jetës, s'ka mbetur njeri pa martuar; "Ai bëri si gjithë bota: mori një vasho, u martua (e ku ka mbetur laraskë pa bisht, që të mbetet trim pa nuse". (Vepra 4, f. 368)

Lart - *Lart e më lart*: në shkallë të larta të pushtetit; "...të mos ish prishur turku, Zylua do ish ngjitur lart e më lart". (Vepra 1, f. 281)

Leckë - *E ha me gjithë lecka*: jam err të gjitha; "Na hëngër me gjithë lecka, i shoftë zoti". (Vepra 1, f. 252)

Lek - *Ka hyrë leku në bri të buallit*: është bërë shumë e vështirë të fitosh lek; "Po të paktë janë ata që u ka dora për të blerë samarë të rinj se, siç tha vetë aty më parë ka hyrë leku në bri të buallit". (Vepra 1, f. 264)

Lepur - *E zë lepurin me qerre*: nuk ngutet, e merr punën ngadalë; “Shiko si qënka Vendani ynë...*e zë lepurin me qerre*”. (Vepra 3, f. 328)

Lesh - *Lesh e li*: lësh, e ngatërruar; “...i kish hyrë në shpirt krimbi i dyshimit dhe i kish bërë të gjitha *lesh e li*”. (Vepra 3, f. 262)

Llogo - *Mban llogo*: flet; “...Bardhua e kish shikuar i çuditur avokatin që *mbante llogo* duke bërë gjeste të mëdha”. (Vepra 3, f. 400)

Lopatë - *I zë lopata ujë*: ka pushtet, ka influencë për të zgjidhur një punë; “Ama edhe ne këte mos na harro kur të të *zerë lopata ujë*, se helbete”. (Vepra 1, f. 249)

Lopkë - *I shkull ndonjë lopkë*: i rrëmben pakgjë; “... futte duart nëpër torbat e pazarakëve për të *shkullur ndonjë lopkë*”. (Vepra 1, f. 234)

Lot - *I venë lotët çurk*: qan me lot shumë; “Çupës i *venë lotët çurk*”. (Vepra 4, f. 444)

Lugat - *Lugat e shkuar lugatit*: i keq, i shëmtuar; “Bie poshtë një shuk i madh, si targaç cergëtari, i nxirë, i përzhitur. *Lugat shkuar lugati*”. (Vepra 4, f. 419)

Lugë - *Me lugë në brez*: gati për të ngrënë, për të përfutur; “Ne s’e bënim fjalën dy, se *lugën e kishim në brez* edhe haj”. (Vepra 2, f. 179)

Për një lugë çorbe: Për pak gjë, për një qyl të vogël; “*Për një lugë çorbe* turku tradhëtove fisin tënd”. (Vepra 4, f. 229)

Ha me lugë floriri: jeton shumë mirë, ha si i pasur; “*Do të hamë me lugë floriri*...Tashi që thua ti vendi ra në zot”. (Vepra 3, f. 415)

Lule - *Në lulen e moshës*: në rini; “si mund të të *zërë gjumi në një natë të tillë*, kur je *në lulen e moshës*”. (Vepra 3, f. 126)

Lumë - *E hedh lumin*: e kalon një vështirësi, një sëmundje, një rrezik; “Thashë se *e hodha lumin*, po isha këputur sikur të më paskëshin rrahur me *dyzet kopaçe*”. (Vepra 4, f. 375)

E mori lumi: e pësoi, humbi; “Që kur na vure në kurriz ato tri mangjoshkat edhe shtrigoren, *na mori lumi* fare”. (Vepra 4, f. 473)

Lë - *Lëre mos e nga*: nuk thuhet dot, nuk tregohet dot; “...hiqeshin këto bukuri valle për Pasen e Qipros e maçokun e Shamshallos, që *lëre mos e nga*”. (Vepra 2, f. 169)

Lëkurë - *Ia bën lëkurën shoshë*: e qëllon shumë herë me plumb a thikë; “Dua vetë të më dalë përpara ndonjë ulk o ulkonjë, që *t’ia bëj lëkurën shoshë*”. (Vepra 1, f. 204)

Ia bën lëkurën dy pare: e shan, e tall: “...i kishin vajtur bashkë në derë Tili Samarxhiut, *ia kishin bërë lëkurën dy pare*”. (Vepra 1, f. 283)

S’e nxë lëkura: është i revoltuar; “*S’e nxinte as lëkura*, as konaku, as tërë vendi. I ziente zemërimi në zemër”. (Vepra 1, f. 214)

Shpëton lëkurën: mbetet gjallë, mbron jetën e vet; “...kur pa se s’kish udhë tjetër, vendosi të *shpëtojë lëkurën*”. (Vepra 3, f. 152)

Lëmsh - *I mblidhet vreri lëmsh në zemër*: mërzhitet, dëshpërohet; “Ama një lëngë me të qarë e për të qarë, se i qe mbledhur vreri lëmsh në zemër”. (Vepra 1, f. 329)

Lëndinë - *E nxjerr në lëndinë*: e lë pa asnjë mjet jetese, pa shtëpi, pa katandi; “Pastaj mall e gjë s’kam, se ma mori beu i madh e më nxorri në lëndinë”. (Vepra 2, f. 181)

Lëng - *lëng stërlëngu*: mbeturina; “-Pse ore, nuk e mbushin, - A? Nuk i pe mishrat. Apo... -E mbushin me lëng stërlëngu. Këto mishra, që i ka gjysmuar e përgjysmuar sipërmarrësi me shokë, do t’indajnë këmbë-këmbë oficerët, bekrinjët, sarhoshët”. (Vepra 1, f. 283)

Lis - *Sa një lis*; i madh, i gjatë; “...mbreti i Turkut kur paske parë këtë burrë *sa një lis*, u paske mahnitur”. (Vepra 1, f. 229)

Llokume -*Si llokume me arra*: shumë e mirë, e dashur, e ëmbël; “Ti nuk e di si ëhtë Margulla. *Llokume me arra*. Kur e shtrëngoja në krahë, i bënte trupi këërc, këërc”. (Vepra 1, f. 147)

Majë – 1) *majë më majë*: në nivel të lartë; “...e mbajtën xhegun *majë më majë*, gjer në të gdhirë”. (Vepra 2, f. 230) 2) *majë më majë*: plot e përplot; “...do t’i mbushë mendjen çunit të Qipros *majë më majë*”. (Vepra 2, f. 201)

Mal - *Merr malet*: ikën larg; “...atij ia kish frikën edhe ariu i madh dhe *merrte malet* kur ia dëgjonte emrin”. (Vepra 4, f. 340)

Shtatë male larg: *shtatë male larg* binte erë barut; shumë larg; “Shtatë male larg binte erë barut”. (Vepra 1, f. 213)

Mall - *Ka mall e gjë*: ka pasuri; “...në *kish mall e gjë* në fshat, ç’kërkonte vallë matanë kaq male e dete me ujë”. (Vepra 1, f. 108)

Mbaj - S’di nga t’ia mbajë: s’di si të veprojë, s’gjen dot zgjidhje; “Iriqi s’kish nga t’ia mbante se e kishin zënë ngushtë”. (Vepra 4, f. 320)

Mbjell - *S’mbjell e s’korr*: nuk punon; “...Halit kasapi, që *s’mbjell e s’korr*, po vetëm pi, pra s’ua ka frikën, u thotë “tetarë”. (Vepra 1, f. 235)

Mbrej - *E ka mbrehur*: është përballur; “Një herë *e kish mbrehur*, po kish dalë si pulë e lagur”. (Vepra 1, f. 333)

Menç - *Afër menç*: patjetër; “Derë më e re, afër menç, po më e shtuar se ajo e Gjonomadheve”. (Vepra 1, f. 179)

Mend - *S’do mend*: është e qartë, është e kuptueshme. “Se *s’do mend* ajo, kur ke kazan, do kesh një copë vreshtë”. (Vepra 2, f. 269)

I shkon nëpër mend: i lind një mendim, i kujtohet. “Ç’*të shkon nëpër mend*”. (Vepra 2, f. 275)

Në ke mend e kokë: në je i mënçur. “*Në ke mend e kokë* largohu, se do t’i nxjerr zorrët nëpër ferrat”. (Vepra 4, f. 299)

Ve mend: ndërgjegjësohet; “...e vunë në pranga, e futën në kripore. Që *të venë mend* të tjerët”. (Vepra 1, f. 498)

Mendim - *Rri i kredhur në mendime*: mendohet; “Tërë pylli *rri i kredhur në mendime*”. (Vepra 4, f. 327)

Mendje - *E humb mendjen*: nuk arësyetohet dot. "...e humbet mendjen e s' di ç' thotë, ia merr përçar". (Vepra 4, f. 344)

Vret mendjen: mendohet, arësyetohet për të zgjidhur një problem. "...zuri të kujtojë vitet që kishin shkuar e të vrasë mendjen për vitet që do të vinin pasandaj". (Vepra 4, f. 238)

Bluan në mendje: mendohet rreth një pune, një problemi. "Këto të gjitha i bluante në mendje Skënderbeu, kryezoti i Arbrit". (Vepra 4, f. 238)

Ia merr mendjen: e bën për vete. "*Ma mori mendjen* fare, ma prishi gjumin". (Vepra 2, f. 142)

Kthen mendje: ndryshon mendim. "...u mat t'ia merrte udhës së shkurtër përbri shtëpisë së Lakes...po pastaj e ktheu mendjen e bëri përpara, drejt Çukës së Vogël". (Vepra 1, f. 312)

I thotë mendja: mendon se. "Apo të thotë mendja se ne e harruam gjakun e Gurit të Pjetërkalit". (Vepra 1, f. 198)

Ta prët mendja: sigurisht, patjetër. "*Ta prët mendja*: asnjë nuk vinte me duar bosh". (Vepra 1, f. 78)

Rref mendjen: mendohet. "Dua tri ditë ta rraf mendjen si e qysh" (Vepra 1, f. 227)

E mban mendjen në vend: është përgjegjshëm. "Ndezi një cigare, esëll, që t'ia priste vrundullin e rrotullimit e të mbante mendjen në vend". (Vepra 1, f. 67)

S'ia prët mendja: nuk e parashikon dot, nuk e imagjinon dot. "...jo një herë e dy e zinte mëngjesi ku s'ta prët mendja". (Vepra 1, f. 67)

Mbledh mendjen: qartësohet, bëhet i përgjegjshëm. "Më dërgoi fjalë një mik që të mbledh mendjen se ndryshe s'më bëhet mirë" (Vepra 1, f. 118)

I vërtitet mendja: është i shqetësuar, mendon lloj-lloj gjërash. "Në s'të ka shpirti qetësi a vjen e të vërtitet mendja e shkretë si gur mulliri, pi raki se qetësia vjen vetë" (Vepra 2, f. 271)

I shket mendja: çmendet. "Jo se më shket mendja të ngrihem e të them se fshatrat e tjera nuk e pinë rakinë, po si ky fshati im, s'ka fshat në botë". (Vepra 2, f. 266)

I shkrep një mendje: i lind një mendim. "Aty për aty i shkrep një mendje tjetër". (Vepra 1, f. 79)

Ki mendjen: kujdes, jë i vëmendshëm. "*Ki mendjen* këtu". (Vepra 1, f. 269)

E ka mendjen top: është shumë, shumë mirë mendërisht. "Tutje nëntëdhjetave po mendjen e ka top". (Vepra 1, f. 272)

S'e ka mendjen: s'është i vëmendshëm për atë që flitet, mendon për ndonjë gjë tjetër. "Ago Zylali bëri sikur s'e kish mendjen aty". (Vepra 1, f. 276)

Ia bën mendjen dhallë: e huton, e shpërqëndron. "- Ku e lashë? - pyeti. - Se ma bëri mendjen dhallë ai miku i Buzoz". (Vepra 1, f. 293)

I vjen mendja: kthjelllet, kupton. "...Lumi i madh priti sa priti që t'i vinte mendja fshatit, pastaj, një ditë, kur u nxi qielli andej mbi Krushë, u lëshua me bujë të madhe". (Vepra 1, f. 355)

Me mendje plot: i mençur, i ditur. "Dhjetarët janë burra me mendje plot". (Vepra 1, f. 255)

S'i shkon mendja: s'e ka idenë. "...s'u shkonte fare mendja se ky ujë është përzierë me lotët e një robinje". (Vepra 4, f. 310)

Ja sjell mendjen: e kthjell, e ndërgegjëson. "... u vërvit t'ua sjellë mendjen mishngrënësve, po këta ia kishin mbathur". (Vepra 4, f. 322)

Sjell në mendje: kujton. "Dhe nisi të sjellë në mendje jetën e ëmbël kur kish qënë shkruet i vogël i një satrapi të madh dhe pronar skllëvërish". (Vepra 3, f. 272)

Ingulet në mendje: i fiksohet, i ngulitet në kujtesë një fjalë, një ndodhi. "Atij i qenë ngulur në mendje si ca heshta fjalët fluturake: "Vdekja duhet vrarë". (Vepra 3, f. 311)

I punon mendja: është i zgjuar, i zgjidh gjërat shpejt. "...mendja e saj punonte vetëtimthi: aty për aty e gjeti udhën". (Vepra 4, f. 303)

E gjen mendjen: e zgjidh problemin, vendos për diçka. "Gjeje mendjen vetë grua! Mos e bëj të të marrin për veshi". (Vepra 4, f. 292)

E ka mendjen të fjetër: është i qetë, është i qartë, i sigurt. "...Mehmeti e kish mendjen të fjetur: do ta shtronte Arbërinë". (Vepra 4, f. 225)

I qerthullohet mendja: turbullohet, hutohet. "Dhe shtati i tij mban një erë të këndshme ftoi sa më qerthullohet mendja". (Vepra 4, f. 142)

I çalon mendja: nuk është krejt në rregull mendërisht, ka arsyetim të dobët. "I çalë s'ish po ata thoshin se çalon nga mendja". (Vepra 4, f. 380)

I del nga mendja: harron të kryejë një punë, zbatojë një porosi, një rregull: "Më doli fare nga mendja se ligji është themeli i të gjithave". (Vepra 3, f. 271)

I mbushet mendja: bindet. "Shko mbushja mendjen plakut". (Vepra 3, f. 324)

Thotë me mendje: Flet pa zë, flet me vete: "Po, tha me mendje, mbreti më thirrka sepse I qënkan ankuar këta burra". (Vepra 3, f. 219)

S'ia ha mendja: nuk i besohet. E sheh dhe vetë se s'hyjmënë punë. - Ehe... S'ma ha mendja". (Vepra 3, f. 286)

Iu tipos në mendje: iu fiksua. "Anyta preku një për një shkronjat e gdhendura në gur, sikur të donte t'i thëthinte, t'i tiposte në mendje". (Vepra 4, f. 104)

I pjell mendja: fantazon. "Si ia pjell mendja gjithë këto fjalë". (Vepra 3, f. 448)

E ka mendjen firifiu: është mendjelehtë. "U bëre për të martuar e mendjen ma ke firifiu". (Vepra 3, f. 444)

Mendjen e ka një okë: di shumë, është shumë i mençur. "Mendjen e kish një okë, fjalën të matur të shtruar". (Vepra 3, f. 368)

Ku e ke mendjen: për çfar mendon, pse s’ dëgjon çfar flitet këtu. “Ti *ku e ke mendjen*” (Vepra 3, f. 34)

S’e shkul dot nga mendja: nuk e heq, nuk e harron, nuk e largon dot nga mendja. “Ai *nuk e shkulte dot nga mendja* fjalën “haraç”. (Vepra 3, f. 330)

Mi - **Të bjerë miu thyen kokën:** është bosh, s’ka asgjë; “Hazna e Stambollit ka mbetur bosh, *të bjerë miu thyen kokën*”. (Vepra 3, f. 348)

Miell - **Mielli që bluan mulliri i tij:** punët që bën ai; “...turpërime, rrëmbime, vrasje, prerje, shkatërrime. Ky ishte *mielli që bluan mulliri i tij*”. (Vepra 1, f. 214)

Mik - **Mik pas miku:** me mik; “...bënim si bënim ia gjenim radhën *mik pas miku*”. (Vepra 4, f. 373)

Mijë - **Ka punuar një mijë të këqija:** ka bërë keq; “Atë vraje, there, rripja lëkurën, se *ka punuar një mijë të këqija*”. (Vepra 4, f. 346)

Mish - **I dridhen mishrat:** vuan, i vjen keq; “*Të dridhen mishrat* kur i sheh ata burra si lisa që hidhen e vijnë rrotull shpatëzhveshur, i përpjekin shpatat njëri mr tjetrin si në luftë të vërtetë”. (Vepra 4, f. 226)

Mishit të piqet, helli mos digjet: të kryhet një punë pa prishur një tjetër; “...kemi një fjalë që thotë: *Mishit të piqet, helli mos digjet*. Po ajo që u bë u bë”. (Vepra 3, f. 48)

Mizë - **Dëgjohet miza një të shtënë dyfeku larg:** është shumë qetësi; “Më të djathtë e më të mëngjër sikus s’kish njeri të gjallë... *Dëgjohej miza një të shtënë dyfeku larg*”. (Vepra 1, f. 209)

Si miza: shumë, me shumicë; “Si mblodhi njerëz *si miza* i çoi prapë fjalë Konstandinit”. (Vepra 1, f. 228)

Mjegull - **Si nëpër mjegull:** në mënyrë jo të qartë. “Etleva e mori vesh *si nëpër mjegull* se varri i dashur ishte ai i Mendës dhe i urryeri ishte i Megaklesë”. (Vepra 3, f. 56)

Mollë - **E shpie si molla:** e shpie shëndoshë e mirë; “...vëllai i Xinxifillos e *shpuri* morë në shtëpi *si molla*”. (Vepra 4, f. 367)

Mur - **Muri ka veshë:** dëgjohet çdo gjë që thuhet; “- Zotrote do më shpiesh në Tiranë? – Unë jo, se jam burrë plak, po mos harro se *muri ka veshë*”. (Vepra 3, f. 510)

Mushkë - **Kështu i do mushka drutë:** kështu duhet, kështu e lyp puna; “Vurratat janë arne që vijnë e shkojnë, shkojnë e vijnë, se *kështu i do mushka drutë*”. (Vepra 3, f. 420)

Mustaqe - **Qesh nën mustaqe:** nënqesh, qesh me ironi; “jo bir, unë s’e kam nga pleqëria... Ashtu thotë ai, po bota *qesh nën mustaqe*, se baba Rushiti është tej qindit”. (Vepra 1, f. 245)

Nam - **Nuk i ndihet nami e nishani:** Nuk i gjendet asnjë gjurmë; “...kishin humbur si nëpër ujë, *nuk u qe ndier nami e nishani*”. (Vepra 1, f. 64)

Narden - *U bë narden*: u mërzi, u inatos; “Si dëgjoji këto fjalë mbreti *u bo narden* e s’hongri e s’piu asaj dite”. (Vepra 1, f. 229)

Natë - *E zuri nata*: u bë natë kur ishte duke udhëtuar; “*Më zuri nata* udhës”. (Vepra 4, f. 142)

Ndoresh - *I vjen ndoresh*: është i aftë, ka talent të bëjë diçka; “Përveç fjalës *i vij ndoresh* për sende shumë: shëronte bagëtinë e njerinë me të kënduara, bënte linjë e prokavë në vegël, thurte tërkuzë”. (Vepra 1, f. 224)

Nge - *ia ke ngenë*: ke kohë të tepërt; “Po kush *ka nge* t’i vërë re këto të gjitha”. (Vepra 1, f. 327)

Ngushtë - *E zë ngushtë*: e vendos në një situatë të vështirë; “...*e kishin zënë ngushtë*: duhej të hidhte valle përpara vëllait të madh dhe drekëtarëve”. (Vepra 4, f. 320)

Njëfarë - *Njëfarë gjeje*: diçka as e mirë, as e keqe, as e bukur, as e shëmtuar e të tjera të kësaj natyre; “si dolët sivjet me të lashtat? - *Njëfarë gjeje*”. (Vepra 1, f. 251)

Njëherë - *Njëherë e një kohë*: dikur; “Sa e sa burra ishin vrarë *njëherë e një kohë*”. (Vepra 1, f. 194)

Njëherë e njëmot: dikur, kohë më parë; “...trëndelinë e luleshtrydhe bëheshin *njëherë e njëmot* në atë rrahun e Skurrës”. (Vepra 1, f. 207)

Njeri - *S’pipëtin njeri*: heshtin të gjithë prej frikës; “Ditën këta luftonin me sprijën e madhe që kish pushtuar ujërat e botës e s’linte të *pipëtin*te njeri e kafshë”. (Vepra 4, f. 454)

Njeri pa njeri: vetëm, pa asnjë njeri të vetin; “Na ish njëherë një djalë jetim, filli i vetëm në botë: pa nënë, pa babë, pa motër, pa vëlla, shkurt: *njeri pa njeri*”. (Vepra 4, f. 502)

Orë - *Një orë e më parë*: sa më shpejt; “Këtë punë ta mbarosh *një orë e më parë*”. (Vepra 4, f. 166)

Orent - *S’kanë orient*: s’dinë si të veprojnë; “...xhandarët *s’kanë orient* se ku të shkojnë më parë tek rrihen, plagosen e vriten njerëz”. (Vepra 1, f. 247)

Pallë - *Bën pallë*: bën qejf; “Nuk do t’i çaj vetë qetë e buajt, po do të m’i sjellin ushtarët: të therur, të rrjepur, të pjekur. Atëhere *do të bëj pallë*”. (Vepra 4, f. 279)

I prët palla: i shkon fjala; “Ai ishte vetë ali, vetë kadi, *i priste palla* më të katër anët”. (Vepra 1, f. 209)

Pare - *Pare xhepi*: quhen ato pak pare që mbahen për shpenzime ditore; “...së bashku me thekërishten kish humbur edhe tre lekë *pare xhepi*”. (Vepra 1, f. 284)

S’bën dy pare: nuk vlen; “Mishi im *s’bën dy para*”. (Vepra 4, f. 346)

Pendë - *Pendë i lehtë*: si pa peshë, i shkathët; Edhe Xhezari u ngrit *pendë i lehtë*, i gjatë, i fortë, ashtu siç kish qënë kur kish ardhur nga Devolli”. (Vepra 1, f. 149)

Prapa - *Të ha nga prapa*: Të ha në pabesi, fshehurazi; "...Xheladin bej "babaxhani" ishte si ata qentë e liq që *të hanë nga prapa*". (Vepra 1, f. 68)

S'i bie prapa: e le++, nuk e nget; "...hëpërhë *s'po të biem prapa*, pot ë lëmë të gjallë". (Vepra 3, f. 77)

Peri - *Që në pe e në gjilpërë*: me të gjitha hollësitë; "Më rrëfeu si pati ngjarë *që në pe e në gjilpërë*". (Vepra 1, f. 119)

Peshk - Mbetet si peshku më të thatë: mbetet pa mundësi për të jetuar; "Më mbyti ky viran. Kur më zë mbetem si peshku më të thatë". (Vepra 1, f. 301)

Peshqesh - *Ja jep peshqesh*: ja dhuron. "...Ky i bën fjalë *t'ia japë peshqesh*". (Vepra 4, f. 113)

Pi - *E piu të gjallë*: na zhveshi fare materialisht; "*Na piu të gjallë* spahiu, dhjetari, si i thonë tashi viranit". (Vepra 1, f. 251)

Pikë - *Në pikë të mëngjesit*: herët, pa zbardhur mirë dita; "Një ditë Gjeto Basho Muji u ngrit që *në pikë të mëngjesit*, lau sytë, u vesh e u mbath mirë". (Vepra 4, f. 105)

Pisk - *Pisk e lakuriq*: i zhveshur, pa asnjë rrobe në trup; "...e zhveshin dhe lënë të shkojë *pisk e lakuriq* në atë botë". (Vepra 3, f. 458)

Plesht - Më marrtë pleshtat: më marrtë të këqijat; "Uf, na marrtë pleshtat e beharit! Po ne ç'jemi". (Vepra 3, f. 419)

Plëng - *Ja lë plëng në dorë*: ja lë mallin në dorë pa e pyetur; "...*na e la plëng në dorë* këtë rrësk të keq". (Vepra 3, f. 415)

Poshtë - *S'bie poshtë*: qëndron lart; "...nga trimëria asnjëri *s'bie poshtë*". (Vepra 4, f. 169)

Pulë - *Si pulë e rrjepur*: i mundur keq; "Një herë e kish mbrehur, po kish dalë *si pulë e rrjepur*". (Vepra 1, f. 333)

Punë - *E ka punën me kokë*: ka punë me rrezik jete; "Ata e kanë *punën me kokë*; kjo s'është e mirë. Më mirë më pak se sa...". (Vepra 3, f. 373)

I hyn në punë: i shërben, i intereson; "Po ty ç'të *hyn në punë* të dish sa është sahati". (Vepra 1, f. 248)

Purtekë - *Dridhet si purtekë*: ka shumë frikë; "...*dridheshin si purteka* ata që guxonin të ngrinin sytë e ta shikonin". (Vepra 1, f. 209)

Nuk e ka punën me kokë: nuk ka punë me rrezik jete; "Pse, baba, ne *nuk e kemi punën me kokë*? Tërë ditën majë shkallëve, majë skelave". (Vepra 3, f. 373)

S'e prët puna: s'ka kohë; "Thuamë shpejt, se *s'më prët puna*". (Vepra 3, f. 455)

E prishi punën: prish, keqëson marrëdhëniet me dikë; "Po ta zhveshim këtë *do ta prishim punën* me Grabonin". (Vepra 3, f. 282)

Punë e madhe: e çfar pastaj. Kjo thuhet me ironi për të nënveftësuar një veprim; "*Punë e madhe*... A mos ata i bënë malet e fushat". (Vepra 3, f. 505)

E ka trashë punën: 1) ka para një tryezë të bollshme ushqimesh; “Sot e paskan trashë punën: Mish me pilaf. Ohoho...”. (Vepra 1, f. 283) 2) e ka punën keq; “Mjaft mre, kaur i keq, e mundon këtë fëmijë, se vallahi! *E kemi trashë punën*”. (Vepra2, f. 22)

Ia donte puna: kishte nevojë; “...kish lënë nja njëzet e ca pashë vend, që të hapej, kur *t’ia donte puna*”. (vepra 1, f. 359)

E do punën me të mirë: e do një punë me dakortësinë e tjetrit; “Unë e dua punën me të mirë, se përndryshe bëj si di vetë”. (Vepra 4, f. 288)

Si e ke punën: ç’problem ke; “Hë, *si e ke punën*, Trëndelino”. (Vepra 4, f. 282)

Punë fshati: punë që kanë lidhje me jetën e fshatit; “Harallambit s’kish ç’t’i prishë se ai ish rrip, po *punë fshati* këto ore”. (Vepra 2, f. 201)

E kthen e vërtit punën: manipulon, përpiket ta kthejë punën në të mirën e vet; “Dhëlptra e sheh se i vjen fundi, po prapë mundohet *ta kthejë e vërtitë punën*”. (Vepra 4, f. 346)

E kthen punën mbarë e prapë: e mendon nga të gjitha anët, të mirat e të këqijat; “*E ktheu punën mbarë e prapë* e më në fund tha së shoqes”. (Vepra 4, f.403)

Puna jote: këtë e di ti; “Ku të vete, ku të mbytem... -*Puna jote*: ti i bëre, ti rriti”. (Vepra 4, f. 400)

Punë me baltë: veprime të ndyra; “...nuk ka bërë kurrë ndyrësi, “*punë me baltë*”. (Vepra 1, f. 272)

U trash puna: u rëndua, u vështirësua; “Trëndelinua e pa se *po trashej puna*. “Këta , - tha ajo me mendje, - do të më hanë të gjallë bashkë me time bijë”. (Vepra 4, f. 392)

E vë punën në udhë: e zgjidh; “...mblidhen njerëzit për të vënë në udhë *punët e fshatit*”. (Vepra 1, f. 235)

Pusullë - *E humb pusullën*: hutohet; “Tete Ngjelua e *humbi pusullën*: u skuq, u zverdh, u nxi, pastaj prapë u skuq, prapë u zverdh”. (Vepra 3, f. 472)

Pëllëmbë - *Në pëllëmbë të dorës*: e mban me gjithë të mirat; “Do ta mbaj në *pëllëmbë të dorës* me gjithë të mirat”. (Vepra 4, f. 278)

Tri pëllëmbë burrë: Burrë i shkurtër; “...Ici Matua s’ish *tri pëllëmbë burrë*”. (Vepra 3, f. 460)

Pykë - *Futet si pykë*: ndërhyt pa lidhje në një çështje apo midis dy njërëzve; “...u fut si pykë midis dy palëve, që të ndante grindjen”. (Vepra 1, f. 303)

Qafë - *E heq qafe*: e largon; “Dhe rëndom nuk i martojnë (ata thonë *i heqin qafe*) brënda në fshat, në lagje, po larg, në fshatra të tjera, për “harka”, për të “forcuar rrethin e miqësisë”. (Vepra 1, f. 243-244)

E ngarkon qafën: bën keq, mëkaton; “S’e bëj dot be ...Mjaft e *kam ngarkuar qafën*, bej. Nuk e ngarkoj dot më shumë”. (Vepra 1, f. 303)

Thyej qafën: ik, zhduku; “...mbaj thesin të ta shtie, pastaj merre në kurriz e *thyej qafën*”. (Vepra 1, f. 253)

Mos më merr në qafë: Mos më detyroni të bëj keq; “*Mos më merrni më qafë tani kur po më afrohet dita e lirimimit*”. (Vepra 1, f. 246)

E ze për qafe: e përqafo; “*Stanari hidhet e ze për qafe*. - O trim, unë të paskam djalën e mikut”. (Vepra 4, f. 340)

Qejf - *Për shtatë qejfe*: me kënaqësi; “*Hej, ç’ma paske këtë gëzof për shtatë qejfe*”. (Vepra 4, f. 347)

I shkrep qejfi: i teket, ka dëshirë; “*...tërë paraja, mal e fushë qenkëshin të sulltanit edhe ai ua lënka sa kohë të dojë vetë njerëzisë e ua marrka kur t’i shkrepë qejfi*”. (Vepra 1, f. 211)

I qejfit e i ahengut: i dhënë pas të gëzuarit të jetës; “*...Olloman beu ish njeriu i qejfit e i ahengut*”. (Vepra 1, f. 212)

Qen - *Ha qeni petulla*: me bollëk; “*...dasma nga ato që ha qeni petulla e kërcsin trarët e shtëpisë*”. (Vepra 2, f. 115)

Shkon si qeni në vreshtë: vdes kot, pa kuptim; “*...vjen e t’i numëron të gjashta në gojë e shkon si qeni në vreshtë*”. (Vepra 1, f. 268)

Si qen me katër sy: i keq, i hakërruar; “*Shkon një çunak në Tiranë për të bërë ushtrinë kthehet azgan si qen me katër sy*”. (Vepra 1, f. 288)

Sia ha qeni stapin: është shumë i zgjuar, nuk ia hedh dot; “*Ky bandill bën për ministër, në Tiranë, pranë mbretit, se s’ia ha qeni stapin*”. (Vepra 3, f. 505)

Qengj - *Bëhet qengj i butë*: bëhet i urtë, i bindur; “*Kalakulët e morën vesh se ku e kish fjalën e u bënë qengja të butë*”. (Vepra 3, f. 474)

Nga ujk bëhet qengj i butë: nga njeri agresiv kthehet në njeri të ndjeshëm që s’di të bëjë keq; “*Edhe e shikoi me një sy kaq të fortë sa nga ulk na u bë qengj i butë*”. (Vepra 1, f. 215)

Qesh - Nuk është për të qeshur: nuk është për ta tallur; “*Çupa në s’ish rënë qielli, s’ish as për të qeshur*”. (Vepra 1, f. 113)

Plas një e qeshur: qeshin me të madhe, qeshin fort; “*Atëhere plas një e qeshur sa kumbon lirishtja*”. (Vepra 4, f. 329)

Shkulet së qeshuri: qesh shumë; “*...bota shkulet së qeshuri me shakatë e tij*”. (Vepra 2, f. 195)

Gajas së qeshuri: qesh aq shumë sa gati meket; “*Fija zuri lukthet me duar e gajasi së qeshuri*”. (Vepra 3, f. 434)

Qiell - *S’është rënë qielli*: ka të meta, nuk është e përsosur; “*Çupa në s’ish rënë qielli, nuk ish as për të qeshur*”. (Vepra 1, f. 113)

Qojle - *Bëhet qojle e vegël*: Lejon ta përdorin të tjerët; “*...si u bën zemra të bëhi qojle e vegla të këtij katili, që i punon qindin këtij vendi*”. (Vepra 1, f. 216)

Qumësht - *Sjell edhe qumësht dallandyshe*: është i zoti të gjejë çdo gjë; “*...Unë jam i zoti të të sjell edhe qumësht dallandyshe*”. (Vepra 3, f. 311)

Bëhet qumësht e mjaltë: bëhet, tregohet i dashur; “*...kur ia donte puna, beu bëhej si i thonë fjalës qumësht e mjaltë*”. (Vepra 1, f. 68)

Qyp - *I hip qypit*: e vë në në terezi, krijon një nivel shumë të mirë ekonomik, kap një pozicion pune apo një rang shoqëror shumë të mirë; “Fiti *i hypi qypit*, u hap si vaji në lakrat, zaptoi gjysmën e fshatit, u bë Fiti bej”. (Vepra 1, f. 302)

Qyqe - *Kur të këndojë qyqja nga bishti*: thuhet për diçka që nuk do të ndodhë kurrë ndonjëherë; “Bile, ta dha pa pare, borxh, që do ta lash damkuku, *kur të këndojë qyqja nga bishti*”. (Vepra 1, f. 259)

Radhë - *Sa për të shkuar radhën*: pa kujdes, në mënyrë sipërfaqësore; “E jo dasma sidokudo, *sa për të shkuar radhën*, po dasma nga ato që ha qeni petulla”. (Vepra 2, f. 115)

E kështu me radhë: e të tjera si këto; “...sheh sërë-sërë: keçen, manushaqen, poleskën e *kështu me radhë* të gjitha të veshura në të reja”. (Vepra 4, f. 332)

Hyn në radhë: bëhem si të tjerët, rregullohem; “Mulliri bluante ditë e natë, se kishte gjithnjë ujë. *Hyj në radhë*, si gjithë bota”. (Vepra 4, f. 277)

Si e do radha: Si e do mirësjellja; “Djali i falet *si e do radha*”. (Vepra 4, f. 338)

Në radhën e burrave: i rritur, i pjekur; “Të prisja të më zbardhje ditët në pleqëri, të të shoh *në radhën e burrave*, që të na kenë zili bota”. (Vepra 1, f. 170)

Re - *Nuk e vë re*: nuk e shikon; “Të tjerët *nuk e vinin fort re*, se ata kishin hallin e tyre”. (Vepra 2, f. 228)

Vë re: shikon; “Skllavi hedh herë pas here sytë përtej, me të drojtur. Dardua e *vë re*”. (Vepra 3, f. 287)

Refene - *E fut në refene*: e vë në hesap, diskuton, e llogarit: Këtë tonin e *kanë futur në refene* për kallauuz; “Mirë thotë ime bijë: punon kali, ha gomari”. (Vepra 3, f. 431)

Rrip - *Nëpër rripa e zgripa*: nëpër vende të vështira; “U kthyen lajmëtarët këmbëshpejtë, duke prerë udhë *nëpër rripa e zgripa*”. (Vepra 3, f. 190)

Është rrip daulleje: s’ka asnjë lloj pasurie; “Ti je *rrip daulleje*; arë s’ke, luadh s’ke”. (Vepra 1, f. 248)

Rripkë - *S’ka veçse rripkën e kleçkën*: nuk ka asgjë; “Shqipëria nuk mund të bëheshe për laskandurët, për që *s’kanë veçse rripkën e kleçkën*”. (Vepra 3, f. 479)

Rrotë - *Rrota do lyer mirë*: duhet dhënë rryshfet; “...puna merr fund. Ama *rrota do lyer mirë*. I fole Myrto beut dy rroga në mot e ndonjë peshqesh tjetër”. (Vepra 1, f. 249)

Rrozgë - *Bëhet rrozgë*: s’ka asgjë, humbet gjithçka; “Ndenje atje kaq vjet, sa *u bëre rrozgë* fare e më erdhe këtu të shesësh mallin e gjënë”. (Vepra 1, f. 170)

Rrufe - *Si rrufeja në të kthjellët*: papandehur, kur s’e pret; “Ata na *goditën si rrufeja në të kthjellët*”. (Vepra 3, f. 307)

Rrënjë - *I lidhur pas rrënjëve jo pas degëve*: i lidhur me njerëz të rëndësishëm, me pushtet, jo me njerëz të thjeshtë; “Me miq bëhen këto punë... Unë jam *i lidhur pas rrënjëve, jo pas degëve*”. (Vepra 3, f. 475)

Sharrë - *I zë sharra gdhenë*: i ngec puna; “U kish kërkuar strehë dhe mbrojtje. Dhe ata ia kishin dhënë të dyja. Mirëpo kësaj here kish zënë sharra gdhenë. Gdheri i parë ishte Balibardhi”. (Vepra 3, f. 177)

Shesh - *E bën shesh e lëndinë*: e rrafshoj, e hedh në tokë; “- Hap, mre, rrugë se përndryshe - për atë qime! - *të boj shesh e lëndinë*”. (Vepra 1, f. 227)

Del në shesh të burrave: del në fushën e luftës, del përballë; “...a most ë ka zënë gjumi? *Dil në shesh të burrave*”. (Vepra 4, f. 145)

Shi - *Bie nga shiu në breshër*: kalon nga një situatë e keqe në një situatë akoma më të keqe; “Jo, se s’dua të *bie nga shiu në breshër*”. (Vepra 3, f. 353)

Shigjetë - shkon si shigjetë: shkon shpejt; “Më dha urdhër të shkoj si shigjetë”. (Vepra 3, f. 245)

Shinik - *Sa nuk matej dot me shinik*: me shumicë; “...buka ra nga qielli *sa nuk matej dot me shinik*”. (Vepra 2, f. 115)

Shitem - *Shitet e hiqet*: paraqitet jo siç është, por si dikush tjetër; “...Esad pasha ish *shitur e hequr* nga Shkodra”. (Vepra 1, f. 191)

Shkruaj - *Ku i qe shkruar*: ku i qe thënë, ku e kishte fatin, ku e kish vendosur zoti; “E Bukura e detit s’ia bëri fjalën dy, po hapi krahët e shkoi atje *ku i qe shkruar*”. (Vepra 4, f. 394)

Shkrumb - *E bën shkrumb*: e djeg, e kthen në thëngjill; “...i vuri zjarr drithërave dhe *i bëri shkrumb*”. (Vepra 4, f. 233)

Shkurt - *Ja prët shkurt*: nuk e zgjat, del menjëherë tek thelbi i bisedës; “*Ta presim shkurt*: e mbajtën lidhur, i gjetën një nuse, një shëmtirë që s’e kish shoqen”. (Vepra 4, f. 391)

Shok - *S’e ka shokun në botë*: është shumë i mirë, me cilësi të mira, shumë i veçantë: Duam një dhëndër që *s’e ka shokun në botë*: edhe trim e duam, edhe tringo-fringo, edhe qesen plot”. (Vepra 3, f. 445)

Shpirt - *Ia këput shpirtin*: i vjen shumë keq; “Qanin që *të këputnin shpirtin*”. (Vepra 1, f. 269)

Ment i del shpirti: gati të vdesë; “...rendi si langua sa *ment i doli shpirti*”. (Vepra 2, f. 218)

Ia sjell shpirtin në majë të hundës: e mërzit shumë; “Nuk i thashë as rri me shëndet. Ama *ma kish sjellë shpirtin në majë të hundës*”. (Vepra 3, f. 426)

Është me shpirt në gojë: është shumë i lodhur; “Dje kur po ngjitja koritën me llaç, bujer Hocu më lëvdoi: “Të lumtë djalë!” Unë s’ia ktheva se *isha me shpirt në gojë*”. (Vepra 3, f. 374)

Shtatë - *I vete shtatë*: kanë frikë; “...edhe ata mbyllen brenda, me gratë, se *u venë shtatë*”. (Vepra 1, f. 260)

Sa për shtatë: shumë; “Ai s’është si arinjtë e tjerë, po i fortë e i djallëzuar *sa për shtatë*”. (Vepra 1, f. 334)

Shtroj - *Shtrohu e rri si në shtëpinë tënde*: rehatohu, mos ki zor, mos ki teklif; “*Shtrohu e rri si në shtëpinë tënde*. Ne një copë bukë që do na japë zoti do ta hamë bashkë”. (Vepra 1, f. 222)

U shtron të ngrënë e të pirë: ju shtron tryezën e ngrënies me ushqim të bollëkshëm; “Dasmorët shkojnë te miku që i prët mirë, *u shtron me të ngrënë e me të pirë*”. (Vepra 4, f. 153)

Soj - *soj e sorollop*: të gjithë. “Ai me të shoqen e me tërë *sojin e sorollopin* e donin si sytë e ballit zonjzëzën *Ceco*”. (Vepra 3, f. 441)

Sot - *Sot e mot*: përgjithmonë; “Qofsh e gëzuar *sot e mot*”. (Vepra 1, f. 196)

Sot është, nesër s’është: është shumë plak, është afër vdekjes; “Mos më mbaj mëri. Aq më shumë se *sot jam, nesër s’jam*”. (Vepra 1, f. 196)

Spicë - *Fut spica*: shpif, intrigon për të hapur sherr; “Në fshat nuk i është dënuar kurrë emri për keq: s’ka vrarë, s’ka grabitur, *s’ka futur spica*”. (Vepra 1, f. 246)

Sehir - *Bën sehir*: shikon; “Krali i Serbit *bënte sehir* nga Shëndaumi”. (Vepra 1, f. 240)

Sëmundje - *E hedh sëmundjen*: shërohet; “*E hodhi sëmundjen*, e gërmoi në male e në gurë, të mos i dëgjohet më emri”. (Vepra 4, f. 377)

Sëpatë - *Ia prët me sëpatë*: ia tha troç, ia tha ashpër; “Vetë më that a nis e tani *ma prët me sëpatë*”. (Vepra 3, f. 439)

Squfur - *Me squfur e katran*: me gjithë më të këqijat; “...po vjen fundi i botës *me squfur e katran*”. (Vepra 1, f. 226)

Sy - *S’ia sheh synë (lekt)*: nuk ka, nuk i bie lek në dorë “...sot s’ia sheh synë lekt as sikur të vrasësh shtatë” (Vepra 3, f. 480).

Hap sytë: ki kujdes, ruaju! “Vetëm *hap sytë*, se unë jam nga ata që e shpie gjakun gjer më gju” (Vepra 3, f. 450).

Ra në sy: u pa, u dallua. “Këto *u ranë në sy* helenëve kur zunë të shkelin këtej për të tregtuar ose për strehim” (Vepra 3, f. 95).

I lëshuan sytë xixa: a) u shkëlqyen sytë nga kënaqësia. b) u shkëlqyen sytë nga trimëria. “Burrave *u lëshuan sytë xixa*. E shikonin dhe e dëgjonin sit ë magjepsur. Ka të drejtë Homeri që thotë: “Arma e tërheq burrin” (Vepra 3, f. 278).

I vajti syri: pikas, sheh diçka që i pëlqen. “Hyrë e dil, hyrë e dil, na *i vete syri* në një qilim të varur si mënjanë, - as shumë i madh, as shumë i vogël” (Vepra 4, f. 482).

Çakërret sytë: shikon i trembur. “Bufi *çakërriste sytë* e s’shihte gjë” (Vepra 4, f. 319).

I bëhen sytë ujë: ju lodhën sytë duke parë gjithandej në pritje të gjatë të një personi. “M’u *bënë sytë ujë* që kur po të pres” (Vepra 4, f. 342).

Fjeti me një sy hapur e një sy mbyllur: qëndroi gjysmëfjetur, gjysmëzgjuar, qëndroi vigjilent edhe në gjumë. “Haj, mbushi pishtarët me

pishë, që të ketë dritë gjersa të gdhihet. Unë *do të fle me një sy hapur e me një sy mbyllur*” (Vepra 4, f. 354).

Iu mbushën sytë me lot: qau nga vuajtja, dëshpërimi ose nga gëzimi. “*Sytë iu mbushën me lot*. Ndenji ashtu gjersa u mbush me firomë” (Vepra 1, f. 301).

Me sytë përdhe: i turpëruar: “...ata do të ikin *me sytë përdhe* e me bishtin ndër shalë, do t’ia lënë të gjitha ariut” (Vepra 1, f. 260).

E ka syrin pishë: i ndrit syri, e ka syrin zjarr, nuk i shpëton gjë pa parë. “Ndoni e *kish synë pishë* kur bridhte nëpër Mokër e Gorë, sepse për xhaxhon këngëtar Zallorët e shpinin gjakun gjer mbi gju” (Vepra 1, f. 342).

Mbylli sytë: bëri sikur nuk pa. “Po të bësh kështu, *mbyllin sytë* e të lënë të vjedhësh, të rrëmbesh, të fitosh, siç thua zotrote” (Vepra 1, f. 287)

S’ia nxjerr synë: nuk i bën keq, nuk e dëmton. “...sorra sorrës *s’ia nxjerr synë*, e shoshari s’e gënjen shosharë”. (Vepra 2, f. 269)

Sa për sy e faqe: sa për t’u dukur para të tjerëve, sa për të qënë në rregull, sa për formë. “Merrnin përsipër të ndërtonin udhë e ura, u hidhnin të vjetrave një cipë çimentoje, *sa për sy e faqe*, e paguheshin si për të reja” (Vepra 1, f. 286).

Ku sytë këmbët: kuturu, pa e ditur se ku, pa drejtim. “... pleqtë e plakat iknin natën, *ku sytë këmbët* e nuk kthenin kokën prapa” (Vepra 1, f. 212).

I bëjnë sytë: i duket sikur sheh diçka, nuk është i sigurt për atë që sheh: “Po ja – a mos *i bëjnë sytë?* - Poshtë, rrëzë mezhdës, duket një çupë” (Vepra 1, f. 194-195)

Sa të hapësh e të mbyllësh sytë: menjëherë, shumë shpejt, në çast: “*Sa të hapësh e të mbyllësh sytë* zjarri mori të përpjetën” (Vepra 3, f. 292).

Të zë sytë: të ndodh diçka shumë e keqe, të bën qorr: “Buka nuk shkelet se *të zë sytë*” (Vepra 2, f. 123).

I hapet syri: merr kurajo, merr zemër për të bërë diçka: “Pastaj, kur na merrte krahun ndokush, *na hapej syri* dhe më shumë” (Vepra 2, f. 126).

Nuk shikohej dot me sy: aq shumë e bukur sa dehet syri po ta shohë. “Si lulja në mëngjes, me vesë, kur i bie dielli. E hollë, e gjatë. *Nuk shikohej dot me sy*” (Vepra 2, f. 142).

S’e sheh dot me sy: e ka inat, e ka zët. “Më parë *s’kam dashur ta shoh me sy*, tani e kam mike” (Vepra 1, f. 306)

I kanë zënë perde sytë: nuk shikon mirë. “*A i kanë zënë perde sytë*” (Vepra 4, f. 471).

E do si sytë e ballit: e do shumë. “E dua si sytë e ballit, po s’hahem dot me fatin” (Vepra 4, f. 439)

Ia shkeli synë: i bën shenjë. “Dhe namëta e prët fjalën, ia shkel synë hënës” (Vepra 4, f. 438)

Hodhi sytë: shikon me vëmendje. “Dhe kudo *të hidhje sytë*, nuk shihje veçse vdekje, sëmundje, skamje” (Vepra 1, f. 191)

I bën sytë katër: është shumë vigjilent. “...beu me Sheqeren pranë, gjithnjë *sytë katër*; hanëmi me allajkën më këmbë, prapa kurrizit” (Vepra 1, f. 84)

S’ja zë syri: nuk e sheh. “Ka një javë e më shumë që *s’na e ka zënë syri*” (Vepra 4, f. 385)

I qepen sytë: i flihet. “Natën dëgjuam këngë e ushëtimë të madhe, po *sytë na qenë qepur* e s’i hapëm dot”. (Vepra 4, f. 387)

Për sytë e ballit: përdoret për të bindur se ajo që thuhet është krejt e vërtetë. “Të betohem *për sytë e ballit* se pot ë bësh kështu do ta harrojë menjëherë”! (Vepra 4, f. 315)

Hoqi sytë: ndërpret së pari një gjë. “*Hoqi sytë* nga qyteti dhe i hodhi tutje në fushë” (Vepra 1, f. 78)

Kullot sytë: shikon më nge, me kënaqësi. “...që nga Çuka gjer ne Gëmbri, nuk të *kullot syri* përveçse hardhi të gjallë”. (Vepra 2, f. 266)

Nuk e gënjen syri: sheh shumë mirë. “...po bejnë *nuk e gënjente syri*”. (Vepra 1, f. 70)

I mbushen sytë me shkëndija: zemërohët, inatoset. “...tërhiqej i hutuar përpara syve të Anylës që *ishin mbushur me shkëndija* si ato që lëshon hekuri kur e rreh bareja mbi kudhër”. (Vepra 3, f. 219)

Ka sy të fortë: nuk ka turp, është i ashpër, nuk toleron. “Paraja është si morri: lëshon thërrija e këto bëhen morra, pastaj morrat bëjnë gjene thërrija. Ama duhet të dish ta punosh, *ta bësh synë të fortë*”. (Vepra 3, f. 487)

Ëndërron me sy hapur: ëndërron pa u mbështetur në realitet, i shkëputur nga realiteti. “Prapë po *ëndërronte me sy hapur* ishte e s’ishte aty”. (Vepra 3, f. 34)

S’ia mbushi synë - nuk e vlerëson, nuk bindet për zotësinë e dikujt. “Ai *s’ia mbushi synë* valiut të Manastirit, Po kur ky nxori koburen në gjoks, valiut i vanë shtatë”. (Vepra 3, f. 461)

Sy ke e me sy nuk shikon: nuk shikon mirë. “Ku ta - *sy kemi e me sy nuk shikojmë* - ndofta ai krushqari tinëzar s’kish qënë njeri, po gjarpër që kish marrë fytyrë njeriu për të kobuar botën”. (Vepra 4, f. 500)

Merr një sy gjumë: fle pak; “Haj, *merr një sy gjumë*, se po gdhihet”. (Vepra 3, f. 381)

Të plaçin sytë: u verbofsh, vdeksh (mallkim); “*I plaçin sytë* atij që na e solli e na e la plëng në dorë këtë rrësk të keq”. (Vepra 3, f. 415)

I dalin sytë si gogla dushku: i zmadhohen sytë prej të qeshurës; “...ia plasi gazit me bërtimë të madhe sa i bënë dëng tërë rropullitë e ment *i dolën syrtë si gogla dushku*”. (Vepra 4, f. 388)

Lëshon një sy: shikon; “*Lëshona një sy*, djalë, e shikona mirë”. (Vepra 4, f. 164)

I kërcejnë sytë si ato kokarkat e Tushemishtit: i zmadhohen bebëzat e syve, i dalin gogulla; “Ariut të madh të Zaumit *i kërcejnë sytë si ato kokarkat e Tushemishtit*”. (Vepra 3, f. 464)

Shikohen sy më sy: shikohen në sytë e njëri-tjetrit; “*U shikuan të dy sy më sy*”. (Vepra 2, f. 138)

Piqen sy më sy: shkëmbejnë vështrime; “E sado druhesha të mos e shoh, gjithë *piqeshim sy më sy*”. (Vepra 1, f. 116)

I bëhet syri thanë: thuhet për dikë që prët prej kohësh për të parë diçka, që e ka shumë për zemër; “Përç – kapedani rri buzë liqerit, shikohet në pasqyrë, kreh mjekrën, zbukurohet, dhëndërrohet. Ariut *i bëhet syri thanë*. – *Hap-na de-rën, moj*”. (Vepra 4, f. 358)

Për sytë e botës: që të mos e gjykojnë të tjerët, për të qënë në rregull me të tjerët; “Desha ta lë udhën e saj *për sytë e botës*, po zemra më thosh; shko e një herë”. (Vepra 1, f. 116)

Tagar - *Tagar e shoshë*: i rrahur shumë keq; “Kush binte në dorë të Qose dhaskalit dilte *tagar e shoshë*”. (Vepra 2, f. 108)

Temena - *I bën temena*: i përkulet, i bën nderime; “Edhe të gjithë *i bënin temena*, po beu as që begeniste”. (Vepra 1, f. 211)

Tepe - *Të lot tepja e kokës*: çmëndesh; “Ama qira të madhe, që *të lot tepja e kokës*”. (Vepra 1, f. 285)

Telef - *U bë telef*: u lodh, u këput; “...i madh e i vogël *u bënë telef më këmbë*”. (Vepra 3, f. 511)

Teptil - *Për teptil hava*: për një shëtitje; “...kish ardhur këtu *për teptil hava* një burrë i madh nga Tirana”. (Vepra 1, f. 306)

Tmerr - *I kall tmerrin*: e tmërroi; “...ti që *u kall tmerrin* njerëzve, mua nuk më tremb dot”. (Vepra 4, f. 238)

Top - *E hodhi topin*: mbajti një qëndrim, e kaloi problemin tek fusha e tjetrit. “Ajo dhe të vëllezërit prisnin që xheladin beu *të hidhte topin* - kështu apo ashtu” (Vepra 1, f. 80).

Si top me dhjamë: i shëndoshë, pa linja trupore. “...Ish majmur e bërë *si top me dhjamë*”. (Vepra 4, f. 326)

Torbë - *S’ia var torbën*: nuke respekton; “Ky bënte sikur s’e shihte. *S’ia varte fare*”. (Vepra 4, f. 400)

Torua - *E humb toruan*: shastiset, turbullohet mendërisht; “Ky besoi e s’besoi dhe me të besuar e pa të besuar *e humbi toruan*”. (Vepra 1, f. 184)

Tragë - *Ia gjen tragën*: ia gjen gjurmën, e kupton se ku mund të jetë; “Po si mund *t’ia gjejë tragën* skllavi skllavit, kur ai vetë është i lidhur me pranga”. (Vepra 3, f. 261)

Tru - *I ndizen trutë*: i prishet mendja, s’është në rregull nga mendja; “Këtë e kanë marrë më qafë kalendarët që *ia kanë ndezur trutë* si ato fushqitë e dhisë”. (Vepra 3, f. 494)

I japin trutë e gomarit: e budallepsin, e bëjnë për vete; “Pale, po këta emra ua lanë edhe fëmijëve, brez pas brezi. Sikur *u paskan hedhur trutë e gomarit*”. (Vepra 3, f. 491)

Turi - *I var turinjtë*: zemërohet; “Nusja e Gaqos prapë *i vari turinjtë*”. (Vepra 3, f. 461)

Turp - *E lan turpin me gjak*: vë nderin në vend duke luftuar me tjetrin, duke vrarë; “Pret me durim ditën e diel, kërkon *ta lajë turpin me gjak*”. (Vepra 4, f. 167)

Të zitë - *Heq të zitë e ullirit*: vuan; “Këto viset tona, o bej, *kanë hequr të zitë e ullirit*, me kamje e s’kamje”. (Vepra 1, f. 216)

Tym - *Në tym*: në mënyrë të paqartë; “Unë sikur nis të marr vesh, *në tym*, se ç’do të thuash ti”. (Vepra 3, f. 509-510)

Bëhet tym e zjarr: inatoset, nxehet; “Ama *ishte bërë tym e zjarr* nga zemërimi”. (Vepra 1, f. 218) thellë

Them - *Më the të thashë*: e të tjera; “Dreka. Darka... mishra të pjekura, bakllavara, *më the të thashë*”. (Vepra 1, f. 240)

Thikë - *Thika i hyn deri në eshtër*: vuan shumë, deri në ekstrem; “Kemi duruar *thika që na kanë hyrë deri në eshtër*”. (Vepra 1, f. 286)

Zemra i prët thikë: zemra i dhemb, i sëmbon; Prandaj *zemra sot më prët thikë*: më bastisi e shkreta pleqëri e s’mund të marr më të përpjetat”. (Vepra 4, f. 370)

E preu përmes, si thikë: e tronditi, i shkaktoi vuajtje; “Ditani, djali i dytë ish vrarë në luftën e tretë të Lysit, buzë liqenit të bardhë, rrëzë Burrnit. Ky lajm *e preu në mes si thikë*, po e duroi”. (Vepra 3, f. 213)

Udhë - *Merr udhën e varrit*: bëhet për të vdekur; “Po kur pa se *kish marrë udhën e varrit*, Hysua i dërgoi fjalë vashës”. (Vepra 4, f. 152)

Humbet udhë: ngatërron udhën; “Ujqit bredhin syri-syri për të gjetur ndonjë lepur a ndonjë ketër tutkun që *ka humbur udhën*”. (Vepra 4, f. 330)

I bën udhë: e lë të flaës, nuk e kundërshton; “...kur e kupton se të gjitha sjanë veçse ngacmime, shpie buzën në gaz, *i bën udhë*, i pëlqen ta dëgjojë kur flet e qesh”. (Vepra 3, f. 21)

Udhë pa udhë: udhë pa krye, e ngatërruar; “...më tej na ngatërruan leqet: ramë në *udhë pa udhë*”. (Vepra 1, f. 203)

E pa të udhës: e pa të arsyeshme; “...duhej të kthente vijën në arë a në kopësht, siç e *kishin parë të udhës fshaçe*”. (Vepra 1, f. 232)

S’kish udhë tjetër: s’kish zgjidhje tjetër; “...kur pa se *s’kish udhë tjetër*, vendosi të shpëtojë lëkurën”. (Vepra 3, f. 152)

Në udhë e sipër: gjatë udhëtimit; “Shumë nga ata që arratiseshin, qëndronin një ditë a dy - *në udhë e sipër* - në derë të Malush aga Katunishtit”. (Vepra 1, f. 214)

E vë në udhë: e fut në rrugën e zgjidhjes; “...mblidhen njerëzit për të *vënë në udhë* punët e fshatit”. (Vepra 1, f. 235)

Ujë - *Mban ujë me shoshë*: bën gjithçka, bën të mundur të pamundurën; “...në dasmën tënde *do të mbajmë ujë me shoshë*”. (Vepra 3, f. 59)

Si ujin e ftohtë: me padurim; “Unë po të pres me zemër në dorë, *si ujin e ftohtë*”. (Vepra 4, f. 306)

Pa një pikë ujë: pa ujë; "...do të mbetet bota *pa një pikë ujë*". (Vepra 2, f. 204)

S'pin ujë: Nuk vlen, nuk shërben; "Fjala e tij *s'pin ujë*". (Vepra 1, f. 284)

E lëshon ujët nën rrogoz: vepron fshehurazi; "Prandaj duroi, gëlltiti, gjersa t'i vinte rasti që t'ia lëshonte ujët nën rrogoz". (Vepra 1, f. 312)

Nuk ia sjell ujin në mulli: nuk ia sjell gjërat në anën e tij; "...mos ia sill ujin në mulli kësaj gobille". (Vepra 3, f. 444)

Urdhër - *Bën urdhër:* urdhëron; "...*bëj urdhër* se mua gati më ke". (Vepra 4, f. 381)

Uri - *E merr uria:* i hahet; "Ndofta e ka marrë *uria*". (Vepra 3, f. 342)

Urtë - *Urtë e butë:* me të mirë, pa zemërim; "Ti të shkosh poshtë *urtë e butë* dhe hap sytë se, po solle gurë e drurë që t'u biesh mureve, të ha gjarpri I zi". (Vepra 1, f. 352)

Urë - *Bëhet urë e gur:* tolerant por edhe i fortë; "...xha Brahua u bë *urë e gur*, hoqi, duroi, po nuk ia dha të nipit vulën e mullirit". (Vepra 1, f. 171)

Yxhym - *Bën yxhym:* sulet; "Zbret ariu ditë më drekë, *bën yxhym* brënda në fshat". (Vepra 1, f. 260)

Vaj - I sosit vaji i kandilit: vdes; "...nja pesë a gjashtë kishin shkuar me të shumtit, vetvetiu, se u qe sosur vaji i kandiles". (Vepra 3, f. 346)

Hapet si vaji në lakrat: Zgjerohet, merr më shumë se ç'i takon; "...u hap si vaji në lakrat, zaptoi gjysmën e fshatit". (Vepra 1, f. 302)

S'është rrahur me vaj e me uthull: s'ka përvojë; "Ti je i ri, *s'je rrahur me vaj e me uthull*". (Vepra 4, f. 339)

Valle - *Hyn në valle:* bëhet pjesëtar në një çështje, në një punë; "...në krye të tre vjetëve i vjen radha të voglit që të *hyjë në valle*". (Vepra 4, f. 384)

Dredh valle: luan valle; "O Kalakulë, a doni të *dredhim* edhe ne *vallen* e minjve". (Vepra 3, f. 470)

Vrap - *Ia merr vrapit:* vrapon; "...të tjerët kthenin krahët e *ia merrnin vrapit*". (Vepra 4, f. 219)

Vegël - *Bëhet vegël:* bëhet shërbëtor i dikujt, përdoret prej dikujt; "...i treti që bërë *vegël* e tinzar finok në duart e tij". (Vepra 4, f. 236)

Vend - *Luaj vendit:* lëviz; "Kish gisht Osman Çota në këtë gjak të ri? *Luani vendit*". (Vepra 4, f. 243)

Ngrin në vend: nguroset menjëherë; "Veshllapushi i gjorë kish ndërruar jetë nga frika dhe *kish ngrirë në vend*". (Vepra 4, f. 322)

Gozhdohet në vend: nuk lëviz dot; "Dhe ai, Mano persiani *ish gozhduar në vend*". (Vepra 4, f. 312)

E tund nga vendi: e vë në lëvizje; "...i ra veshgjatit me shkop, që *ta tundë nga vendi*". (Vepra 4, f. 268)

E le në vend: e godet fort, e vret, e bën të vdekur; "Mos e thuaj edhe një herë këtë fjalë, se *do të më lesh në vend*". (Vepra 4, f. 456)

S'e mban vendi: nuk gjendet mirë në një vend të caktuar; “*S'na mban vendi*. Shqipëria nuk u bë për ne”. (Vepra 4, f. 479)

E shkel vendin: e pushton; “...të hidhem në luftë kundër qenit turk, që *na ka shkelur vendin*”. (Vepra 4, f. 253)

Vesh - *I bje në vesh*: e dëgjon; “U hap fjala fund e kënd gjersa *i ra në vesh* një plaku të uruar nga Çermenik' e madhe”. (Vepra 2, f. 314)

S'i bën tër veshi: nuk trembet; Koburja i ndan të gjitha. E lija thes në mes të bajgave, si derr, e *s'më bën tër veshi*”. (Vepra 1, f. 296)

Ia zë veshi: e dëgjon; “*Mua ma kish zënë veshi*: vllahçe”. (Vepra 3, f. 491)

Mban vesh: dëgjon; “Heeej, dëgjoni, *mbani vesh*”. (Vepra 4, f. 279)

E merr për veshi: e merr me forcë; “Mos e bëj *të të marrim për veshi* ty e tët bijë, e t'ju shpiem ne Kuma Marua”. (Vepra 4, f. 292)

I rëntë i sotmi rrëzë veshit: vdektë; “Unë t'i bie asaj më qafë? Uf, *më rëntë i sotmi rrëzë veshit*”. (Vepra 3, f. 417)

Veresie - *S'ia lë veresie*: s'ia lë pa kthyer përgjigjen e duhur; “Po as djali i Shaqos *s'ia la veresie*: hapni sytë, ore, mos prishni punën me arinë”. (Vepra 1, f. 257)

Vdekje - *S'e vë vdekjen në kandar*: nuk e llogarit vdekjen, s'i bën përshtypje vdekja; “Ata *s'e kishin vënë kurrë vdekjen në kandar*, s'i qenë drojtur kurrë”. (Vepra 1, f. 176)

Vete - *Jep e merr me vete*: mendohet, vret mendjen; “...nga t'ia mbaj që të shpëtoj këtë copë çupë? Kështu *jep e merr me vete*”. (Vepra 4, f. 289)

E ndien veten: ndihet; “...sikur *e ndiente veten* më të lehtë”. (Vepra 4, f. 313)

E mbledh veten: qartësohet; “Atëhere *Bardhua e mbledh veten*: ti di gjësend. Thuajma”. (Vepra 4, f. 483)

E merr veten: forcohet; “Gjersa të *merrnin veten*, xha Martini kish nisur kuvendin me kuajt”. (Vepra 1, 202)

Vetull - *Var vetullat*: zymtohet; “Sofisti *vari vetullat* dhe thumboi si gjarpër”. (Vepra 3, f. 41)

Vetë - *Si di vetë*: si dua unë; “...përndryshe bëj *si di vetë*”. (Vepra 4, f. 288)

Vetë shkruan, vetë vulos: bën gjithçka si di vetë pa pyetur njeri; “Kaq të bën ora thotë...*vetë shkruan, vetë vulos*”. (Vepra 2, f. 251)

Vend - *S'e mban vendi*: nuk i jep dot mundësinë për të jetuar mirë; “U shojtëm në punë. Krizë! *S'na mban vendi*. Shqipëria nuk u bë për ne”. (Vepra 3, f. 479)

Vetëtimë - *kthehet si vetëtimë*: kthehet shpejt; “Më dha urdhër të shkoj si shigjetë e të *kthehem si vetëtimë*”. (Vepra 3, f. 245)

Volle - *Ia bën vollen*: ia plotëson dëshirën, ia plotëson qejfin; “*Meqë ma bëre vollen* unë do të të përcjell gjer në fshat”. (Vepra 4, f. 282)

Vras - *Vret e prët*: bën ligjin; “Ato tri gatakat vrasin e presin”. (Vepra 4, f. 471)

Të vret e s'të paguan: të shkakton dëm e nuk do t'ia dijë, s'mban përgjegjësi; “Ky është shpatëtar, të vret e s'të paguan. S'e ka mjaft një milor të tërë”. (Vepra 3, f. 326)

Vrer - *Bëhet vrer*: mërzitet, dëshpërohet; “...nuk shih vëllamin ndër miq e shokë; atëhere bëhet vrer”. (Vepra 4, f. 149)

Mbytet në vrer: dëshpërohet pa fund; “Anyta dëgjoi kryeulur, i mbytur në vrer”. (Vepra 3, f. 228)

I mblidhet vreri lëmsh në zemër: hidhërohet; “...ia mori këngës ...një këngë me të qarë e për të qarë, se i qe mbledhur vreri lëmsh në zemër”. (Vepra 4, f. 329)

Vulë - *I shkon vula*: i shkon fjala, i ecën; “Ai ishte vetë vali, vetë kadi...i shkonte vula në Janinë e në Stamboll”. (Vepra 1, f. 209)

I forcon vulën: i jep më shumë pushtet; “Kue desh Olloman beu...që ta forconte vulën, një muaj të tërë kërciste dita më ditë dajaku”. (Vepra 1, f. 211)

Ia madhon vulën: ja zgjeron pushtetin; “Edhe, si shpërblim i vinte një ferman i madh nga Stambolli, që ia forconte rrënjët e ia madhonte vulën”. (Vepra 1, f. 212)

Vijë - *E vë punën në vijë*: e çon problemin drejt zgjidhjes, e vë punën për mbarë; “Shkon plaka e piqet me Xexovicën, e vë punën në vijë”. (Vepra 3, f. 467)

Xham - *Bëhet xham*: pastrohet; “Qielli është bërë xham”. (Vepra 4, f. 395)

Xhind - *U bë xhind*: u inatos, u zemëruashumë. “Kur po zbrisnim në dhe doli era e dredhkës, u bë xhind, e nxiu ditën e bëri natë”. (Vepra 3, f. 393)

Xhuxhullimë - *E ha xhuxhullima*: vdes; “...mos ma gërryey kopshtin se të ha xhuxhullima”. (Vepra 1, f. 350)

Yll - *U pjek ylli*: pëlqehen; “A ka gjë më të mirë sesa ahëre kur pjek ylli”. (Vepra 4, f. 369)

Zap - *E bën zap*: e mbledh, e vë nën kontroll; “Bënin djathë e gjalpë...i shisnin me pare apo i bënin tramba me kripë, sheqer...plumb e barut për të vrrarë ndonjë egërsirë a për të bërë zap ndonjë hasëm”. (Vepra 1, f. 333)

Zegri - *E zë zegri*: ja fut me të vrapuar; “...një dem vrapëtar e kish zënë zegri”. (Vepra 1, f. 300)

Zemër - *Ç'të të dojë zemra*: gjithçka që do; “Aty kish ç'të të donte zemra”. (Vepra 4, f. 482)

I vjedh zemrën: e bën për vete; “Nënës i ardhni keq, u zbut; ndofta ia vodhi zemrën zallahia që bënë xhingamingat”. (Vepra 4, f. 305)

Me zemër të thyer: pa qef, i lënduar; “I tha me zemër të thyer: Në dritare dil, po mos vono shumë”. (Vepra 4, f. 305)

Me zemër në dorë: me padurim; “Unë po të pres me zemër në dorë, si ujin e ftohtë”. (Vepra 4, f. 306)

I hip një rreshk në zemër: i hip malli, dëshira; “...*më ka hipur njërrëshk* i fortë *në zemër*. Më fal pak ujë me dorën tënde të shuaj etjen”. (Vepra 4, f. 164)

Diç i thotë zemra: diçka ndjen; “Nuk e di nënë, po *diç më thotë zemra*”. (Vepra 4, f. 143)

Ia fiton zemrën: e bën për vete; “Duhet *t’ia fitojmë zemrën*, o mbret, ta bëjmë si ne”. (Vepra 4, f. 315)

E mban me zemër: I jep shpresë; “Atëhere i vinin brenda në shpellë pisërëngat e larushta, ketrit e butë...*që e mbanin me zemër*”. (Vepra 4, f. 313)

Ia thyen zemrën: e lëndon, e bën të vuajë; “Kësaj here do *t’ia falim* se kam frikë mos *ia thyejmë zemrën* çupës”. (Vepra 4, f. 315)

I vete drejt e në zemër: i shijon, i pëlqen; “Mishi ka shije kur hahet ashtu siç është, me gjak, se *të vete drejt e në zemër*”. (Vepra 4, f. 316)

I vjen zemra në vend: qetësohet; “...e njeh arinë dhe *i vjen zemra në vend*”. (Vepra 4, f. 275)

Ç’të të lërë e bardha zemër: ç’të të dojë zemra; “Nëm *ç’të të lërë e bardha zemër*”. (Vepra 4, f. 301)

Bën zemër: guxon; “Ca njerëz *bëjnë zemër* e dalin me sfulqje e sopata”. (Vepra 4, f. 297)

E ka zemrën të djegur: i ka ndodhur fatkeqësi; “*Zemrën e kam të djegur*, se më kanë vdekur shumë fëmijë”. (Vepra 4, f. 280)

S’ia lë peng në zemër: nuk e bën të vuajë për diçka; “...*nuk dua të të lë peng në zemër* po të ndodhë të më presë kryet bajlozi”. (Vepra 4, f. 144)

I bëhet zemra mal: gëzohet; “Nga të pesë lekët e gjobës tre i kish marrë polici, dy – Grendelli. Dhe *i qe bërë zemra mal*”. (Vepra 1, f. 284)

Si i bën zemra: si ka mundësi; “...*si u bën zemra* të bëhi qojle e vegla të këtij katili”. (Vepra 1, f. 216)

I mbetet peng në zemër: i mbetet merak për diçka të porealizuar.; “...*I kish mbetur peng në zemër* se nuk kishte arritur të shkruante thjesht, si Batuni”. (Vepra 3, f. 237)

I bëhet zemra copë: vuan; “*M’u bë zemra copë*, kur i pashë atje fëmijët e peshkëpiarëve e të lubanishtarëve tanë tëhumbur midis vllësh, turqsh, tatarësh, gegëucësh”. (Vepra 3, f. 354)

I ka punuar me zemër: i ka punuar me dashuri; E shoh se ai miku *t’i paska punuar me zemër*”. (Vepra 3, f. 288)

Merr zemër: ngrohet, bëhet optimist; “Kaligjeni *mori zemër*, i qeshi fytyra e rrethuar me mjekër e leshra të kërleshura”. (Vepra 3, f. 47)

Ia ndan zemrën më dysh: e bën të dojë dy gjëra njëherësh; “Ti, xha Batun, *më ndave zemrën më dysh*; mëngjalle një dashuri të re. I ke dhënë jetë gurit. Dhe nuk di kë dua më shumë”. (Vepra 3, f. 122-123)

I jep zemër: i jep kurajë; “Ajo i printe përpara, ajo e nxiste, *i jepte zemër*”. (Vepra 3, f. 27)

I vjen zemra: qetësohet; “Hë i thotë, *të erdhi zemra*”. (Vepra 3, f. 458)

Me zemër të zhuritur: me vuajtjen e një malli të madh: “Matua vdiq me lot në sy, *me zemër të zhuritur* e na e la me gojë të vdekjes që t’ia shpiem ehtrat në fshat”. (Vepra 2, f. 42)

Zemërim - *I zjen zemërimi*: është i zemëruar; “*I ziente zemërimi* në zemër, sindozot zien jashtë fërtyma e kollozheku”. (Vepra 1, f. 214-215)

Zi - *Zi e zibiti*: varfëri, skamje, vuajtje; “...e merrte okën më të madhe se sa oka e vërtetë atje ku kishte shumë, ku vrahu ishte i madh, dhe më të vogël atje ku kishte *zi e zibiti*”. (Vepra 1, f. 327)

Zot - *I del për zot*: e merr në mbrojtje; “*I dilte për zot* çdo të mjeri, i merrte krahun, luftonte”. (Vepra 4, f. 152)

E vrau zoti: vdiq; “Do të shohim se cilin *do të vrasë zoti*: mua apo ty”. (Vepra 4, f. 146)

Zoti e ndjeftë: zoti e ndihmoftë; “Unë gramat...i mësova me Gjorgjin e priftit (*Zoti e ndjeftë*, se ish i ri fort kur ra e vdiq) që e vinte Shkurtua e Qosja të na bëjë mathimë”. (Vepra 2, f. 111)

Si mos o zot: shumë keq; “Pa kemi vuajtur për bukë e për ujë, *si mos o zot*”. (Vepra 2, f. 15)

Mos të lëntë zoti: mos mbetsh pa një gjë të rëndësishme; “Muj, *most ë lëntë zoti* kurrë pa vëlla”. (Vepra 4, f. 85)

Zë(ri) - *Thërret sa i ha zëri*: thërret me zë të lartë; “...tundi këllëçin e *thirri sa i hante zëri*”. (Vepra 1, f. 239)

I bën zë: i thërret, e lajmëron; “Po të ndodhë gjësend, *bëmë zë*”. (Vepra 3, f. 15)

Nuk bën zë: qëndron në heshtje, nuk flet, nuk vepron; “Ju do të më jepni besën se *nuk do të bëni zë* e nuk do të qëlloni askënd”. (Vepra 4, f. 185)

S’i ndihet zëri: nuk flet; “Ç’ka Ymer Aga që *s’po i ndihet zëri*”. (Vepra 4, f. 48)

I këputet zëri: ndërpret të folurën; “Këtu, *zëri* i xha Martinit *u këput* siç këputet e bie nga lart një zog kur kris rrufeja”. (Vpra 1, f. 212)

Pa bërë zë: pa folur; “Xheladin beu *u zbyth pa bërë zë*”. (Vepra 1, f. 98)

IV. PËRFUNDIME

Në këtë studim janë arritur disa përfundime:

1. Kuteli ka një stil origjinal, krejt të pakrahasueshëm me të tjerët, për një arsye thelbësore: për arsye të raportit që ai ka me gjuhën, të përdorimit cilësor të mjeteve të saj. Ai është padiskutim rasti i shkrimtarit që di t'i "qepet" fjalës shqipe në tërësi dhe fjalës së vendlindjes në veçanti, duke e funksionalizuar atë në shtresat kuptimore të tregimeve dhe rrëfenjave të tij. Në mënyrë të përmbledhur do të nënvizonim se pasuria gjuhësore e veprës së tij është unike për tri arsye: së pari, për vetë konceptin që shkrimtari ka për veshjen gjuhësore, të cilën e konsideron parësore për një vepër letrare, si dhe aftësinë dhe talentin që ai ka për ta realizuar këtë synim, së dyti, gjerësia e thellësia e veprës në pikëpamje përmbajtësore dikton një përkushtim të thellë ndaj gjuhës dhe, së treti, jo më pak i rëndësishëm, është formimi i tij i shkëlqyer kulturor, vendlindja e tij e dalluar për pasuritë natyrore e kulturore, origjina, familja, fëmijëria, lidhjet e tij të hershme me folklorin etj. Të gjitha këto së bashku e sjellin veprën e Kutelit drejt një pejsazhi gjuhësor nga më të ylbertet, nga më interesantët.

2. Vepra e Kutelit është në vetvete një shkollë gjuhësore, në kuptimin e plotë të fjalës, për nga mënyra se si ai i vesh gjuhësisht idetë, mendimet, mesazhet, për nga mënyra se si sendëzon këndvështrimet e tij për jetën dhe botën.

3. Leksiku i begatë i veprës së tij është treguesi kryesor se ai e njeh në nivel shumë të mirë gjuhën e popullit, gjuhën e trevës juglindore dhe gjuhën shqipe në tërësi. Ai ka fjalorin e vet dhe fjalët e veta më të dashura, të cilat i japin frymë dhe gjallëri ideve të tij të mëdha, ballafaqimeve të rëndësishme e bazike dhe kundërthënieve jetësore të personazheve të tij dhe jo pak të tilla bëhen stilformuese në veprën e tij. Sjellja gjuhësore e Kutelit ngjan me delikatesën e kopshtarit të dashuruar mbas çdo lule e bimëze, mbas çdo rrënje e sythi, mbas çdo degëze të përgjumur apo të harlisur; sjellja e tij gjuhësore tenton "hirin i fjalës", fuqinë e saj biblike.

4. Në veprën e Kutelit vërehet qasja e tij e fortë drejt gjuhës letrare. Prirja e tij kah gjuha letrare kombëtare nuk është aspak e rastësishme, përkundrazi, ajo realizohet në mënyrë të vetëdijshme, përmes një përpunimi të hollë, duke ju nënështuar një sistemi rregullash të rrafshëve të ndryshme gjuhësore: fonetike, gramatikore, leksikore, sintaksore etj. Përgjatë rrugëtimit të tij krijues, Kuteli i ka shpërthyer kufijtë krahinorë duke shkuar gjithnjë e më shumë drejt gjuhës kombëtare, drejt zgjerimit të saj dhe për ta vërtetuar këtë mjafton të ndalemi disa çaste të krijimit të tij i mëvonshëm "Nga Dyrakioma në

Bardhonë”, e cila krahasimisht me krijimet e tjera të mëparshme, është në nivel të lartë e pastruar nga krahinorizmat, nga fjalët e huaja, veçanërisht nga turqizmat, duke i lënë vendin fjalëve të moçme shqipe, që shfaqen si bukuroshe të fjetura.

5. Vepra letrare e Kutelit është në vetvete një ndihmë e shquar në pasurimin e gjuhës kombëtare, gjë që ai e realizon me të gjitha mënyrat. Së pari, duke shpëtuar prej harrimit shumë njësi të vjetra, të mënjanuara, apo të nxjerra jashtë përdorimit prej zhvillimeve të reja social-historike. Ai sjell njësi të qëmoçme, të cilat kanë lidhje me mjedisin gjeografik, me leksikun e Liqenit të Ohrit, me bujqësinë, me blegtorinë, me fenë, me etnografinë, me etnozoolojinë, me etnobotanikën e zonës, por edhe përtej saj. Meritë e veçantë e tij është se edhe kur këto fjalë janë të panjohura, ai i vendos në kontekste të tilla, që ato të bëhen të kuptueshme për lexuesin. Kuteli, me anë të veprës së tij, jo vetëm ripërtëriti, por edhe i zgjeroi dhe rikuptimësoi semantikisht një numër të konsiderueshëm njësisish leksikore, në mënyrë të veçantë një kategori njësisish leksikore abstrakte. Ai dha një ndihmesë të madhe për pasurimin e shqipes letrare veçanërisht përmes fjalëformimit. Fjalëkrijimet e tij janë ndër më të bukurat dhe me interes, jo vetëm për gjuhën artistike, por edhe për atë letrare. Mund të themi se ai i përdor me sukses të gjitha modelet fjalëformuese të shqipes, ndonëse mbizotëruese janë fjalët e krijuara me anë të prejardhjes dhe kompozimit. Disa prej tyre duket se burojnë prej gurrës popullore, por ka edhe krijime vetjake që tingëllojnë tepër poetike. Të zgjedhura me kujdes dhe të vendosura në kontekstet përkatëse këto fjalë *“kthehen në mjete të plotvlershme e kalojnë jashtë caqeve të gjuhës së letërsisë, dalin në lëmin e gjerë të stileve funksionale e të gjuhës së folur të përditshme dhe në mënyrë të veçantë kjo mund të thuhet për rastet kur fjala dialektore vjen e plotëson ndonjë mungesë të gjuhës letrare duke dhënë mundësi të plotësohet fondi aktiv i fjalorit ose të përtërihet ai duke nxjerrë jashtë përdorimit fjalë të huaja të panevojshme.”*⁹⁴ Ai zgjeroi figurshmërinë e shqipes, pasuroi leksikun poetik, duke figurativizuar edhe fjalët më të zakonshme të gjuhës, sidomos kategorinë e foljeve dhe mbiemrave, kryesisht, përmes prapashtesimit; krijoi modele sintetizmi, ekonomizimi gjuhësor veçanërisht te ndajfoljet e krijuara me anë të prapashtesimit; zgjeroi dhe pasuroi sinoniminë e gjuhës letrare në të gjitha tipat e saj veçanërisht ata stilistikë me burime të ndryshme, zgjeroi dhe përpunoi variantet stilistike sinonimike; zgjeroi e zhvilloi antoniminë leksikore, stilistike e semantike të shqipes letrare, duke plotësuar në sistem strukturën leksikore; solli pasuri në fushën e frazeologjisë dhe polisemisë, duke pasuruar fjalët me kuptime të reja.

6. Duke u ndalur te fjalorthet shpjeguese me të cilat është pajisur seria e veprave të Kutelit, jemi përpjekur të hetojmë konkretisht pasqyrimin në fjalorët e shqipes të atyre njësisive leksikore, të cilat i takojnë një fondi të lashtë leksikor ose që kanë karakter ngushtësisht krahinor dhe kemi vërejtur se gati

94 Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e gjuhës shqipe*, Tiranë 2009, f. 3.

60 përqind (ose diçka më shumë) e tyre janë të pasqyruara në fjalorin e 1980-ës dhe 40 përqind jo. Mbeten pa u përfshirë, kryesisht, njësi dialektore të cilat emërtojnë elemente të veshjeve të hershme, objekte të vjetra të cilat sot ose kanë dalë nga përdorimi ose përdoren shumë rrallë.

7. Duke e parë në tërësi leksikun e veprës së Kutelit, del se grupin më të madh e përbën leksiku asnjans, me funksione të pastra shënuese, i përbashkët për variantet ligjërimore dhe për stilet funksionale të shqipes letrare, por duhet thënë se shpesh edhe ky leksik merr karakteristika të ngjyrimit stilistik dhe emocionues e vlerësues. Vendin e dytë e zë leksiku i cilësuar stilistikisht për shkak të polisemantizmit dhe figurshmërisë që arrijnë nivele më të larta veçanërisht te shtresa e fjalëve me kuptime të prejardhura.

8. Leksiku popullor në veprën e Kutelit merr një peshë të veçantë, ai paraqitet shumë i pasur si në sasi dhe në tipologji. Autori zotëron shumë mirë jo vetëm potencialin gjuhësor të dialektit jugor, por edhe atë të dialektit verior, të variantit arbëresh, të disa të folmeve etj. dhe nuk ngurron t'i përdorë ato në ligjërimin e vet gjithmonë në varësi të temës, subjektit, kulturës, profesionit, prejardhjes së personazhit. Nuk mungojnë edhe dialektalizmat e huazuara, por ato janë më të pakta në numër, krahasuar me ato që burojnë prej gjuhës shqipe.

9. Në veprën e Kutelit janë të pranishëm të gjithë tipat leksiko-gramatikorë të dialektalizmave: emërorë, mbiemërorë, ndajfoljorë, përemërorë etj.

Nga studimi tërësor i veprës së tij rezulton se dialektizmat emërorë përbëjnë grupin më të madh (mbi 600). Të parë sipas tipave leksiko-fjalëformues, vërehet se brenda grupit të dialektalizmave emërorë mbizotërojnë fjalët e thjeshta, dhe më pas vijon me radhë fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra.

Prejardhja, më konkretisht prapashtesimi, është një dukuri e rëndomtë te Kuteli dhe duket se prapashtesat përdoren për të sjellë dallime kuptimore, funksionale dhe stilistike. Një grup formimesh të tilla të ngarkuara me ngjyresa stilistike, janë emrat e formuar me disa prapashtesa me burim vendas, si: *-ak, -ale, -ar, -im, -ishtë, -li, -nik, -një, -ore, -ri, -tar, -uc, -ule, -ës* dhe me burim të huaj, si: *-injë, -çi, -eshë, -llëk, -xhi*. Në grupin e dialektalizmave emërorë të prejardhur krijojnë grupe të veçanta emrat me prapashtesën *-kë*; emrat që krijohen me anë të prapashtesave zvogëluese *-osh, -oshe, -th, -thi, -zë, -z* etj., që përveç kuptimit bazë marrin edhe nuancat e përkëdhelisë apo të ironisë së lehtë; emrat abstraktë të formuar me prapashtesat *-esë, -si, -ri*, që përveç vlerave shënuese, marrin vlera të veçanta në rrafshin stilistikor; emrat onomatopeikë të krijuar me anë të prapashtesës *-im* etj.

Dialektizmat emërorë të përbërë janë jo vetëm më të paktë në numër, por, gjithashtu, *“ndryshe nga dy klasat e mësipërme, ata kanë më shumë karakter të përgjithshëm se sa karakter të ngushtë popullor”⁹⁵.*

95. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f.141.

10. Në vend të dytë për nga sasia e përdorimit janë dialektalizmat leksikorë mbiemërorë, ku grupin më të madh e përbëjnë mbiemrat e prejardhur dhe mbiemrat e formuar me anë të paranyjëzimit të pjesores, ndërsa grupin më të vogël e përbëjnë mbiemrat e parmë.

Kuteli është i kujdesshëm në përdorimin e mbiemrave të përbërë. Sigurisht, këta lloj mbiemrash, siç ka vënë në dukje Jani Thomai, “*kanë më shumë karakter të përgjithshëm se sa karakter të ngushtë popullor*”⁹⁶. Kuteli di të shfrytëzojë shumë mirë gjedhet fjalëformuese popullore, duke rritur e zgjeruar vargjet fjalëformuese të tipit: *barkbosh, brifortë, brirëdredhur, bukëbardhë* etj. Ai përdor dendur mbiemrat ekzocentrikë (karakteristikë për krijimtarinë gojore) për të treguar cilësi fizike, shpirtërore e mendore të personazheve; ndërkohë përdorimi i tyre sjell jo vetëm shprehësi stilistikore, por edhe ekonomizim të gjuhës.

Duke i parë në tërësi fjalët e përbëra, qoftë emrat, qoftë mbiemrat të marrë së bashku, bie në sy mbizotërimi i temës emërore, ku paraprijnë kompozitat të cilat njëra gjymtyrë përcakton tjetrën dhe jo kompozitat këpujore që përbëhen prej gjymtyrësh të barazvlershme. Vlera të rrafshit stilistikor sjell në veprën e Kutelit sidomos përdorimi i kompozitave me temë të njëjtë.

11. Vendin e tretë për nga sasia e përdorimit e zënë dialektalizmat ndajfoljorë, të cilët janë të shumëllojshëm për nga fjalëformimi: të parmë, të prejardhur, me parashtesim, prapashtesim, me përbërje apo me përngjitje. Bien në sy krijimi i ndajfoljeve me anë të prapashtesave: -as, -çe, -az, -thi etj., të cilat shprehin një kuptim më të intensifikuar, me anë të të cilave krijohen përftesat - variante stilistikore që krijojnë një atmosferë të lartë shprehësie. Në një numër të konsiderueshëm janë dhe lokucionet ndajfoljore. Gjithashtu, në veprën e Kutelit shihen jo rrallë ndërtime të tilla, si: *gur i rëndë, i ftohtë akull, brisk i ftohtë, derr fare* etj. Këto ndërtime janë rrjedhojë e një krahasimi të pashprehur dhe e leksikalizimit të figurave gjuhësore, pra për të mbërritur te ato, është zhvilluar një proces i gjatë kuptimor, nga figura letrare (zakonisht metaforë) në një kuptim të figurshëm dhe pastaj në një kuptim të ri leksikor. Këtë mund ta vërejmë sidomos për ato fjalë, ku ky kuptim nuk ndjehet më si i figurshëm: *akull i ftohtë, mjaltë i ëmbël* etj.

12. Një vend të rëndësishëm në veprën e Kutelit zënë dialektalizmat foljorë; ndër ta marrin rëndësi të veçantë foljet e prejardhura të formuara me anë të parashtesës –*stër*, të cilat duke dhënë një veprim të zmadhuar, e ngjyrosin kuptimisht e stilistikisht ligjërimin, si dhe disa folje të krijuara prej tij me anë të prapashtesës fjalëformuese -o, të vendosur mbi një temë emërore.

Në prozën e Kutelit ndeshet dendur dhe përdorimi i foljes në kohën e tashme të mënyrës habitore, përmes së cilës “*shprehet modaliteti i vërtetësisë, i shoqëruar edhe me ndjenjën e habisë së folësit për një veprim të papritur, që*

96. Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f.141

është kryer në të shkuarën ose që kryhet në çastin e ligjërimin.”⁹⁷ Me anë të tyre Kuteli realizon, pikërisht qëndrimin afektiv, por, ndërkohë, bën dhe aktualizimin e ngjarjes, pra bën që veprimi të kryhet përpara syve të lexuesit, gjë që sjell një ndikim më të madh te ai.

13. Kuteli zgjedh përemra që kanë përdorime e trajta krahinore, madje dhe forma që i përkasin shqipes së hershme dhe i vendos në lidhje të veçanta, të cilat i japin ligjërimin të tij vlera artistike. Të tilla janë: *njato*, *gjësend*, *kusur* etj. Në ligjërimin e tij përbën dukuri të veçantë paraprirja e emrave me përemra dëftorë, të cilët i shtojnë atyre nota kuptimore theksuese - veçuese, si dhe parandejtimi i përemrave pronorë (karakteristikë kjo e ligjërimin bisedor dhe e letërsisë gojore). Përsa i përket përemrave hasen dhe forma të shqipes së hershme, me fonetikë të vjetër, me grupin *-tn* të asimiluar në *-n*: *të zonë* në vend të *të zotin*.

14. Kuteli përdor forma dialektore edhe për sa i përket lidhëzave, si: *daha* “akoma”, *sindozot* “sikurse, sikundër”, *anagjore* “po ashtu” etj.

15. Kuteli di t’i shfrytëzojë shumë mirë format onomatopeike dhe t’i verë ato në funksion të harmonizimit gjuhësor e të krijimit të rrjedhave fonologjike, të krijimit të pamjeve të gjalla të natyrës, si përplasja e valëve, rrjedhja e lumenjve, burimeve, frymëmarrja e pyjeve, bimëve, zhurma e gjetheve, kënga e zogjve, gjuha e kafshëve, zhurma apo tingujt që lëshohen gjatë një procesi pune e kështu me radhë. Kuteli shfaqet jo vetëm si njohës shumë i mirë i njësive onomatopeike, por edhe si krijues i tyre, dhe kjo duket edhe në përdorimin e onomatopeve me karakter sinonimik. Kështu, për të qeshurën e njeriut ai përdor disa trajta onomatopeike: *ga-ga-ga*, *hi-hi-hi*, *ho-ho-ho*, *ku-ku-ku* ose për këngën e këndesit përdor sipas rrethanave trajtat: *ki-ki-ki*, *kikiriku*, *kukuriku*, *kukurigu* etj. Përdorimi i dendur i onomatopeve, pra i njësive tingullore, ndihmon në estetizimin e mëtejshëm të prozës së tij, duke ndikuar që gjithçka që paraqitet në vepër t’i shkojë lexuesit më me gjallëri dhe të mund të përjetohet prej tij maksimalisht edhe në mënyrë shqisore. Nuk mungojnë fjalëkrijimet me karakter onomatopeik, në krijimin e të cilave shfaqen si modelet fjalëformuese të shqipes, ashtu edhe prirja fjalëformuese vetjake e autorit. Onomatopetë në veprën e Kutelit janë më të shumta se sa fjalët onomatopeike. Po kështu, onomatopetë me kuptim të figurshëm dhe që sjellin pasurim të shprehësisë leksikore janë më të shumta në numër, se sa onomatopetë të cilat janë thjesht imituese të zhurmës së dukurive, pra që mbeten te vlera e tyre shënuese.

16. Kuteli ka sjellë një thesar fjalësh nga fusha e etnografisë, ekzistenca e të cilit rrezikohej në një masë të konsiderueshme, përballë rrjedhave të kohës, përballë zhvillimeve të reja; në pikëpamje gjuhësore vepra e tij është një pikë takimi gjyshërish e stërgjyshërish, nipërish, stërnipërish e nipstërnipërish, është një mekanizëm jetësues që e bën shqipen të duket ashtu siç është, një nga gjuhët më të vjetra por edhe më të pasura të botës. Për meritë

97 . *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 1995, f. 291-292.

të padiskutueshme të gjuhës, lexon veprën e tij dhe të duket sikur zhytesh në një surrealistet, por në të vërtetë je duke prekur rrënjët e tua, identitetin tënd. Sipas një renditjeje hierarkike dialektalizmat nga fusha e etnografisë janë së pari: fjalë që emërtojnë dukuri, vegla e mjete të ndryshme, profesione njerëzish etj.; fjalë që emërtojnë veshmbathje karakteristike për banorët e zones; fjalë që emërtojnë prodhime ushqimore; fjalë që emërtojnë marrëdhënie fafësnore e ndërnjerëzore; fjalë që shërbejnë si emra kafshësh; së dyti, vijnë fjalët nga bota e kafshëve dhe së treti, vijnë fjalët nga bota bimore.

17. Përbërës të rëndësishëm të shtresës dialektore në prozën e Kuteli janë edhe togfjalëshat popullore apo lidhjet fjalësore sipas modeleve të gjuhës së përditshme të popullit dhe krijimtarisë së tij gojore, të cilat më shpesh i gjejmë në krijimet që mbështeten në rrëfimet popullore, përrallat apo mitet dhe kjo është e natyrshme. Në përgjithësi, ai i merr ato si formula të gatshme, por nuk mungojnë rastet, kur ai vetë ndërton sipas gjedhes së tyre.

18. Kuteli ka mbledhur me një dorë të kujdesshme dhe i ka përdorur dendur dhe natyrshëm në veprën e tij urimet dhe mallkimet që janë tipike për ligjërimin gojor, por meritë e tij është se në përdorimin e tyre sjell vlera të veçanta edhe në ligjërimin artistik. Ato shpërfaqin pasuri sinonimike, shkallë të lartë intensiteti, figurshmëri të krijuar nga metaforat, krahasimet, hiperbolat, epitetet etj. Të ruajtura e të përcjella brez mbas brezi, ato kanë fituar një nivel ngurtësimi e vijnë në trajtë formulash të njëjta, por Kuteli, përveçse i përcjell si të tilla, krijon vetë variante të ndryshme përmbajtësore e stilistike, ndaj në strukturën e urimeve dhe mallkimeve mund të gjenden fjalë ose trajta dialektore, të cilat përforcojnë frymën autentike etnografike të krahinës së autorit. Kjo shihet veçanërisht në urimet dhe në mallkimet, të cilat kanë në përbërjen e tyre emra vendesh, zogjsh, kafshësh apo të besimit popullor të zonës, si emra perëndish, shenjtësh, djajsh etj.

19. Pena e shkrimtarit krijon imazhe të pasura e të detajuara duke futur në ligjërim, krahas fjalëve që shënojnë elemente të besimit popullor e mitologjik, si dhe të leksikut fetar, edhe një varg të gjatë emrash të mjediseve, të bimëve, të zogjve, të kafshëve të cilët gjenden në arealin gjeografik, ku ndodhin ngjarjet.

20. Ndodh që Kuteli të i njëjti tregim kombinon natyrshëm forma të ndryshme dialektore e krahinore dhe madje bashkë me to edhe variante letrare, sepse e thënë në mënyrë metaforike, atij do t'i rrinte ngushtë kostumi prej shkrimtari lokal, gjë që shënon një vlerë më tepër në fizionominë e tij prej shkrimtari gjithëkombëtar e gjithëshqiptar. Për shembull, të "Xinxifillua" ai përdor aty për aty një herë variantin dialektor jugor "çupë", një herë variantin dialektor verior (ndoshta me një ndërthurje të të folmes të labërishtes) "vasho" dhe një herë tjetër variantin letrar "vajzë".

21. Në veprën e Kutelit kanë prani të konsiderueshme edhe variantet fonetike krahinore: *fambrikantë* (fabrikantë), *shtatirë* (shtatore), *kureshtë* (kureshtje), *frenjat* (frenat), *kondratë* (kontratë), *profît* (profet) etj.

22. Në veprën e Kutelit paraqiten shumë të pasura grupet paradigmatiche: sinonimet dhe antonimet. Ashtu siç thotë Jani Thomai, begatia sinonimike e shqipes pasqyrohet në veprën e tij “*në një sistem të pasur e të ndërlikuar sinonimesh e mënyrash sinonimike të cilat autori i përdor sipas rastit, herë për të bërë nuancime të holla kuptimore e emocionuese, herë për mbushjen e fushës semantike dhe variacionin leksikor të frazës.*”⁹⁸ Kuteli i krijon paralelet sinonimike duke shfrytëzuar burime të ndryshme popullore dialektore, por më së shumti dialektin juglindor, duke nxjerrë prej harrimit shumë prej tyre (si rezultat mospërdorimit për arsye nga më të ndryshmet), por duke krijuar edhe vetë neologjizma, dhe në këtë pikë duket se autori zhvillon aktivitet krijues gjuhësor, qoftë në mënyrë origjinale, qoftë duke u mbështetur te modelet ekzistuese të fjalëformimit të shqipes. Në vështrim leksikor vërehet se ndërthurjet sinonimike krijohen më së shumti me fjalë dialektore, të cilat kanë kuptim konkret, me fjalë të cilat kanë lidhje me bimësinë, kafshët, me etnologjinë e zonës e të tjera dhe, më pak, me fjalë të kuptimit abstrakt. Dukuri e shpeshtë në veprën e Kutelit janë vargjet sinonimike; vërehet se në këtë rast hyjnë në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që nuk janë të tilla, dhe me to krijohen tufa përfitesash të gjera të cilat janë të ngarkuara me ngjyresa kuptimore dhe me vlera të larta shprehësie. Kështu, ato nxisin një qëndrim aktiv të lexuesit për të mos mbetur një pjesëmarrës sipërfaqësor, por të hyjë në thellësitë e kumteve të veprës. Estetizohet në nivel më të lartë teksti, kur në to krijohet shkallëzim e sidomos, kur elementet e vargut sinonimik krijojnë lidhje fjalësore të figurshme.

Pasuria krahinorizmave e dialektalizmave në veprën e Kutelit gjen shprehje edhe në paradigmen antonimike. Ky autor shfrytëzon mjeshtërisht mundësitë pa kufi të gjuhës për të krijuar kundërvënie konceptesh, idesh, kundërvënie ngjarjesh e dukurish, kundërvënie gjendjesh etj., të cilat janë aq të pranishme në jetën e njeriut dhe të universit. Ai krijon kundërvënie të mundshme, qoftë në rrafshin e leksikut, qoftë në atë të semantikës; për të mundësitë e kundërvënies janë të pafundme, ndaj provon të antonimizojë në kontekste të caktuara deri edhe fjalë të cilat përbërësi kuptimor i përbashkët është i largët, madje i skajshëm. Vlerat estetike, të buruara prej antonimisë kontekstuale rriten veçanërisht, kur ajo merr karakter sintaksor, pra strukturohen në formë fjalish apo frazash.

23. Fjalët e huazuara do të jenë të pranishme në veprën e Kutelit, por gjithmonë në masën e duhur, në varësi të temave dhe subjekteve të tregimeve të tij, në varësi të kontekstit të tyre historik, të origjinës, të kulturës, të psikologjisë dhe të mendësisë së personazheve etj. Për shembull, ka një sasi më të madhe të fjalëve të huaja (turqizime) në prozën ‘Vjeshta e Xheladin beut’, se sa në prozën ‘Lumi i madh’ apo ‘Xinxifillua’ e kështu me radhë.

Sipas sasisë së përdorimit, në vend të parë në veprën e Kutelit qëndrojnë orientalizmat, të ndjekura sipas radhës nga sllavizmat, greqizmat,

98 J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001, f. 143.

neolatinizmat, fjalët arumune etj., të cilat shfaqin më shumë interes në përdorimin e tyre në funksion të efekteve stilistike. Fjalët e huaja kthehen në përftesa dhe i rrisin koloritin e ligjërimit kutelian, sidomos, kur përdoren të grumbulluara me shumicë në një kontekst të caktuar. Vlera stilistike dhe ngjyresa emocionale e vlerësuese sjellin në veprën e Kutelit edhe fjalët turke të krijuara me anë të prapashtësës *-eshë -llëk, -xhi* etj.

Dihet se sllavizmat dhe greqizmat kanë karakter më të ngushtë krahinor, sepse lidhen me fqinjësitë gjeografike të krahinave të ndryshme dhe një rol të rëndësishëm për praninë e tyre në veprën letrare luan vendlindja e shkrimtarit dhe raporti i tij me gjuhën. Kështu në veprën e Kutelit paraqesin më shumë interes sllavizmat e greqizmat që kanë karakter të theksuar krahinor (të cilat në çdo rrafsh diskutimi janë më të shumta në numër), se sa ato që i kanë kapërcyer këta kufij; ato dalin si emërtime të dukurive, sendeve, gjallesave, të cilat nuk njihen në krahina të tjera dhe prandaj realizojnë ngjyrosjen e koloritit mjedisor.

24. Vepra e Kutelit shquhet për një sistem të pasur e tepër të larmishëm të figurshmërisë, bota shqiptare jepet në lëvizje me figurshmëri konkretizuese, e kombinuar me imazhe dëgjimore e imazhe pamore piktoriale. Ai arrin të shfrytësojë maksimalisht mjetet e stilistikës gjuhësore në të gjitha rrafshet, si në atë fonostilistik, leksikostilistik, sintaksostilistik dhe semantostilistik. Kuteli shquhet për krijimin e mjeteve të reja me ngjyrim stilistik, si dhe vendosjen e fjalëve të përdorura më parë në kontekste të reja e origjinale; si mjeshtër i fjalës, ai zbulon vlerat e saj duke u mbështetur në gjithë përdorimet e mundshme, në gjithë leksematikën dhe lidhjet e shumta sintagmatike. Një mjet i rëndësishëm me të cilin Kuteli rrit figurshmërinë janë neologjizmat stilistikorë, ku dallohen neologjizmat foljorë të krijuar me prapashtesën *-o*, neologjizmat ndajfoljorë të krijuar me prapashtesat *-çe, -thi, -as, -shëm*, mbiemrat të formuar me prapashtesat *-të, -or, -ake* dhe emrat abstraktë të formuar me prapashtesat *-ri, si, -esë*, si dhe mbiemrat e përbërë. Figurshmëria e neologjizmave-përftesa zbulohet më mirë brenda kontekstit të caktuar të përdorimit, si; *brazdoj liqerin, zë mbrëmësor, lingëri fjalësh* etj. Leksikut të figurshëm i shtohen dhe disa përftesa që krijohen mbi mbiemrin **i(e) madh(e)**: *fjalëmadhe, fustanmadh, kokëmadh, kusurmadh lavdimadh, nakarmadh, nazemadhe, poteremadh, romuzmëdhenjtë, sqimëmadhe, trirëmadhe, xhybemadh, zemërmadh, zulmëmadh, zëmadh* etj.

Në veprën e Kutelit kanë prani të ndjeshme fjalët e zbuluara, si dhe emrat në shumës, të krijuar jashtë normës letrare, me anë mbaresash të tilla, si *-ra*, të cilat shquhen për ngjyrimin e tyre shprehës emocional.

25. Kuteli ka aftësinë t'u prishë fjalëve lidhjet e tyre të qëndrueshme e njëherazi t'u krijojë atyre mundësinë që të futen në marrëdhënie të reja fjalësore, me qëllim që fjalët të shpërfaqin me shumë forcë e shumanësi mendim dhe lidhjet e tyre të tingëllojnë të reja, të freskëta, të befta. Struktura dygjymtyrëshe është rrafshi minimal, ku realizohet sintagma metaforike. Në to

arrihet me anë të disa procedurave thjeshtuese të elementëve jo të domosdoshëm për këto kuptime. Kështu, një mori dukurish të rëndomta e prozaike, në mekanizmin tepër veprues të metaforës së tij estetizohen, shndërrohen në të bukura dhe zgjerojnë leksematikën e gjuhës. Kuteli dallohet, veçanërisht, në krijimin e metaforave - emra, prej të cilëve më së shumti metaforizohen emrat e parmë dhe shumë më pak ata të prejardhur. Sintagmat emërore me marrëdhënie përcaktore, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të sintagmave në prozën e Kutelit, formohen nga lidhja e figurshme e dy gjymtyrëve të cilat janë: emër + emër në rasën gjinore: *dikeli i skllavërisë, bandrat e robërisë*; emër + emër në rasën rrjedhore: *breshër heshtash, hamullimë zërash* etj., emër + mbiemër: *mendim i sapozgjuar, gojëdhënë e mjegullt*. Vlera stilistike të shtuara sjellin në prozën e Kutelit, veçanërisht sintagmat metaforike në të cilat mbiemri është një fjalë e përbërë: *fjalë gjëmëmadhe, natë lemerimadhe* etj.

Përsa i përket sintagmave metaforike me lidhje kallëzuesore, për nga sasia zënë vendin e parë; folja këtu mund të jetë në veprorë jokalimtare ose joveprore pësore, bashkim ku semat e emrit nuk përputhen me kufizimet përzgjedhëse të foljes: *lëpin era, qesh fati, grisët nata, gurgullon urrejta, mprehet vdekja, loton mëngjesi* etj. Metaforat emër+ folje mbizotërojnë te Kuteli për nga denduria e përdorimit të tyre, ndërsa duke i parë në tërësi, del se ato vishen me domethënie e nënkuptime dhe aktualizohen e shpjegohen brenda tërësisë së organizimit letrar.

26. Krahasimi para së gjithash, shërben për ta bërë më konkrete e më të qartë domethënien dukurive dhe objekteve, por te Kuteli ai nuk ka vetëm funksion logjik, ai shërben edhe për t'u shprehur më me ndjenjë dhe më estetikisht përmes krijimit të raporteve të reja midis objekteve e dukurive nga çdo fushë e jetës, shërben për të karakterizuar personazhet, pamjen fizike, gjendjen shpirtërore, psikologjike, shërben për të përshkruar mjedise etj. Në veprën e Kutelit mbizotërojnë krahasimet e thjeshta dhe për t'i ndërtuar përdoren kryesisht emra konkretë, çka nxit përfytyrimin e lexuesit; gjithashtu, mbizotërojnë krahasimet të ndërtuara sipas gjedheve të njohura të ligjërimit të përditshëm dhe të ligjërimit popullor, të cilat i gjejmë si në gojën e autorit edhe në gojën e personazheve, në përputhje me idetë e parashtruara në prozën e Kutelit. Natyrshëm në strukturën e tyre gjenden shumë fjalë dialektore, krahinore si dhe të leksikut të përgjithshëm, si të tilla janë: *si uthull i thartë, si s'ka mbi dhe, si Mançja i Gorricës, si të ketë pirë verë, si qengj* etj. Nuk mungojnë krahasimet vetjake emocionale të autorit, të poetizuara përmes fjalëve të përzgjedhura dhe ndërthurjes së mjeteve e mundësive shprehëse gjuhësore të cilat e afrojnë prozën e tij me tekstin poetik: *si gjethëza e ahut në pranverë, si muzgu kur err botën* etj. Karakteristikë vetjake e tij mbetet edhe grumbullimi i disa krahasimeve pranë njëri tjetrit, dhe ndërlidhja e tyre me figura të tjera, si epiteti, metafora etj, çka i çon vlerat që ato mbartin në shkallën më të lartë.

27. Epiteti përbën një figurë tjetër me vlerë gjuhësore dhe letrare që ndikon dukshëm në rritjen e shprehësisë dhe figurshmërisë së prozës së Kutelit, sidomos kur është i lidhur me figura të tjera, veçanërisht me metaforat dhe krahasimet. Në veprën e tij gjendet një shumëllojshmëri epitetesh për nga forma, përbërja, volumi etj., por së pari bien në sy dy lloje: epitete të rëndomta dhe epitete të rralla të cilat mbajnë vulën e tij vetjake. Duke u përpjekur të zbulojë anë të reja të dukurive të natyrës, të sendeve e të botës njerëzore, ai krijon lidhje të pazakonta e befasuese, stilema të goditura të cilat krijojnë vlera në rrafshin semantik e stilistik, disa nga këto janë: *lis vishkullor, nuse freskoshe, zë mbrëmësor, vrap i vrulltë, kithi i krirtë, sy i qielltë, shtat i eshkët* etj. Së dyti, epitetet paraqiten të larmishëm dhe në pikëpamje të fjalëformimit, ku më me interes janë epitetet e shprehur me mbiemra jo të pamë sepse ata shprehin figurshmëri më të lartë. Shprehësia e tekstit rritet dhe karakterizimi artistik bëhet më i plotë në rastet kur Kuteli përdor një varg epitetesh të përbërë dhe kur epiteti shoqërohet me rend të përmbysur. Te Kuteli përbëjnë një grup të konsiderueshëm, ndoshta më të madhin, mbiemrat e leksikut popullor.

28. Kuteli përdor me sukses frazeologji, bashkime të lira fjalësh dhe frazeologji letrare të larmishme si në përmbajtje dhe në tipologji. Vetë gjerësia përmbajtësore e veprës, shtrirja e saj tematike dhe kohore kushtëzon një frazeologji të pasur në ide, në figuracion dhe në ngjyrimë të shumta emocionuese dhe vlerësuese, aq sa është krejtësisht e pamundur të gjesh faqe të veprës së tij pa praninë e tre-katër frazeologjizmave, ndërkohë që në shumë prej tyre mund të gjesh edhe mbi dhjetë të tilla. Frazeologjizmat hasen jo vetëm në gojën e personazheve, por edhe në gojën e autorit; kjo në funksion të një harmonizimi gjuhësor të veprës. Ato janë në funksion të tipizimit të personazheve të cilët janë jo vetëm të shumtë në numur, por ç'është më kryesorja, me profile të ndryshme shoqërore. Frazeologjizmat që ata përdorin në bashkëbisedim me njëri-tjetrin, apo në bashkëbisedim me veten, ndihmojnë drejtpërsëdrejti në zbërthimin e identitetit të tyre, se kush janë, prej cilës shtrese shoqërore vijnë, ç'eksperienca jetësore mbajnë mbi supë, çfarë formimi arsimor e kulturor kanë etj. Frazeologjizmat në veprën e Kutelit shërbejnë gjithashtu, edhe për tipizimin e mjedisit, ku personazhet jetojnë dhe veprojnë, si dhe në funksion të krijimit të vlerave të veçanta stilistikore.

29. Kuteli shquhet për përdorimin vetjak dhe për risitë që sjell në përdorimin e njërive frazeologjike, në funksion të synimeve përmbajtësore dhe estetike. Ai shkon deri në krijimin e njërive të reja frazeologjike.

Ndryshimet që pëson frazeologjia në veprën e Kutelit janë të dyllorshme: në strukturë dhe në semantikë, por të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ndryshimet strukturore janë rrjedhojë e risive semantike, si rezultat i përdorimit të tyre stilistik e funksional.

Risitë semantike strukturore të frazeologjisë gjuhësore në veprën e Kutelit, rrjedhin në radhë të parë, nga veçoritë e lidhjeve të brendshme të

njësive frazeologjike, në të cilat vihet re një përpunim i shumëllojtë në përmbajtje dhe në formë. Dukuritë më interesante janë: “rrudhja”, e cila është në funksion të rritjes të ritmit të ligjëritimit dhe ekonomizimit gjuhësor; ndryshueshmëria leksikore e sinonimike, e cila çon në lindjen e nuancave kuptimore, deri në lindjen e njësive të reja frazeologjike.

Proza e Kutelit dallohet dhe për shumësinë e lidhjeve leksiko-sintaksore të njësive frazeologjike përmes të cilave zbulohen më mirë vlerat e tyre stilistike emocinuese.

30. Kuteli tregohet i kujdesshëm edhe në strukturimin e lidhjeve të jashtme të njësive frazeologjike. Kështu, kontaminimi, shkrirja e dy a më shumë njësive frazeologjike në një sintagmë të vetme, e ngjesh dhe e rrit forcën shprehëse të saj.

Çiftëzimi i dy njësive frazeologjike sjell vlera si në aspektin strukturor, ashtu edhe në atë kuptimor. Ato e ngarkojnë fjalinë me ngjyresa të theksuara vlerësuese pozitive ose negative. Në funksion stilistik, diferencues janë edhe vargjet dhe vargëzimet frazeologjike.

Në prozën e Kutelit, përveç të tjerash, shfaqet shpesh edhe dukuria aktualizimit të njësive frazeologjike e cila siç e përkufizon Ali Jashari është “*pranëvënia e fjalëve të tjera përpara, në mes ose pas gjymtyrëve të togfjalëshit frazeologjik, për ta lidhur më ngushtë me situatën konkrete të ligjëritimit, me idetë e ngjarjet, me personat e çështjen për të cilën shkruhet, me kohën a vendin për çka bëhet fjalë në kontekstin e dhënë.*”⁹⁹ Aktualizuesit, përsa i përket pozicionit i gjejmë në fillim, në mes, në fund dhe përsa i përket sasisë mund të jenë një dhe më shumë se një.

31. Njësitë frazeologjike e kanë në thelbin e tyre figurshmërinë, prandaj, në veprën e Kutelit, ato shërbejnë si mjete për të ndërtuar tekste të figurshme tekste, ku spikasin më fort vlerat stilistike. Dhe në këtë pikë nuk mungon origjinaliteti i Kutelit i cili krijon modele të krijimit të teksteve të figurshme duke pasur në qendër njësitë frazeologjike dhe duke i plotësuar ato me mjete të tjera, siç janë aktualizuesit, identifikatorët semantikë, perifraximet etj. Përsa i përket mënyrave të organizimit dhe ndërtimit të teksteve të figurshme, Kuteli shfaq shumëllojshmëri tipash: Me anë të perifraximit ose përsëritjes së gjymtyrës vatër të njësisë frazeologjike si edhe zgjerimit me fjalë e togfjalëshja, me anë të lidhjeve të reja leksikore të vatrës semantike me anë të lidhjeve të reja leksikore të vatrës semantike, duke ngërthyer disa njësi njëherësh të cilat nuk jepen në formën e tyre të plotë, tekste të figurshme që ndërtohen duke përdorur krahas njësive frazeologjike edhe togje të lira si identifikues të tyre semantikë. Në tekstet e figurshme frazeologjike gjenden të ndërthurura njëri me tjetrin rrafshi i drejtpërdrejtë dhe rrafshi i figurshëm dhe ndodh që rolin e identifikuesit semantik ta luajë një shprehje përgjithësisht proverbiale që vendoset në krye të tekstit.

⁹⁹ Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjëritimin e shkruar*, Korçë 2000, f. 117.

Vepra letrare e Mitrush Kutelit vazhdon dhe do të vazhdojë të mbërthejë ndjenjat dhe mendjet e lexuesve të thjeshtë dhe lexuesve të kualifikuar, mendjet e shkrimtarëve dhe gjuhëtarëve. Ajo vazhdon dhe do të vazhdojë të na flaës për bukuritë e shqipërisë e të shpirtit shqiptar dhe të na bëjë të dashurohemi pas tyre, ajo do të vazhdojë të jetë një shenjë e zotit se sa e pasur, se sa e fisme, se sa zonjë, se sa e lashtë dhe moderne është gjuha shqipe. Ajo nuk është një rrëkezë, nuk është një përrua, ajo është një lumë i madh në lëmin gjuhësor e artistik, rrjedha e të cilit ka qenë dhe do të jetë e pandalshme dhe e pamortshme.

PROPOZIME

Duke u mbështetur te puna e bërë dhe në përfundimet e arritura nga ky studim propozojmë:

T'i jepet më shumë rëndësi ndërmarrjes së studimeve me karakter gjuhësor për shkrimtarët bashkëkohorë.

Të ndërmerren studime të tjera krahasuese përse i përket mënyrës origjinale të përdorimit të gjuhës nga autorë të ndryshëm bashkëkohorë.

Në librat e letërsisë t'i lihet më shumë hapësirë analizës së mjeteve gjuhësore të përdorura nga shkrimtarët në veprat e tyre.

Për vetë bollshmërinë e materialit, mund të ndërmerren studime të mëtejshme për çështje të veçanta për veprën e Kutelit, si: paradigma sinonimike dhe antonimike, leksiku i figurshëm, rrjedhat fonologjike, frazeologjia dhe lidhjet e lira etj.

Të përfshihen në fjalorët e shqipes një numër i konsiderueshëm dialektalizmash dhe fjalëkrijimesh të pranishme në prozën e Kutelit, sepse sjellin pasurim të mëtejshëm të shqipes.

V. SHTOJCA

5.1. Fjalorth toponomastik i veprës së Mitrush Kutelit

Atikë
Ballkan,
Bardhonë
Bari
Beos
Besarabi
Boston
Brailë
Bukuresht
Bukuresht
Bullgari
Çamëri
Çëravë
Çikago
Dardani
Dashareti
Dekunë
Delfi
Deti i Zi
Dibër
Dimal
Domosdovë
Driloni
Drim
Drimi i Madh
Drimi i Vogël
Drimonë
Drin
Durrës
Dyrakionë
Dyrrah
Egjipt
Enkeli

Epidamnos-Dyrakionë
Epir
Faltorja e Thanës
Filat
Fokshan
Follorinë
Fusha e Domuzovës
Fusha e Maliqit,
Galac
Gjakovë,
Gjirokastër
Gjurgjok
Gorë
Gostivar
Grabovicë
Greqi
Gureshtë
Gurët e Gjetë
Guri i Bufit
Guri i Dyrakionës
Guri i Prerë
Hani i Zarçes
Heladë
Hush
Itali
Jash
Kaliforni
Kalisht
Kanada
Karakurt
Karavllahi
Kerakë
Kolonjë
Konstancë
Korçë
Korint
Korkyrë
Kostur
Kotorr
Krajovë
Kroi i Madh
Kroi i Vogël
Kulmi i Malit të Thatë

Laveshtë
Lesbos
Librazhd
Liqer i Bardhë
Liqeri i Dritës
Llampallankë
Llëngë
Lubanisht
Lumi i Aosës
Lumi Shkampos
Lyhniđë
Lynkesta
Malet e Dasharetisë
Malet e Eordisë
Malet e Kandavisë
Malet e Pirustisë
Malet e Skampos
Mali i Burrnit
Mali i Pëllumbave
Mali i Thatë
Mali i Thatë
Maliq
Manastir
Metonë
Mitrovicë
Mokër
Mollosi
More
Ndënkodër
Ohër
Olimp
Oliny
Ollteni
Omezh
Pandelimon
Pejë
Pelagoni
Pellagonia
Persi
Peshkëpi
Poradec
Potide
Prahovo

Prishtinë
Qafa e Thanës
Qostenxhë
Rëmenj
Rusçuk
Selenik
Shkëmbisht
Shkodër
Shkumbin
Shkup
Shqipëri
Spartë
Stamboll
Starovë
Strugë
Sul
Taulanti
Tebë
Tërgovishte
Tetovë
Thationë
Thesali
Tiranë
Tullçë
Tuna
Turqi
Ura e Çernavodës
Urakë
Vasllui
Velitërnë
Vëllkov
Vërdovë
Vermosh
Vllahi
Vllahoklisurë
Vlorë
Voskopojë
Xhurxhu
Xhurxhu
Zagorçan
Zërvaskë

5.2. Fjalorth onomastik i veprës së Mitrush Kutelit

Agapicë
Agarista
Agroni
Ahura Mazda
Akamios
Akiram
Alcest
Alçibiad
Aleksandër
Alkman
Aminda
Amua i Lynkestës
Andon
Andonia
Antigona
Anylë
Aplon
Apostol
Aqathoni
Arisodori i Spartës
Aristodem
Aristomak
Arriba
Artana
Artemidori i Ambrakisë
Ashemi i Mëllinjës
Asopari
Atalanta
Bajo Bickali
Balibardh
Balobaton
Bardhua i Llambores
Bardhyl
Batuni
Batush
Beso
Burrni
Cakropidi,

Ceco
Çili
Çuli
Danal
Dardo
Dardo i Gureshtës
Dasha
Dastan
Delo
Destan
Dial
Dibman
Ditan
Dritana
Dullëu
Dyndar
E Bukura e dheut
Edip
Efrem Gjini Elbasani
Eleftorofi
Elektra
Elihrisi i Potidesë
Enkele
Eno i Malabanit
Epokil
Eskil
Eteokël
Etleva e Enkelisë
Etuta e Brezos
Fato
Fedra
Fejzo Fetahu
Fejzo Griba
Fije
Filipi i Maqedonisë
Filotas
Frombos
Garabet Xhenabetiani
Genth
Gjemth
Gjon
Goldgeldi
Gole

Gongila
Graboni i Bardhonës
Hajdukian
Hanibal Pungureanu
Dellakurmezish
Harmonia
Hermes
Herodot
Hesiod
Hipotheus
Hysen
Hysen Kraposhniku
Hysen Radoica
Ibiari
Ici Matua
Ilçe Kacarefi
Ilçe Kocarefi
Iponat
Istrefi i Zyberit
Izmini
Januka e Bardhë
Januka e Bardhë
Jokastë
Kadmi,
Kajua i Babjenit
Kapllan
Kapo
Kleftopol
Kliti
Koço
Kodrin
Kodro
Konstantinos Spiridhonopulos Karavllahidhis
Kopeni i Lyhnidës
Korrangi
Kostandin
Kostil
Ksenodul
Kuma Maro
Lahonë
Lato
Lena
Licëficëmicë

Llambi
Llazi
Loli
Lykodor
Lynkestian
Mahir Beu
Malaban
Mardok
Markua i Stefan Palos
Mbreti i Verdhë
Medea
Megaklenë
Mëhill Gjongjoni
Menda
Mërtir
Mërtir Bukëvala
Mërtir Sojaxhiu
Miellushell Hocu
Miron
Mitropapa
Moni i Dhorës
Monun
Muj
Musko
Naim Frashëri
Naço
Ndini
Neacë Strungëreacë
Nëna e Vatrës
Neoptolemi
Nevola
Ngjelino
Nikolla Naço
Nuni i Zades
Ohan
Ohanian
Olimbi
Oman Çota
Omer i Ri
Orest
Ormuz
Paji Harambash
Pandeli i Zhurkës

Pangallosi
Pangallozi
Papallazo
Parmenioni i Maqedonisë
Perdika i Maqedonisë
Perëndi e Mërisë
Pilipidi i Keferonës
Pilo
Pindar
Pleurat
Pleurati i Lyhnidës
Polinik
Postol Cardoli
Postoli i Shkëmbishtit
Prema
Promete
Pungëshevsku
Qerim
Qose
Radu Llupu
Rali
Redving Minesota
Rinë Katerinëza
Risto
Ristua i Ristos
Sabatar
Sapho
Selim
Selman Gjongjoni
Shahin Matraku
Shasho
Shloim Xhurxhuvianut
Sillogu
Simoni i Ndinit
Simonidi i Amorgosit
Sisir
Skenobardhi i Menzanës
Smail Dërdusha
Sokol Halili
Sotiri i Nushkës
Spirua i Dhamit
Sulltan Hamidi
Sulo

Sumbo
Surdin
Taqe Agapaqe
Tatua i Brygos
Teutan
Thamir
Thana
Themistokli
Thuqidhidhi
Tike
Tiresias
Titan
Trëndelino
Trikup
Tushi
Tyril
Vangjeli i Bellkamenit
Vasil
Vendan
Vendani i Bardhonës
Xexua i Xexos
Xheladin
Xhim Xhimsoni
Xhixhe
Xhon Tomi
Xinxifillo
Xëme e Alarupit
Ymer Aga
Zaim
Zalmoks
Zef
Zenel
Zeus
Zonja e Burimeve
Zoti i Dodonës
Zoti i Dushkut

Bibliografia e shfrytëzuar

Alberto Sobrero, *Una societa fra dialetto e lingua – appunti di italiano contemporaneo*, Milella, Lece, 1975.

Aleksandër Xhuvani, “Kompozitat”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

Ali Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Kotti, Korçë, 2000.

Ali Jashari, *Përsiatje për gjuhën shqipe*, Kotti, Korçë, 2003.

Androkli Kostallari, “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

Androkli Kostallari, “Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

Androkli Kostallari, “Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

Artan Haxhi, *Gjuha e Gjergj Fishtës*, Shkodër, 2003.

Aurel Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Tiranë 1995.

Artan Goga, *Vështrim mbi disa sintagma të figurshme në letërsinë artistike*, Studime filologjike 3-4, 2004.

Begzad Baliu, *Onomastikë dhe identitet*, Era, Prishtinë, 2012.

Begzad Baliu, *Onomastika e Kosovës*, Era, Prishtinë, 2008.

Eduart Sapir, *Gjuha – hyrje në studimin e ligjërimin*, Prishtinë, 1980.

Emil Lafe, *Vendi i orientalizmave ndër huazimet e shqipes*, Studime filologjike, 1-4, Tiranë, 1993.

Emily A. Schultz, Robert H. Lavenda, *Antropologia culturale*. Zanichelli, Bolonjë, 1999.

Emine Sadiku, *Kujdesi për shprehësinë e fjalëve*, Gjuha jonë, 4, Tiranë, 1987.

Engjëll Angoni, “Onomatopetë dhe mundësitë e tyre fjalëformuese”, në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II”, 1975.

Eqrem Çabej, “Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor”, në “Konferenca kombëtare e studimeve etnografike”, 28-30 qershor, Tiranë, 1977.

Ferdinant Leka, Sofika Morcka, “Zhvillimi dhe psurimi i terminologjisë pas çlirimit”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II”, Tiranë, 1972.

Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980 (A. Kostallari, J. Thomai, Xh. Lloshi, M. Samara, J. Kole, P. Daka, P. Haxhillazi, H. Shehu, F. Leka, E. Lafe, K. Sima, Th. Feka, B. Keta, A. Hidi).

Francesco Coco, *Introduzine allo studio della dialettologia Italiana*, Patron Editore, Bologna, 1977.

François Laplantine, *La description ethnographique*, Armand Colin, 2006.

Giorgio Raimondo Cardona, *Introduzione all' etnolinguistica*, UTET Università, Torino, 2010.

Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001.

Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, ShBLU, Toena, Tiranë, 1999.

Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Nga drejtshkrimi të shkrimit profesionale, Toena, Tiranë, 2008.

Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, UFO Press, Tiranë, 2009.

Hajri Shehu, *Vlerat potenciale të leksikut popullor për gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime filologjike, 2, Tiranë, 1987.

Jani Thomai, “Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjive të shqipes”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë 1972.

Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2001.

Jani Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë së shqipes*, Studime filologjike, 1975/3.

Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.

Jani Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shkenca, Tiranë, 1999.

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, ShBLU, Tiranë, 1999.

Jani Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989.

Jani Thomai, *Teksti dhe gjuha*, ShBLU, Tiranë, 1992.

Jani Thomai, *Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*, Toena, Tiranë, 2006.

Jorgji Gjinari, “Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II”, Tiranë, 1972.

Jorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 2003.

Kostaq Cipo, “Rreth disa kompozitave”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

Marisa Napoli, *I linguaggi della retorica*, Zanichelli, Bolonja, 1999.

Mehmet Gjevori, *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1980.

Miço Samara, “Mbi antonimet në togfjalësha dhe mbi antoniminë e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën shqipe”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.

- Miço Samara**, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985.
- Niko Mustaka**, *Shprehje popullore nga rrethi i Korçës*, Tiranë, 1989.
- Nasho Jorgaqi**: *Rrëfimet e Mitrush Kutelit*: Tregime të zgjedhura, Tiranë 1972.
- Nikolas Laurent, *Initiation a la stylistique*, Hachette, Paris, 2001. ?
- Pierre Fontanier**, *Le figures des discours*, Flammarion, Paris, 1968.
- Qemal Murati**, *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.
- Richard Bauman, Joel Sherzer**, *Explorations in the Ethnography of Speaking*, Cambridge University Press, 1977.
- Roman Jakobson**, *Essais de linguistique generale*, Paris, Editions de Minuit, 1963. ?
- Ruqaiya Hasan**, *Linguistics, language, and verbal art*, Oxford University Press, 1989.
- Sali Bashota**, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Prishtinë 2007.
- Shefkije Islamaj**, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2000.
- Shefkije Islamaj**, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 4, 1968.
- Shezai Rrokaj**, *Çështje të gjuhës shqipe I*, Albatros, Tiranë, 2007.
- Shezai Rrokaj**, *Çështje të gjuhës shqipe II*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2009.
- Sofika Morcka**, *Frazeologjia shqipe me gjymtyrë që emërtojnë pjesë të trupit të njeriut*, Studime filologjike, 4, 1979.
- Sokol Jakova**, *Parime të ndërtimit të figurave artistike në tregimin tonë*, Studime filologjike, 4, Tiranë, 1976.
- Valter Memishaj**, *Ushtrime për leksikologji e semantikë leksikore* (Botim i përmirësuar), Tiranë, 2012.
- Xhevat Lloshi**, “Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes”, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I”, Tiranë, 1972.
- Xhevat Lloshi**, *Shkrimtari dhe gjuha, Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*, Tiranë, 1976.
- Xhevat Lloshi**, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2005.
- Xhevat Lloshi**, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988.

Literatura artistike e vjelë

Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 1*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.

Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.

Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 3*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.

Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 4*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990